



KOMANDA E DOKTRINËS DHE STËRVITJES

REVISTA USHTARAKE

**Organ teoriko-shkencor
i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes**

Nr. 1/2014

Tiranë, prill 2014

Këshilli Botues i Revistës Ushtarake
Miratuar me Urdhër të Ministrit të Mbrojtjes Nr. 1304, datë 20.06.2013

Kryetar

Kolonel Ruzhdi Kuçi, Zëvendëskomandant i KDS

Anëtarë

Kolonel Dr. Ahmet Leka
Kolonel Prof. Asc. Dr. Agim Q. Sula
Kolonel Prof. Asc. Dr. Gëzim Mustafaj
Kolonel Prof. Dr. Kristaq Xharo
Kolonel (R) Prof. Dr. Pëllumb Danaj
Kolonel (R) Prof. Dr. Pajtim Ribaj

Shef i Degës së Botimeve

Nënkolonele Majlinda Sallaku

Redaktore

MSc. Silvana Markgjonaj

Faqosja

Teuta Mullisi

Përkthyes

Dr. Jaup Zenuni
MSc. Granit Zela

ISSN 2227-8133 (Print), ISSN 2227-8141 (Online)

Copyright © 2012 nga Qendra e Doktrinës (QD) të Komandës së Doktrinës dhe Stërviçjes).

Copyright © 2012 by the Center for Doctrine (CD) of the Albanian Training and Doctrine Command.

Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në Revistën Ushtarake janë tërësisht të autorit/autorëve dhe jo domosdoshmërisht pasqyrojnë politikën apo pozicionet zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm dhe Komandës së Doktrinës dhe Stërviçjes.

Autori/Autorët e shkrimeve të Revistës Ushtarake nuk do të jenë subjekt i ndëshkimit për shprehjen e lirë të qëndrimeve e pozicioneve të tyre individuale edhe sikur përmbajtja e tyre të mos jetë në përputhje me qëndrimet zyrtare të institucionit të mbrojtjes.

Njëkohësisht, autori/autorët mbajnë përgjegjësi për shtrembërimet e fakteve si dhe kopjimet e preferuara të krijimeve dhe mendimeve të autorëve të tjerë.

Ky botim i Revistës Ushtarake gjendet në website <http://www.tradoc.mil.al/>

Në rast se nuk mund të merrni informacionin që kërkontë në internet lutemi të kërkontë një kopje të tij në adresën: e-mail: revistaushtarake@aaf.mil.al ose qd@aaf.mil.al

Komanda e Doktrinës dhe Stërviçjes

Qendra e Doktrinës

Dega e Botimeve

Shtypur: prill 2014

PËRMBAJTJA

<i>Forca e besëlidhjes sonë me Aleancën Euroatlantike</i> _____	5
<i>(Mbajtur në ceremoninë e 5-vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO)</i> Edi Rama, Kryeministër i Shqipërisë	
<i>Objektivi ynë madhor, rivitalizimi i ushtrisë</i> _____	8
<i>(Mbajtur në ceremoninë e 5-vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO)</i> Mimi Kodheli, Ministër i Mbrojtjes	
<i>Nuk duhet të harrojmë se vlera jonë më e madhe gjithmonë do të jenë njerëzit</i> _____	10
<i>(Mbajtur në ceremoninë e 5-vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO)</i> Gjeneralmajor Jeronim Bazo, Shef i Shtabit të përgjithshëm të RSH	
RUBRIKA E PARË: Analiza, sinteza dhe vlerësime të sigurisë	
<i>Politika e sigurisë së NATO-s dhe ndikimi në politikën e sigurisë kombëtare</i> _____	13
Kolonel Editson Zarka	
<i>Procesi i ndryshimit-thelbi i transformimit i FA</i> _____	20
Kol.(R) Kanan Himaj	
<i>Nevoja e rishikimit të dokumentit të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë</i> _____	27
Nënkolonel MSc. Ardian Lulaj	
<i>Operacionet COIN dhe David Galula</i> _____	34
Nënkolonel Arian Rroshi Nënkolonel Vladimir Imeraj	
<i>Roli i rojës bregdetare shqiptare në mjedisin detar dhe ndikimi i anijeve cisternë gjatë procesit të ballastimit</i> _____	44
Kolonel MSc. Riza Zaja, MSc. Bledar Sakaj	
<i>Forcat speciale dhe ndryshimi i ambientit të luftimit konvencional në jokonvencional</i> _____	51
Kolonel Dritan Demiraj	
<i>Kultura Strategjike e SHBA-ve</i> _____	60
MSc. Lindita Mukaj Nënkolonel Arben Dhuli	
_____	3

<i>Roli veprues i doktrine ushtarake, në pasqyrimin e gjendjes moralo-psikologjike të ushtrisë</i> _____	70
Nënkolonel (R) Ajet Nuellari	

RUBRIKA E DYTË: Hapësira shqiptare dhe gjeopolitika

<i>Gjeopolitika - imperativ i elitave dhe politikave të larta</i> _____	85
Prof Dr. Pajtim Ribaj	

<i>Bashkimi për Mesdheun dhe gjeopolitika evropiane e Parisit</i> _____	96
MSc. Silvana Markgjonaj	

<i>Mendimi gjeopolitik në vendet gjermanishtfolëse</i> _____	109
MSc. Lah Nitaj, Prishtinë	

RUBRIKA E TRETË: Integrimi i ushtarakëve në rezervë dhe pension në shoqëri

<i>Një vështrim për pensionet e ushtarakëve shqiptarë në vite</i> _____	121
Nënkolonel (R) MSc. Xhemal Çangu	

<i>Angazhimi në shoqëri i ushtarakëve në pension</i> _____	135
Major Festim Alimadhi	

RUBRIKA E KATËRT: Punime historike

<i>Strategjia e “Shpagimit Masiv” si ndryshim i parë madhor në strategjinë bërthamore amerikane</i> _____	144
Gjeneralmajor Viktor Bërdo, Nënkolonel Dritan Stroni	

<i>Wilhelm zu Wied dhe Shqipëria</i> _____	163
Major Dr. Marenglen Kasmi	

<i>Aspekte të betejës së Lumës, nëntor 1912</i> _____	178
Kolonel (R) Sali Onuzi	

<i>Përmbledhje në anglisht</i> _____	188
--------------------------------------	-----

<i>Kujtesë për bashkëpunëtorët</i> _____	197
--	-----

*Forca e besëlidhjes sonë me Aleancën Euroatlantike**

Edi Rama
Kryeministër i Shqipërisë

Anëtarësimi i vendit tonë në NATO, më 1 prill 2009, shënon padyshim një ndër ato ngjarje që historia i numëron për rëndësinë e tyre krejt të veçantë. Përvjetori i pestë i anëtarësimit të Shqipërisë në NATO është rasti më i mirë, për të shprehur mirënjohjen e thellë ndaj të gjithë atyre që e mundësuan këtë arritje unike. E në radhë të parë, mirënjohja u përket të gjithë qytetarëve të këtij vendi, popullit shqiptar, që në harmoni me vokacionin e përhershëm evropian, mbështetën, në mënyrë plebishitare, projektin e integritit euroatlantik të vendit, duke u afirmuar kështu, pa asnjë ekuivok, njëri ndër kombet më euroatlantike, ndër ata që dolën nga robëria e perandorisë komuniste, pas rënies së perdes së hekurt.

E njëjta mirënjohje u përket padyshim të gjitha kombeve dhe qeverive të vendeve anëtare të NATO-s, që e mbështetën projektin e madh të integritit të Shqipërisë dhe mundësuan që siguria e Shqipërisë të shndërrohet edhe në një çështje të tyre. E po ashtu, mirënjohje e respekt të thellë meritojnë të gjithë ata shqiptarë, në Forcat e Armatosura, administratën shtetërore, shoqërinë civile, radhët e politikës pa dallim, që realizuan në praktikë reformat e mëdha, të cilat ishin parakusht për anëtarësimin. Pa dashur aspak që të klasifikoj shkallët e mirënjohjes sonë, të qeverisë shqiptare ndaj vendeve dhe qeverive mike dhe aleate, mendoj se një fjali krejt e veçantë mirënjohjeje ndaj popullit e qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës është e pashmangshme, sa herë që Shqipëria e shqiptarët do të gëzojnë ditë dhe data si kjo, apo do të reflektojnë e do të veprojnë për çështje të ekzistencës së tyre kombëtare.

Natyrisht që mirënjohja jonë ndaj NATO-s nuk kufizohet vetëm tek anëtarësimi. Mirënjohja shqiptare ndaj NATO-s lidhet ngushtë edhe me rolin jetik që kjo aleancë e madhe e lirisë luajti në shuarjen e luftërave të reja në Ballkan dhe posaçërisht, në lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Zgjerimi i hapësirave të lirisë në lindje të Evropës, pushimi i luftës, vendosja e paqes në Ballkan dhe liria e Kosovës mbeten një kontribut i pashlyeshëm i Aleancës, pas përballimit me sukses të plotë të Luftës së Ftohtë.

Duke bashkuar sigurinë tonë me atë të 27 vendeve të tjera të Aleancës së Atlantikut të Veriut, ne, shqiptarët, kemi realizuar investimin më të madh për sigurinë tonë kombëtare. Me nënshkrimin e Traktatit të Uashingtonit, vendi ynë është bërë pjesë e aleancës më të fuqishme dhe padyshim më të pathyeshme në historinë e njerëzimit. Garancia për sigurinë

*Fjalë e mbajtur në ceremoninë e 5-vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO.

tonë kombëtare ka mbërritur, kësisoj, në nivelet më të larta të mundshme dhe të pa imagjinueshme.

Duke u integruar në aleancën e madhe, Shqipëria është bërë, njëkohësisht, edhe pjesë e pandashme e përmbytjes dhe e shprehjes së botës së lirë, botës së vlerave të larta të demokracisë, lirisë dhe të drejtave njerëzore, ekonomisë së lirë dhe shtetit ligjor. Anëtarësimi në NATO e ka rritur, si kurrë më parë, rëndësinë dhe fuqinë politike të Shqipërisë si shtet, i cili tashmë është pjesë aktive e vendimmarrjeve më të rëndësishme për sigurinë, në rrafshin global. Të gjitha përparësitë e jashtëzakonshme që shoqërojnë praninë tonë në NATO janë, në të njëjtën kohë, pa më të voglin dyshim, edhe përgjegjësi po aq madhore për secilin ndër ne.

Me hyrjen në NATO, Shqipëria jo vetëm ka garantuar angazhimin e saj, por ka garantuar edhe angazhimin e të gjithë aleatëve të saj për të mbrojtur edhe ushtarakisht integritetin dhe pavarësinë e saj. Nga ana tjetër, Shqipëria është angazhuar ligjërisht për të kontribuar, në të njëjtën mënyrë, edhe për mbrojtjen e integritetit dhe të pavarësisë së çdo vendi aleat me të, ashtu sikundër, edhe për mbrojtjen e paqes, lirive dhe të drejtave kudo ku kjo aleancë e sheh eventualisht të bëhet e nevojshme.

Përgjegjësia për të mbajtur edhe barrën e të tjerëve përbën, padyshim, një ndër arsyet për të qenë sot krenarë për Shqipërinë, por dhe një ndër detyrimet e jashtëzakonshme, për nga serioziteti, të vendit tonë gjatë historisë së tij. Po ashtu, mbajtja e barrës përkatëse në të gjithë spektrin e angazhimeve operationale të NATO-s kudo në botë, është sot pjesë përbërëse e detyrimeve të vendit dhe e detyrimeve tona ndaj vetë vendit. Mund të pohohet me krenari, në këtë pesëvjetor të shënuar, se Shqipëria ka plotësuar dhe vazhdon ta plotësojë, me përgjegjësi të plotë dhe me sukses, çdo pjesë të përgjegjësisë së saj në gjirin e kësaj Aleance të madhe.

Përgjegjësitë e vendit tonë në kuadër të Aleancës nuk janë thjesht dhe vetëm ushtarake. Dhe këtë, secili nga ne nuk duhet ta harrojë, sepse, në radhë të parë, Shqipërisë i kërkohet të përmbushë me dinjitet, aspirata e pritshmëri në rrafshin politik, nëpërmjet realizimit të standardeve më të larta të demokracisë e shtetit ligjor dhe të ekonomisë së tregut të lirë. Janë këto standarde dhe respekti për parimësinë dhe për vlerat e demokracisë, që është në themelin e kësaj Aleance të madhe ushtarake. Angazhimi ynë për t'i përmirësuar më tej këto standarde, në mënyrë të vazhdueshme, këmbëngulëse dhe të pandalshme dhe për t'i dhënë vendit tonë prestigjin më të lartë në Evropë dhe në botë, duke i dhënë po ashtu edhe seriozitetin më të lartë në tryezën e vendimmarrjes së madhe të NATO-s, mbetet gjithnjë prioritar.

Jetojmë në një botë që provon çdo ditë se sa largpamëse ka qenë ideja për t'i dhënë jetë kësaj Aleance dhe se sa aktuale është çdo përpjekje për ta forcuar dita-ditës këtë Aleancë. Zhvillimet e fundit në Ukrainë, ndër të tjera, shërbyen edhe njëherë tjetër, për ta sjellë para syve tanë, rëndësinë e jashtëzakonshme të vlerave dhe parimeve të botës, së cilës i kemi dhënë përkatësinë dhe padyshim rëndësinë e çështjes së sigurisë, si një çështje që është çdo ditë në rendin e ditës, sado e sigurt që të duket bota nga hapësira ku ne jetojmë dhe nga këndi prej ku ne e shohim atë. Turbullirat e rrezikshme në një vend si Ukraina, shkëputja prej andej e gadishullit të Krimesë nga Rusia, ndryshimi arbitrar i kufijve shtetërorë, ilustrjnë, në mënyrën më

brutale, domethënien e madhe të përpjekjes për siguri dhe nga ana tjetër, të mungesës së sigurisë nëpër botë.

Ukraina është një tjetër provë, më e freskëta e për këtë dhe më e dhimbshme e ditëve tona, që tregon se siguria nuk mundet dhe nuk duhet të zbresë kurrë më poshtë nga kreu i përparësive të botës sonë, të botës së kësaj Aleance të madhe dhe padyshim të një shteti që është pjesë e kësaj Aleance, siç është dhe Shqipëria e vogël. E ndërgjegjshme për këtë, qeveria e Shqipërisë, krahas inovacionit dhe progresit të vazhdueshëm, e ka sigurinë, moton qendrore të përpjekjes së saj për të ecur më shpejt drejt rilindjes, në interes të garantimit të sigurisë në të gjitha përmasat e saj, nga siguria më e vogël, por po kaq e rëndësishme e të përditshmes së çdo individit në raport me shtetin e vet këtu në Shqipëri, tek siguria më e madhe, por po aq e rëndësishme në cilësinë e vet, e shtetit tonë krahas për krahas me të gjitha shtetet e Aleancës ku jemi pjesë e po punojmë për realizimin e një programi të tërë transformimi rrënjësor të instrumenteve të sigurisë kombëtare.

Hartimi i dokumentit të parë të strategjisë së sigurisë kombëtare, pas anëtarësimit të vendit tonë në NATO; reforma e thellë ligjore dhe strukturale e institucioneve të sigurisë; modernizmi i vazhdueshëm i forcave të armatosura, policisë së shtetit, shërbimeve inteligjente dhe strukturave të tjera ligjzbatuese janë sot, prioritete të dorës së parë dhe janë në rendin e ditës së punës sonë me mish e me shpirt, si qeveri e Shqipërisë për një Shqipëri evropiane, për një Shqipëri serioze dhe gjithnjë të përgjegjshme në tryezën e madhe të vendimmarrjes së Aleancës së Atlantikut të Veriut.

Javën që shkoi presidenti i SHBA-ve *Barack Obama* tha: “Situata në Ukrainë na kujton se *Liria nuk është falas (Freedom is not free)*”. Kjo thirrje lakonike ndeshet shpesh, gjatë historisë, në fjalime e në refrene këngësh. Ajo duket se kërkon të na kujtojë se të gjithë ne duhet të jemi të gatshëm të paguajmë çmimin e lirisë sonë, në çdo përmasë dhe nga çdo kënd. Lirinë, askush, asnjë individ, asnjë komunitet, asnjë popull dhe padyshim edhe një Aleancë e madhe si kjo, nuk mund ta ketë falas.

Përvjetori i 5-të i anëtarësimit të vendit tonë në NATO na kujton gjithashtu se, për fatin tonë më të madh, ne tashmë e kemi bashkuar të ardhmen me popuj të lirë, me popuj të mëdhenj, me popuj që çmimin e lirisë e kanë paguar dhe e paguajnë, pa as më të voglin ngurrin, si çmimin e mirëqenies dhe të sigurisë për të sotmen dhe për brezat që vijnë. Pjesëmarrja në këtë Aleancë e bën barrën tonë shumë më të lehtë, sigurinë tonë shumë më të lartë, çmimin e lirisë sonë shumë më të merituar. Por megjithatë, liria nuk mund të jetë falas.

E në këtë përvjetor të anëtarësimit tonë në NATO, gjaku i dëshmorit tonë, kapiten Feti Vogli dhe gjaku i shumë djemve dhe vajzave ushtarakë dhe ushtarake, në gjirin e forcave aleate, në frontet ku kjo Aleancë lufton për lirinë dhe sigurinë, janë dëshmia më kuptimplotë e çmimit të lirisë, por janë dhe prova më e padiskutueshme e forcës së besëlidhjes sonë të madhe euroatlantike.

Gëzuar 5 vjetorin e pjesëmarrjes në NATO, në Aleancën e madhe euroatlantike të popujve të lirë, të popujve që çdo ditë paguajnë çmimin e lirisë së tyre, për mirëqenien e tyre dhe për sigurinë e gjeneratave të tjera dhe të botës ku jetojmë!

*Objektivi ynë madhor, rivitalizimi i ushtrisë**

Mimi Kodheli
Ministër i Mbrojtjes

Është nder dhe privilegj për mua t'ju drejtohem sot, në përvjetorin e 5-të të anëtarësimit të Shqipërisë në Aleancën e Atlantikut të Veriut. Pesë vite janë një periudhë relativisht e shkurtër për historinë 65-vjeçare të NATO-s, por sot është e rëndësishme të përmend faktin se vendi ynë, menjëherë pas ndryshimit të sistemit politik, shprehu vullnetin për t'u rilidhur me botën euroatlantike. Kështu, në qershor të vitit 1992, Shqipëria u pranua si anëtare e Këshillit për Bashkëpunim të Atlantikut të Veriut, një mekanizëm ky i NATO-s për të zgjeruar bashkëpunimin edhe me vendet që, pak kohë më parë, gjendeshin të rreshtuara kundër Aleancës.

Vetëm një vit më vonë, vendin tonë do ta vizitonte Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, *Manfred Wörner*, i cili do të deklaronte në kuvend se NATO do ta mbështesë Shqipërinë me qëllim modernizimin e Forcave të Armatosura, të cilat do të aftësoheshin jo vetëm për të siguruar vendin, por edhe për të garantuar sigurinë euroatlantike, së bashku me forcat NATO-s. Pas angazhimit politik-strategjik në Këshillin e Bashkëpunimit të NATO-s, Shqipëria u bë pjesë edhe e një nisme tjetër që e angazhonte atë edhe në planin politiko-ushtarak, Partneritetit për Paqe. Shumë prej nesh kujtojnë angazhimet e para, sado modeste, të forcave tona jashtë vendit, pikërisht nën ombrellën e kësaj nisme.

Bashkëpunimi i shkëlqyer midis qeverisë dhe shoqërisë shqiptare me strukturat aleate të NATO-s, mundësoi përballimin me sukses të krizës humanitare përgjatë luftës së Kosovës, në vitin 1999. Angazhimi i NATO-s në zgjidhjen përfundimtare të atij konflikti, përveçse na bën të jemi mirënjohës përjetësisht, na bën, në mënyrë të veçantë, krenarë për qenien pjesë e kësaj organizate.

Më tej, duke vijuar me përvojat ushtarake si partner të NATO-s, ne mund të rikujtojmë edhe përvojat domethënëse të periudhës së paraanëtarësimit. Gjej rastin të falënderoj pjesmarrësit tanë të misionëve të asaj periudhe, në Bosnjë Hercegovinë, Irak, Afganistan, Çad, etj. Përvojat e atij procesi, sidomos që nga nënshkrimi i Planit të Veprimit për Anëtarësim në vitin 1999, kanë ndikuar shumë në transformimin e procesit të sigurisë së vendit tonë. Sot, pas dy dhjetëvjeçarësh, Shqipëria është anëtare me të drejta të plota në NATO dhe Forcat tona të Armatosura janë të angazhuara në mënyrë aktive në partneritet të ngushtë me aleatët tanë, për të siguruar paqen dhe integritetin e vendit, sigurinë e rajonit, të Aleancës, madje duke kontribuar edhe për paqen e sigurinë globale.

*Fjalë e mbajtur në ceremoninë e 5-vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO.

Përfitoj nga rasti për t'i përshëndetur ushtarakët tanë në misione jashtë vendit, të cilët, janë simboli më i qartë i anëtarësimit të vendit tonë në Aleancë.

Përkujtimi i ditës së anëtarësimit të vendit tonë në NATO është një veprimtari simbolike, por festimi i kësaj dite nuk ka vetëm vlerë historike. Për vendin e popullin tonë, për të gjithë bashkëkombësit tanë, kjo datë do të mbetet në ndërgjegje si ngjarja që na ribashkoi plotësisht me vlerat dhe parimet euroatlantike të lirisë, demokracisë dhe progresit. Nuk është aspak e vështirë për ne shqiptarët që NATO-n ta cilësojmë si një "lidhje bese" midis miqsh të nderuar, të vendosur për të mbrojtur njëri-tjetrin, në të drejtën për të jetuar në paqe dhe begati. Ndaj ne jemi të vendosur të mbajmë e të lartësojmë rolin tonë si anëtarë të kësaj Aleance.

Ne do të zbatojmë me vendosmëri reformat e nevojshme për të rivitalizuar ushtrinë dhe institucionet nën varësinë e Ministrisë së Mbrojtjes, me qëllim që t'i vendosim ato në standardet e organeve homologe të vendeve aleate të NATO-s. Qasja jonë për të arritur këtë objektivi madhor është dyplanëshe:

Së pari, ne synojmë të bëjmë rregullime ligjore përkatëse, duke filluar nga dokumentet strategjike kombëtare e ushtarake, për të garantuar një bazë ligjore të shëndoshë e të përditësuar.

Së dyti, qëllimi ynë është të realizojmë sa më shpejt ristrukturimin e të gjitha niveleve të FA, për ta bërë atë më të zhdërvjelltë dhe më të ndërveprueshme në detyrat e brendshme dhe në ato të jashtme, sipas nevojës.

Ministria e Mbrojtjes dhe qeveria shqiptare janë të fokusuar tek reformat, sidomos ato që lidhen me përmirësimin e sistemit arsimor të ushtarakëve, modernizimin e bazës materiale, sistemin e stërvitjes dhe rigjallërimin e projekteve për të cilat jemi dakordësuar me Aleancën prej disa vitesh, por që për këtë është bërë pak. Kemi akoma shumë punë për të bërë për të ngritur FA në një pozicion të respektueshëm, brenda Aleancës. Ne jemi të vendosur t'iu rikthejmë dinjitetin e munguar FA-ve, jo vetëm duke iu krijuar kushtet për të kryer sa më mirë detyrat e tyre, por edhe duke shmangur praktikat korruptive dhe zhvlerësuese të punës së tyre.

Jemi të vendosur gjithashtu të mbështesim Aleancën në çdo angazhim ku ajo thirret të veprojë; të ofrojmë kontributet tona në interesin e përbashkët për një botë më të paqte e më të begatë, përkrah aleatit tonë strategjik, SHBA; të kryejmë sa më parë detyrimet, në kuadër të anëtarësimit në BE; të vijojmë bashkëpunimin me organizatat e tjera rajonale që adresojnë çështje të sigurisë, me qëllim promovimin e paqes në rajon e më gjerë, si dhe anëtarësimin e vendeve të rajonit në strukturat euroatlantike.

Në mbyllje do të doja të shprehja mirënjohjen për mbështetjen e aleatit të madh të Shqipërisë, SHBA. Falënderime të ngrohta shkojnë dhe për të gjithë aleatët tanë në NATO-s, për mbështetjen dhe bashkëpunimin e tyre në kuadrin e kësaj ëndrre të madhe shqiptare. Falënderime të sinçerta iu shkojnë dhe ushtarakëve shqiptarë e punonjësve të ministrisë ndër vite, të cilët kanë shërbyer me përkushtim. Së fundi do të doja t'i përcillja urimet më të mira vetë NATO-s, e cila feston 68-vjetorin e krijimit të saj, pa harruar bashkudhëtarët tanë kroatë për 5-vjetorin e anëtarësimit. Një urim i veçantë shkon edhe për vendet e tjera të rajonit, të cilat presin t'i bashkohen Aleancës.

*Nuk duhet të harrojmë se vlera jonë më e madhe gjithmonë do të jenë njerëzit**

Gjeneralmajor Jeronim Bazo
Shef i Shtabit të përgjithshëm të RSH

Anëtarësimi i Shqipërisë në NATO, pesë vite më parë, u quajt një ngjarje e madhe historike. Termi “historik” përdoret shpesh në ditët e sotme, por duke u nisur nga rëndësia e periudhave transformuese që ka kaluar apo po kalon vendi ynë, vështirë të mund të shmangesh nga këto ngjyime hiperbolike.

NATO është koalicioni më i suksesshëm në histori, i bazuar në ndarjen e vlerave demokratike dhe në një angazhim të të gjithëve, për një siguri të paprekshme. Anëtarësimi në NATO ishte preludi i përpjekjeve tona politiko-historike, që filluan me ndryshimin e sistemit politik në Shqipëri, vendosjen e demokracisë, shprehjen e vullnetit politik për t’iu bashkuar kësaj Aleance dhe pjesëmarrjen aktive në organizmat dhe programet që i paraprinin anëtarësimit. Anëtarësimi i Shqipërisë në NATO, zgjidhi një prej problemeve kryesore që na ka shoqëruar këto 101 vite si shtet i pavarur, problemin e sigurisë.

Shqipëria sot është më e sigurt, kjo në këndvështrimin e mbrojtjes kombëtare. Shpesh dëgjohen edhe zërat skeptikë, që vënë në dyshim vlerën e NATO-s. Por ne jemi më se të qartë se vlera e NATO-s nuk matet në terma financiarë, sepse, siguria jonë është e pamatshme. Mbrojtja e lirisë nuk mund të vijë asnjëherë pa shpenzime dhe është shumë e rëndësishme që edhe Shqipëria të qëndrojë së bashku me vendet e tjera në mbrojtjen e vlerave të përbashkëta të lirisë së kombeve, demokracisë dhe mbizotërimit të ligjit.

Anëtarësimi në NATO shënoi fillimin e një procesi të rëndësishëm. Ky proces, përfshiu transformimin e Forcave tona të Armatosura në fushat doktrinare, organizative, stërvitore/trajnuese, pajisjeve, personelit dhe burimeve, duke i bërë ato më të ndërveprueshme me simotrat e tyre në Aleancë. Prosesi u udhëhoq dhe u monitorua nga Komanda e Aleancës për Transformim (ACT) dhe përfundoi me certifikimin e integritit të plotë, në tetor të vitit 2013.

Ne jemi krejt të vetëdijshëm që ky proces, nuk përfundon këtu. Si vetë Aleanca, që për lejtmotiv ka “transformimin”, edhe Forcat tona të Armatosura, si një organizëm jetik, janë gjithmonë në një proces të vazhdueshëm transformimi dhe zhvillimi. Ky transformim kryhet për t’iu përshtatur sa më mirë kushteve në të cilat FA operojnë, për të ndërtuar kapacitetet e duhura me qëllim realizimin e misionit dhe detyrave të ngarkuara, por edhe detyrimeve që rrjedhin nga anëtarësimi në NATO, sepse një Aleancë e suksesshme

*Fjalë e mbajtur në ceremoninë e 5-vjetorit të anëtarësimit të Shqipërisë në NATO.

mund të triumfojë vetëm nëpërmjet vëmendjes dhe kontributit të vazhdueshëm të vendeve anëtare.

Sikundër Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, z. Rasmussen, është shprehur: “Ne jemi shumë të ndërgjegjshëm për ndarjen jo të drejtë të peshës brenda Aleancës, që po ushtron një ndikim të madh në lidhjet transatlantike. Reformimi i lidhjeve transatlantike është një përgjegjësi e përbashkët që kërkon hapa kuptimplotë, praktikë dhe urgjentë. Evropa duhet të bëjë më shumë për ofrimin e kapaciteteve mbrojtëse”. Jemi duke marrë të gjitha masat e duhura, si në aspektin planëzues por edhe në atë organizativ, për të përmbushur me sukses detyrimet e paketës së *Objektivave të Kapaciteteve*, të pranuar në qershorin e kaluar, me fokusin kryesor, krijimin, organizimin, trajnimin dhe vënien në dispozicion të Aleancës së një batalioni këmbësorie të motorizuar. Për realizimin me sukses të këtij objekti, fokusi i modernizimit do të drejtohet për pajisjen me armatim dhe pajime luftarake individuale, sipas standardeve të NATO-s, të personelit të këtij batalioni.

Njëkohësisht, si shprehje e vullnetit për përmbushje sa më të mirë të detyrimeve ndaj kësaj Aleance, Shqipëria ka vijuar pjesëmarrjen me sukses në operacionet e NATO-s, si në operacionin ISAF në Afganistan me ekipe OMLT/MAT, të forcave speciale etj, si dhe në operacionin KFOR në Kosovë me personel në shtab. Po ashtu, Shqipëria është e gatshme të vijojë kontributin e saj edhe pas përfundimit të operacionit ISAF dhe fillimit të misionit “*Resolute Support*”.

Në këto 5 vite anëtarësim, Forcat e Armatosura kanë pasur edhe arritje të tjera të rëndësishme. Këtu mund të përmendet procesi i demontimit të municioneve dhe armatimit të tepërt, njohja dhe përdorimi i *Procesit të Planifikimit të Mbrojtjes së NATO-s*, duke e përafuar *Planifikimin Kombëtar*, si dhe automatizimin e sistemit të menaxhimit të personelit dhe materialeve. Por ndërkohë ka filluar dhe vijon puna për reformën legislative, nëpërmjet të cilës do të rregullohet më mirë veprimtaria e FA.

Ne nuk duhet të harrojmë se vlera jonë më e madhe gjithmonë do të jenë njerëzit-burrat e gratë kurajozë e të palodhur në radhët e Forcave të Armatosura. Ata mishërojnë vlerat tona dhe janë shembuj për t’u ndjekur nga shoqëria e më gjerë. Ne, lidershipi civilo-ushtarak, iu detyrohemi atyre në angazhimin tonë për një mbështetje sa më dinjitoze, me qëllim vlerësimin e vlerave që ata mishërojnë në kryerjen e detyrave kushtetuese.

Një falënderim i veçantë u takon partnerëve dhe aleatëve tanë në NATO dhe strukturave të saj organizative, të cilat na kanë mbështetur dhe vijojnë ta bëjnë atë, në rrugën tonë të bashkëpunimit. Në përfundim, dua të shpreh bindjen time të plotë dhe njëkohësisht garantoj që Forcat e Armatosura të RSH, do të jenë gjithmonë anëtare të denja të NATO-s, duke përmbushur me sukses sfidat dhe përballjet që ato kanë përpara dhe duke qenë në lartësinë e detyrave që i ngarkon misioni i tyre kushtetues.

RUBRIKA E PARË

Analiza dhe vlerësime për sigurinë

Shkrimet, pjesë e kësaj rubrike, të trajtuara nga specialistë profesionistë të fushës, trajtojnë një sërë çështjesh të rëndësishme, që kanë të bëjnë me problemet aktuale, ato perspektivës si dhe ato që lidhen ngushtë me Konceptin e Sigurisë e të Mbrojtjes së RSH e më gjerë.

Në shkrimin “Politika e Sigurisë e NATO-s dhe ndikimi në politikën e sigurisë kombëtare”, autori përshkruan Konceptin Strategjik mbi Sigurinë të NATO-s, ndikimin e tij në politikat përkatëse të vendeve anëtare, por edhe si ndikon kjo në hartimin apo ndryshimet në politikën e sigurisë të RSH.

“Procesi i ndryshimit - thelbi i transformimit të FA” trajton nevojën për transformim të Forcave tona të Armatosura. Autori mendon se procesi i ndryshimit në FA rezulton në zbatimin rigoroz të një sistem planifikimi, programimi, buxhetimi e vlerësimi të pajtueshëm me ato të Aleancës Euroatlantike. Trendi aktual i ndryshimit kërkon nga FA pranimin dhe zbatimin e koncepteve doktrinare, të performancës së teknologjisë, organizimit e funksionimit si një e tërë e në përshtatje me Konceptin e ri Strategjik të NATO-s.

Shkrimi “Nevoja e rishikimit të dokumentit të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të RSh” trajton çështje të riformulimit të këtij dokumenti, të aktorëve kryesorë pjesëmarrës, por jep edhe disa rekomandime që lidhen me këtë proces kaq të rëndësishëm. Strukturat e mbrojtjes nuk do të jenë në rol drejtues në proces, por pjesë përbërëse e tij. Përfshirja e personelit me përvojë dhe ekspertëve të të gjitha fushave përbën një element të rëndësishëm, nënvizohet në shkrim.

Në trajtesën që i bën temës “Forcat Speciale dhe ndryshimi i ambientit të luftimit nga konvencional në jokonvencional”, autori rrok një sërë çështjesh që kanë të bëjnë me kushtet e ndryshuara të sigurisë, të nevojës për të patur doktrinë, trupa, teknologji, teknikë luftarake, por edhe një koncept të ri që të lidhet me mënyrat dhe metodat e realizimit të luftimit jokonvencional.

“Kultura Strategjike e SHBA” është një tjetër trajtesë, nëpërmjet së cilës, autorët sjell dukuri të spikatura të kulturës amerikane të të bërit të gjërave, nga më të thjeshtat e deri në ato në rrafshin global të sigurisë. Në kushtet e reja të krijuara ka lindur nevoja e krijimit të një mendësie të re në marrëdhëniet mes kulturës politikëbërëse dhe asaj të strategjisë.

Në “Roli i rojës bregdetare shqiptare në mjedisin detar dhe ndikimi i anijeve cisternë gjatë procesit të ballastimit”, autorët trajtojnë çështje të rëndësishme të përdorimit të ballasteve, të ndikimit të derdhjes prej tyre të mbetjeve të dëmshme për faunën e florën detare si dhe për jetën dhe shëndetin e njerëzve. Në shkrim trajtohen edhe probleme të mprehta që kanë të bëjnë me pajisjen, detyrat dhe përdorimin e infrastrukturës dhe mjeteve të Rojës Bregdetare për ruajtjen e bregut dhe të ujërave të afërta detare nga këto ndotje.

Politika e sigurisë së NATO-s dhe ndikimi në politikën e sigurisë kombëtare

Kolonel Editsion Zarka,
Drejtor i Drejtorisë së Politikave Strategjike, MM

Trajtesë e shkurtuar Anëtarësimi i vendit tonë në NATO në vitin 2009 dhe integrimi i plotë i Forcave të Armatosura në këtë Aleancë në vitin 2013, ka shtruar nevojën e harmonizimit të mëtejshëm të politikave, proceseve e procedurave midis kësaj organizate dhe institucioneve kombëtare. Ky është një proces i cili ka filluar që para anëtarësimit në NATO, sidomos pas përfshirjes së vendit tonë në Planin e Veprimit për Anëtarësim (MAP) në vitin 1999. Gjatë një periudhe 10-vjeçare u punua në pesë fusha kryesore për arritjen e standardeve të kërkuara të anëtarësimit, përkatësisht në fushën politike/ekonomike, të mbrojtjes/ushtarake, të burimeve të mbrojtjes, të sigurisë së informacionit të klasifikuar dhe legjislacionit.

Tashmë, anëtarësimi dhe integrimi i plotë në NATO e ka vendosur vendin tonë si një anëtar të barabartë midis 27 vendeve të tjerë aleate, ku merren vendime politike dhe ushtarake, të cilat kthehen të detyrueshme për t'u zbatuar në nivelin kombëtar. Për këtë qëllim, ky shkrim synon të hedhë dritë mbi procedurat e formulimit dhe vendimmarrjes së NATO-s në drejtim të politikave të sigurisë dhe mbrojtjes, duke e krahasuar me procedurat e formulimit dhe vendimmarrjes të politikave të sigurisë dhe mbrojtjes kombëtare. Ndikimi i të parave mbi të dytat është një karakteristikë, e cila duhet marrë në konsideratë nga strukturat tona politikëbërëse.

Objektivat e politikës së sigurisë- gur themeli për ndërtimin e politikave të sigurisë

Orientimi i politikës së sigurisë dhe mbrojtjes kombëtare drejt integritit në strukturat euroatlantike të sigurisë kërkon, para së gjithash, harmonizimin e këtyre politikave me ato të organizatave ndërkombëtare ku vendet janë anëtare, ose synojnë të bëjnë pjesë. Njohja e parimeve, synimeve dhe objektivave të politikave të sigurisë së këtyre organizatave dhe mënyrave për realizimin e tyre mendojmë se janë hapi i parë drejt harmonizimit të politikave kombëtare në fushën e sigurisë, si dhe rrugëve e mjeteve për realizimin e tyre.

Në Traktatin e Uashingtonit është përcaktuar qëllimi kryesor i NATO-s, i cili ka të bëjë me ruajtjen e lirisë dhe sigurisë së të gjithë anëtarëve të saj, me anë të mjeteve politike dhe ushtarake¹. Vërejmë se gjatë gjithë kohës së ekzistencës së Aleancës ky qëllim ka

¹ NATO Handbook 2006, faqe 18.

mbetur i pandryshuar, të cilit i janë bashkuar edhe vendet e reja të NATO-s, përfshirë vendin tonë, si anëtar me të drejta të plota.

Në analogji me Traktatin e Uashingtonit, nëse vijmë në nivel kombëtar, Kushtetua është ajo që vendos bazat e zhvillimit të shtetit dhe shoqërisë, mbi të cilat ngrihen edhe politikat e sigurisë dhe mbrojtjes kombëtare. Pikërisht, që në pjesën e parë të saj, ku listohen parimet themelore, në nenin 3 theksohet se:

“Pavarësia e shtetit dhe tërësia territoriale e tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë”²

Parimi kryesor, me anë të të cilit punon Aleanca është angazhimi i përbashkët dhe bashkëpunimi reciprok ndërmjet shteteve sovraane, në mbështetje të sigurisë së plotë të të gjithë anëtarëve të saj. Me anë të përpjekjeve kolektive, Aleanca mundëson përbushjen e objektivave thelbësore të sigurisë kombëtare. Po cilat janë objektivat e sigurisë së NATO-s dhe ato kombëtare? Ku përcaktohen ato dhe a kanë lidhje me njëra-tjetrën?

Koncepti i Sigurisë së NATO-s dhe Strategjia e Sigurisë Kombëtare

Objektivat e sigurisë së NATO-s përcaktohen në Konceptin Strategjik të saj, ndërsa objektivat e sigurisë kombëtare përcaktohen në konceptet, apo strategjitë e sigurisë kombëtare të secilit vend. Harmonizimi i tyre sa më shumë që të jetë e mundur, përqendron përpjekjet dhe burimet drejt objektivave të përbashkëta të sigurisë dhe mbrojtjes, duke lehtësuar barrën fiskale për vendet anëtare.

Konceptet Strategjike të NATO-s zhvillohen duke ruajtur përmbajtjen dhe frymën e detyrave themelore të sigurisë së NATO-s, të dhëna në Traktatin e Uashingtonit. Këto koncepte janë deklarime autoritative të objektivave të Aleancës, të cilat përbëjnë udhëzimet e nivelit më të lartë për mjetet politike dhe ushtarake që duhen përdorur në përbushjen e këtyre objektivave. Ato mbeten baza për zbatimin e politikës së Aleancës si një e tërë³. Strategjitë e Sigurisë Kombëtare zhvillohen duke ruajtur përmbajtjen dhe frymën e Kushtetutës së vendit, si ligji themeltar i ekzistencës së shtetit dhe akti më autoritativ mbi ligjet e tjera në vend.

NATO deri tani ka zhvilluar disa koncepte strategjike, të cilat i janë përgjigjur sfidave, rreziqeve dhe kërcënimeve në një periudhë të caktuar kohe, në varësi të mjedisit strategjik të sigurisë. Për analogji, edhe strategjitë e sigurisë kombëtare gjithashtu janë përshtatur dhe zhvilluar nga vetë vendet, duke pasur në konsideratë rrethanat specifike të tyre. Në bazë të zhvillimit të koncepteve, strategjive dhe politikave kryesore të NATO-s, vendet anëtare zhvillojnë dhe përshtatin konceptet, strategjitë dhe politikat e sigurisë kombëtare me ato të Aleancës ku bëjnë pjesë. E njëjta gjë është duke ndodhur edhe në hartimin e ri të strategjisë kombëtare, e cila ka mbetur ende e pandryshuar qysh prej vitit 2004. Në draftin e paraqitur nga *Grupi i Punës Ndërministerial* janë pasqyruar këto kërkesa dhe

² Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr.8417. datë 21.10.1998, neni 3, faqe 4, Botimi i Qendrës Shqiptare për të drejtat e njeriut 4.

³ http://www.nato.int/cps/en/natolive/topics_68144.htm? 25 tetor 2012.

pritet finalizimi dhe botimi i dokumentit. Një strategji sigurie e mirë jep një koncept të qartë, realist dhe efektiv të përdorimit të instrumenteve të fuqisë kombëtare si të atij diplomatik, ekonomik, ushtarak, apo edhe të instrumenteve të tjera për të përmbushur objektivat e sigurisë kombëtare. Në këtë kuadër, strategjia e sigurisë mund të parashikojë role të ndryshme për forcat e armatosura, të cilat shpesh etiketohen si misione të këtyre forcave.

Koncepti i fundit strategjik i NATO-s u miratua në Samitin e Lisbonës në 19 Nëntor 2010. Në këtë dokument përshkruhet qartë se për të arritur sigurinë e vet, Aleanca duhet të vijojë të përmbushë tri detyra themelore kyçe të politikës së sigurisë, të cilat janë: mbrojtja kolektive, menaxhimi i krizave dhe bashkëpunimi në fushën e sigurisë. Duke parë me vëmendje këto objektiva, menjëherë vihet re se nga ana sasiore, Aleanca ka përcaktuar një numër relativisht të vogël të tyre (vetëm tre), por duke i parë ato nga ana sasiore, shohim se ato mbrojnë një spektër të gjerë të fushës së sigurisë dhe mbrojtjes. Përpunimi i këtyre tri objektivave dhe zbatimi në praktikë, si nga NATO ashtu edhe nga vendet anëtare të saj, mundëson harmonizimin e përpjekjeve për rritjen e sigurisë dhe mbrojtjes së Aleancës dhe përparimin e interesave kombëtare të secilit vend.

Mbrojtja kolektive është një nga detyrat thelbësore, e çimentuar në Traktatin e Uashingtonit dhe që mbetet baza e Aleancës së NATO-s. Konsiderimi i sulmit ndaj cilitdo anëtar të NATO-s si sulm ndaj Aleancës, siguron unitetin e përpjekjeve të të gjithë anëtarëve përballë kërcënimeve apo sulmeve të mundshme nga kundërshtarët e vet. Nga ana tjetër, vendi ynë duke u bërë anëtar i NATO-s, ka marrë përsipër barrën dhe përgjegjësinë për zhvillimin e kapaciteteve të nevojshme për të kontribuar në mbrojtjen kolektive të Aleancës. Këto përpjekje kanë filluar shumë më herët, që kur vendi ynë ishte pjesëmarrës në Partneritetin për Paqe, sidomos në Planin e Veprimit për Anëtarësim (MAP), që zgjati për një kohë prej 10 vjetësh.

Në konceptin e fundit strategjik të NATO-s u theksua me të madhe rëndësia e Nenit 5 të Traktatit të Uashingtonit, Mbrojtja Kolektive, pas kërkesave të shumë anëtarëve të rinj, sidomos të vendeve Balltike që gjenden në periferi të territoreve të Aleancës. Kjo kërkesë është bërë sot më thelbësore po të mbajmë parasysh zhvillimet e fundit në shtetet që janë në periferi të Aleancës, duke pasur parasysh këtu atë që po ndodh në Krime të Ukrainës. Tendencat drejt një lufte të re të ftohtë me Rusinë, çojnë në ridimensionimin e rëndësisë që ka mbrojtja kolektive.

Skenarët strategjikë janë ata që udhëzojnë zhvillimin e forcave të armatosura, megjithëse këta skenarë mund të ndryshojnë nga dinamika e zhvillimit të gjërave. Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes, zhvilluar në vendin tonë gjatë viteve 2011-2012, mori në konsideratë fuqishëm mbrojtjen kolektive si një nga mjetet më efektive për sigurimin e ruajtjes së integritetit territorial dhe pavarësisë së vendit. Mbetet në dorë të strukturave të nivelit operacional për realizimin në praktikë të konceptit të mbrojtjes kolektive, duke shfrytëzuar sa më mirë të gjitha avantazhet që sjell kjo lloj mbrojtje.

Menaxhimi i krizave është një tjetër element unik i Aleancës dhe kapaciteteve politike e ushtarake të saj. Krizat mund të ndodhin në çdo vend të botës dhe mund të kenë ndikime të drejtpërdrejta në sigurinë e Aleancës dhe vendeve të saj. Prandaj, që pas viteve '90, NATO i ka kushtuar një rëndësi të veçantë mekanizmave për përballimin e spektrit të plotë të krizave, para, gjatë dhe pas shpërthimit të një konflikti. Sfidat e para me të cilat u përball Aleanca në fillim ishte kriza e Ballkanit, sidomos në Bosnje-

Hercegovinë, Kosovë dhe Maqedoni. Më tej, ky spektër i menaxhimit të krizave u shtri edhe në vendet e Lindjes së Mesme si Irak, Afganistan, Libi etj. Edhe vendi ynë ka vijuar përpjekjet për përshtatjen e mekanizmave për menaxhimin e krizave, duke identifikuar kapacitetet e përshtatshme kombëtare për përballimin e tyre. Ky ka qenë një proces që filloi të zbatohej që në vitet '90, duke iu përshtatur dinamikës dhe realitetit ku kanë ndodhur këto kriza. Dërgimi i forcave tona ushtarake në misionet e Bosnje-Hercegovinë që në vitin 1996 në IFOR dhe më pas në misionin e NATO-s ISAF në Afganistan, si dhe në Koalicionin e Vullnetit "Liria e Irakut" në Irak, bëri të mundur kuptimin më mirë të procedurave të punës, kapaciteteve të kërkuara dhe ndërveprimet me forcat e tjera aleate. Kjo i shërbeu edhe zgjerimit të pjesëmarrjes në operacionet e drejtuara nga Bashkimi Evropian (BE), siç ishte rasti i pjesëmarrjes të Forcave tona të Armatosura në misionin T-Chad, në Çad të Afrikës.

Përmirësimi i mekanizmave të menaxhimit të krizave mbetet një sfidë dhe shqetësim i vazhdueshëm i Aleancës. Këtij qëllimi i përket edhe zhvillimi i stërvitjeve vjetore të NATO-s, të nivelit të lartë politiko-ushtarak për menaxhimin e krizave, të tipit "CMX" dhe "Able Staff". Në këto stërvitje merr pjesë edhe vendi ynë, duke përfshirë Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ministrinë e Mbrojtjes, Ministrinë e Brendshme, si dhe institucione të tjera të rëndësishme. Përvoja e fituar në to shërben si bazë për përsosjen e procedurave të vendimmarrjes dhe rritjen e shpejtësisë së veprimit me forumet konsultuese e vendimmarrëse të NATO-s.

Bashkëpunimi në fushën e sigurisë me vendet partnere dhe organizatat ndërkombëtare i mundëson Aleancës angazhimin aktiv në rritjen e sigurisë ndërkombëtare. Në këtë drejtim ajo kontribuon në mënyrë aktive në kontrollin e armëve, mospërhapjen e armëve dhe çarmatimin si dhe mban derën të hapur për demokracitë e reja të NATO-s, që përmbushin standardet e Aleancës.

Anëtarësimi i vendit tonë në NATO ka hapur një perspektivë të re edhe në procesin e bashkëpunimit në fushën e sigurisë. Kjo perspektivë lidhet, para së gjithash, me vendimet që merren në NATO lidhur me Partneritetin për Paqe, bashkëpunimin me institucionet ndërkombëtare, si dhe angazhimin në rajone e vende të veçanta. Aktet e miratuara unanimisht në NATO janë të detyrueshme për t'u zbatuar edhe nga secili vend më vete. Kjo bën që politika kombëtare të përpunohet më tej, duke marrë në konsideratë zhvillimet e politikave dhe qëndrimeve të NATO-s. Bashkëpunimi i NATO-s në fushën e sigurisë është rritur ndjeshëm. Kjo krijon mundësitë për rritjen e bashkëpunimit kombëtar në këtë fushë, duke parë interesa reciproke me vendet dhe rajonet e veçanta ku kërkohet të bëhet ky bashkëpunim. Roli moderator i Shqipërisë në rajonin e Ballkanit gjatë dy dhjetëvjeçarëve të fundit, krijoi një premisë të re për vendin pas anëtarësimit në NATO. Tashmë ky rol mund të avancohet më tej, duke u bërë më aktiv dhe ndikues për politikën rajonale drejt integritetit të përbashkët euroatlantik të vendeve të rajonit.

Bashkëpunimi midis strukturave të NATO-s dhe atyre kombëtare në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes

Organet kryesore të politikës dhe vendimmarrjes së Aleancës janë Këshilli Atlantik i Veriut (NAC), Komiteti i Politikës dhe Planifikimit të Mbrojtjes (DPPC) dhe Grupi i Planifikimit të Bërthamës (NPG). Vendimet e marra në këto organe kanë të njëjtin status dhe përbëjnë politikën e miratuar të vendeve anëtare, pavarësisht nga niveli në të cilin merren ato. Formulimi dhe zbatimi i politikave të sigurisë së NATO-s, një aleancë e

përbërë nga vende sovrane dhe të pavarura, varet nga vendimet dhe qëndrimet e qeverive të këtyre vendeve, duke qenë plotësisht të informuara mbi politikat dhe synimet e përgjithshme të njëra-tjetrës. Kjo gjë kërkon këshillime të rregullta politike, kurdo që është e mundur gjatë fazës së diskutimeve të politikëbërjes, para se të merren vendimet kombëtare.

Këshilli Atlantik i Veriut nxjerr deklarata dhe komunikata të cilat shpjegojnë politikat dhe vendimet e Aleancës. Çështjet e diskutuara dhe vendimet e marra në mbledhjet e Këshillit mbulojnë të gjitha veprimtaritë e organizatës dhe shpeshherë bazohen në raportet dhe rekomandimet e përgatitura nga komitetet vartëse me kërkesë të Këshillit. Përfaqësuesit e përhershëm kombëtarë në NATO, veprojnë sipas udhëzimeve të marra nga vendet respektive, duke informuar pikëpamjet dhe vendimet politike të qeverive të tyre. Edhe vendi ynë ka misionin e vet në NATO, i cili ka në përbërje dy struktura, Përfaqësinë e Përhershme dhe Përfaqësinë Ushtarake. Drejtuesit e misioneve i raportojnë autoriteteve të tyre kombëtare pikëpamjet e shprehura dhe qëndrimet e mbajtura nga qeveritë e vendeve të tjera anëtare të NATO-s, duke i informuar ato mbi zhvillimet e reja dhe duke i mbajtur ato në të njëjtin hap me lëvizjet drejt arritjes së konsensusit për çështje të rëndësishme, apo fushat ku divergojnë pozicionet kombëtare. Kur Këshilli mblidhet në nivel të Ministrave të Mbrojtjes, apo trajton çështje të mbrojtjes, si dhe aspekte që lidhen me strategjinë e mbrojtjes, komitete të tjera përfshihen si organe këshilluese kryesore.

Pas Samitit të Lisbonës, NATO hyri në një proces të thellë reformimi të komandave, shtabeve, komiteteve, agjensive e grupeve të punës. Ndryshimeve të bëra në NATO duhet t'i përgjigjemi me ndryshime reciproke në vend, për të ndjekur në vijimësi ritmin e transformimit të Aleancës. Aktualisht janë rreth 20 komitete në NATO, si dhe 3 agjenci të mëdha, që rezultuan pas konsolidimit të strukturave ekzistuese. Ato kanë ndryshuar jo vetëm emërtimin, por edhe funksionet që kryejnë dhe problematikat me të cilat merren. Njohja e këtyre ndryshimeve është elementi i parë që duhet të shqetësojë strukturat kombëtare që merren drejtpërdrejt me çështjet e NATO-s. Përfaqësimi, përfshirja në procesin e këshillimit e vendimmarrjes në këto komitete e agjenci është një tregues i rritjes së performancës dhe ekspertizës së strukturave tona kombëtare.

Ndër komitetet kryesore të NATO-s ku merren vendime të rëndësishme për aspektet e politikës së sigurisë dhe mbrojtjes përmendim *Grupin e Planifikimit Bërthamor, Komitetin e Politikës dhe Planifikimit të Mbrojtjes, Komitetin Ushtarak, Komitetin Politik dhe të Partneriteteve, Komitetin e Mospërhapjes, Bordin e Komandim Kontrollit* etj. Organet vendimmarrëse kombëtare ndryshojnë nga vendi në vend, ku me të drejtë gjen vend shprehja “*No one size fits all*” (asnjë masë nuk i përshtatet të gjithave). Ndryshimet e historisë, kulturës, sistemeve kushtetuese dhe tradita politike janë arsyt kryesore që qëndrojnë prapa këtyre ndryshimeve⁴. Në rastin e vendit tonë, aktorët kryesorë kombëtarë që i përgjigjen dinamikës së punës së NATO-s, përfshijnë kryesisht Ministrinë e Punëve të Jashtme, Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, Drejtorinë e Mbrojtjes së Informacionit të Klasifikuar, etj. Përveç këtyre strukturave, gjithnjë e më tepër po rritet gama e pjesëmarrjes së institucioneve të tjera, sidomos në kuadër të menaxhimit të sfidave të reja siç janë mbrojtja kibernetike, apo aspektet e paskonfliktit që përfshijnë strukturat e rindërtimit të vendit dhe forcimit të ligjit.

⁴ Bard B.Knudsen, Senior Fellow/DCAF “National Security Policy -a general overview”, [www.dcaf.ch, layout/ Nepal_Nov_2009_National_Security_Policy.pdf](http://www.dcaf.ch/layout/Nepal_Nov_2009_National_Security_Policy.pdf), taken 15 November 2012.

Megjithatë, duke mbetur në fushën mbrojtjes dhe atë ushtarake, gjujkojmë se ka vend për t'u përmirësuar me tej metodologjia e bashkëpunimit dhe procesit të vendimmarrjes, duke harmonizuar më mirë aspektet politiko-ushtarake të kësaj vendimmarrjeje. Më konkretisht, Ministria e Mbrojtjes mbulon një sërë komitetesh, të cilat ndodhen në pjesën "civile" të NATO-s me ekspertizë të mjaftueshme ushtarake. Koordinimin e punës në Misionin tonë në NATO për këto komitete e mbulon Seksioni i Politikës së Mbrojtjes, i cili ofron ekspertizën më të mirë të mundshme, duke bashkëpunuar me përfaqësuesit ushtarakë. Strukturat e Shtabit të Përgjithshëm mbulojnë komitetet që kërkojnë më shumë ekspertizë ushtarake. Komiteti Ushtarak, është një komitet i Shefave të Mbrojtjes/Shefave të Shtabeve të vendeve anëtare të NATO-s. Këto takime ndiqen periodikisht nga Përfaqësuesit Ushtarakë (përfaqësuesit e Shefave të Shtabeve/Shefave të Mbrojtjes të këtyre vendeve), të cilët përçojnë qëndrimet dhe vendimet e marra në vendet respektive. Duke zbritur më poshtë në linjën e komandim-kontrollit të NATO-s kemi dy komandat strategjike, përkatësisht Komandën Aleate për Transformimin (ACT), me qendër në Norfolk të SHBA-së dhe Komandën Aleate për Operacionet (ACO), me qendër në Mons, SHAPE, Belgjikë. Këto struktura janë të nivelit strategjik dhe padyshim edhe në nivelet kombëtare, lidhja dhe bashkëpunimi i mbetet këtyre niveleve.

Lidhur me aspektet e veçanta siç janë ato të mbrojtjes ajrore, menaxhimit të trafikut ajror, aspekteve të komandave të forcave tokësore apo detare, institucionet e arsimimit dhe stërvitjes, të kërkimit shkencor dhe teknologjisë etj, bashkëveprojnë me strukturat përkatëse kombëtare që shtrihen respektivisht tek këto komanda.

Një gjë gjujkojmë se duhet mbajtur mirë parasysh lidhur me procesin e vendimmarrjes. Ai mund të konsiderohet si një proces i cili duhet të marrë në konsideratë tri drejtime kryesore: nga poshtë-lart, ku bëhen edhe propozimet për vendimmarrje; horizontal, ku bashkëpunohet për të nxjerrë një produkt sa më real dhe efektiv; dhe vertikal ku merret vendimi. Këtyre drejtimeve mendojmë se duhet t'i përgjigjet më mirë edhe qasja në strukturat kombëtare, ku format dhe metodat mund të jenë të shumta. Në rastin tonë, krijimi i një strukture *ad-hoc* i tipit bord, apo grup pune, në përbërje të të cilit të jenë përfaqësuesit më madhorë të fushës funksionale, të cilat i korrespondojnë strukturave homologe në NATO, do të ishte një gjë pozitive. Kjo për vetë arsyen, se duke u mbledhur rregullisht, do të diskutohen aspektet që trajtohen në NATO, duke shkëmbyer informacionin dhe duke dhënë gjykime për vendimmarrësit kombëtarë. Të gjitha përfundimet dhe qëndrimet e formuluar do të kanalizohen në takimet e nivelit të lartë të NATO-s, takimet e kërësve të shtetit dhe qeverive, kur kemi të bëjmë me zhvillimin e samiteve, të ministrave të jashtëm apo të mbrojtjes, kur mblidhen ministeriale, apo takimet e Shefave të Mbrojtjes/Shtabeve të cilët trajtojnë aspekte kryesisht ushtarake. Harmonizimi i gjithë kësaj "piramide" procesesh, përfaqësuesish dhe vendimmarrjesh, në nivelin e NATO-s me atë kombëtar, mendojmë se do të rriste shumë efektivitetin.

Si përfundim mund të themi se politika e sigurisë dhe mbrojtjes kombëtare nuk është një politikë statike, e ngurtësuar vetëm në dokumentet e prodhuara dhe të miratuara në një periudhë kohe të caktuar. Por ajo është një politikë që zhvillohet vazhdimisht, duke marrë në konsideratë ndryshimet që ndodhin në mjedisin e sigurisë, në institucionet ndërkombëtare të sigurisë, ku vendi ynë bën pjesë dhe të të gjithë dinamikës që përfshin këtë proces.

Anëtarësimi në organizatat ndërkombëtare të sigurisë ndikon në procesin e zhvillimit të politikave të sigurisë kombëtare, si dhe në procesin e vendimmarrjes për çështje madhore.

Në rastin e NATO-s, këto çështje linden, zhvillohen duke kaluar në zinxhirin e komiteteve, bordeve, grupeve e nëngrupeve të punës dhe marrin “vulën” e vendimmarrjes në Këshillin e Atlantikut të Veriut, si organi më i lartë i vendimmarrjes së Aleancës. Kjo gjë gjykojmë se duhet të ndodhë edhe në terrenin kombëtar, ku përvoja e fituar, sfidat e kaluara dhe ato të ardhme duhet të kalojnë përmes mekanizmave të ngjashme me ato të Aleancës. Në demokraci, shpeshherë procesi i vendimmarrjes është më i ngadaltë, por produkti është edhe më “i pjekur” pasi nuk neglizhon hallkat e zinxhirit të vendimmarrjes, duke marrë në konsideratë të gjithë ekspertizën e nevojshme për zhvillimin e politikave e strategjive. E gjitha kjo do të sjellë pa dyshim progresin e kërkuar.

Bibliografia

- Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Ligji Nr.84/17. datë 21.10.1998, neni 3, Botimi i Qendrës Shqiptare për të drejtat e Njeriut.
- NATO, “Active Engagement, Modern Defense. Strategic Concept for the defense and security of the Members of the North Atlantic Council Treaty Organization” miratuar nga Krerët e Shteteve dhe Qeverive në Samitin e NATO-s në Lisbonë, 19-20 Nëntor 2012, NATO Public Diplomacy Division, 1110 Brussels, Belgium, www.nato.int/ebookshop
- NATO Handbook 2006, NATO Public Diplomacy Division, 1110 Brussels, Belgium
- Faqja zyrtare elektronike e NATO-s, <http://www.nato.int>
- Bard B. Knudsen, Senior Fellow/DCAF “National Security Policy-a general overview”, www.dcaf.ch/layout/Nepal_Nov_2009_National_Security_Policy.pdf

Procesi i ndryshimit¹–Thelbi i transformimit të Forcave të Armatosura

MSc. Nënkolonel (R) Kanan Himaj
Analist, QKSM

Trajtesë e shkurtuar. Në tërë botën, sot vërehen ndryshime të vazhdueshme dhe të thella, vlerësimi i të cilave përcaktohet nga sjellja e parametrave të reja në përmirësimin e jetës njerëzore, përmirësimin e rendit politik, ekonomik, por edhe ushtarak. Proceset e ndryshimit në Forcat e Armatosura Shqiptare kanë marrë forma të ndryshme dhe secila prej etapave të ndryshimit ka “emrin” e vet. Në periudhën e kaluar dhe deri në hyrjen në NATO, ndryshimet janë të njohura, por emri i pagëzimit njihet me “transformim” dhe ato kanë sjellë ndryshime në formë dhe përmbajtje të modernizimit të FA. Aktualisht, termi më i përmendur është marrë nga terminologjia e NATO-s. Në fakt, të gjitha proceset vijojnë t’i nënshtrohen ndryshimeve që ndikojnë në organizimin ushtarak, në të gjitha dimensionet e tij: konceptual (strategjia, doktrina), strukturor (personeli, pajisjet, etj), teknologjik dhe kulturor/organizativ.

Mendoj se shkas për këtë shkrim është momenti dhe pritshmëria e ndryshimeve tërësore dhe reale të Forcave tona të Armatosura. Ndryshimet në çështjet e planifikimit të mbrojtjes lidhen me bazën e zhvillimit të strategjisë së re të sigurisë, strategjisë ushtarake dhe më tej, planeve të perspektivës së forcës. Sot, këto çështje madhore janë shtruar për zgjidhje në të gjitha hallkat e drejtimit strategjik të vendit pasi janë çështje jo vetëm të FA, por të mbarë shoqërisë shqiptare. Prandaj, procesi për ndryshim është vëmendja kryesore në shumë aspekte për një konceptim më të mirë të sistemit të planifikimit të mbrojtjes, në kuadrin e sigurisë dhe mbrojtjes kolektive të Aleancës euroatlantike.

Fjalë kyçe: ndryshim, NATO, reforma, transformim, modernizim, ristrukturim, aftësitë, siguria, mbrojtja dhe siguria kolektive.

¹ **Ndryshimi** (Diferencë, dallim, mospajtim, shenjë dalluese, ndërrim, këmbim, modifikim, pakësim, mospajtim, shenjë dalluese, zhvendosje, ndërrim, spostim, transmetim, përmirësim, korrigjim, ndreqje, ndryshesë, këmbim, pezullim, ndërrim vendesh, veçori, veçanti, pabarazi, kontrast, mospajtim, kthesë, rrotullim, vërtitje) është një koncept kyç i filozofisë, tregon procesin nga i cili një fenomen apo veprim dallohet nga një tjetër, brenda një fushe ose një sistemi konceptual të caktuar. Në sistemin filozofik perëndimor, diferenca është parë tradicionalisht si krahasim me identitetin, duke ndjekur parimet e Leibniz. (*Gottfried Wilhelm Leibniz* ishte filozof, shkencëtar, matematikan, diplomat dhe jurist gjerman, i cili kryesisht shkruante në gjuhën latine dhe frënge).

Procesi i ndryshimit sjell modernizimin e forcës

Në konceptin e terminologjisë së kohës, ndryshimi shpreh zëvendësimin e një praktike apo veprimi të vjetër me një të re, modifikimin, transformimin ose veprimin për ndërtimin e një force të re, në formë dhe përmbajtje, përmirësimin apo krijimin e një produkti, objekti, shërbimi të ri, në funksion të interesave të vendit, etj.

Në objektin e këtij shkrimi janë parësore Forcat tona të Armatosura, të cilat kanë pësuar shumë ndryshime dhe tashmë janë përfshirë në një proces të gjerë zhvillimi. Së pari, treguesit e zhvillimit lidhen me reagimin ndaj ambientit të sigurisë. Në vite ato kanë bërë zhvillim të dukshëm në krijimin e aftësive dhe dhënien e kontributeve për sigurinë dhe mbrojtjen në vend dhe jashtë tij, duke u mbështetur në burimet e mbrojtjes. Në këtë aspekt, natyrshëm janë bërë ndryshime, sipas standardeve të reja dhe nivelit të zhvillimeve demokratike në vend, në kryerjen e detyrave cilësisht të reja, rritjen e aftësive në kushtet e mbrojtjes civile, krijimin e elementëve të rinj që përcaktojnë edhe ndryshimet e shprehive të punës, vlerat dhe qëndrimet që lidhen me misionet brenda dhe jashtë vendit, etj. Pra, vlerësimi i ndryshimit në Forcat e Armatosura në dimensionin e sjelljes ka qenë dhe është thelbësor. Kjo përbën një anë të veçantë mbi procesin e ndryshimit në realitetet tona, pasi ajo shkon në përputhje me planet e strategjive të ndryshimit, në përshtatje me nivelin e demokracisë në vendin tonë.

Duke vlerësuar përvojën në vite, duhet pranuar se nuk mund të konceptojmë se gjithmonë ka pasur ndryshime me tendencë të theksuar progresive. Trendi i ndryshimeve ka konsistuar në mënyrën se si janë zbatuar kërkesat e reja në planifikimin afatgjatë dhe vizionar. Ndryshimet janë parë gjithnjë të lidhura me zbatimin e misionit kushtetues, detyrat në tërësi dhe plotësimin e angazhimeve para aleatëve. Në vëmendjen e strukturave përgjegjëse ka qenë dhe është përpunimi i strategjive zhvilluese për përdorimin e burimeve të mbrojtjes dhe respektimin e kufizimeve financiare dhe mbështetëse, sidomos me miratimin e Dokumentit të Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes të RSH-2013 (RSM). Në qendër të ndryshimeve të forcave është vlerësimi i momenteve të ndryshimeve të mjedisit të sigurisë në rajon, të cilat detyrojnë modifikimin e strategjive për planifikimin e mbrojtjes. Prandaj, për sot dhe për perspektivën, strategjitë në tërësi përbëjnë një bazë ligjore, të detajuar në akte normative dhe udhëzuese me theks për të drejtuar transformimin, pasi ajo japin kornizën e duhur dhe metodat e ndërveprimit mes faktorëve, deri në prurjen e ndryshimeve të pritshme të realizimit të ambicieve politiko-ushtarake.

Procesi i transformimit dhe ndryshimet kanë nevojë gjithnjë për mbështetjen vertikale të hallkave të hierarkisë të drejtimit civilo-ushtarak. Në këtë kuptim, ndryshimi i lidhshëm konsiderohet një çështje e rëndësishme në procesin e ndryshimit të FA-ve. Ato kanë kaluar një proces të gjerë reformash dhe kanë bërë të mundur krijimin e një ushtrie të re, më të vogël në kushtet e sistemit të ri demokratik, me kapacitete të besueshme dhe efektive për mbrojtjen, të përshtatura me mjedisin e ri të sigurisë në rajon dhe më gjerë. Procesi i reformimit të Forcave të Armatosura ka qenë dhe është i lidhur, në mënyrë të natyrshme, me kërkesat e sistemit të planifikimit të mbrojtjes së Aleancës Euroatlantike. Kjo mënyrë ka dhënë frytet e veta në aspektet e sigurisë së vendit. Në përkufizimin e transformimit pranohet se ai përfshin ndryshime të thella në nivelin e doktrinave të forcave, organizimin dhe strukturat përkatëse, gjerësia e veprimtarisë dhe informacionit, ndryshimin konceptual të arsimimit dhe trajnimit, edukimin dhe kërkesave për personelin,

Procesi i ndryshimit-thelbi i transformimit i FA

ngritjen e formës së re për menaxhimin e programimit buxhetor, etj.

“Programi i Qeverisë”² në fushën e mbrojtjes përmban objektiva ambiciozë të cilat kërkojnë vijimin e reformave dhe transformimit të mëtejshëm të Forcave tona të Armatosura, krijimin e kapaciteteve të nevojshme ushtarake për përballimin e sfidave të sigurisë dhe mbrojtjes, si dhe vendosjen e tyre në lartësinë që meritojnë në shoqërinë shqiptare.

Zhvillimi sjell progres në strukturat e mbrojtjes

Ndryshimet në tërësi gjithnjë përfshijnë një fushë të gjerë veprimi dhe kanë ndikim në shumë aspekte. Gjithsesi, në praktikë dhe veprimtarinë e ndryshimeve konceptuale, doktrinare dhe programore ka pasur edhe përvojë jo të mirë sidomos në shtyrjen e afateve kohore të fazave të zhvillimit të forcës, kufizimin e zhvillimeve vetëm në ndryshime pjesore strukturore dhe të pambështetura në vizionin e zhvillimit të forcës.

Programi i ndryshimit në nivelin e organizimit ushtarak ka një koncept të gjerë dhe nuk është i thjeshtë, i kufizuar në veprime numerike njësishe apo personeli, por ka si objekt shumë elementë thelbësorë si strategjitë e mbrojtjes, teknologjinë e përdorur, kulturën profesionale dhe qytetare, etj. Zakonisht, ndryshimet e strategjisë krijohen nga faktorë të jashtëm, duke pasur në konsideratë kërcënimet dhe sfidat, risitë teknologjike që kërkojnë vijimin e procesit të ndryshimeve tërësore.

Procesi i transformimit të mbrojtjes ka kaluar në një rrugë të gjatë me sfida të mëdha në sistemin e mbrojtjes për cilësinë e strukturës së re, madhësinë e personelit, burimet e kufizuara të mbrojtjes dhe përdorimin e tyre; realizimin e aftësive luftarake të ndërveprueshme me aleatët (objektivat e forcës); mbajtjen e nivelit të gatishmërisë së planifikuar të njësisve, teknikës, pajisjeve, etj., për operacione; kërkesat në rritje të bashkëpunimit për misionet dhe operacionet ndërkombëtare; promovimin e një konsensusi të gjerë politik në vend për reformat e mbrojtjes dhe mbështetjen e transformimit, etj.

Ndryshimi teknologjik në Forcat e Armatosura përfshin të gjithë elementët e mbrojtjes, në mbështetje të procesit të reformimit. Ndryshimi i referohet zhvillimeve të forcave tokësore, ajrore dhe detare, por edhe të njësisve mbështetëse dhe shërbimeve, në shumë aspekte. Disa nga çështjet më të ndjeshme në fushën e mbrojtjes kanë qenë dhe janë aspektet e vëzhgimit të hapësirës detare dhe ajrore, integritetit të plotë me vendet aleate dhe NATO-n.

Ndryshimet, në tërësinë e tyre, kanë shumë elemente të rëndësishme që të çojnë në plotësimin e misionit, si akti final dhe themelor. Në këtë kuadër, drejtuesit kanë peshën dhe përgjegjësinë të ndryshojnë mënyrën e drejtimit të proceseve reformuese. Gjithnjë ka pasur dhe do të ketë probleme që kërkojnë zgjidhje të tilla si: ndryshimet strukturore bëhen të pamotivuara dhe, në brendinë e tyre, në emër të reformave, ka motive jo të drejta që shënojnë regres. Në tërësinë e procesit të planifikimit dhe programimit të mbrojtjes duhet të mbahen mirë parasysh standardet e pranuar që përfshijnë një sërë ndryshimesh strukturore si dhe kërkesat e mjedisit të ri të sigurisë. Planifikimi i mbrojtjes kërkon të bëhet në përshtatje me ambientin e sigurisë, gjendjen reale të zhvillimit dhe mundësitë e mbështetjes për perspektivën e FA. Ai duhet të jetë në përshtatje me kërkesat e politikës së mbrojtjes dhe të sistemit të mbrojtjes kombëtare dhe kolektive.

² Direktiva e Mbrojtjes 2014, f. 2.

Procesi i transformimit³ dhe zbatimi i programeve të mbrojtjes do të kalojë në një rrugë të gjatë dhe në disa momente kryesore të cilat janë dhe *sfidat kryesore të sistemit të mbrojtjes*: cilësia dhe madhësia e duhur e personelit, burimet e kufizuara të mbrojtjes dhe përdorimi tyre; realizimi i aftësive luftarake të ndërveprueshme me aleatët (objektivat e forcës); ristrukturimi organizativ brenda mundësive me një madhësi racionale të personelit; mbajtja e nivelit të gatishmërisë së planifikuar të njësive, teknikës, pajisjeve, etj., për operacionet; kërkesat në rritje të bashkëpunimit për misionet dhe operacionet ndërkombëtare; promovimi i një konsensusi të gjerë politik në vend për reformat e mbrojtjes dhe mbështetjen e transformimit.

Pika e nisjes për rishikimin e strukturës organizative të FA është misioni i përshtatur sipas spektrit të sfidave të sigurisë. Zhvillimi i sistemit të sigurisë dhe mbrojtjes përfshin kushtet dhe gjendjen aktuale dhe të perspektivës të vendit tonë si: aspektet politike, ligjore, kontrollin, organizimin, aspektet materiale dhe financiare, të inteligjencës dhe sigurisë, informacionin dhe komunikimin, kërkimin dhe zhvillimin, arsimimin dhe veprimtari të tjera për zbatimin e misionit kushtetues. Planifikimi i mbrojtjes do të parashikojë rishikimin e strukturës organizative në natyrën e saj, përbërjen, ndarjen sipas aspektit të gatishmërisë operacionale, forcat sipas llojit të forcës dhe shërbimit mbështetës.

Rishikimi i strukturës kërkon që madhësia dhe struktura, personeli, komanda dhe kontrolli, logjistika, inteligjenca, komunikimi dhe sistemi i informacionit, edukimi dhe trajnimi, etj., të zhvillohen në përshtatje me realizimin e qëllimeve, zhvillimin e aftësive dhe realizimin e objektivave të forcës (OF).

Suksesi i ndryshimit të nivelit të aspekteve të forcës dhe kulturës profesionale shprehet në aftësitë për të vepruar në operacionet luftarake dhe jo luftarake, të mbështetura në bazën e duhur ligjore dhe në vlerësimin para syve të shoqërisë civile. Çështjet e mësipërme lidhen me identifikimin e përvojës më të mirë në vite; vendosjen e disa metodave të mbështetjes për përparësitë e njësive dhe të personelit ushtarak dhe civil; shikimi drejt një kulture të re profesionale me standarde të reja, e cila mund të përbëjë një fillim të ndryshimit; përmbushjen e parashikimeve në planet afatmesme dhe afatgjatë, për prurje domethënëse në aftësitë e FA.

Në të gjitha rastet, strategjia, teknikat dhe ndryshimet strukturore sjellin ndryshime organizative të cilat përbëjnë vlerat e forcave, qëndrimet dhe prirjet progresive ose jo. Në këtë aspekt, lidhshipi në FA ka përgjegjësinë për të përcaktuar rrugët më të efektshme për të arritur objektivat që përputhen me ambiciet e politikës së mbrojtjes së vendit.

Ndryshimi në periudhën post-integrimit në NATO dhe zhvillimi i aftësive

Ristrukturimi dhe modernizimi i Forcave të Armatosura konsiderohet si kusht për integrimin e plotë në organizatat euroatlantike. Prandaj, në një kohë relativisht të shkurtër, ishte e nevojshme zbatimi i disa reformave thelbësore për të krijuar dhe marrë cilësinë e një force si anëtare e Aleancës.

Koha e post-integrimit në NATO, ristrukturimi dhe modernizimi ishte përvijim i interesave kombëtare; dinamikës dhe mjedisit të sigurisë; kërkesave për të modernizuar

³ Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes 2013, referohet në: Kreu II - Supozimet dhe parametrat e planifikimit, Interesat Kombëtare të RSH; Mjedisi Strategjik i Sigurisë; Roli i Forcave të Armatosura në Mjedisin e Sigurisë; Niveli i Ambicies së RSH; Supozimet bazë të RSM.

Procesi i ndryshimit-thelbi i transformimit i FA

institucionin ushtarak në lidhje me tendencat ekzistuese, burimet buxhetore; fizionominë, tipologjinë dhe tendencat e konflikteve ushtarake; doktrinën e ardhshme, ridimensionimin dhe përmbushjen e disa objektivave, pajisjen, standardizimin dhe ndërveprimin me NATO-n⁴ dhe shtetet e tjera aleate.

Procesi i transformimit në FA lidhet edhe me rishikimin e rolit, misioneve dhe detyrave të FA, pasi ai përbën boshtin e zhvillimit të planifikimit të mbrojtjes. Kërkesa e sotme dhe ajo e perspektivës së mbrojtjes sonë është krijimi i një force të vogël profesioniste, të motivuar, të mirë trajnuar, të pajisur, të ndërveprueshme dhe të aftë për të përmbushur me profesionalizëm detyrat e misionit kushtetues, sipas skenarëve të parashikuar, brenda dhe jashtë vendit. Rishikimi i rolit të FA ka tendencën e cilësisë së kapaciteteve dhe aftësive për kryerjen e misionit, të një ushtrie moderne, si një forcë me kapacitete modeste dhe të vogla, e aftë për të vepruar në mjedisin e ardhshëm të sigurisë. Ndryshimet e pritshme nxjerrin në pah krijimin e kapaciteteve të FA të RSH, disa mungesa në eficiencën e burimeve të mbrojtjes, etj. Rishikimi i rolit dhe misionit të FA është orientuar në *Listën e Detyrave Themelore të Misionit* për nivelin e detyrave strategjike, operative dhe taktike të njësive (ST,OT,TT), bazuar në përvojën e *Listës së Detyrave të NATO-s* (NTL).

Gjithashtu, rishikimi dhe planifikimi i perspektivës përfshin hapësirën e zbatimit të misionit kushtetues të Forcave tona të Armatosura për mision për mbrojtje, misione mbështetëse të paqes dhe sigurisë ndërkombëtare dhe kontribute në kohë paqeje. Nisur nga sa më lart, rol të rëndësishëm në transformimin e FA ka administrata e Ministrisë së Mbrojtjes (MM) dhe Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura (SHPFA), të cilët drejojnë tërë procesin e reformave për të sjellë ndryshime në transformimin e FA. Transformimi kërkon që madhësia dhe struktura, personeli, komanda dhe kontrolli, logjistika, inteligjenca, komunikimi dhe sistemi i informacionit, edukimi dhe trajnimi, etj., të zhvillohen në përshtatje me realizimin e qëllimeve, zhvillimin e aftësive dhe sidomos për realizimin e objektivave të forcës (OF).

Rritja e shpejtësisë në operacione ka nevojë për rritjen dhe përshtatjen institucionale të kapaciteteve të nevojshme në për përmirësimin e bashkëpunimit midis agjencive dhe përsosjen e mekanizmit të kontrollit civil dhe demokratik mbi Forcat e Armatosura. Gjithashtu, vëmendja kërkohet të përqendrohet në krijimin e kapaciteteve për të vepruar edhe me organizatat jo qeveritare, të cilat luajnë rol në rritje në operacionalitetin dhe të veprojnë për operacionet e mbështetjes dhe mbrojtjes civile.

Në *Strategjinë Ushtarake*, transformimi është konsideruar si ndryshime në doktrinë, teknologji e sistemin e informacionit, blerje e armatimeve të reja, shkatërrim i armëve dhe municioneve të tepërta dhe të vjetra; në strukturën e forcave (organizimi i strukturave, komandën, kontrollin, komunikimi, informacion, mbikëqyrja dhe një mbështetje adekuate logjistike me infrastrukturën e duhur për jetesë dhe stërvitje); planifikim i detyrave dhe operacioneve (përpunim i doktrinave të përbashkëta dhe forcave; arritje e ndërveprimit me ushtritë e vendeve anëtare të Aleancës.

⁴ Koncepti Strategjik i NATO-2010, Nënçështja: Mbrojtja kolektive. Anëtarët e NATO-s, gjithmonë, do të ndihmojnë njëri-tjetrin ndaj çdo sulmi, në përputhje me Nenin 5 të Traktatit të Uashingtonit. Ky angazhim mbetet i palëkundur dhe detyrues. NATO do të parandalojë dhe mbrojtë kundrejt çdo kërcënimi dhe agresioni si dhe ndaj sfidave të sigurisë në zhvillim që kërcënojnë sigurinë themelore të secilit vend aleat individualisht, ose të Aleancës si një e tërë.

Kështu, procesi i ndryshimit në periudhën e post-integrimit, përfaqësuar nga një reaksion zinxhir, ka treguar tendencën progresive për vendin tonë. Fillimisht, procesi i integrimit ka në bazë përvojën e vendeve perëndimore për t'u përballur me sfidat e kohës në mjedisin e sigurisë.

Zhvillimi i aftësive të mbrojtjes do të respektojë parimet e planifikimit të mbrojtjes së NATO-s dhe do të fokusohet në realizimin e misionit dhe detyrave të sistemit të mbrojtjes, në nivel kombëtar dhe mjedise ndërkombëtare. Ai bazohet në: përmirësimin e madhësisë dhe strukturës së sistemit të aftësive të mbrojtjes në drejtim të rritjes cilësore dhe zvogëlimin e sasisë së personelit në madhësinë e arsyeshme; riorientimin e disa aftësive të pashfrytëzuara ose të panevojshme dhe përqendrimin në fushat përparësore të sistemit të mbrojtjes; specializimin përzgjedhës dhe listën e përparësive të zhvillimit aftësive, në përputhje me nevojat dhe burimet, kryesisht me qëllim shfrytëzimin racional të burimeve, gjithnjë e më të kufizuara në shifrat financiare; ndërveprimin e aftësive, si pjesë e mbrojtjes kolektive dhe sigurinë e përbashkët dhe mbrojtjen brenda aleancave.

Më konkretisht, zhvillimi i aftësive bazë duhet të orientohet drejt efektivitetit të elementeve kyç të aftësive si: personeli, materialet, objektet, doktrina, organizimi, lidhshëmi, trajnimi dhe ndërveprimi (DOTMLPFI). Koncepti i zhvillimit të aftësive të forcave të vazhdojë të jetë paketa ekzistuese e NATO-s, qëllimet/synimet e aftësive, duke e bërë më shpejt transformimin.

Aftësitë e dislokueshme të FA përbëjnë çelësin e aftësive operacionale për të lejuar disponueshmërinë në kohë të forcave, funksionimin e sistemit të komandës dhe kontrollit, inteligjencës, dislokimit, lëvizshmërisë, mbijetesës, mbrojtjes së forcave dhe qëndrueshmërisë logjistike. Planifikimi shpreh bashkëpunimin me Aleancën, në nivelin strategjik, për të filluar, në kohën e duhur, planëzimin e skenarëve të mbrojtjes kolektive për mbrojtjen e Republikës së Shqipërisë, sipas nenit 5⁵ të Traktatit të Uashingtonit, si dhe me pjesëmarrjen e forcave tona në operacione të Aleancës, jashtë nenit 5 të Traktatit të Uashingtonit.

Në kohën e tashme, rishikimi i dokumenteve madhore të zhvillimit të FA do të parashikojë ndryshimet në planifikim që vijnë si rezultat i detyrave të sistemit të mbrojtjes, si vend aleat i NATO-s, duke harmonizuar planifikimin e mbrojtjes kombëtare me atë kolektive, standardizimin e dokumenteve, proceseve; metodologjisë, kapaciteteve dhe produkteve përkatëse që lidhen me aftësitë luftarake. Ambicia jonë është për krijimin e një force të mbështetur me kapacitete moderne të komandim-kontrollit, një forcë me cilësi dhe manovrueshmëri të lartë, e aftë për t'u dislokuar dhe vepruar edhe në operacionet jashtë vendit. Ka ardhur momenti që një ushtri e vogël të jetë moderne, me aftësi dhe veprimtari të lartë *autonomie për interesat e mbrojtjes kombëtare dhe kolektive*. Me rëndësi do të jetë planifikimi afatgjatë i kërkesave për krijimin e kapaciteteve për *spektrin e Emergjencave Civile kombëtare*.

Në vend të mbylljes

Për FA gjithëpërfshirja është nevojë e transformimit brenda standardeve të Planifikimit të Mbrojtjes të NATO-s, si kërkesë për të rritur qëndrueshmërinë, koherencën për

⁵ Siguria Shtetërore lidhet më shumë me masat për sigurinë dhe mbrojtjen tradicionale të vendit dhe ka të bëjë kryesisht me ruajtjen e sovranitetit, mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe të pavarësisë. Shqipëria, në përputhje me Nenin 5 të Traktatit të Uashingtonit, respekton parimin themelor të sigurisë dhe mbrojtjes kolektive.

Procesi i ndryshimit-thelbi i transformimit i FA

përmbushjen e qëllimit strategjik të sigurisë, mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare dhe kolektive.

Procesi i transformimit të Forcave të Armatosura është në përputhje me procesin e transformimit të NATO-s. Në këtë drejtim, konceptet dhe aftësitë e transformimit, përfaqësojnë vizionin afatmesëm dhe afatgjatë, duke iu referuar ridimensionimit për të marrë pjesë në operacionet e ardhshme, që lidhen me konfigurimin e ardhshëm të strukturës dhe aftësitë e nevojshme për përmbushjen e misionëve.

Kërkesat dhe detyrat për aftësitë e miratuara do të vendosen në planet e perspektivës, të përfshira në procesin e planifikimit të mbrojtjes. Në të gjitha rrethanat, çdo proces fillon me një plan “vizionar” që përshkuan në mënyrë të qartë objektivat dhe synimet kryesore të zhvillimit dhe modernizimit të FA. Procesi, nga faza në fazë, detajon detyrat e politikës së mbrojtjes dhe përshtatet me strategjinë dhe kërkesat e Aleancës.

Tashmë, procesi i ndryshimit në FA rezulton në zbatimin e një sistemi planifikimi, programimi, buxhetimi dhe vlerësimi në përputhje me ato që ekzistojnë në vendet anëtare të NATO-s. Ky sistem konsiston në planifikimin e programimit, buxhetimit dhe vlerësimit të burimeve njerëzore, materiale dhe financiare të dizenuara për FA, në një konceptim të integruar, në bazë të programeve. Sistemi i planifikimit, programimit dhe buxhetimit përfshin veprimtari ciklike të kombinuara për zbatimin e direktivës së planifikimit të mbrojtjes dhe vlerësimin e programimit si dhe menaxhimin e tyre.

Për Forcat e Armatosura, trendi aktual i ndryshimit përfaqësohet nga pranimi dhe zbatimi i koncepteve doktrinarë, performancës së teknologjisë, kërkimit gjithmonë të të resë, organizimit dhe funksionimit në një nivel me standardet e vendeve demokratike dhe sidomos brenda sistemit të planifikimit të mbrojtjes së NATO-s.

Përshtatja dhe vendosja e përkatësisë në strukturat euroatlantike, civile dhe ushtarake, (NATO , OKB e BE), janë qasjet dhe sfidat e reja në fushën kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurisë.

Bibliografia:

- Strategjia e Sigurisë Kombëtare, botimi 2004; Draft SSSH-2014, pjesa e Politikës së Mbrojtjes.
- Koncepti i Ri Strategjik i NATO-s, Samiti i NATO-s, Lisbonë 2010.
- Programi i Qeverisë Shqiptare 2013-2017.
- Strategjia Ushtarake, botimi i 2007; Draft SU-2013.
- “*Smart Defence*, një qasje e re në planifikimin e mbrojtjes së RSH”, Dr. L.Demi; Doktorant Kol (R) Th. Hudhra, paraqitur në faqen e Qendrës Kombëtare të Sigurisë dhe Mbrojtjes.
- “Një koncept mbi Strategjinë e re Ushtarake të RSH, si vend aleat i NATO-s” (Projekt Kërkimor) *paraqitur në faqen e Qendrës Kombëtare të Sigurisë dhe Mbrojtjes.*
- Dokumenti “Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes të RSH”, 2013.

Nevoja e rishikimit të dokumentit të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë

Nënkolonel MSc. Ardian Lulaj
Pedagog në AFA

Trajtesa e shkurtuar. Dokumenti i Strategjisë së Sigurisë Kombëtare është një dokument shumë i rëndësishëm që për nga rëndësia, sipas mendimit tim, vjen pas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Në këtë dokument Forcat e Armatosura, si një nga elementët e Fuqisë Kombëtare janë një ndër aktorët kryesorë në hartimin dhe në implementimin e sigurisë kombëtare. Për më tepër, në Direktivën e Mbrojtjes 2014¹, për Forcat e Armatosura është shprehur se një nga drejtimet kryesore të punës është hartimi i dokumenteve strategjike në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

Në këtë shkrim do të japim disa nga arsyet pse ky dokument duhet të riformulohet. Njëherazi do të bëjmë një paraqitje të aktorëve që duhet të përfshihen në hartimin e këtij dokumenti. Së fundmi do të japim disa rekomandime, që mund të merren në konsideratë gjatë punës për hartimin e dokumentit të ri të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë.

Nevoja e riformulimit të dokumentit të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të RSH (SSK të RSH)

Koncepti i Strategjisë së Sigurisë Kombëtare (SSK) në Shqipëri është relativisht i ri, pa një traditë të gjatë e me përvojë, si rrjedhim dhe me mungesa në studime dhe analiza. Dokumenti i parë i cili u shpreh në lidhje me sigurinë kombëtare ishte “Politika e Sigurimit dhe Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë”, miratuar nga Këshilli i Mbrojtjes, më 25 Maj 1995². Ky dokument u pasua me Dokumentin e Politikës së Mbrojtjes³, si dhe me dokumentin e parë të Strategjisë së Sigurisë Kombëtare në vitin 2000.⁴ Dokumenti i SSK⁵, i cili *de jure* është në fuqi, daton qysh nga viti 2004.

Studiuesi *Harry R. Yarger*, në librin e tij “Strategjia dhe siguria kombëtare: mendimi strategjik dhe formulimi i strategjisë në shekullin e 21-të” citon se strategjia është “një

¹ Direktiva e Mbrojtjes 2014. Nr. 84, datë 8.1.2014. f. 3.

² Politika e Sigurimit dhe e Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë. Shtëpia Botuese e Ushtrisë. Tiranë, 1995.

³ Ligji Nr. 8571, datë 27.01.2000, për “Miratimin e dokumentit të Politikës së Mbrojtjes të RSH”.

⁴ Ligji Nr. 8572, datë 27.01.2000, për “Miratimin e dokumentit të Strategjisë së Sigurimit të RSH”.

⁵ Ligji Nr. 9322, datë 25.11.2004, për “Miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të RSH”.

proces intelektual i disiplinuar, me përcaktime të qarta të nxjerrjes së gjendjes përfundimtare, mënyrave, dhe burimeve të cilat do t'i shërbejnë qëllimeve politike kombëtare dhe politikave në kontekst të paqëndrueshmërisë, pasigurisë, kompleksitetit dhe natyrës së pakuptimtë të mjedisit të sigurisë”⁶

Nisur nga sa më sipër, qysh prej vitit 2004 që është prodhuar dokumenti i fundit i SSK të vendit tonë, mjedisi i sigurisë, si në rrafshin global, rajonal dhe atë të brendshëm, ka ndryshuar shumë. Tashmë, në këto vite, ka pasur zhvillime dhe fakte historike në mjedisin e sigurisë të cilat kanë lënë gjurmë dhe kanë ndikuar në ndryshimin e realitetit si dhe kanë krijuar kushte të tjera dhe shpesh të paparashikuara në këndvështrimin gjeopolitik dhe gjeostrategjik. Natyrshëm, këto ndryshime të mjedisit të sigurisë, si në atë të jashtëm dhe atë brendshëm, kanë pasur dhe kanë ndikimin e tyre që duhet analizuar në vlerësimin e rreziqeve dhe kërcënimeve për rishikimin e dokumentit të ri të SSK. Le të ndalemi më konkretisht në disa nga arsyt pse duhet të rishikohet dokumenti i SSK të Republikës së Shqipërisë.

Së pari, është një detyrim ligjor, i cili buron nga vetë dokumenti aktual i SSK i miratuar me Ligjin. nr. 9322, datë 25.11.2004. Në pikën 84 të këtij dokumenti shprehet se “Strategjia e Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë rishikohet në një periudhë jo më vonë se 3(tre) vjet nga data e miratimit të saj.”⁷

Së dyti, kemi krijimin e shtetit të Kosovës që prej shkurtit të vitit 2008. Kjo ngjarje e lavdishme dhe historike, padyshim ka një ndikim të jashtëzakonshëm në mjedisin e sigurisë, si atë rajonal por edhe atë të brendshëm.

Së treti, vendi ynë qysh prej prillit të vitit 2009⁸ është anëtar me të drejta të plota në NATO. Kjo ngjarje historike për vendin tonë, ka shënuar realizimin e një prej objektivave të shprehura në dokumentin e SSK aktuale: “Integrimi në strukturat evropiane dhe euroatlantike. Anëtarësimi në NATO dhe BE mbetet objektiv parësor në funksion dhe në dobi të politikës së sigurimit të vendit”⁹. Gjithashtu, anëtarësimi në aleancën më të madhe të mbrojtjes kolektive ka një ndikim të jashtëzakonshëm për konceptin e sigurisë, dhe përbën një evolucion thelbësor në të gjithë elementët e fuqisë kombëtare, të cilët janë shtyllat mbi të cilën bazohet ndërtimi i dokumentit të SSK.

Së katërti, kriza globale financiare që ka përfshirë në tërësi botën sot, ka ndikimet e veta në mjedisin e sigurisë, si atë të jashtëm dhe të brendshëm. Shembulli më konkret i kësaj krize është rasti i fqinjit tonë jugor Greqisë. Kur mendojmë të ndërtojmë dokumentin e ri të SSK, nuk mund të anashkalojmë dhe mos t'i referohemi këtij fenomeni, i cili natyrisht ka ndikimet dhe pasojat e veta në zhvillimin ekonomik të vendit tonë.

⁶ Harry R. Yarger, “Strategy and the national security professional: strategic thinking and strategy formulation in the 21st century” (British Library of Congress Cataloguing-in-Publication Data, 2008)9-10.

⁷ Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligj nr. 9322, datë 25.11.2004. Qendra e Shtypit, Botimeve dhe Përkthimeve Ushtarake. Tiranë, 2005, f. 55.

⁸ Marrja e ftesës së anëtarësimit në NATO (në Samitin e Bukureshtit 2 prill 2008) dhe anëtarësimi me të drejta të plota në Samitin e Strasburg&Kehl, 2 prill 2009, finalizoi ato përpjekje dhe atë aspiratë mbarëshqiptare për anëtarësim në NATO.

⁹ Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligj nr. 9322, datë 25.11.2004. Qendra e Shtypit, Botimeve dhe Përkthimeve Ushtarake. Tiranë, 2005, pika 16.1, f. 21.

Së pesti, ne kemi një *Koncept Strategjik të Ri të NATO-s*, i cili u deklarua në Samitin e Lisbonës në vitin 2010. Ky koncept është një “*vulë aprovimi*” për shekullin XXI, duke provuar se Aleanca është një formacion thelbësor për kornizën e sigurisë globale. Detyrat kryesore të *Konceptit të ri Strategjik* janë: *Mbrojtja Kolektive* (Artikulli 5); *Menaxhimi i Krizave* (adresimi i plotë i spektrit të konfliktit); *Siguria Bashkëpunuese* (partneriteti, kooperimi dhe dialogu).¹⁰ Theksi vendoset tek “*politika e dyerve të hapura*”, çka do të thotë rrugë e lirë për pranim në Aleancë për të gjitha demokracitë e reja, të cilat ndajnë vlerat e vetë Aleancës si: demokracia, liria individuale dhe të drejtat e njeriut.¹¹ Pa dyshim, ky koncept duhet të gjejë vendin e vet në dokumentin e ri të SSK.

Së gjashti, zhvillimet konfliktuale në vendet e përfshira në “Pranverën Arabe” të cilat janë ende në një proces i cili është vështirë të përcaktohet se si do të shkojë, kur për më tepër se 3 vjet ne kemi një Siri të përfshirë në një luftë civile, e cila ka arritur përtej kufijve të imagjinatës, deri në përdorimin e Armëve të Dëmtimit në Masë. Po kështu edhe ngjarjet e fundit në Ukrainë, demonstrojnë dhe një herë më shumë paqëndrueshmërinë e mjedisit të jashtëm të sigurisë. Këto ngjarje duhet të merren në shqyrtim kur të bëhen vlerësimet për rreziqet dhe kërcënimet, njëherazi për të përcaktuar dhe politikat dhe detyrimet që burojnë si pjesë e Aleancës së Atlantikut, por njëkohësisht politikat kombëtare që duhet të pasqyrohen në dokumentin e ri të SSK.

Së shtati, do të rreshtoja Samitin e Çikagos, i mbajtur më 20-21 Maj 2012. Në këtë samit, krahas të tjerave, kemi konceptin e “mbrojtjes së mençur”. Ky koncept natyrshëm duhet të gjejë pjesë të shprehur në këtë dokument dhe, për mendimin tim, duhet të zbatohet jo vetëm në fushën ushtarake por në të gjithë fushat e elementëve të fuqisë kombëtare. (diplomaci, informacion, ekonomi).

Së fundmi, do të shkoj më tej, duke përmendur disa ngjarje të cilat, në një mënyrë shumë konkrete, janë fakte historike që nuk mund të kalohen dhe tregojnë se mjedisi i sigurisë së brendshme shqiptare, pavarësisht progresit të jashtëzakonshëm që ka bërë, është vështirë të shkëputet përfundimisht nga mentaliteti dhe kultura e rrugëve jo progresive drejt demokracisë. Roli i lidërsipit dhe klasës politike është i pazëvendësueshëm në historinë e një kombi sepse me veprimet ose mosveprimet e saj, kjo klasë /mund të investohet shpesh për të gjeneruar vlera negative. Ndër ngjarjet më negative, mbas aktit të daljes së Dokumentit të SSK në fund të vitit 2004, ishte ngjarja lidhur me ripërcaktimin e kufirit detar me fqinjën tonë jugor, Greqinë. A është ky një cenim i sovranitetit kombëtar? Një fakt tjetër shumë domethënës dhe aspak i dëshiruar për popullin shqiptar dhe për demokracinë në tërësi, është ngjarja e 21 janarit 2011. A është vrasja e katër qytetarëve shenjë e kulturës dhe qytetarisë demokratike? A kërcënohet siguria kombëtare dhe vetë ekzistenca e shtetit nga ngjarje të tilla? Apo strukturat e shtetit duhet të veprojnë më me profesionalizëm dhe klasa e vendimmarrësve duhet të jetë më e përgjegjshme për përgjegjësitë që ka mbi vete? Këto janë disa nga pyetjet që natyrshëm lindin kur flitet për strategjinë e sigurisë kombëtare të një shteti. Sigurisht, këta shembuj negativë duhen të merren në shqyrtim dhe analizë kur të bëhet vlerësimi i rreziqeve dhe kërcënimeve të brendshme dhe të krijohet mundësia që rreziqet dhe kërcënimet, si ato të jashtme dhe të brendshme, të parandalohen dhe të reduktohet efekti i tyre, në mënyrë që të mos arrijnë

¹⁰ Koncepti i Ri Strategjik i NATO-s 2010, Pika 4, f. 2.

¹¹ Koncepti i Ri Strategjik i NATO-s 2010, Pika 27, f. 8.

të cenonjë interesat kombëtare që kanë të bëjnë me integritetin dhe sovranitetin territorial dhe me ruajtjen e vlerave kombëtare e rritjen e mirëqenies së shtetasve.

Disa nga aktorët e përfshirë në hartimin e dokumentit të SSK (Disa modele)

Praktika botërore na tregon disa modele të ndryshme për të përcaktuar metodologjinë që ndiqet dhe aktorët që marrin pjesë në procesin e përgatitjes së dokumentit të SSK.

Së pari, modeli amerikan na tregon se kërkesa për të hartuar një SSK fillimisht u bazua në *Aktin e Sigurisë Kombëtare* të vitit 1947. Më vonë, ky akt u ndryshua me aktin e quajtur "*Goldwater-Nikols*" të vitit 1986¹². Ky akt përcakton që SSK duhet të nënshkruhet nga presidenti, por presidenti çdo vit duhet të paraqesë një raport mbi sigurinë kombëtare para kongresit. SSK harmonizon interesat ndërkombëtare, qëllimet dhe objektivat, të cilat janë jetësore për sigurinë kombëtare të SHBA. Ajo, gjithashtu, adreson politikën e jashtme, angazhimet ushtarake kapacitetet e vendit si dhe përdorimin e kapaciteteve kombëtare në terma afatshkurtër dhe afatgjatë.

SHBA-të kanë publikuar 15 dokumente të SSK gjatë administrimit të pesë administratave të ndryshme që nga implementimi i *Aktit Goldwater-Nikols* në vitin 1986¹³ deri në vitin 2010, kur daton dokumenti i fundit. Procesi i formulimit të këtij dokumenti kalon nga lart poshtë dhe, në këtë proces merr pjesë një rreth i ngushtë njerëzish, të caktuar nga presidenti i vendit. Kur ish-presidenti *George W. Bush*, lexoi draft dokumentin e SSK të vitit 2002 u shpreh: "Mendova se ky dokument duhet të ishte strategjia ime.... Ky nuk më ngjan me tonin tim"¹⁴. Ai kërkoi që dokumenti të shkruhej sipas zërit të tij. Këshilltarja *Rice* mori draftin dhe punoi vetë mbi të. Gjatë hartimit ajo u këshillua me drejtorët më të lartë të Këshillit të Sigurimit. Në këtë dokument u përfshinë dhe komente të ndryshme politike në lidhje me nevojën që SHBA-të duhej të parandalonin sulmet terroriste. Pas hartimit, SSK u hodh për konsultim në një audiencë të gjerë, përfshirë institucionet e sigurisë, të inteligjencës, median dhe popullin amerikan.

Strategjia e Sigurisë Kombëtare e SHBA, e vitit 2010, e ka origjinën tek *Rishikimi i Prioriteteve të Sigurisë Kombëtare* (NSPR) nga administrata e Obamës. *James Jones* (gjeneral në pension), këshilltar për Sigurinë Kombëtare për presidentin Obama dhe shkruesi i fjalimeve të presidentit dhe zëvendëskëshilltari *Ben Rhodes* u ngarkuan për hartimin e SSK. Hartuesit rishikuan fillimisht SSK 2002 dhe 2006 në detaje, për të përcaktuar ku duhet të ishin ndryshimet në dokumentin e tyre. Ata punuan për 6-8 muaj,

¹² Stolberg, Alan G. "How Nation-States Draft National Security Strategy Documents", October 2012, p.70. Strategic Studies Institute (SSI) is part of the U.S. Army War College: <http://www.StrategicStudiesInstitute.army.mil/>

Alan G. Stolberger; është një Profesor i Asociuar i Studimeve të Sigurisë Kombëtare dhe pjesë e stafit të Programit të Politikës së Sigurisë Kombëtare në Kolegjin e Luftës së SHBA. Mban gradën e kolonelit në rezervë dhe ka shërbyer në funksione të ndryshme në fushën e Inteligjencës, Politikës dhe Strategjisë si oficer i fushës me jashtë për Evropën dhe Euroazinë. Ai ka përfunduar studimet për Master në Marrëdhëniet Ndërkombëtare në Universitetin e Kalifornisë së Jugut, si dhe Master në Studimet e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare në Kolegjin e Luftës të Forcave Detare. Ai mban Titullin Doktor i Shkencave (Ph.D) në shkencat politike nga Universiteti "Temple".

¹³ Po aty, f. 71.

¹⁴ Stolberg, Alan, po aty, October 2012, p.75. Strategic Studies Institute (SSI) is part of the U.S. Army War College: <http://www.StrategicStudiesInstitute.army.mil/>

duke koordinuar ngushtë me drejtoritë e tjera të stafit të Sigurisë Kombëtare për çështjet e tyre përkatëse. Drafti fillestar, i plotë, iu dërgua për koment zyraive homologe në departamentet dhe agjencitë e tjera të lidhura me sigurinë kombëtare. Drafti përfundimtar i dokumentit të SSK, u miratua në një takim të kufizuar të Komitetit dhe më pas u miratua dhe nënshkrua nga presidenti

Për këtë model mund të themi se, për hartimin e dokumentit të SSK të SHBA kemi një grup pune specifik të caktuar, me ekspertë të zgjedhur. Koordinimi i dokumentit bëhet me të gjithë departamentet por atyre që nuk janë pjesë e stafit iu lihet shumë pak kohë në dispozicion për rishikim dhe komente. Dokumenti i SSK të SHBA flet me zërin e presidentit.

Modeli i Britanisë së Madhe na tregon se, në mars të vitit 2008 doli e para *Strategji e Sigurisë Kombëtare* e Mbretërisë së Bashkuar. Nismën për hartimin e këtij dokumenti e ka një “*Think tank*” i njohur si DEMOS¹⁵. Që në fillim të vitit 2006, diskutimet e nisura nga ky institut studimesh gjetën mbështetje të plotë nga i gjithë spektri politik. Kjo strategji ishte stimuluar nga *Strategjia e Sigurisë Kombëtare* të SHBA.

Në takimin vjetor DEMOS të sigurisë në dhjetor 2006, u paraqit plani afatgjatë dhe natyra e kërcënimeve të shekullit të 21-të. Në shkurt 2007 u publikua raporti DEMOS që përpunoi nevojën për një qasje të gjithë qeverisë në një *Strategji të Sigurisë Kombëtare*.

Një veçori tjetër është se për hartimin e dokumentit të SSK në Britaninë e Madhe, *Instituti për Hulumtime të Politikave Publike* (IPPR)¹⁶, një “*Think tank*”, krijoi një komision të pavarur për *Sigurinë Kombëtare* në shekullin e 21-të. Ky komision kryesohej nga *Lord George Robertson*, ish Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s dhe ish Sekretari i Mbrojtjes së Britanisë së Madhe. Raporti i tyre fillestar, në tetor 2007, theksonte ndryshime të rëndësishme në mjedisin e sigurisë që ata mendonin se nuk janë trajtuar si duhet nga qeveria. Ato përfshinin një zhvendosje të pushtetit nga Evropa në Azi dhe Paqësor, dështimet dhe shtetet e dështuara, ndryshimin e klimës dhe mungesën e burimeve. Procesi u drejtua nga stafi i *Sigurisë Kombëtare*, komponent i Zyrës së Kabinetit dhe nën kujdesin e Sekretarit të Kabinetit. Sekretariati i *Sigurisë Kombëtare* ishte krijuar, në përputhje me rekomandimet e bëra në raportin DEMOS “*Think tank*”.

Formimi i komitetit ndërqeveritar apo ndërinstitutional u bë me përfaqësues të lartë nga të gjitha departamentet përkatëse. Komiteti përfshiu personel nga Zyra e Kabinetit të Sekretariatit të Sigurisë Kombëtare si agjent drejtues, Ministria e Mbrojtjes, Departamenti për Zhvillim Ndërkombëtar (DFID) (departamenti përgjegjës për orkestrimin e ndihmës së jashtme të qeverisë, i ngjashëm me Agjencinë Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID) dhe agjencitë e zbulimit. SSK e vitit 2008 u përpilua duke përfshirë të gjitha strukturat qeveritare. Rezultati ishte: dy qasje të ndara dhe të ndryshme për SSK. Njëra e Zyrës së Kabinetit, e përbërë nga burokratë të shërbimit civil të karrierës dhe oficerë, dhe tjetra e kryeministrit (personale) me 10 këshilltarë që merrte parasysh pikëpamjen politike. Zyra e Kabinetit mori përgjegjësinë për të sjellë në emërues të përbashkët këto dy qasje si dhe përgjegjësinë e monitorimit të zbatimit të saj.

SSK e vitit 2009 ishte ripunim i dokumentit të vitit 2008, duke marrë në konsideratë ndryshimet që nga botimi i SSK të vitit 2008. Dallimi i rëndësishëm mes dy SSK ishte

¹⁵ DEMOS një qendër studimi në fushën e sigurisë, e cila në gjuhën shqipe është vështirë të shqipërohet dhe, çdo ditë e më tepër, po gjen vend në gjuhën angleze “*Think tank*”.

¹⁶ Stolberg, Alan G., po aty, f. 57.

se seksionet e SSK të vitit 2008 ishin përgatitur nga ministrinë përkatëse, ndërsa seksionet e tyre për SSK të vitit 2009 ishin shkruar në tërësinë e tyre nga Zyra e Kabinetit të Sekretarit të Sigurisë Kombëtare, e koordinuar ngushtë me ministrinë.

Procesi i përpilimit të SSK të vitit 2010 ishte një proces gjithëpërfshirës dhe ai u bë paralelisht me procesin e Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes dhe Sigurisë (SDSR). Në proceset paralele të përpilimit të dokumenteve të SSK dhe RSM, iu kushtua rëndësi bashkëpunimit me shumë agjenci dhe këto procese u shoqëruan me takime javore në nivel ministror, si dhe përfshirje të ekspertëve për çështjet e sigurisë së energjisë, *cyber defence*, terrorizmin në Afganistan, etj.

Si përfundim, për këtë model mund të themi, se procesi i përpilimit të SSK të Britanisë së Madhe ka qenë gjithëpërfshirës, ku numri i aktorëve gjithmonë ka qenë në rritje. Strukturat e mbrojtjes nuk kanë pasur rol drejtues të procesit, por janë pjesë integruese e gjithë procesit. Një rol shumë të rëndësishëm luajnë institutet "*Think tank*". Procesi i përpilimit të SSK ka realizuar një përjasje të gjithë dokumenteve të lidhura drejtpërdrejt me sigurinë e vendit. Përfshirja e personelit me përvojë dhe ekspertëve të të gjitha fushave ka qenë element mjaft i rëndësishëm. Procesi i përpilimit të SSK ka ndikuar në ndryshimin e kulturës politike, sepse ka qasje të qeverisë dhe strukturave të tjera në të.

Disa rekomandime për procesin e formulimit të dokumentit të ri të SSK të vendit tonë

Së pari, vendi ynë ka krijuar një përvojë shumë të mirë në mënyrën sesi u zhvillua procesi i ndërtimit të dokumentit të *Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes*.¹⁷ Mendoj se ky format duhet të ruhet. Megjithëse shpesh krijohen shumë komisione e grupe pune nga shumë institucione dhe agjenci ku niveli i përfaqësimit të tyre është ai i drejtuesve të institucionit, ku shpeshherë, për arsye objektive, kontributi i tyre faktik është pothuajse një mision i pamundur. Mendoj që paralel me këtë format do të ishte shumë mirë që të ngrihej një grup i vogël pune me ekspertë të fushës së elementëve të fuqisë kombëtare, të cilët duhet të shpëputen nga detyrat e tyre funksionale dhe të merren vetëm me këtë detyrë duke iu lënë në dispozicion një kohe 3-6 mujore.

Së dyti ky grup duhet të jetë nën drejtimin e zyrës së kryeministrit, sepse në dokumentin e SSK shprehen të gjithë elementët e fuqisë kombëtare, që paraqiten nëpërmjet ministrive dhe agjencive përkatëse, por që, sipas hierarkisë dhe strukturës shtetërore, në krye të tyre është institucioni i kryeministrit. Gjithashtu, është ky institucion që shpreh objektivat e qeverisë, nëpërmjet programit të tij me marrjen e mandatit.

Së treti, nisur nga përvoja e dokumenteve të mëparshëm të SSK, mendoj se kryeministri duhet të jetë autoriteti i cili duhet të firmosë këtë dokument përpara se ai të kalohet për të marrë votimin në parlament. Dokumenti i SSK duhet të rishikohet brenda vitit të parë të krijimit të qeverisë së re. Praktikisht kjo duhet të bëhet në çdo 4 vjet.

Së katërti, krahas identifikimit dhe vlerësimit të rreziqeve dhe kërcënimeve që tashmë janë pasqyruar në dokumentet e mëparshëm, duhet të merren në konsideratë rreziqet dhe kërcënimet e Cyber Defence, Sigurisë Energjetike, Sigurisë Mjedisore si dhe lufta kundër korrupsionit dhe sundimi i ligjit.

¹⁷ Dokumenti i Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë. shkurt 2013.

Së fundmi, mendoj se duhet të ndryshohet mënyra e të shprehurit të dokumentit të SSK dhe të mos ndiqet praktika e shprehur në dokumentin ekzistues, por të shprehet në forma më përgjithësuese.

Bibliografia:

- Direktiva e Mbrojtjes 2014. Nr. 84, datë 8.1.2014.
- Dokumenti i Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, shkurt 2013.
- Stolberg, Alan G. "How Nation-States Craft/Draft National Security Strategy Documents", October 2012. <http://www.StrategicStudiesInstitute.army.mil/>
- Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë, miratuar me Ligj Nr. 9322, Datë 25.11.2004. Qendra e Shtypit, Botimeve dhe Përkthimeve Ushtarake. Tiranë, 2005.
- Koncepti i Ri Strategjik i NATO-s. Samiti i Lisbonës 2010.
- Harry R. Yarger, "Strategy and the national security professional: strategic thinking and strategy formulation in the 21st century" (British Library of Congress Cataloging-in-Publication Data, 2008).
- Politika e Sigurimit dhe e Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, Shtëpia Botuese e Ushtrisë. Tiranë, 1995.
- Ligji.Nr. 8571, datë 27.1.2000. Për miratimin e dokumentit të Politikës së Mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë.
- Ligji.Nr. 8572, datë 27.1.2000. Për miratimin e dokumentit të Strategjisë së Sigurisë të Republikës së Shqipërisë.

Operacionet COIN dhe David Galula

Nënkolonel Arjan Rroshi,
Pedagog në AFA

Nënkolonel Vladimir Imeraj
Pedagog në AFA

Trajtesë e shkurtuar. Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë vazhdojnë të kontribuojnë me trupa dhe kapacitete në operacionet e Aleancës brenda dhe jashtë zonës Euroatlantike. Ky është fakt domethënës për vendin tonë parë si në aspektin e një force gradualisht të vogël, ashtu edhe në aspektin e kapaciteteve që zotërojmë. Natyrisht, të qenurit anëtar i NATO-s ka përgjegjësitë dhe detyrimet e saj. Si e tillë, Qeveria Shqiptare dhe Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Shqipërisë si në programin e saj, ashtu edhe në takimet e lidershit politik e ushtarak me ato të Aleancës ka rikonfirmuar tashmë vendosmërinë për kontribut të mëtejshëm. Parë në këtë këndvështrim, lind pyetja. A është ky kontribut një sfidë për Forcat tona të Armatosura? A i zotërojmë ne kapacitetet e nevojshme njerëzore dhe materiale për të marrë përsipër përgjegjësi të reja? Dhe mbi të gjitha a i përshtatemi ne mjedisit të sotëm operacional të operacioneve të NATO-s? A zotërojmë ne doktrinën e duhur, të fundit të ndërthurur me atë të Aleancës, por të realizueshme në kushtet tona?

E gjithë kjo çka theksuam më lart lidhet me atë se si ne duhet të përgatitemi për përballimin e këtyre sfidave, për të qenë përfaqësues sa më dinjitoz dhe anëtar i denjë i Aleancës.

Natyra e konflikteve të sotme është bërë shumë më komplekse se më parë. Pjesëmarrja e trupave tona speciale në misionet në Afganistan e veçanërisht misioni “Eagle” ka shtruar nevojën për kërkimin e një doktrine bashkëkohore në studimin, përgatitjen dhe planëzimin e operacioneve kundër rebelimit. Është detyrë e jona që t’i japin forcave të luftimit, kurseve që zhvillohen në Akademinë e Forcave të Armatosura njohuritë koherente lidhur me këto lloj operacionesh.

Natyrisht përpjekjet janë të shumta dhe puna e bërë nuk mungon. Botimi i tekstit mësimor “Lufta kundër rebelimit” përgatitur me kontributin e përbashkët të pedagogëve të Akademisë së Forcave të Armatosura dhe Qendrës së Doktrinës në KDS e botuar nga kjo e fundit, është një ndihmë e dukshme. Por le të mos harrojmë bazën teorike që na afron Aleanca dhe ushtritë e tjera partnere si ajo e SHBA, e cila zotëron një doktrinë të posaçme për këtë. Ajo çka duam të theksojmë është pikërisht fakti që këto ushtri moderne i referohen shumë dhe historisë, veçanërisht ekspertëve të operacioneve kundër rebelimit.

Le t'i referohemi pikërisht njërit prej tyre, David Galulës, për t'i ardhur në ndihmë edhe kurseve në Akademinë e Forcave të Armatosura për ta patur si referencë edhe në punën e tyre kërkimore- shkencore. Përvajës së tij i është referuar edhe ushtria amerikane në përgatitjen e manualit të saj "Për operacionet kundër rebelimit".

Kush ishte David Galula?

Lindur në qytetin Sfax të Tunizisë, pjesë e protektoratit francez, *David Galula* rridhte nga një familje tregtare hebraike. Përfundoi shkollën speciale ushtarake në Saint-Cyr. *Galula* mbahet si arkitekti i doktrinës së luftës kundër rebelimit (COIN). Ai arriti të jepte përshkrimet, librat e tij pas një eksperience shumëvjeçare në zona të ndryshme të globit. Pasi u largua nga ushtria franceze, ai jetoi në Afrikën e Veriut. Atje u bashkua me Korpusin e parë të Ushtrisë Çlirimtare në luftën për çlirimin e Francës ku dhe u plagos gjatë pushtimit të Elbës, në qershor të vitit 1944. Në vitin 1945, u zhvendos në Kinë ku shërbeu si ndihmës atashe ushtarak në ambasadën Franceze të Pekinit. Gjatë kësaj kohe, ai u bë dëshmitar i lindjes së Partisë Komuniste Kineze. Në vitin 1948, gjatë luftës civile greke, *Galula* ishte pjesë e Komitetit Special të Kombeve të Bashkuara në Ballkan (UNSCOB). Gjatë viteve 1952-1956 shërbeu si atashe ushtarak në konsullatën Franceze të Hong Kongut. Gjatë kësaj periudhe kohore ai vizitoi ishujt Filipine dhe studioi luftën indokineze, pa marrë pjesë personalisht në të.

Nga gushti i vitit 1956 deri në prill të vitit 1958, me gradën Kapiten, ai drejtoi kompaninë e tretë të batalionit të 45^{-të} të këmbësorisë Koloniale Franceze. Gjatë kësaj lufte ai u dallua në përdorimin e taktikave kundër rebelimit (COIN), me anë të të cilave ai arriti të eliminonte me sukses të plotë rebelimin nacionalist në sektorin e tij të përgjegjësisë dhe, si rezultat, fitoi ngritje në detyrë. Në vitin 1958 ai u transferua në Shtabin e Mbrojtjes Kombëtare në Paris, ku dhe mori pjesë si lektor në një sërë konferencash ndërkombëtare. Më vonë ndoqi Kolegjin e Shtabit të Forcave të Armatosura. Në vitin 1962 *Galula* dha dorëheqjen nga pozicioni i tij dhe u largua për studime në SHBA. Atje ai fitoi një pozicion si kërkues shkencor në Qendrën për Çështjet Ndërkombëtare të Universitetit të Harvardit. Në vitin 1964 ai vdiq si pasojë e kancerit në mushkëri.

Të gjithë eksperiencën e jetës së tij në Indokinë, Greqi, Algjeri, ai e përmbledhi në dy botime: "Paqja në Algjeri" në vitin 1963 dhe "Lufta Kundër Rebelimit" (teori dhe praktikë) në vitin 1964. Sipas teorisë së tij, në luftën revolucionare/kundër rebelimit, 80% e veprimeve janë politike dhe vetëm 20% e tyre janë ushtarake.

Katër "ligjet" që Galula propozon në luftën kundër rebelimit

Së pari, synimi i luftës, më shumë se për të kontrolluar territore është sigurimi i mbështetjes popullore. Kjo është e vlefshme si për rebelët, ashtu edhe për forcat kundër rebelimit. Qëllimi kryesor për forcat kundër rebelimit nuk është si të pastrohet një zonë, por se si të mbahet një zonë e pastër, kështu që forcat kundër rebelimit të mund të operojnë në një zonë tjetër. Kjo mund të arrihet vetëm me mbështetjen e popullsisë vendase. Është shumë i lehtë shkatërrimi dhe largimi i rebelëve nga një zonë e caktuar duke përdorur forca ushtarake. Nëse është e mundur të kryhet shkatërrimi i organizatave politike të rebelëve me anë të veprimeve intensive të policisë, është e pamundur ndalimi i rikthimit të rebelëve dhe rindërtimi i organizatave politike pa patur bashkëpunimin e popullsisë. Si rrjedhojë, popullsia kthehet në një objektiv të veçantë për forcat kundër rebelimit, sikurse është edhe për forcat rebele. E vërteta është se në fillim të konfliktit

rebelët janë gjithmonë më afër popullsisë dhe kanë më shumë mundësi për të bashkëpunuar me popullsinë vendase, pasi edhe ata vetë janë pjesë e popullsisë.

Së dyti, shumica e popullsisë është neutrale në konflikt dhe mbështetja e masave popullore mund të sigurohet me ndihmën e minoritetit aktiv miqësor. Mbështetja nuk tregohet vetëm më anë të formës së simpatisë apo miratimit, por edhe me pjesëmarrjen aktive në luftën kundër rebelëve. Në çdo situatë, çfarëdo që të jetë kauza, do të ekzistojë një minoritet aktiv pro kauzës, një minoritet aktiv asnjans dhe një minoritet aktiv kundër saj. Teknika për të realizuar suksesin bazohet në mbështetjen mbi minoritetin aktiv pro kauzës, me qëllim që të bëjmë për vete minoritetin asnjans dhe të neutralizojmë minoritetin kundër kauzës sonë. Në çështjet ekstreme, kur kauza dhe rrethanat janë jashtëzakonisht të mira ose të këqija, njëri nga minoritetet zhduket ose bëhet i pallogaritshëm. Por ekzistenca e çështjeve të tilla është shumë e rrallë. Kushtetuta dhe ligjet mund të diktojnë kufizime, qëllimi mund të jetë i mirë ose i keq, por ligji qëndron mbi gjithçka pavarësisht variacioneve të ndryshme, të cilat mund të jenë të panumërta në sasi e formë, pasi ligji zbatohet në mënyrë të pavetëdijshme në shumicën e shteteve. Ligji nuk mund të vazhdojë të injorohet apo zbatohet në mënyrë të pavetëdijshme në shtetet e përfshira nga lufta revolucionare/rebele, në rastet kur fuqia e forcave kundër rebelimit sfidohet nga minoriteti aktiv nëpërmjet subversionit dhe angazhimit të drejtpërdrejtë. Forcat kundër rebelimit që refuzojnë të zbatojnë ligjet për qëllimet e tyre, forcat që mbështeten vetëm në kufizimet e kohës së paqes, kanë tendencën për ta zvarritur luftën, pa arritur t'i afrohen fitores. Deri në çfarë mase do të vendosen kufizimet, është çështje etike dhe serioze.

Të gjitha llojet e luftërave janë të pamëshirshme. Por lufta revolucionare/rebele mund të konsiderohet si më e pamëshirshme, ku çdo banor me apo pa dashje, në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe aktive, bëhet pjesë e konfliktit, për të vetmen arsye se rebelët nuk mund të pranojnë neutralitetin e tyre. Mizoria e luftës revolucionare/rebele nuk është mizori masash/anonime, por është specifikisht e individualizuar dhe personale. Nuk mund të ekzistojë krim më i madh për forcat kundër rebelimit sesa pranimit ose përshtatja e tyre në një konflikt të tejzgjatur, ose tërheqja para kohe nga zona e konfliktit, pa u plotësuar kushtet e tërheqjes. Problemi strategjik për forcat kundër rebelimit mund të përcaktohet si "*Gjetja e minoritetit mbështetës, organizimi i tyre me qëllim mobilizimin e popullsisë kundër rebelëve*". Çdo lloj operacioni, qoftë ushtarak, politik, ekonomik, social apo psikologjik duhet të çohet deri në fund. Sa më e drejtë të jetë çështja dhe situata, aq më i madh do të jetë minoriteti aktiv që favorizon forcat kundër rebelimit. Në këtë mënyrë, realizimi i misionit nga forcat kundër rebelimit do të jetë shumë më i lehtë për t'u arritur. Kjo e vërtetë e rëndomtë dikton synimin kryesor të propagandës, tregon që çështja dhe situata e forcave kundër rebelimit është më e mirë se ajo e forcave rebele. Dhe më e rëndësishme, nënvizon nevojën e forcave kundër rebelimit për të dalë me një kundër kauzë të pranueshme nga popullsia vendase.

Së treti, popullsia duhet të mbrohet në mënyrë efikase, me qëllim që të bashkëpunojë pa frikë apo pa u ndëshkuar nga pala kundërshtarë. Pasi rebelët vendosin ndikimin e tyre ndaj popullsisë, minoriteti, i cili ishte armiqësor ndaj tyre, do të bëhet i pallogaritshëm. Disa nga anëtarët e tyre do të jenë eliminuar fizikisht, duke u bërë shembull për të tjerët. Një pjesë do të kenë ikur jashtë apo do të jenë struktur duke fshehur ndjenjat e tyre të vërteta dhe do të jenë asimiluar me shumicën e popullsisë; ndërsa një numër i vogël do të jenë akuzues ndaj organizatave politike dhe do të nxisin dënimin nga njësitë rebele.

Minoriteti armiqësor ndaj rebelëve nuk do dhe nuk mund të shfaqet për sa kohë që rreziku nuk është eliminuar deri në njëfarë mase të pranuar. Për më tepër edhe pasi rreziku të jetë eliminuar, shfaqja e mbështetësve kundër rebelëve nuk do të jetë në gjendje të mbledhë masën dërrmuese të popullsisë derisa popullsia të bindet që forcat kundër rebelimit zotërojnë dëshirën, mjetet dhe aftësinë për të fituar. Kur një njeri rrezikon jetën e tij, nevojitet shumë më tepër se propagandë për ta bërë atë të lëvizë dhe të bashkohet me një palë të caktuar.

Nga ky ligj mund të nxjerrim katër deduksione të ndryshme:

- Veprime efektive politike mbi popullsinë duhet të paraprihen nga operacione ushtarake dhe policore kundër forcave rebele dhe organizatave politike të tyre.
- Reformat politike, sociale, ekonomike e të fushave të tjera, sado që të jenë të dëshiruara, nuk mund të kenë efektivitetin e dëshiruar nëse ofrohen në kohën që rebelët zotërojnë kontrollin mbi popullsinë.
- Forcave kundër rebelimit u nevojitet një sukses bindës sa më shpejt të jetë e mundur, me qëllim që të demonstrojnë se ata zotërojnë dëshirën, mjetet dhe aftësitë për të fituar.
- Forcat kundër rebelimit nuk mund të futen në bisedime të sigurta, nëse nuk janë në një pozicion dominues ndaj rebelëve. Në të kundërt, mbështetësit e tyre do të bashkoheshin me anën tjetër, atë të rebelëve.

Së fundmi, vendosja e rendit duhet të kryhet në mënyrë progresive duke larguar apo zhvendosur kundërshtarët e armatosur. Në vazhdim duhet të përftohet mbështetja e popullsisë, duhet përfunduar pozita duke ndërtuar infrastrukturën dhe vendosur marrëdhënie afatgjata me popullsinë. Ky veprim duhet realizuar në çdo zonë, duke filluar nga një zonë paqësore që mund të gjendet brenda rajonit të përgjegjës, duke u zgjeruar në zonat e tjera kufitare, derisa të arrihet sukcesi në të gjithë rajonin e dëshiruar. Në këtë mënyrë, ligjet e *Galula*-s nxjerrin në pah rëndësinë e aforizmave, bazuar në idetë e liderit kinez *Mao Tze Tung* "Populli është deti në të cilin noton revolucioni".

Galula arrin në përfundimin se fitorja në luftën kundër rebelimit (COIN) nuk është shkatërrimi i ndonjë zone të caktuar që është nën drejtimin e rebelëve apo forcave të tyre politike. Fitorja është izolimi total i rebelëve nga popullsia, i cili nuk arrihet duke e detyruar me forcë popullsinë, por duke punuar për popullsinë, duke u plotësuar kushtet e nevojshme, me qëllim që vetë popullsia të distancohet nga pala rebele. Në luftën konvencionale fuqia vlerësohet me ushtrinë apo forca të tjera të matshme, sikurse mund të jenë sasia e divizioneve në përdorim, pozicioni që ata mbajnë, burimet industriale, etj. Në luftën revolucionare/COIN, fuqia duhet të vlerësohet nga shkalla e mbështetjes së popullsisë. Kundër rebelimit arrin njëfarë sukcesi dhe fuqie kur depërton në një organizim politik të dalë dhe mbështetur nga populli.

Me këto katër ligje në mendje, *Galula* vazhdon më tej duke përshkruar një strategji të përgjithshme ushtarake dhe politike, të ndërmarrë në një territor të ndodhur totalisht në kontrollin e rebelëve.

Në një terren, zonë dhe situatë të tillë, thekson ai, ndiq hapat e mëposhtëm:

- Përqendro forca ushtarake të mjaftueshme për të shkatërruar ose dëbuar forcat kryesore të armatosura rebele.
- Poziciono në zonat ku banon dhe jeton popullsia vendase trupa me fuqi të

- mjaftueshme për të ndaluar rikthimin e rebelëve.
- Krijohet/vendos kontakte me popullsinë vendase, kontrollo lëvizjet e tyre me qëllim shkëputjen e lidhjeve të tyre me forcat rebele.
- Shkatërro organizatat politike të rebelëve lokalë.
- Vendos, me anë të zgjedhjeve, autoritete të reja drejtimi në ato zona.
- Testo këto autoritete duke u ngarkuar detyra të shumta konkrete. Zëvendëso ato autoritete që nuk u japin dot zgjidhje situatave dhe janë jo kompetentë në detyrën e tyre. Organizohet/krijohet njësi vetëmbrojtjeje.
- Grupet dhe edukohet liderët në një lëvizje kombëtare politike.
- Fito ndaj mbetjeve të fundit të rebelëve ose jepu fund aktiviteteve të tyre në zonën e përgjegjësisë.

Disa nga këto hapa edhe mund të anashkalohen në zona që janë pjesërisht nën kontrollin e forcave rebele. Shumica e tyre janë të panevojshme në zonat që janë të kontrolluara nga qeveritë pro forcave kundër rebele. Esenca e luftës kundër rebelimit përmbledhet nga Galula në këtë mënyrë: “Ndërto ose rindërto organizime politike nga pjesa e lartë e popullsisë vendase”.

Por ajo çka thekson Galula dhe çka mendojmë se është e rëndësishme dhe aktuale edhe sot është i ashtuquajtur “*adaptimi i mendjeve*”. Ç’do të thotë kjo?

Nëse forcave u duhet të përshtaten me misionin e tyre të ri, është shumë e rëndësishme që mendjet e liderëve civilë dhe ushtarakë të përshtaten sipas kërkesave speciale të luftës kundër rebelimit. Reflektet dhe vendimet që mund të konsiderohen të duhurat për një lider ushtarak në luftën konvencionale dhe për shërbyesit civilë në kohë normale, jo domosdoshmërisht do të jenë të duhurat në situatat kundër rebelimit. Në luftën konvencionale një lider ushtarak duhet të përdorë të gjithë arsenalin që zotëron kundër armikut, në të kundërt ai do të dënohet për braktisje apo shkelje të detyrës. E kundërta duhet të përdoret në rastet e luftës kundër rebelimit, ku rregullisht është që të përdoret minimumi i zjarrit. Në luftën konvencionale, detyra e luftëtarit është të mundë armikun përballë. Ndërsa në luftën kundër rebelimit detyra e tij është të japë ndihmën e tij për të fituar mbështetjen e popullsisë.

Doktrina e tij është e përfunduar me një teori të rëndësishme në lidhje me njerëzit dhe me çfarë i motivon ata të marrin armët, apo të bëhen palë me ata që marrin armët. Teoria e tij thekson se në kohët e rrezikshmërisë/luftës shumica e njerëzve motivohen nga një nevojë kryesore për siguri. Por gjithashtu, do të ekzistojë një numër i vogël njerëzish – nxitësit kryesorë të lëvizjes – të cilët do të jenë të motivuar nga ideologjia ose fanatizmi. Këta persona janë edhe besuesit e vërtetë të kauzës së ngritur.

Një faktor mjaft të rëndësishëm për realizimin e misionit, ndryshe nga operacionet e mirëfillta luftarake, në operacionet kundër kryengritësve, Galula konsideron popullsinë. Numri i madh i popullsisë ndikon në luftën revolucionare në të njëjtën mënyrë sikurse edhe madhësia e shtetit: sa më shumë banorë të ketë një shtet, aq më e vështirë do të jetë për të patur kontroll mbi ta. Por ky faktor mund të zbutet ose zmadhohet nga densiteti dhe shpërndarja e popullatës. Sa më e shpërndarë të jetë popullsia, aq më e lehtë do të jetë për rebelët; kjo është dhe arsyeja përse rebelët në Malaja, Algjeri dhe Vietnamin e Jugut tentonin që të rigruponin popullsinë (sikurse edhe në Kamboxhia në vitet 1950 - 1952). Në rastet kur popullsia në zonat rurale dominon mbi atë në zonat urbane, rebelët do të kenë avantazh domethënës; për shembull, përpjekjet kundër rebelëve në Algjeri

ishin jo të favorshme, pasi mbështeteshin vetëm mbi popullsinë evropiane të vendosur në qytete (Algjer dhe Oran). Kontrolli mbi një qytet ka varësi të madhe nga furnizimet e jashtme, kërkon forca më të vogla me qëllim kontrollin e së njëjtës sasi popullsie të shpërndarë në zonat rurale. Bën përjashtim rasti i revoltave popullore, që zakonisht nuk zgjat për një kohë të gjatë.

Shkalla e zhvillimit dhe forcimit të ekonomisë mund të ketë impakt në dy drejtime. Një shtet shumë i zhvilluar është shumë i rrezikuar nga një valë e shkurtër dhe intensive e terrorizmit. Por, nëse terrorizmi tejzgjatet, përçarja merr përmasa të tilla, sa që popullata nuk mund ta ndalojë atë, dhe si pasojë mund të kthehet kundër terroristëve edhe pse fillimisht nuk ishte kundër tyre. “*Standardi i ulët i jetesës dhe mungesa për reforma ekonomike mund të bëhet shkak për konflikte dhe pakënaqësi të grupeve të caktuara që mund të kenë objektiv rrëzimin e qeverisë legjitime*”... - theksohet në manualin amerikan për operacionet COIN.¹

Një shtet i pazhvilluar është më pak i rrezikuar nga terrorizmi, por më shumë i hapur ndaj një lufte guerile. Kjo situatë ndodh pasi rebelët nuk mund të jenë eficientë në një shtet me infrastrukturë të mirë transporti dhe komunikimi dhe popullsia mbart një nivel më të lartë të despotizmit.

Si përmbledhje, situata ideale për rebelët do të ishte një shtet i madh, pa dalje në det dhe me sipërfaqe të madhe të mbuluar nga xhunglat. A i plotëson pikërisht Afganistani këto kushte ku rebelët kanë gjetur “qiej të sigurtë”? Përgjigja është e thjeshtë, po t’i referohemi pozicionit gjeografik, ekonomisë dhe popullsisë që ky vend ka. Por jo pak tregon edhe dështimi i ushtrisë ruse në këtë vend.

Gjithashtu, sipas ekspertit të luftës kundër rebelimit, *Galula*, nëse burimet brenda vendit mungojnë, rol vendimtar luan faktori i jashtëm, i cili mund të jetë në formë të ndryshme, mbështetja morale. Me anë të saj, rebelët përfitojnë pa bërë asnjë përpjekje nga ana e tyre duke u siguruar që “era e historisë” shkon sipas rrjedhës së tyre. Mbështetja morale shprehet nga pesha e opinionit publik nëpërmjet mjeteve të shumta të komunikimit dhe mediave. Propaganda është arma kryesore e saj. Ajo përdoret për të lëkundur opinionin publik në rastet kur është kundër ose për të përforcuar simpatinë ekzistuese të publikut.

Synimi i rebelëve është për t’i kthyer zonat e pushtuara në zona rebelimi, zonat e rebelimit në baza rebelimi dhe këto të fundit në baza të rregullta rebelimi. Me qëllim mobilizimin e popullsisë, çdo banor që është nën kontrollin e rebelëve i përket të paktën dy organizatave: e para horizontale, është një organizatë gjeografike me shtrirje në lagje, fshatra apo qytete. Tjetra vertikale, grupon banorët sipas kategorive të ndryshme: moshës, seksit, profesionit, etj.

Deri tani dhamë një përshkrim në detaje rreth teorisë dhe doktrinës së ekspertit *Galula* në lidhje me operacionet COIN. Por a është e vlefshme ende në ditët e sotme teoria dhe doktrina e tij?

Lidhur me këtë çështje, do të marrim në konsideratë dhe do të shqyrtojmë konfliktet e ndodhura kohët e fundit në rajone të ndryshme të rruzullit tokësor. Le të fokusohemi në dy konflikte të ndodhura në rajone të ndryshme nga njëri-tjetri. Konkretisht në konfliktin e Kosovës të vitit 1999 dhe konfliktin e Afganistanit në vitin 2001 e vazhdim. Po t’i

¹ FM: 3.24.2 “Tactics in counterinsurgency”, faqe 1-4.

analizojmë këto konflikte sipas katër ligjeve dhe teorisë së ekspertit *Galula*, do të dalim në përfundimin se teoria e tij po zbatohet edhe në konfliktet e ditëve tona.

Le të analizojmë konfliktin në Kosovë.

Fillimisht në këtë konflikt ekzistonin dy palë: ajo kosovare dhe serbe. Me përshkallëzimin e konfliktit, komuniteti ndërkombëtar, veçanërisht NATO, u bë pjesë e konfliktit.

Si ndikoi mbështetja e popullsisë vendase në këtë konflikt? Gjenerali *Rupert Smith* thekson “Në luftë gjëja më e rëndësishme është të fitosh mbështetjen dhe vullnetin e popullsisë”.²

Që në çastet e para të ndërhyrjes ndërkombëtare, zonat e Kosovës në të cilat popullsia ishte pro ndërhyrjes së NATO-s ishin pikat fillestare të ndërhyrjes ndërkombëtare. Ajo përbëhej kryesisht nga popullsia shqiptare e Kosovës. Në këto rajone, paqja dhe stabiliteti u arrit të vendosej që në krye të herës. Forcat ndërkombëtare e fokusuan operacionin duke u mbështetur te popullsia shqiptare e Kosovës. Edhe popullsia shqiptare nga ana e saj e mbështeti fuqimisht ndërhyrjen, pasi ishte e bindur në dëshirën, kapacitetet dhe aftësinë e tyre për ta realizuar me sukses misionin. Dhe me kalimin e kohës në këto rajone u përforcua rendi ligjor dhe bashkëjetesa e popullatës vendase me ndërkombëtarët ishte shumë bashkëpunuese. Shumica dërrmuese e planeve dhe projekteve të ndërkombëtarëve kanë ecur sipas parashikimeve. E kundërta ka ndodhur dhe po ndodh në rajonet me popullsi serbe, të cilët kanë qenë dhe janë kundër ndërhyrjes ndërkombëtare. Edhe sot, 15 vite pas ndërhyrjes, rendi ligjor dhe bashkëpunimi i popullatës serbe me ndërkombëtarët është në nivele minimale. Ndërkombëtarët kanë arritur të sigurojnë avantazhe shumë minimale, pasi nuk gëzojnë mbështetjen e popullsisë. Rol shumë të rëndësishëm ka luajtur dhe propaganda nga elementë destabilizues në zonat serbe, si dhe vetë Beogradi zyrtar herë në mënyrë të drejtpërdrejtë e herë në mënyrë të tërthortë. Si rrjedhojë, shumica dërrmuese e popullatës serbe e sheh të ardhmen e saj tek Beogradi apo tek liderët lokalë që mbështeten nga Beogradi. Përse e përdorëm gjithë këtë analizë? Për të dalë pikërisht te pika më e rëndësishme në këtë konflikt, e cila lidhet edhe me objektin e këtij materiali pra, me ligjin e katërt të *Galula*-s, ligj që ka të bëjë me unifikimin e përpjekjeve të të gjitha palëve dhe organizmave ndërkombëtare në zgjidhjen e këtij konflikti. Po t’i referohemi mësimet të nxjerra nga operacione të ndryshme të Aleancës, aty theksohet se “*Realizimi i bashkëpunimit kërkon botëkuptim nga të gjithë pjesëmarrësit ushtarakë, civilë, organizatat humanitare e të zhvillimit, të kuptojnë politikën, kulturën, kapacitetet, fuqinë e njëri-tjetrit, burimet dhe kufizimet*”.³

Shumë shtete, organizma ndërkombëtarë apo individë me influencë ose nuk japin maksimumin e tyre në zgjidhje të kësaj krize, ose në të kundërt minojnë përpjekjet e partnerëve të tyre duke e tejzgjatur krizën, duke e dërguar drejt një konfuziteti ekstrem, si dhe duke u munduar të demoralizojnë palët që duan ta zgjidhin krizën.

Le të analizojmë për analogji konfliktin në Afganistan, për të parë se si reflektohen ligjet e *Galula*-s në këtë konflikt.

Të gjithë aktorët pjesëmarrës në konfliktin në Afganistan, tanimë janë të bindur se pa arritur mbështetjen e popullsisë vendase, konflikti nuk do të arrijë të zgjidhet kurrë. Pa

² Gjeneral Rupert Smith, “Lessons learned in peacekeeping operations”.

³ David Lightburn rishikon përvojën paqeruajtëse të NATO-s dhe krahason si Aleanca dhe Kombet e Bashkuara janë duke zbatuar mësimet e nxjerrë prej saj.

arritur të shkëputen lidhjet e talebanëve dhe grupimeve të tjera ekstremiste në Afganistan me popullsinë lokale, ndërkombëtarët dhe Qeveria Afgane do ta kenë të pamundur kontrollin e territorit afgan. Për realizimin e këtij qëllimi ndërkombëtarët duhet të bindin popullsinë afgane se ata janë të duhurit dhe jo talebanët. Gjë që nuk ka ndodhur gjatë këtyre 12 viteve të konfliktit. Më shumë se gjysma e popullsisë afgane nuk beson se ndërkombëtarët kanë dëshirën, qëllimin dhe aftësinë për të dërguar rajonin drejt stabilitetit.

Në fillimet e konfliktit, në vitin 2001, u duk se ndërkombëtarët (amerikanët) po ecnin në rrugën e duhur. Ata shfrytëzuan minoritetin aktiv në veri të Afganistanit, nga ku nisën veprimet e tyre dhe filluan zgjerimin drejt zonave të tjera me qëllim shtrirjen e kontrollit në të gjithë Afganistanin (shfrytëzim i përpiktë i ligjit të dytë të Galula-s në operacionet COIN). Në vitet e para u duk se situata po ecte sipas parashikimeve dhe se çështja do të ishte nën kontroll. Me kalimin e kohës, aleatët filluan të kishin mosmarrëveshje ndërmjet tyre. Jo të gjithë aleatët ecën dhe punuan nën të njëjtin qëllim dhe drejtim, duke cenuar unifikimin e përpjekjeve për zgjidhjen e kauzës. Herë për qëllime individuale të shteteve pjesëmarrëse, herë për kapriço të pajustificueshme, ndërkombëtarët e kanë tejzgjatur zgjidhjen e kauzës afgane. Këtu del në pah lidhja me Galula-n e pikërisht me ligjin e katërt të tij ku theksohet se: *“Vendosja e rendit duhet të kryhet në mënyre progresive duke larguar apo zhvendosur kundërshtarët e armatosur. Pastaj duhet të përfitohet mbështetja e popullsisë dhe në vazhdim duhet përforcuar pozita duke ndërtuar infrastrukturën dhe vendosur marrëdhënie afatgjata me popullsinë. Ky veprim duhet realizuar në çdo zonë, duke filluar nga një zonë paqësore që mund të gjendet brenda rajonit të përgjegjesisë dhe duke u zgjeruar në zonat e tjera kufitare, derisa të arrihet suksesi në të gjithë rajonin e dëshiruar”*.⁴

Në vitet e para pas fillimit të konfliktit, kohë kur ndërkombëtarët kishin arritur rezultate të kënaqshme, popullsia afgane po afrohej dhe po tregohej bashkëpunuese me forcat aleate. Në atë kohë ata gjetën te ndërkombëtarët një forcë dhe dëshirë për ta zgjidhur në mënyrë të drejtë konfliktin. Por në momentin kur ata panë se ndërkombëtarët po e zvarritnin situatën, filluan të largohen dhe të mos ishin pjesë e zgjidhjes.

Në ditët e sotme aktorët kryesorë, të cilët po tentojnë zgjidhjen e konfliktit afgan, po bëjnë të pamundurën për të bindur aleatët dhe forcat në terren se fitimi i besimit të popullsisë vendase është çelësi i suksesit. Mund të citojmë thënie shumë të rëndësishme të politikanëve dhe gjeneralëve kryesorë amerikanë e evropianë në lidhje me këtë çështje: *“Kjo është një luftë krejt ndryshe. Strategjia jonë nuk duhet të fokusohet në kapjen e terrenit apo në shkatërrimin e forcave rebele; objektivi ynë duhet të jetë popullsia. Të fitosh mbështetjen e tyre kërkon kuptim më të mirë të zgjedhjeve dhe interesave të popullsisë. Ne duhet të ndryshojmë kulturën operacionale për t’u lidhur me popullin. ISAF duhet të fokusohet në mbrojtjen e popullit afgan, kuptimin e ambientit të tyre dhe ndërtimin e marrëdhënieve me të”*.⁵

Gjeneral *Petraeus* u mundua të ecë në të njëjtin drejtim. Ai punoi shumë për të bindur aleatët dhe trupat në terren se fitorja në Afganistan do të vinte nga fitorja e besimit popullor. Ai theksonte se fitimi i mendjeve dhe zemrave afgane do të çonte drejt suksesit,

⁴ “A Counterinsurgency Campaign Plan Concept: The Galula Compass A Monograph by Major Stephen Vrooman US Army”.

⁵ Gjen. McChrystal, Komandant i ISAF 2009.

pavarësisht se nuk është e lehtë për t'u realizuar. Kjo gjë kërkon përpjekje dhe unifikim të të gjitha resurseve, mjeteve dhe aktorëve në dispozicion. Ai bëri maksimumin për t'i nxjerrë trupat e ISAF nga bazat ushtarake dhe t'i dërgonte në terren, me qëllim që të ishin sa më pranë popullsisë, t'u tregonin atyre arsyen e ndodhjes atje, si dhe vendosmërinë e tyre për ta zgjidhur krizën. Sipas Gjeneral. *Petraeus* forcat ushtarake duhet të jenë shumicën e kohës atje ku ndodhet, jeton dhe ushtron aktivitetin e tyre popullsia afgane, t'i qëndrojnë asaj sa më pranë, duke i dhënë sigurinë e nevojshme. Që populli afgan të ndjehej i sigurtë në vendin e tij, ai mendonte të krijonte ndarjen përfundimtare të popullsisë nga talebanët dhe aktorët e tjerë rebelë në rajon. Në këtë mënyrë ai zvogëloi në maksimum propagandën talebane mbi popullsinë vendase. Në këtë drejtim Gjeneral. *Petraeus* arriti rezultate të shkëlqyera. Kjo për arsyen se ai vinte nga një eksperiencë domethënëse në Irak, ku gjithashtu kishte arritur mjaft sukses. Kjo ishte dhe arsyeja kryesore se përse Presidenti i SHBA-ve Barak Obama ia besoi Gjeneral *Petraeus* detyrën e drejtimit të operacionit ISAF disa vite më parë.

Talebanët, nga ana e tyre, po e përdorin në mënyrë efikase popullsinë afgane. Me anë të një propagande shumë aktive ata kanë arritur të bindin shumicën e popullsisë se ndërkombëtarët nuk kanë aftësinë për ta kontrolluar situatën në vend dhe se ata janë të vetmit që mund të stabilizojnë situatën, kështu që populli duhet të ndjekë ata e jo ndërkombëtarët. Në rast të mosbindjeve ata përdorin shantazhin dhe dhunën për të detyruar popullsinë t'u bindet atyre dhe mos të bashkohet me forcat aleate. Momentalisht popullsia afgane vazhdon të jetë në një dilemë të madhe, të bashkohen me ndërkombëtarët apo të jenë pranë talebanëve? Duhet theksuar se ndërkombëtarët nuk kanë shumë kohë në dispozicion, pasi afërsisht pas një viti duhet që shumica e trupave ushtarake të tërhiqen nga vendi dhe drejtimin total të situatës ta marrin institucionet vendase.

Pra, siç e pamë në këta dy shembuj të dhënë më sipër, Kosovës dhe Afganistanit, ku edhe mund të shtojmë edhe shume raste të ngjashme si ai Irakut apo konflikteve në kontinentin e Afrikës, popullsia është elementi kyç në fitore gjatë operacioneve COIN. Po të analizojmë me vëmendje veprimet dhe ndërhyrjen e ndërkombëtarëve në këto konflikte, të duket sikur po vënë në praktikë në mënyrë të përpiktë doktrinën e *David Galula*-s. Edhe kjo, në pikëpamjen tonë është më se e vërtetë. Katër ligjet e *Galula*-s dhe teoria e tij e operacioneve COIN janë ndjekur në mënyrë kronologjike nga palët pjesëtare në konflikte, pavarësisht se cila nga palët e ka zbatuar në mënyrë më korrekte dhe gëzon avantazh domethënës mbi kundërshtarin përballë.

Përfundime

Doktrina dhe teoria e shkruar dhe e ideuar më shumë se gjysmë shekulli më parë nga eksperti *David Galula*, ruan edhe sot e kësaj dite freskinë e saj. Për më tepër mund të themi se kjo doktrinë duket sikur është ideuar konkretisht për ditët e sotme, sepse po jetojmë në një kohë kur lufta konvencionale pothuajse duket se është shuar së ekzistuari. Operacionet në përgjigje të krizave janë thelbi i epokës sonë. Këto lloj operacionesh (operacionet e mbështetjes së paqes, OMP) duket se trendin e kanë drejt operacioneve COIN, pasi shumica e konflikteve kohët e fundit nuk po zhvillohen mes dy apo më shumë shteteve, por brenda një shteti të vetëm. Po të shohim trazirat e 3-4 viteve të fundit do të vëmë re krizën e "Pranverës Arabe", krizat e shumta në kontinentin Afrikan dhe së fundmi konflikti i tejzgjatur i Sirisë. Dhe shumë e shumë kriza apo trazira lokale në rajone të ndryshme të globit. Në të gjitha konfliktet e lartpërmendura, ku populli

ngrihet dhe rebelohet kundër qeverive dhe regjimeve të tyre, kanë dominuar operacionet COIN.

Ja pse është e rëndësishme dhe aktuale doktrina e *Galula*-s në lidhje me operacionet COIN; mendja e tij e mprehtë dhe e ndritur që analizon në detaje veprimet dhe kundërveprimet që duhet të ndërmerren për të qenë sa më i suksesshëm në këto operacione. E theksojmë këtë, pasi edhe sot e kësaj ditë shumë drejtues ushtarakë apo politikë nuk arrijnë ta kuptojnë idenë e operacioneve COIN. Konfliktet po tejzgjaten dhe po shkojnë drejt një amullie pa fund. Eksperti *David Galula* këtë teori e kuptoi dhe e konceptoi afër 50 vite më parë, për më tepër në një epokë që dominohej nga lufta konvencionale dhe ajo e ftohtë. Sot doktrina dhe teoria e tij është më e freskët dhe më e gjallë se kurrë. Ajo po dominon konfliktet/krizat e sotme. Ndaj le t'i referohemi më shumë atij dhe ekspertëve të tjerë, taktikat e të cilëve kanë dominuar në konfliktet dhe operacionet e këtij lloji, pse jo edhe në ato me spektër të plotë. Le të shërbejë ky material edhe si nxitje për të kërkuar më tepër e për të përshtatur nocionet dhe teoritë, për të bërë analiza e krahasime të së kaluarës me të sotmen, për t'i reflektuar ato në operacionet e Forcave tona të Armatosura.

Bibliografia:

- Allied Joint Doctrine for Counterinsurgency (COIN), AJP-3.4.4.
- FM 3-24 MCWP 3-33.5 "Counterinsurgency", December 2006: Headquarters Department of the Army
- "A Counterinsurgency Campaign Plan Concept: The Galula Compass A Monograph by Major Stephen Vrooman US Army.
- Galula, David. "Counterinsurgency Warfare; Theory and Practice". New York: Frederick A. Praeger, Publishers, 1964.
- O'Neill, Bard E. "Insurgency and Terrorism: Inside Modern Revolutionary Warfare". USA: Brassey's Inc, 1990.
- Jason Rineheart "Counterterrorism and Counterinsurgency".
- Insurgency and counterinsurgency in the 21st century":
- Steven Metz, Raymond Millen "Reconceptualizing threat and response" November 2004.

Roli i rojës bregdetare shqiptare në mjedisin detar dhe ndikimi i anijeve cisternë gjatë procesit të ballastimit

Kol. MSc. Riza Zaja
Programi i Doktoraturës 2011-2014, AFA

MSc. Bledar Sakaj
Programi i Doktoraturës 2011-2014, AFA

Trajtesë e shkurtuar. Aktualisht në Shqipëri dhe konkretisht në gjirin e Vlorës është ndërtuar porti i Petroliferës, i cili ka bërë që në gjirin e Vlorës të operojnë një numër i madh anijesh cisternë. Një numër i madh ambientalistësh në Shqipëri e kritikojnë praninë e këtyre cisternave, të cilat sjellin ndotjen e gjirit të Vlorës nga kryerja e procesit të ballastimit. Ky problem ka shkaktuar një përplasje institucionale ndërmjet institucionit të portit të Petroliferës dhe shoqatës së ambientalistëve në qytetin e Vlorës.

A duhet të shqetësohemi në konkretisht për impaktin që do të kenë operimi i këtyre anijeve cisternë në gjirin e Vlorës? Përgjigjen e kësaj pyetjeje e gjejmë duke u bazuar mbi argumentet e ndryshme eksperimentale në udhëzimet e Komitetit për Mbrojtjen e Mjedisit Detar (MSC), si dhe të Manuali i Rojës Bregdetare Shqiptare, i vitit 2002.

Ballastet e anijeve

Ballastet janë pesha që i vihen anijes për t'i dhënë zhytjen e dëshiruar dhe për ta ekuilibruar në raste kur ngarkohet jo simetrikisht. Dikur, për të kryer këtë ekuilibrim, përdoren thasë me rërë, me zhavorr ose materiale të tjera inerte. Sot përdoren rezervuarë të cilat mbushen me ujë deti. Nëse një anije shkarkon 10.000 ton mall dhe duhet të kthehet bosh, helika i del në sipërfaqe, zhytja është shumë e vogël dhe nuk garanton stabilitet ndaj dallgëve. Në këtë rast, për të rifituar zhytjen, hapen valvulat e rezervuarëve të ballasteve, sipas një rregulli të caktuar që e përcakton situata, dhe ngarkohet aq sasi sa të jetë e nevojshme. Ballastet përdoren gjithashtu edhe në raste avarish të skafit, etj. Rezervuarët e ballastit, në përgjithësi, gjenden në fundin e dyfishtë të anijes, ose në bordin e dyfishtë si p.sh., kontenierë, cisterna, etj. Pra, depozitat e ujit, të cilat shërbejnë si ballaste për anijet dhe operojnë në hapësirën detare, nuk kanë lidhje me depozitat e karburanteve që ndodhen në këto anije dhe shërbejnë për transportimin e hidrokarbureve të ndryshme.




Fig. 1. Paraqitja e ballasteve të anijes cisternë

Udhëzimet e Organizatës Ndërkombëtare të Detarisë (IMO)

Organizata Ndërkombëtare e Detarisë (International Maritime Organisation) ka lëshuar udhëzime të qarta në lidhje me trajtimin dhe menaxhimin e ujit të ballastit të anijeve. Ky problem po bëhet shumë i ndjeshëm kundrejt opinionit publik, i cili kërkon gjithnjë e shumë shpjegime për dëmet dhe pasojat që mund të shkaktojnë derdhja e ballasteve të papërpunuara në det. Nga ana tjetër, presioni nga organizatat ambientaliste dhe impakti që krijohet për mbrojtjen e mjedisit detar dhe turizmit janë sfida të cilat ndikojnë në politikat e menaxhimit të transportit detar, veçanërisht në anijet e tonazhit të madh për transportin e ngarkesave të lëngshme dhe ngarkesave *rifuxho*. Masat e marra nga IMO për vendosjen e sistemeve SBT (*Segregated Ballast Tank-Ballasti i anijes kontenier*) dhe DBT (*Dedicated Ballast Tank-Ballasti i anijes cisternë*) bënë të mundur që anijet e transportit të karburanteve dhe ngarkesave *rifuxho* të mos marrin ujë në depot e ngarkesës, me përjashtim të rasteve të jashtëzakonshme të motit të keq. Duke iu referuar problemit të shfaqjes së mikroorganizmave të rrezikshme në ujë, mundësia e përshtatjes me mjedisin ose mutacioni që mund të pësojnë ato duhet studiuar dhe rivlerësuar.



Për këtë qëllim, IMO ka nxjerrë udhëzimet e mëposhtme dhe ka marrë këto masa:

1. Udhëzimet për kontrollin dhe menaxhimin e ballasteve.
2. Minimizimin e transferimit të mikroorganizmave të rrezikshme nëpërmjet shkëmbimit të ballasteve duke iu referuar Artikullit 15(J) të Konventës së Organizatës Ndërkombëtare Detare si dhe rezolutës Art.774(18) në lidhje me shkarkimet e pakontrolluara të ballasteve dhe llumrave nga anijet, të cilat shkaktojnë dëmtim të shëndetit publik dhe dëmtim të mjedisit.
3. Në përputhje me udhëzimet e miratuara për parandalimin dhe ndërhyrjen e padëshiruar të mikroorganizmave ujore në ballastet e anijeve dhe shkarkimet e llumrave, Komiteti për Mbrojtjen e Mjedisit Detar (MSC)¹ duhet të mbajë ballastet në përputhje me udhëzimet e Konferencës së Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe Zhvillimet (UNCED)² të vitit 1992, në të cilën është ndërtuar

¹ Komiteti për Mbrojtjen e Mjedisit Detar (MSC).

² Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Mjedisin dhe Zhvillimet (UNCED) e vitit 1992.

axhenda 21 e kërkesave të IMO-s, për të marrë në shqyrtim zbatimet e rregullave përkatëse në ballastet për parashikimin e përhapjes së mikroorganizmave nga jashtë si dhe të shpallë Deklaratën e Mjedisit dhe Zhvillimit të Shteteve për Kombet e Bashkuara.

4. Aplikimi në brendësi të ballisteve i vrasjes së mikroorganizmave të dëmshme me anë të metodave, si: filtrimi, rrezatimi ultraviolet, solucionet dhe kimikatet, nxehësia, elektrojonizimi, sistemi i gazit super-ngopje.

Eksperimentet në laboratorë shkencorë kanë vërtetuar se me ndërhyrjen në brendësi të ballasteve të anijeve në mënyra të ndryshme, duke vrarë mikroorganizmat e dëmshme brenda tyre, mund të marrim një rezultat të kënaqshëm për një kontroll sa më të sigurt të anijeve dhe sigurimin e një mjedisi detar sa më të pastër.

Stimulimet e trajtimeve të ballasteve të anijeve

Rikërkimet e universitetit *Hertfordshire*³, lidhur me këto sipërmarrje, kanë qenë të lidhura me aspektet e trajtimeve të ballasteve. Modelimi i shkëmbimeve të ballastit në oqean të hapur, përgjatë territorit të ujërave ose përgjatë rrjedhës, përfaqëson shkëmbimin në sajë të:

- modelimit të ballasteve të ndara, sipas skicimit optimal;
- optimizimit, përmes rrugëve për aplikimin e rrezeve UV për trajtimin e ballasteve;
- sistemit të skicimit të ballasteve përmes metodës së rrjedhjes.

Kombinimi i ballasteve është vazhdim i rekomandimeve mbi ballastet kryesore në menaxhimin e masave sipas *Aktit kombëtar të SHBA mbi speciet e dëmshme*⁴, legjislacionit, rregullave dhe udhëzimeve të IMO-s.

Objektivat kryesore të këtyre përmbledhjeve synojnë të realizojnë dizenjimin e anijeve duke përdorur:

- praktikat e skicimit;
- përvojën operacionale lidhur me përbërësit në det;
- të dhënat për cisternat e ballastit (stabilitetet, llumrat e mbledhur, pompat e ballastit dhe tubat punues).

Sistemi antindotje

Komiteti për Mbrojtjen e Mjedisit Detar (MEPC-Maritime Environment Protection Committee) adopton vendosjen e dy udhëzuesve lidhur me Konventën Ndërkombëtare të vitit 2001:

- Udhëzimi për mbledhjen e mostrave të sistemit anti-ndotje.
- Udhëzimi për inspektimin e anijeve për sistemin anti-ndotje.

Regjistrimi (Libri i regjistrimit të mbetjeve vajore)

Problemet që përfshihen gjatë kontrollit nga ana e Kontrollit Portual, lidhur me përmbajtjen e *Librit të regjistrimit të mbetjeve vajore* (pjesa I), janë nën kujdesin e MEPC. Problemet kanë dalë si pasojë e nxjerrjes së përmbajtjes së *Librit të mbetjeve vajore* (pjesa II) (MARPOL 73/78)⁵, pas ribotimit në vitin 2002 dhe nxjerrjes së

³Universiteti Hertfordshire në SHBA.

⁴USA National Invasive Species Act

⁵MARPOL 73/78

rezultateve dalluese ndërmjet përmbajtjes së *Librit të mbetjeve vajore* (pjesa I) më 1997 dhe ribotimit të vitit 2002).

Konventa Ndërkombëtare për Kontrollin dhe Menaxhimin e Ballasteve të Ujit të Anijeve dhe të Llumrave

Komiteti për Mbrojtjen e Mjedisit Detar, në sesionin e 49-të të tij në qershor 2003, në përshtatje me finalizimet e draftit të propozuar nga Konventa Ndërkombëtare për Kontrollin dhe Menaxhimin e Ballasteve të Ujit të Anijes dhe të Llumrave⁶ parashikon procedurat që duhet të ndjekë kapiteni dhe kryemekaniku i anijes, gjatë plotësimit të *Librit të mbetjeve vajore dhe hidrokarbureve*⁷ (*Oil Record Book*). Në këtë libër tregohen qartë masat që duhet të marrë kryemekaniku, në rast të konstatimit të tepricave që ndodhin gjatë kohës së punës si dhe procedurat e mbushjes dhe të zbrazjes së ballasteve të anijeve.

Krijimi i autoritetit të port-kontrollit, nën autoritetin e rojës bregdetare shqiptare

Manuali i Rojës Bregdetare Shqiptare i vitit 2002⁸, i cili jep detyrat dhe kompetencat e Rojës Bregdetare Shqiptare, duhet të plotësohet me disa amendamente shtesë ku të zgjerohen kompetencat e Rojës Bregdetare Shqiptare për sa i përket autoritetit ligjzbatues për monitorimin dhe inspektimin e mjeteve detare si dhe atyre me flamuj të huaj.

Duke iu referuar Organizatës Ndërkombëtare Detare-IMO⁹ për nxjerrjen e disa rregullave të veçanta ndaj të gjitha mjeteve që ushtrojnë veprimtarinë në det, mundësohet krijimi i Autoritetit të Kontrollit Portual, i cili duhet të konsiderohet si autoriteti më i lartë i Kontrollit Shtetëror që përfaqëson një vend.

Roja Bregdetare Shqiptare e cila përfaqëson Ministrinë e Mbrojtjes, duhet të ushtrojë kompetenca të plota duke iu referuar Memorandumit të Parisit për Autoritetin e Kontrollit Portual.

Autoriteti i Kontrollit Portual (Port State Control) ndjek me përpikëri mangësitë që duhet të plotësojë anija gjatë afateve që janë përcaktuar nga rregullat e Kontrollit Portual¹⁰.

Procedurat për anijet dhe kontrollin portual

Procedurat për anijet

Duke iu referuar kodit ISM-*International Safety Management* për Planin e Menaxhimit të Ballasteve të Anijeve¹¹, çdo anije që mbart ballastet duhet që nëpërmjet menaxhimit të ballisteve të minimizojë transferimin e mikroorganizmave të dëmshëm ujorë. Çdo anije duhet të jetë e pajisur me planin e menaxhimit të ballasteve, i cili duhet të jetë specifik për çdo anije, në përputhje me tipin dhe madhësinë.

Plani i menaxhimit të ballasteve duhet të përfshijë dokumentet si më poshtë:

- dokumente që kanë lidhje me pjesë të këtyre udhëzimeve;
- dokumente të aprovuara që kanë lidhje me trajnimet e ekuipazhit;
- treguesit e regjistrimit që kërkohen;

⁶Konventa Ndërkombëtare për Kontrollin dhe Menaxhimin e Ballasteve të Ujit të Anijes dhe të Llumrave.

⁷Oil Record Book (Libri i Mbetjeve Vajore dhe Hidrokarbureve).

⁸Manuali i Rojës Bregdetare Shqiptare i vitit 2002.

⁹Organizata Ndërkombëtare Detare (IMO).

¹⁰www.parismou.org; secretaria@parismou.org

¹¹Plani i Menaxhimit të Ballasteve të Anijeve.

- vendosje e mundshme e disa pikave të modeleve;
- procedurat për Port-Kontrollet.



Fig 2. Procedura e Rojës Bregdetare për marrjen e kampionit nga ballasti i anijes

Marrja dhe trajtimi i ballasteve dhe mbeturinave që dorëzohen në sistemet e marrjes së tyre nëpër porte duhen të jenë në dispozicion të subjekteve që merren me trajtimin e mjedisit e të llumrave të cisternave.

Shkarkimet e ballasteve të anijeve, gjatë pritjes në port dhe trajtimet lehtësuese sjellin kuptimin e kontrollit të Autoritetit të Kontrollit Portual. Duke dëshiruar shfrytëzimin e këtyre strategjive, mund të adoptojmë sigurinë e mjaftueshme për procedura nga ana e Rojës Bregdetare për marrjen e kampionit nga ballasti i anijeve (Fig. 2).

Shkarkimi i ballasteve gjatë qëndrimit në port

Më poshtë mund të përmendim një nga rastet që ka të bëjë me procesin e shkëmbimit të ballasteve në ambientin detar, kur kapiteni i anijes është i detyruar që të përdorë shkëmbimin e ballasteve në mënyrë që të sigurohet:

- jeta e ekuipazhit të anijes;
- siguria e anijes;
- siguria e mjeteve të tjera të ankoruara në port.

Duke iu referuar kodit ISM (*International Safety Management*)¹² ku jepen udhëzime të qarta për planin e menaxhimit të ballasteve të anijeve, mendojmë se:

1. Në të gjitha rastet, Autoritetet e Kontrollit Portual duhen të marrin parasysh të gjitha efektet e ballastit dhe procedurat e shkarkimit të llumrave në sigurinë e anijeve e të mjedisit. Udhëzimet duhet të jenë në pajtim me masat operationale të pranueshme që vendosen në anije. Kontrollat portuale nuk duhet të kërkojnë çdo veprim nga kapiteni kur ai vë në rrezik jetën e ekuipazhit ose sigurinë e anijes.

Ruajtja e mjedisit detar nga mikroorganizmat e dëmshme, si rrjedhojë e shkarkimeve të ballasteve, ka kuptimin e plotë kur siguria e anijes është e garantuar sepse nuk do të kishte kuptim ruajtja e disa mikroorganizmave nga uji i ballasteve kur rrezikohet jeta e ekuipazheve ose vetë anija.

Dihet që ballastet ndikojnë në stabilitetin e anijes dhe nuk ka kuptim detyrimi i kapitenit të anijes për t'i shkarkuar ato në det të hapur, kur rrezikohet anija dhe ekuipazhi. Kjo nënkupton se kapiteni i anijes ka autoritetin e plotë të veprojë në mënyrë të drejtë me qëllim ruajtjen e anijes dhe ekuipazhit.

2. Inspektorët e Kapitenerive të Porteve të cilët inspektojnë anijen gjatë qëndrimit në kalatë, nuk duhet të veprojnë me masa administrative kur shikojnë që, për arsye të kohës së keqe, veprohet me ballastet e anijes kur ajo është bosh, duke

¹²Kodi i menaxhimit të sigurt të anijes (International Safety Management Kod (ISM)).

shmangur kështu incidentet e mundshme që mund të lindin si pasojë e mungesës së qëndrimit së anijes në port, për shkak të kohës së keqe.

Përfundime

Së pari, mendojmë se marrja e këtyre masave si:

- zhdukja e mikroorganizmave të dëmshme që krijohen brenda në ballast (duke ndërhyrë në brendësi të ballasteve të anijeve),
- vëzhgimi në terren i Rojës Bregdetare Shqiptare,
- inspektimi i oficerëve të kapitenerisë së portit, do të sjellë një minimizim të ndotjes nga shkëmbimi i ballasteve në det.

Së dyti, monitorimi nga Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare do të bëjë të mundur identifikimin e të gjitha mjeteve në hapësirën detare dhe në zonën e ndotur.

Së treti, administrimi i rregullave të ballasteve, shkëmbimet e informacionit lidhur me udhëzimet përmes organizatave, kërkojnë që administratat detare të vendeve nënshkruese të sigurojnë më parë organizimin duke ndjekur:

- Informacion të rreptë në manifestimin e mikroorganizmave të dëmshëm ujqorë të cilët paraqesin rrezik.
- Kopjet e drejtimin të brendshëm të normave dhe rregullave.
- Teknikat dhe rikërkimet e informimit.
- Edukimi nëpërmjet materialeve (siç audio dhe video-regjistrim) si dhe materialeve të printuara.
- Informimi i opinionit publik për gjithçka që është e panjohur dhe që është shqetësuese.

Rekomandime

1. Përgatitja e një stafi të Rojës Bregdetare Shqiptare, sipas Procedurave të Autoriteteve të Kontrollit Portual sipas Memorandumit të Parisit (*Port State Control- PSC*).
2. Pajisja me mjete lundruese për kapitenerinë e porteve, gjë që do të bëjë të mundur inspektimin në hapësirën detare ku këto mjete do të qëndrojnë.
3. Krijimi i disa akteve nënligjore për forcimin e Autoritetit të Rojës Bregdetare Shqiptare gjatë kontrollit të anijeve me flamuj të huaj.
4. Krijimi i një laborator biologjik shkencor pranë Rojës Bregdetare Shqiptare do të bënte të mundur kontrollin dhe monitorimin e kampioneve të marra nga ballastet e anijeve, gjë që do të ndihmonte në kontrollin e vazhdueshëm të ballasteve të anijeve.
5. Anijet e angazhuara në shkëmbimin e ballasteve në det duhet të sigurojnë më parë procedurat, duke ndjekur udhëzimet.
6. Shmangia e mbi dhe nën presionit të ujit të cisternave të ballastit, mbasi efektet e sipërfaqes së lirë ndikojnë në qëndrueshmërinë dhe ngarkimin e ballastit në tank, i cili është i plogët në çdo kohë. Kjo është në varësi të kushteve të motit.
7. Mirëmbajtja e mjaftueshme, stabilitet i paprekur në përputhje me miratimin e broshurave të trimit¹³ dhe stabilitetit.

¹³ Trimi është diferenca ndërmjet bashit dhe kicit të anijes.

8. Lejimi oqeanik, lejimi i fortësisë dhe momenti i përqendrimit, sipas manualit të miratuar të ngarkimit.
9. Shmangia e:
 - forcave të përdredhjes, kur kanë lidhje me të:
 - minimumit/maksimumit përpara dhe pas rrymës së ajrit.
 - induktimit të valëve të detit në vibrimin e trupit të anijes.
10. Regjistrimi i dokumentimit të ballastimit dhe zhballastimit.

Bibliografia:

- Udhëzimet e Komitetit për Mbrojtjen e Mjedisit Detar (MSC).
- Konferenca e Kombeve të Bashkuara për Mjedisin të vitit 1992 dhe Zhvillimet (UNCED).
- www.parismou.org; secretaria@parismou.org
- USA National Invazive Species Act, Botim i vitit 2003.
- MARPOL 73/78
- Oil Record Book (Libri i Mbetjeve Vajore dhe Hidrokarbureve).
- Manuali i Rojës Bregdetare Shqiptare, 2002.
- Plani i Menaxhimit të Ballasteve të Anijeve.
- Konventa Ndërkombëtare për Kontrollin dhe Menaxhimin e Ballasteve të Ujit të Anijes dhe të Llumrave.

Forcat Speciale dhe ndryshimi i ambientit të luftimit nga konvencional në jokonvencional

Kolonel Dritan Demiraj
Shef i Qendrës së Simulimit

Trajtesë e shkurtuar. *Nga elementet e mjedisit operacional dhe mikroklimat që ata prodhojnë në këtë mjedis, lind nevoja për një formë luftime që është më e preferuar dhe zgjedhja më e duhur, shumë e ndryshme nga lufta moderne konvencionale. Ka disa dimensione të cilat shpjegojnë qartë ndryshimin midis luftës jokonvencionale dhe asaj konvencionale por këtu do të përmend vetëm disa prej tyre. Para se të analizojmë këto dimensione është e nevojshme të përkufizojmë termat “lufta konvencionale” dhe “lufta jokonvencionale”.*

Operacionet speciale shpesh kryhen në bashkëpunim me operacionet ushtarake konvencionale si pjesë e një fushate të qëndrueshme politiko-ushtarake. Disa operacione speciale janë aksione të drejtpërdrejta spektakolare që kanë tërhequr vëmendje të gjerë, por shumë të tjera janë afatgjata, ato janë një përpjekje jo e drejtpërdrejtë që asnjëherë nuk janë bërë të njohura. Pavarësisht se në ç'formë kryhet, çdo operacion special realizohet për të zgjidhur sa më ekonomikisht probleme të veçanta në nivel operacional apo strategjik të cilat janë të vështira ose të pamundura për t'u realizuar vetëm me forca konvencionale.

Lufta Konvencionale është një formë e luftës e cila kryhet duke përdorur armë ushtarake konvencionale dhe taktikat konvencionale në mes dy ose më shumë shteteve apo forcave të armatosura, në përballje të hapur. Forcat, në çdo anë, janë të mirëpërcaktuara dhe objektivi i secilës forcë është që të shkatërrojë apo eliminojë forcën kundërshtarë.¹


Lufta Jokonvencionale është një luftë e dhunshme mes një shteti dhe aktorëve jo shtetërorë, për të fituar legjitimitetin dhe ndikimin mbi popullsinë. Lufta jokonvencionale favorizon metoda apo taktika josimetrike apo jo të drejtpërdrejta, që të shkatërrojë fuqinë e një kundërshtari, të rrisë ndikimin mbi popullsinë dhe të shkatërrojë dëshirën e kundërshtarit për të luftuar. Lufta jokonvencionale, në thelb, është një konflikt i tejzgjatur.²

Grafiku i mëposhtëm ilustron më qartë ndryshimin kryesor midis luftës konvencionale dhe asaj jokonvencionale.³

¹ Martin van Creveld, *Modern Conventional Warfare: An Overview*, Hebrew University, Jerusalem, f. 2-5.

² United States Department of Defense, *Irregular Warfare (IW)*, Version 1.0, Viti 2007, f. 5.

³ Po aty, f 11.



Skicë 3-13. Ndryshimi ndërmjet luftës konvencionale dhe jokonvencionale

Siç mund të shikohet, në pjesën e majtë të grafikut më lart shohim se lufta konvencionale ose “tradicionale” ka si synim apo fokus që të mposhtë forcat e armatosura të kundërshtarit, duke i shkatërruar kundërshtarit kapacitetin luftarak, të kapë ose të mbajë një pjesë të territorit të kundërshtarit në mënyrë që ta detyrojë atë të ndryshojë politikën apo qeverinë. Me pak fjalë, fokusi i operacioneve ushtarake konvencionale është zakonisht forca e armatosur e kundërshtarit, me qëllim që të ndikojë qeverinë e kundërshtarit.⁴

Lufta jokonvencionale fokusohet në kontrollin ose ndikimin e popullsisë në zonën operacionale dhe jo në shkatërrimin e forcës kundërshtarë apo kontrollin e territorit kundërshtar. Lufta jokonvencionale është një luftë për kontroll apo ndikim dhe fitimin e mbështetjes së popullsisë në zonën operacionale. Me pak fjalë, palët në konflikt kërkojnë të forcojnë legjitimitetin dhe kredibilitetin e tyre, për të ushtruar autoritet mbi popullsinë.⁵ Dimensionet të cilat tregojnë qartë ndryshimin midis luftës konvencionale dhe asaj jokonvencionale janë:

a. Organizimi

Duke u bazuar në historinë e luftërave të mëparshme, veçanërisht të Luftës I dhe II Botërore, mund të themi se këto dy luftëra janë shembuj të pastër, përse i përket kuptimit të forcave konvencionale dhe luftës konvencionale. Forcat e armatosura të vendeve, të përfshira në këto dy konflikte botërore, ishin të mirëorganizuara dhe operonin në linja operacionale të qarta.

Forcat jo të rregullta, forcat guerrile ose në rastin e Afganistanit forcat tribale (fisnore) kanë një organizim të shpërbërë dhe jo të përqendruar, linjat e operacioneve janë të paorganizuara dhe të paqarta, si dhe nuk kryejnë angazhime strategjike. Këto forca jo të rregullta janë formuar në bazë fisnore apo klanesh, me përkatësi ideologjike të njëjtë dhe kufizohen në një vend gjeografik specifik dhe janë nën strukturën e një lidhësi tradicional. Talebanët në Afganistan dhe në Pakistan janë një shembull tipik i një force jo të rregullt apo një force jokonvencionale.

b. Teknologjia luftarake

Në vendet e zhvilluara sundon ideja se teknologjia e përparuar është një faktor kyç që luan një rol të rëndësishëm në luftë për të arritur epërsinë për fitimin e saj. Kjo është e

⁴ United States Department of Defense, *Irregular Warfare (IW)*, Version 1.0, Viti 2007, f 10.

vërtetë përse i përket luftës konvencionale, ku kundërshtarët përballen me njëri-tjetrin me të njëjtat fuqi luftarake.

Përse i përket luftës jokonvencionale ajo përfshin shfrytëzimin e çdo burimi; bërjes së pajisjeve luftarake në treg të zi, vjedhjes së të mirave materiale në zonën ku vepron, plaçkitjeve të ndryshme apo prodhimeve lokale. Forcat jo të rregullta janë të specializuara për luftimet në prita, goditje të befasishme, ku si mjete luftimi kryesore përdorin armët granatahedhëse, automatikët, mitrolozët, mortajat dhe minat surprizë. Disa forca jo të rregullta që kanë një organizim më të mirë, mund të kenë dhe anije si në rastin e “Tigrave të Tamilit” gjatë konfliktit në Sri Lanka, talebanët gjatë kohës që drejtonin Afganistanin kishin avionë, helikopterë, tanke apo artileri tokësore, por forca kryesore varet në përdorimin e armëve të lehta. Rrjedhimisht duke qenë se forcat jo të rregullta nuk zotërojnë atë teknologji luftarake që kanë forcat konvencionale, atëherë për t’i bërë ballë kësaj teknologjie të përparuar, forcat jo të rregullta përdorin taktika jokonvencionale.

c. Logjistika

Forcat konvencionale kur dislokohen në zona operacionale të ndryshme, marrin me vete të gjithë sistemin logjistik që është tepër i nevojshëm për kryerjen e operacioneve. Forca apo njësi të mekanizuara konsumojnë sasi të mëdha naftë, municioni dhe pjesë për riparim e mirëmbajtje. Ky lloj sistemi kufizon lëvizshmërinë dhe fleksibilitetin operacional, duke krijuar disa dobësi që mund të përdoren në avantazh të kundërshtarit.

Forcat jo të rregullta janë shumë më pak të varura ndaj faktorit mbështetës logjistik. Nevojat e tyre për ushqim, armatim dhe municion janë më të thjeshta dhe nuk kanë nevojë që të lëvizin nëpër distanca të largëta. Këto forca kanë mbështetje nga popullsia lokale. Shumica e armatimit transportohet lehtësisht dhe në të njëjtën kohë, këto forca kanë aftësi organike për të riparuar armatimin apo makineritë që disponojnë, pa patur nevojën e një elementi mbështetës. Në këtë aspekt forcat jo të rregullta nuk kanë dobësi logjistike që mund të sulmohen nga kundërshtari, si p.sh. sisteme transporti rrugor apo hekurudhor, ura apo fabrika prodhimi armësh.⁶

d. Komandim-kontrolli

Lufta konvencionale, në themel, është luftë e një shteti me shtetin tjetër. Duke qenë e tillë kjo luftë ka nevojë për një drejtim qendror të centralizuar dhe të mirëdrejtuar, që të sigurojë organizimin e nevojshëm dhe të menaxhojë burimet luftarake, teknologjike dhe njerëzore. Janë të domosdoshme sisteme komunikimi shumë të avancuara për komandim-kontrollin e forcave në terren. Lufta jo e rregullt apo luftërat tribale janë luftëra të shkallëve të vogla, të cilat drejtohen nga liderë lokalë dhe, në shumicën e rasteve, për arsye dhe qëllime personale. Është e vështirë të analizosh këto arsye pasi vlerat, qëllimet, strategjitë dhe taktikat e tyre bazohen në faktorë jo të qartë që nuk varen nga njëri-tjetri. Liderët lokalë përdorin metoda komunikimi për distanca të shkurtëra, si p.sh., telefona fiks, *walkie-talkies*, si dhe korrierë. Për forcat e rregulla, vetëm krisma e armëve mund të shërbejë si sinjal për t’u organizuar dhe në shumicën e rasteve kjo është një metodë po aq e efektshme sa dhe sistemet moderne të komandim-kontrollit.⁷

⁵ Po aty.

⁶ William Driver, Bruce E. DeFeyer, *The Theory Of Unconventional Warfare: Win, Lose, And Draw*, Naval Postgraduate School Monterey, California, viti 2008, f 20-28.

⁷ Po aty, f 29-31.

e. Doktrina

Një nga themelet e një ushtrie moderne konvencionale, është zhvillimi i një doktrine të qartë për nivelet strategjike, operacionale dhe taktike të luftës. Doktrina do të përcaktojë se për çfarë do të luftojnë, si do të furnizohen, si do të organizohen dhe dislokohen, armët që do të përdorin dhe si do të luftojnë.

Forcat jo të rregullta nuk kanë një doktrinë të zhvilluar. Kjo forcë është mësuar që të luftojë në një terren të njohur që e vetëzotëron, kanë njohuri të shkëlqyera të terrenit, të armatimit personal dhe përshtaten, në çdo situatë, në nivelin taktik. Mosekzistenca e një doktrine për forcat jo të rregullta, e bën tepër të vështirë që forcat konvencionale të kuptojnë se si forcat jo të rregullta operojnë dhe në shumicën e rasteve këto forca nënvlerësohen duke sjellë dhe humbje të mëdha në forca dhe mjete. Është tepër e kushtueshme që të mësosh se si luftojnë forcat jo të rregullta nëpërmjet përvojës personale.

f. Beteja/Dyluftime vendimtare

Lufta konvencionale kërkon që kundërshtari të mposhtet shpejt në një konfrontim ballë për ballë. Kjo lloj lufte është për ato forca që janë superfuqi botërore, që kanë burimet e mjaftueshme për të investuar në një teknologji luftarake dhe një forcë të armatosur për të fituar luftën në mënyrë vendimtare e të shpejtë.

Në luftën jo të rregullt, forcat jo të rregullta shmangin operacionet që janë të gjata dhe intensive. Ato luftojnë duke përdorur konceptin e goditjes së befasishme dhe tërheqjen e menjëhershme nga fushëbeteja. Terreni, kultura dhe armatimi që zotërojnë, janë faktorët që detyrojnë forcat jo të rregullta të veprojnë në mënyrë të tillë. Në një konflikt të lokalizuar ose të izoluar, lëvizshmëria operacionale apo strategjike ka shumë pak rëndësi në krahasim me lëvizshmërinë taktike.⁸

g. Ushtarakët dhe luftëtarët

Ushtarakët dhe luftëtarët nuk janë e njëjta gjë. Ushtritë moderne përdorin një proces modern dhe bashkëkohor stërvitjeje dhe indoktrinimi, që nxjerr ushtarakë dhe njësi të rregullta të disiplinuar dhe profesionale. Ushtaraku modern i sotëm është një produkt i këtij sistemi që e shkëput individin nga jeta civile dhe e shndërron atë në një profesionist të disiplinuar e të gatshëm, nga i cili pritet të kryhen detyrat e caktuara nga eprorët dhe gjithë zinxhiri i komandimit, të cilët veprojnë për të përmbushur objektivat e qeverisë dhe vendit të tyre.

Luftëtari, në krahasim me ushtarakun, nuk shkëputet nga shoqëria civile. Ai gjendet në shoqëri me rolin e luftëtarit. Aftësitë dhe armatimi i tij burojnë nga fisi/grupimi ku ai bën pjesë. Njohuria e tij mbi luftën dhe luftimin kufizohet nga njohuritë që ka fisi apo grupimi ku ai bën pjesë. Ai vepron në një organizatë jo shumë të rregullt dhe në një sistem disiplinor më të relaksuar. Luftëtari jeton afër zonës ku operon dhe me njerëzit në atë zonë. Në të njëjtat rrethana dhe kushte, ky luftëtar mund të jetë po aq i efektshëm sa edhe ushtaraku modern.

Me pak fjalë, mund të themi se kompleksiteti i mjedisit operacional të sotëm dhe të së ardhmes do të ketë si themel përpjekjet globale për t'i bërë ballë sfidave të ideologjive dhe politikave rajonale. Duke u përballur me forca konvencionale, kundërshtarët e

⁸ United States Department of Defense, *Irregular Warfare (IW)*, Version 1.0, viti 2007, f. 20-25.

vendeve të NATO-s do të detyrohen të përdorin kapacitete jotradicionale për të arritur objektivat strategjike të tyre. Si shembull mund të përmendim mundësitë që ekzistojnë që Al Kaeda apo grupe të tjera terroriste të përdorin armë të dëmtimit në masë (WMD) mbi popullsinë civile të vendeve anëtare apo aleatëve të NATO-s. Këto forca kundërshtarë, do të vazhdojnë të përdorin luftën jokonvencionale kundër forcave aleate deri në momentin që vendet anëtare të NATO-s dhe aleatët të jenë në gjendje të kryejnë luftë jokonvencionale ashtu siç kryejnë luftë konvencionale.

Nga ndryshojnë misionet klasike nga ato speciale?

Operacionet speciale shpesh kryhen në bashkëpunim me operacionet ushtarake konvencionale, si pjesë e një fushate të qëndrueshme politiko-ushtarake. Disa operacione speciale janë aksione të drejtpërdrejta spektakolare që kanë tërhequr vëmendje të gjerë, por shumë të tjera janë afatgjata, ato janë një përpjekje jo e drejtpërdrejtë dhe asnjëherë nuk janë bërë të njohura. Pavarësisht se në ç'formë kryhet, çdo operacion special realizohet për të zgjidhur sa më ekonomikisht probleme të veçanta, në nivel operacional apo strategjik, të cilat janë të vështira ose të pamundura për t'u realizuar vetëm me forca konvencionale.⁹

Duke pasur parasysh natyrën e tyre jokonvencionale, operacionet speciale janë të lidhura drejtpërdrejt me forma të tjera luftimi si: terrorizmi, lufta guerile dhe rebelimi. Megjithatë, FS janë të stërvitura për të luftuar forma të tilla të luftës, duke përdorur taktika, teknika, pajisje, logjistikë dhe manovër superiore për të mposhtur terroristët, guerilasit dhe kryengritësit, të cilët përdorin taktika jokonvencionale. FS mundohen të privojnë kundërshtarët jokonvencionale nga disa avantazhe taktike që ata posedojnë, duke iu mohuar manovrueshmërinë, rezervat, befasinë dhe iniciativën. Në raste të tjera, FS mund të organizojnë dhe të zhvillojnë luftë guerile apo kryengritëse për të rrëzuar shtete të caktuara kundërshtarë, të cilët i bazojnë taktikat e tyre në luftën konvencionale, për shembull, duke ndërprerë linjat e furnizimit, ngritjen dhe trajnimin e forcave partizane, krijimin e rezistencës kombëtare me organizatat e E&E, apo duke tërhequr vëmendjen e forcave të armikut nga operacionet konvencionale në kërcënimet që iu kanosen në zonat e përcaktuara është shkalla e operacioneve të tyre-operacionet speciale janë operacione relativisht në shkallë të vogël kur kryhen nga kompanitë, grupe apo nëngrupe speciale, ndërsa operacionet e njëjësive të specializuara zhvillohen nga njësitë e mëdha të tilla si regjimentet, brigadat apo divizionet.

Fusha e dytë është konvencionaliteti-operacionet speciale karakterizohen nga taktika jokonvencionale dhe shpesh jo të drejtpërdrejta, ndërsa operacionet e forcave ushtarake të specializuara karakterizohen nga taktika konvencionale.

Për të përmbledhur sa thamë më lart, operacionet speciale ndryshojnë nga operacionet konvencionale në bazë të tri kritereve:

1. Mënyra ekonomike e përdorimit të forcave.
2. Konsiderata të ndryshme për llogaritjen e rrezikut politik dhe atij operacional.
3. Pajisje, organizim dhe stërvitje krejtësisht e ndryshme nga ajo e forcave konvencionale.

⁹ Po aty, fq12.

¹⁰A Theory of Special Operations The Origin, Qualities and Use of SOFRobert G. Spulak, Jr. viti 2007, f. 10.

Karakteristikat dhe cilësitë e këtyre forcave ushtarake

Cilësitë “Speciale” të këtyre forcave janë një produkt i organizimit të tyre, trajnimit, mbështetjes dhe më e rëndësishmja, përzgjedhjes. Të gjithë këta faktorë janë diskutuar me hollësi më poshtë dhe janë këta faktorë, të cilët mundësojnë krijimin e një force fleksibël që përdor taktika jokonvencionale për të zgjidhur probleme të vështira dhe të rrezikshme.

a. Ekonomia dhe rreziku

Në operacionet speciale realizohet me përpikmëri parimi i “ekonomisë së forcës”. Me një numër të vogël operatorësh të FS, shpesh, mund të arrihen rezultate shumë më të mëdha se me operacionet ushtarake konvencionale. Për shembull, në vitin 1977 operatorët FS të Gjermanisë Perëndimore (GSG-9; Border Force Group 9) ishin në gjendje të lironin 90 pengje nga një aeroplan i rrëmbyer nga terroristët islamikë në Mogadishu, Somali, vetëm me një humbje nga forcat e tyre.¹¹ Në qoftë se një përpjekje e tillë do të kryhej nga forcat konvencionale ushtarake apo paramilitare, do të ishte praktikisht e pamundur për arsye politike dhe, pa dyshim, kjo do të kishte çuar në humbje të konsiderueshme si nga forcat ushtarake dhe nga ana e pengjeve. Duke pasur parasysh që FS kanë kthim të lartë të investimit të bërë në to, operacionet speciale kanë vlerë të madhe për vendimmarrësit më të lartë politikë dhe ushtarakë, si në nivel strategjik dhe operacional, si një metodë me kosto të ulët për zgjidhjen e problemeve të ndërlikuara me një probabilitet të lartë suksesi.¹²

Operacionet Speciale mund të jenë ekonomike, por ato nuk janë pa rrezik. Një rrezik i tillë përfshin edhe kthimin mbi investimin e përmendur më lart. Suksesi nuk është i garantuar në çdo operacion dhe rreziku strategjik është shumë i madh, në qoftë se operacioni dështon për të arritur rezultatet e dëshiruara, Përgjegjësia pas një dështimi të tillë mund të ketë pasoja të rënda, si politikisht dhe ushtarakisht. Një shembull i tillë është dhe përpjekja e dështuar e FS amerikane Delta Force, për të shpëtuar pengjet amerikane nga Irani në vitin 1980, situatë e cila krijoi imazhin para botës se SHBA nuk mund të kryejnë operacione në mënyrë efektive, në prag të përfundimit të Luftës së Vietnamit.¹³ Një shembull tjetër shumë i keq ishte dhe reagimi i ngadalshëm dhe performanca e dobët e paramilitarëve të operacioneve speciale të Gardës së Sigurisë Kombëtare të Indisë, gjatë sulmeve terroriste të Mumbait, në vitin 2008, të kryer nga ana e organizatës terroriste pakistaneze Lashkar-e-Taiba (LET). Në të dyja rastet, dështimi i plotë apo dështimi për të kryer si duhej operacionin pati shumë raporte kritike në media, hetime zyrtare dhe një nivel të caktuar të krizës politike të brendshme dhe ndërkombëtare.¹⁴

Përveç pasojave politike dhe strategjike, një formë tjetër e rrezikut është e lidhur me vetë natyrën e operacioneve speciale. Duke pasur parasysh faktin se shumica e operacioneve speciale ndodhin në territore të mohuara apo armiqësore, duke përdorur një numër të vogël personeli në krahasim me armikun, dështimi taktik përkthehet në vdekje për ata që janë të përfshirë në operacion.

¹¹Special Forces, by Chris Chant, UK 2012 GSG-9, f. 58.

¹² Joint Pub 3-05, 17 prill 1998, f. 4.

¹³ NSHQ, Special Forces Study, dhjetor 2008, f. 13.

¹⁴ NSHQ, Study Case, shtator 2009, f. 15.

b. Fleksibiliteti dhe përshtatshmëria¹⁵

Duke pasur parasysh kohën dhe burimet e kufizuara, çdo njësi ushtarake mund të stërvitet për të kryer një detyrë specifike në një standard shumë të lartë. Një stërvitje e tillë përsëritet aq shpesh sa të gjitha të metat të jenë identifikuar dhe korrigjuar dhe ekzekutimi i misionit të bëhet në mënyrë instiktive. Ajo që i diferencionon FS nga forcat konvencionale është spektri i gjerë i kushteve që ndikojnë, nën të cilat pritet që detyra të zbatohet pa ulur standardet. Çdo forcë nuk mund të trajnohet për të kapur një objektiv me vlerë të lartë (HVT) si për shembull një udhëheqës terrorist apo një strukturë ushtarake, me mundësi të lartë për sukses, por FS janë në gjendje të kryejnë misione të shumta dhe me spektër të ndryshëm për një periudhë kohore të vetme me pothuajse pa asnjë reduktim në standardet e zbatimit të misionit. Në kushtet e pamjes së kufizuar, distancave shumë të largëta, motit të keq dhe lodhjes së tejskajshme, nga operatorët e FS pritet që të kryejnë misione përtej aftësisë së njësive të tjera. Përveç kësaj, ashtu siç evoluojnë teknikat e kundërshtarit, FS në të njëjtën kohë duhet të përshtatin vazhdimisht teknikat e tyre sepse ajo që dikur ishte “Speciale” mund të bëhet normë për forcat konvencionale apo nuk mund të jetë më efektive kundër kundërshtarit.

c. Përdorimi i drejtpërdrejtë dhe jo i drejtpërdrejtë i forcës

Detyrat që kryejnë FS ndahen në dy kategori të gjera:

Kategoria e parë e operacioneve speciale është aplikimi i forcës ushtarake në mënyrë të drejtpërdrejtë ose kinetike. Operacionet e drejtpërdrejta shpesh përfshijnë shkatërrimin, vrasjen ose kapjen e njerëzve, pajisjeve dhe të objekteve me vlera të mëdha. Si shembull mund të jetë misioni i Grupit të 6-të të *Seals*-ve të SHBA-së në Abbottabad, Pakistan, që në shënjestër ishte Osama bin Laden në vitin 2011. Operacionet speciale të drejtpërdrejta shpesh bëhen të njohura edhe si “goditje objekti spektakolare”, për të tërhequr vëmendjen e publikut dhe politikanëve, duke vënë në pah guximin dhe vendosmërinë e operatorëve specialë, dhe japin rezultate të menjëhershme. FS i klasifikojnë këto misione sipas objektivit që ato kanë në aksione të drejtpërdrejta që janë lloji më i përgjithshëm i goditjes së objektivit; operacionet antiterroriste, targetimi i liderëve specifikë terroristë, organizatorëve, ndjekësve të tyre dhe infrastrukturës. Për të zbutur rrezikun dhe për të siguruar suksesin, operacionet speciale kërkojnë forca të stërvitura jashtëzakonisht mirë dhe të pajisura me pajisjet më të mira në dispozicion, me mbështetje shumë të mirë logjistike, financiare e ligjore, me një informacion të detajuar zbulimi për objektin që do të sulmojnë dhe që kanë kryer një numër shumë të madh përsëritjesh e provash para ekzekutimit të misionit.

Kategoria e dytë e operacioneve speciale është aplikimi jo i drejtpërdrejtë i forcës ose mospërdorimi i saj. Operacionet jo të drejtpërdrejta ose jokinetike kërkojnë durim dhe kohë të konsiderueshme për t’u realizuar, para se efektet e tyre të jenë të dukshme. Që të kryejnë operacione jo të drejtpërdrejta FS iu nevojitet të punojnë nëpërmjet ndërmjetësve (si për shembull, në prapavijat e kryengritësve ose grupeve të partizanëve që kryejnë “luftë jokonvencionale”), ose palëve të treta (p.sh., qeveritë bien dakord të lejojnë FS të hyjnë në vendet e tyre si pjesë e misioneve “kundër kryengritësve” ose “Ndihmëse për Forcat e Sigurisë”), veprime jo të dhunshme (p.sh., ndërtimi i shkollave dhe hapje pusesh uji; “çështje civile”, projekte për të përmirësuar jetën e popullsisë vendase, mbledhjen

¹⁵ Po aty, f. 14.

e informacionit në mënyrë klandestine nëpërmjet përdorimit të “zbulimit special” dhe mjeteve të tjera të ndryshme (duke përfshirë përdorimin e fletëpalosjeve dhe të internetit, në bashkëpunim me njësitë e “operacioneve psikologjike”). Qëllimi i operacioneve jo të drejtpërdrejta speciale është ose për të rritur efektivitetin kryengritës vendas apo të forcave të sigurisë, ose për të ndikuar në moralin, vullnetin dhe kohezionin e objektivit. E gjithë kjo bëhet sa më ekonomikisht të jetë e mundur dhe me sa më pak ose aspak publicitet, për shkak të natyrës së ndjeshme politike të këtyre lloj misionesh.

d. Dallimi mes operacioneve speciale bashkëkohore dhe atyre të Luftës II Botërore

Një nga dallimet në mes operacioneve speciale bashkëkohore dhe atyre të Luftës II Botërore është qëndrueshmëria e njërive të FS. Operacionet Speciale bashkëkohore e kanë gjenezën e tyre në Luftën II Botërore, por gjatë atij konflikti, forcat ushtarake që përdornin taktika jokonvencionale krijoheshin vetëm për të kryer një detyrë të caktuar dhe pasi operacioni të kishte përfunduar këto forca shpërbëheshin. Sot mbajtja e FS mbi një bazë të përhershme u jep atyre aftësi më të mëdha sesa paraardhësit e tyre të Luftës II Botërore.¹⁶

Njësitë e FS janë ndërtuar mbi tre elemente themelore që i japin atyre emrin “special” dhe që gjithashtu i bëjnë ato të dallohen nga homologët e tyre konvencionalë. Këto tre elemente themelore janë: emërtimi “special”, përzgjedhja dhe stërvitja e specializuar ngushtë dhe pajisjet speciale.¹⁷

Emërtimi “special” pasqyron cilësitë unike dhe aftësitë e demonstruara të një force speciale. Emërtimi special shihet jo vetëm në emër por edhe në disa pjesë të uniformës dhe jo vetëm. Uniformat e tyre janë krejtësisht të ndryshme nga ato të pjesës tjetër të ushtrisë, gjë që i dallon pjesëtarët e FS nga anëtarët e njërive të tjera. Anëtarët e *Shërbimit Special Ajror Britanik (SAS)* dallohen nga bereta ngjyrë rëre dhe emblema “Thikë me krahë”; beretat e gjelbra dallohen nga beretat ngjyrë të gjelbër, FS shqiptare, gjermane, turke, rumune, hungareze, italiane, franceze, polake, holandeze, etj dallohen nga bereta ngjyrë vishnje, ndërsa rusët *Naznachenije Spetsialnoye (Spetsnaz)*¹⁸ mund të dallohen nga beretat e tyre dhe bluzat me vija shirita. Në Shqipëri operatorët e FS dallohen jo vetëm nga bereta vishnje, por edhe nga *set-i* krejtësisht unik i kamuflazhit të tyre. Përveç dallimeve në uniformë dhe emërtimit të njërive, veçanti tjetër janë dhe shenjat e ndryshme të vendosura në uniformën e ceremonialit, të cilat janë medalje nderi që mbahen nga ata të cilët kanë përfunduar kurse të ndryshme të FS, si kursi i forcave speciale, komando, parashutës, zhytjes, snajperit, sportit, liderit alpin dhe operacioneve speciale, si dhe për pjesëmarrje në misionet e ndryshme ndërkombëtare luftarake, gjë që e bëjnë vetëm FS.

Përzgjedhja dhe trajnimi kryhet në funksion të misionit të tyre, misioni i cili kërkon cilësi të veçanta të cilat nuk i kanë forcat konvencionale. Më konkretisht, përzgjedhja dhe stërvitja e këtyre forcave i identifikon ato si individë me aftësitë fizike dhe, mbi të gjitha, me cilësi psikologjike për të kryer operacione speciale (me cilësi të tilla si: niveli i besueshmërisë në situata stresi ekstrem, inteligjenca, pjekuria dhe aftësia e të menduarit për të zgjidhur problemet nën çdo rrethanë). Procesi i përzgjedhjes shpesh ndodh gjatë disa fazave dhe shpesh është i mbikëqyrur nga operatorët më me përvojë (instructorët). Arsyeja e stërvitjes është që të ngrejë aftësitë e operatorëve specialë në një nivel shumë

¹⁶ Special Forces book UK 2012, f. 121.

¹⁷ Joint Pub 3-05, Doctrine for Joint Special Ops, 17 prill 1998, f. XI.

¹⁸ Special Forces by Chris Chant, book UK 2012, f. 98.

të lartë, t'i zhvillojë ata për punën në grup dhe gjithashtu vazhdimisht të shqyrtojnë kandidatët për përshtatshmërinë e tyre dhe aftësinë e tyre për të shërbyer në këto njësi. Shembuj të një procesi përzgjedhjeje dhe trajnimi të tillë përfshin edhe Kursin e FS në SHBA-së “Beretat Jeshile”, programi i përzgjedhjes dhe trajnimit të SAS-it në Britaninë e Madhe, gjithashtu programi i përzgjedhjes dhe trajnimit të Forcave Speciale Shqiptare “Beretat Vishnje”.

Trajnimi i operatorëve të FS nuk ka vetëm kërkesë të lartë llogarie, por edhe rrezik të lartë. Regjimi i stërvitjes gjatë kursit të FS është dizenuar në mënyrë të tillë që t'i shtyjë kandidatët në kufijtë ekstremë të qëndresës fizike dhe psikologjike dhe të përsosë të gjitha aftësitë taktike si ato individuale, ekipore dhe të zgjidhjes së detyrave në grup. Specializimi i tyre i ngushtë në specialitete të ndryshme si specialistë operacionesh, zbulimi, snajper, armatimi, xhenioje, shëndetësie dhe komunikimi bën të mundur që grupet të veprojnë të pavarur, në nëngrupe dhe grupe të vogla dhe të realizojnë një spektër të gjerë detyrash.¹⁹

Elementi i tretë dhe përfundimtar janë *pajisjet e FS*. Pajisjet mund të përfshijnë pajisje jostandarde, jashtë linjave tradicionale të inventarit ushtarak të furnizimit. Në njësitë më të specializuara, operatorët shpesh janë të lirë të zgjedhin pajisjet që i përshtaten preferencave dhe nevojave të tyre personale. Kjo liri pasqyron besimin në gjykimin e operatorëve të saj dhe sidomos aftësinë e njërive të operacioneve speciale për suksesin e misionit. Në pajisje të tilla mund të futem pajisje speciale për zbulimin special si kamera termale, kamera dixhitale fotografike, pajisje përgjimi dhe vëzhgimi, etj, pajisje speciale komunikimi si kompjuterë, etj, UAV, armatim special që nga kalibri 4.6 x 30 mm, 45 auto, 9 x 19 mm, 5.56 mm, 7.62 x 39, 7.62 x 51mm, 7.62 x 67 mm, 8.6 mm dhe 12.7 mm, me të gjithë aksesoret e vendosur si dylbi nate, dite, silenciatorë, pajisje për infiltrim nga deti dhe nga ajri si parashuta dhe mjete zhytjeje speciale, pajisje për luftë në arktik, mjete speciale dhe të blinduara, etj, të cilat mundësojnë realizimin e të gjithë detyrave të ngarkuara për FS nga toka, deti dhe ajri.

Bibliografia:

- Martin van Creveld, *Modern Conventional Warfare: An Overview*, Hebrew University, Jerusalem.
- United States Department of Defense, *Irregular Warfare (IW)*, Version 1.0, Viti 2007.
- William Driver, Bruce E. DeFeyer, *The Theory Of Unconventional Warfare: Win, Lose, And Draw*, Naval Postgraduate School Monterey, California, viti 2008.
- A Theory of Special Operations The Origin, Qualities and Use of SOF Robert G. Spulak, Jr. viti 2007
- Special Forces, by Chris Chant, UK 2012 GSG-9.
- Joint Pub 3-05, 17 prill 1998.
- NSHQ, Special Forces Study, dhjetor 2008.
- NSHQ, Study Case, shtator 2009.
- Special Forces book UK 2012.
- Joint Pub 3-05, Doctrine for Joint Special Ops, 17 prill 1998.
- Special Forces by Chris Chant , book UK 2012.
- Joint Pub 3-05, Doctrine for Joint Special Ops, 17 Prill 1998.
- Adm McRAVEN, Teoria e SOF, viti 2001.

¹⁹. Joint Pub 3-05, Doctrine for Joint Special Ops, 17 Prill 1998.

Kultura Strategjike e SHBA

MSc. Lindita Mukaj
Programi i Doktoraturës 2011-2014, AFA

Nënkolonel Arben Dhuli
Kursi i Lartë i Oficerit, AFA

Trajtesë e shkurtuar. *Kultura strategjike amerikane ndikon në shumë sfera të veprimtarisë jetësore. Tendenca e zhvillimit të kësaj kulture kërkon kohë dhe procese integruese dhe bashkëpunuese në të gjitha fushat. Si komb, kjo kulturë është formuar nga siguria e lirë dhe e mbushur me urrejtje kundrejt eksepcionalizmit. Ajo mbart idealizmin liberal dhe e shikon luftën si vazhdimësi të politikës.*

Kultura e ushtrisë amerikane, e ashtuquajtur “Mënyra amerikane e luftës”, thekson strategjitë e drejtpërdrejta, një paraqitje industriale për luftë, fuqinë e zjarrit dhe përpjekje për zhvillimin e një teknologjie intensive në luftë. Artikulli vijues tregon se si duhet të ndikojë kultura strategjike, veçmas ajo amerikane, në politikat e sigurisë. Ndër kulturat e tjera nuk mund të lëmë pa përmendur edhe ngjarjet e fundit në Ukrainë ku duket se po shfaqen disa karakteristika të kulturës strategjike.

Hyrje

Idėja se ekziston një lidhje mes shoqërisë dhe kulturës së saj strategjike, ka një origjinë të hershme. Në historinë e Luftës së Peloponezit, Tuqiditi jep të dhëna se mbreti i Spartanëve, Arkidamusi dhe strategu athinas, Perikliu, u mbështetën secili në kapacitetet e tyre ushtarake për konstituivën e shteteve të tyre. Në shekullin XIX, strategu ushtarak *Karl Von Klauzewit* e përpunoi këtë ide duke e identifikuar kulturën dhe strategjinë e luftimit si “një provë të fortë morale dhe fizike”. Qëllimi i strategjisë, shkruan ai, më tepër se sa mundja e armikut në fushëbetejë, është shkatërrimi i moralit të tij. Në një shkrim¹, më shumë se 2400 vite pas Luftës së Peloponezit, Xhulian Korbet cilësoi një dallim mes shkollave të mendimit strategjik gjerman ose “kontinental” dhe anglez ose “detar” duke u fokusuar në luftën mes forcave tokësore dhe më vonë, në konfliktet mes fuqisë detare dhe tokësore. *Basil H. Liddell-Hart*² e përmirësoi argumentin e Korbet, duke vënë në dukje se Britania, historikisht, kishte ndjekur një mënyrë të veçantë në luftë, duke shmangur angazhimet e mëdha në tokë dhe duke përdorur fuqinë e detit, për të rritur presionin ekonomik që mban larg kundërshtarët e saj. Lufta e Dytë

¹ Karl von Klauzewitz, “Mbi luftën”, f. 111.

² Basil H. Liddell Hart, *The British Way in Warfare* (New York: MacMillan, 1933).

Botërore nxiti një valë të re kërkimesh për karakterin e ndryshëm kombëtar të vendeve që konsiston në gjuhën, fenë, traditat dhe interpretimin e kulturës së përbashkët.

Pa u zgjatur, veçojmë se studiues të ndryshëm pohojnë se kultura ka ndikim të thellë lidhur me strategjinë dhe më domethënëse janë ngjarjet e kohëve të fundit që po e rrisin interesin e kulturës strategjike për sigurinë kombëtare. Sipas Xheffry S. Landis dhe Darryl Hovlett për kulturën ka tri qasje kryesore: *e para* e shikon kulturën si një funksion, si faktor që mund të ndikojë mbi sjelljen e shtetit, e cila luan rol dytësor në presionet e sistemeve ndërkombëtare. Qasja *e dytë* e trajton kulturën si pjesë e të gjithë sjelljes strategjike. Ky funksion ndikon në fushat e tjera të saj, si në atë të psikologjisë politike, që e vlerëson kultin si ndryshore të pavarur dhe e shpjegon politikën e sigurisë, po aq mirë madje dhe më mirë se neorealizmi apo institucionalizmi neoliberal. Qasja *e tretë* përfshin autorin, i cili beson te aspekti i sjelljes së njeriut dhe mund të kuptohet vetëm duke u përfshirë brenda një kulture.

Disa antropologë dhe sociologë veçojnë arsyen se kultura përbëhet nga një kombinim i shprehjeve ligjëruese dhe atyre jo ligjëruese. Ata thonë se kultura është e fuqishme, por është e pamundur për ta matur si ndikim mbi politikën. Kultura strategjike e një kombi rrjedh nga gjeografia dhe burimet, historia dhe përvoja, shoqëria dhe struktura politike.

Kultura strategjike përfaqëson një qasje që një shtet i caktuar e ka themeluar suksesshëm atë në të shkuarën.³ Edhe pse kultura në përgjithësi është e pandryshueshme, ajo ka tendencën të zhvillohet ngadalë. Nuk është koincidençë, për shembull, që Britania historikisht ka favorizuar fuqinë e detit dhe strategjitë jo të drejtpërdrejta, ose që tradicionalisht i është larguar mbajtjes së një ushtrie të madhe. Mungesa e thellësisë gjeografike të Izraelit, popullsia e tij e vogël, por e edukuar dhe njohja teknologjike, kanë prodhuar një kulturë strategjike që thekson zhvillimin strategjik, operacionet e ndryshme, nismat dhe një teknologji në rritje dhe në zhvillim.⁴ Statusi minimal gjeopolitik i Australisë, identiteti kontinental në vend të atij detar, dhe përvoja formative e ushtrisë, e kanë formuar rrugën e saj të luftës.⁵

Ky shkrim flet për kulturën strategjike të Shteteve të Bashkuara. Për arsye të dukshme, kultura strategjike e Shteteve të Bashkuara ka marrë vëmendje të konsiderueshme. Shtetet e Bashkuara janë kombi më i fuqishëm në botë dhe do të jenë deri në një të ardhme të paparashikuar: Ekzaminimi i kulturës strategjike të Shteteve të Bashkuara të Amerikës trajtohet në nivelin e kombit, të ushtrisë dhe shërbimit të armatosur. Si komb, kjo kulturë është formuar nga siguria e lirë dhe e mbushur me urrejtje kundrejt eksepcionalizmit. Kultura strategjike amerikane mbart idealizmin liberal dhe e shikon luftën si vazhdimësi të politikës. Kultura e ushtrisë amerikane, e ashtuquajtur "Mënyra amerikane e luftës" thekson strategjitë e drejtpërdrejta, një paraqitje industriale për luftë, fuqinë e zjarrit dhe përpjekje për zhvillimin e një teknologjie intensive në luftë.

³ John Belyes, James J. Wirz & Colin S. Gray & Elio Cohen, *Strategjia në botën bashkëkohore*, UET Press, Tiranë 2013, f. 110-113.

⁴ Michael I. Handel, "The Evolution of Israeli Strategy: The Psychology of Insecurity and the Quest for Absolute Security" in Williamson Murray, MacGregor Knox, and Alvin Bernstein, eds., *The Making of Strategy: Rulers, States, and War* (Cambridge: Cambridge University Press, 1994).

⁵ Michael Evans, *The Tyranny of Dissonance: Australia's Strategic Culture and Way of War, 1901-2005* (Canberra: Land Warfare Studies Center, 2005).

Përcaktimi i Kulturës Strategjike

Në mënyrë specifike, “Kultura strategjike është ai set i besimeve të ndara, përmbledhjeve dhe mënyrave të sjelljes, që rrjedhin nga përvoja të përbashkëta dhe tregime të pranuar (gojore dhe të shkruara), që i japin formë identitetit kolektiv dhe marrëdhënieve të grupeve të tjera, të cilat përcaktojnë mjetet për të arritur objektivat e sigurimit. Sipas *Kolin S. Grey*, kultura strategjike e amerikanëve: “i referohet mënyrave të menduarit dhe veprimit, me respekt për forcën, e derivuar nga perceptimi i eksperiencës historike nacionale, aspirimit për vetkarakterizim... dhe nga të gjitha eksperiencat e dalluara të Amerikës (nga gjeografia, politika filozofike, kultura qytetare dhe “mënyra e jetesës”) që karakterizojnë një qytetar amerikan.⁶ Një nga sfidat qendrore, në përballjen me shkollën e strategjisë kulturore të çdo shteti, është përcaktimi se cili institucion shërben si mbajtës dhe transmetues i strategjisë kulturore. Është shteti? Ushtria si një e tërë? Apo ndonjë pjesë e ushtrisë? Një pjesë tjetër lidhet me përmbajtjen e kulturës strategjike, besimet dhe qëndrimet të cilat përfshijnë kulturën. I fundit, por jo më pak i rëndësishëm, është problemi i përcaktimit të shtrirjes të secilës kulturë strategjike, e cila në fakt përcakton qëndrimet dhe sjelljet.⁷

Ky shkrim e konsideron kulturën strategjike në tre nivele: në atë të kombit, atë ushtarake dhe të shërbimeve ushtarake. Në nivel kombëtar, kultura strategjike pasqyron një sërë vlerash të shoqërisë, të cilat i detyrohen përdorimit të forcës. Në nivelin ushtarak, kultura strategjike (ose “mënyra e luftës”) e një kombi është shprehja se si ushtria e tij do t’i bëjë luftërat. Së fundmi, kultura strategjike në nivelin e shërbimit ushtarak e paraqet kulturën organizative të shërbimeve të veçanta, në ato vlera, misione dhe teknologji që institucioni i ruan mirë. Ka dy arsye pse ia vlen të ekzaminosh kulturën në nivele të ndryshme, në mënyrë të qartë. Gjatë vitit 1990, për shembull, një numër dijetarësh diskutuan se ushtria e Shteteve të Bashkuara ishte duke u shndërruar në një ushtri më pak përfaqësuese e shoqërisë amerikane, në termat e sjelljes së saj.⁸ Së dyti, ashtu si *Clausewitz* vuri në dukje, shpesh ka tension (i cili, në përgjithësi, është i mirë) mes ushtrisë, qeverisë dhe shoqërisë, si një e tërë. Ashtu siç ai vuri në dukje, ushtria, në përgjithësi, vepron në fushën e probabilitetit dhe shanseve, ndërsa racionaliteti dhe njerëziteti, përgjithësisht, karakterizojnë lidhshmërinë politike nga pasioni.⁹

Profili i Kulturës Strategjike

Kultura Strategjike Kombëtare, ashtu si edhe ajo historike dhe gjeografike, i kanë dhënë formën kulturës strategjike kombëtare të Amerikës. Në pjesën më të madhe të historisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, pozita ishullore e Amerikës së Veriut dhe fqinjët e dobët të veriut dhe ata të jugut u kombinuan për të vendosur sigurinë e lirë të Shteteve të Bashkuara. Fakti që Shtetet e Bashkuara nuk kishin pse të lodhnin veten për t’u përgatitur për ndërmarrjen e luftërave kundër fqinjëve, i ndau ato nga shtetet e tjera, veçanërisht nga fuqitë e mëdha të Evropës.

⁶ Colin S. Gray, “National Style in Strategy: The American Example,” *International Security* 6, no. 2 (Fall 1981), 22.

⁷ Alan Macmillan, Ken Booth, and Russell Trood, “Strategic Culture” in Ken Booth and Russell Trood, eds., *Strategic Cultures in the Asia-Pacific Region* (New York: St. Martin’s, 1999), 8-12.

⁸ Ole Holsti, “A Widening Gap Between the Military and Society? Some Evidence, 1976-1996,” *International Security* 23, no. 2 (Winter 1998-99): 5-42; and Peter D. Feaver and Richard H. Kohn, *Soldiers and Civilians: The Civil-Military Gap and American National Security* (Cambridge, MA: MIT Press, 2001).

⁹ Clausewitz, *On War*, 89.

Kultura strategjike e Amerikës ka marrë formë nga periudhat e gjata të paqes, të ndërprera nga konfliktet e brezave-Lufta e 1812, Lufta Civile, Lufta e Parë Botërore dhe Lufta e Dytë Botërore, të përcaktuara si një kryqëzatë e të mirës kundër të keqes. Siguria e lirë, në anën tjetër, ndikoi në këndvështrimin e Amerikës mbi botën. Ashtu siç shkruan *C. Vann Woodward*, më shumë se katër dhjetëvjeçarë më parë “Ankthi për siguri e ka mbajtur rritjen e optimizmit brenda caqeve në mesin e njerëzve të tjerë. Mungesa relative e anktheve të tilla, në të shkuarën, ka ndihmuar, së bashku me faktorët e tjerë, ta bëjë optimizmin një filozofi kombëtare në Amerikë”¹⁰ Kultura strategjike e Amerikës, në mënyrë të qartë, refuzon traditën evropiane të fuqive politike. Kjo kulturë, shijon fuqinë e traditës dhe fuqinë politike. Që nga themelimi i shtetit, amerikanët e kanë parë veten si të veçantë. Kjo ka ndikuar në mënyrën se si Shtetet e Bashkuara bëjnë marrëveshje me të tjerët.

Impulsi për të transformuar sistemin ndërkombëtar, në shërbim të idealeve të demokracisë liberale, formon fije të cilat kalojnë nëpërmjet historisë së Amerikës. *George Kennan*, në shkrimet e tij për diplomacinë e Amerikës, dorëzuar në vitin 1950, diskutoi se afrimi i Amerikës në marrëdhëniet ndërkombëtare ishte karakterizuar nga “moralizimi dhe legalizimi” i tepruar që çojnë në një tendencë për të shpallur kryqëzata kundër të pëqinjve. Siç shkruan *Kennan*, “Një luftë e bërë në emër të parimit të lartë të moralit, gjen jo shpejt një formë të sundimit total”. Amerikanët, shpesh, i kanë ndërmarrë luftërat jo si vazhdimësi të politikës, por si një simptomë të dobësisë së tyre. Kur *J.C. Wylie* shkroi disa refleksione mbi disa pikëpamje përreth kulturës amerikane theksoi se: “Është lufta në fakt vazhdimësi e një politike? Për ne, besoj se jo. Lufta, për një komb jo agresor, është në fakt përafërsisht një kolaps i plotë i politikës. Pasi lufta vjen, atëherë të gjitha politikat e paraluftës bëhen të pavlefshme, sepse vendosja në të cilën janë projektuar për të funksionuar, jo për shumë kohë, korrespondon me faktet e realitetit. Kur lufta vjen, ne menjëherë lëvizim në botë radikalisht të ndryshme.

Në mënyrë të ngjashme, tekstet e vitit 1936 të Ushtrisë së Shteteve të Bashkuara mbi strategjinë përmbanin se “Politika dhe strategjia janë radikalisht dhe fundamentalisht gjëra të ndryshme. Strategjia fillon aty ku politika mbaron. Ajo që ushtarët kërkojnë është se në momentin që politika vendoset, strategjia dhe komandat duhet të konsiderohen si një sferë e ndarë nga politika”.¹¹ Kombinimi i refuzimit të politikës së pushtetit dhe mosvazhdimësia mes politikës dhe strategjisë ka dhënë një ndikim në strategjinë kulturore të amerikanëve edhe pse ata janë njerëz që e duan paqen, por kur ngacmohen ata mobilizojnë burimet njerëzore dhe materiale të kombit.

Samuel Huntington e pa egërsinë e Amerikës në luftë si anën e kundërt të paqes liberale jashtë lufte. Ai gjithashtu e përqafon luftën ose e refuzon plotësisht atë. Ky ekstremizëm është kërkuar nga natyra e ideologjisë liberale. Që kur liberalizmi dënon vlefshmërinë morale të interesave të sigurimit të shtetit, lufta duhet ose të dënohet si e papërshtatshme me arritjet liberale, ose të justifikohet si një lëvizje ideologjike, në mbështetje të këtyre arritjeve. Mendimet amerikane nuk e kanë parë luftën në një sens konservativ ushtarak, si një instrument të politikës kombëtare.¹² Kështu Shtetet e Bashkuara kanë shfaqur një preferencë të gjatë dhe të qëndrueshme për fillimin e luftërave, për arsye të pakufizuara politike.

Gjatë Luftës Civile, presidenti *Abraham Lincoln* dhe gjenerali *Ulises S. Grant* luftuan për të mbrojtur konfederatën. Gjatë Luftës së Parë Botërore, gjenerali *John J. Pershing*,

¹⁰ C. Vann Woodward, “The Age of Reinterpretation”, *American Historical Review* 66 (October 1960), 6.

komandanti i Forcave të Ekspeditës Amerikane, favorozoi një politikë të nënshtrimit të pakufizuar kundrejt Mbretërisë Gjermane ku presidenti *Wudrow Wilson* kërkoi një mënyrë për t'i dhënë fund konfliktit.¹³ Në luftën e Dytë Botërore, *Franklin D. Rusevelt* dhe komandantët e tij ishin të një mendjeje se lufta duhet të merrte drejtim me përmbysjen e qeverive gjermane, japoneze dhe italiane, të cilat kishin filluar luftën.

Në luftën e tanishme kundër ekstremistëve xhihadistë, nuk figuron asnjë ndjenjë që mund të çojë në vendosjen e negociatave. Njëlloj siç amerikanët kanë preferuar të luftojnë deri në fund, kanë pranuar edhe pakënaqësitë e luftërave për qëllime të kufizuara politike. Si në luftën e Koresë dhe atë të Vietnamit, drejtuesit e ushtrisë amerikane ishin të vendosur për të luftuar në mënyrë që të rivendosnin ose mbanin *status quo*-në. Në të vërtetë, *Douglas MacArthur* krahasoi çdo gjë shkurt në fitoren totale mbi forcat komuniste në gadishullin korean “paqësor”.¹⁴ Në mënyrë të ngjashme, shpjegimi standard i dështimit amerikan në Vietnam, nga një prej më të njohurve ndër oficerët e ushtrisë së Shteteve të Bashkuara, është se ushtria e Shteteve të Bashkuara do ta kishte fituar luftën, nëse nuk do të kishte ndërhyrje nga civilët.¹⁵ Amerikanët kanë pasur tendencë t'i quanin luftërat e tyre si kryqëzata kundër të pëqinjve. Ashtu siç *Samuel Huntington* u shpreh: “Për amerikanin, një luftë nuk është luftë, nëse nuk është një kryqëzatë”¹⁶ Patjetër, një sjellje e tillë ka rrënjë të forta politike. Gjatë shekullit të njëzetë, Shtetet e Bashkuara luftuan një sërë regjimesh despotike, nga Gjermania e Hitlerit dhe Korea e Veriut e Kim Sung II deri tek Iraku i Sadam Husein dhe Serbia e Slobodan Miloseviç. Gjithsesi, ka ekzistuar gjithmonë një tension i qartë mes nevojës për të çuar publikun në një tubim, në mbështetje të përdorimit të forcës dhe nevojës për të ndjekur qëllime të limituara. Liderët politikë, të cilët demonizuan kundërshtarët e Amerikës, shpesh, u përballën me një reagim të ashpër kur Shtetet e Bashkuara nuk e vazhduan luftën deri në fund.

Nocioni i një kulture ushtarake amerikane, një “mënyrë lufte amerikane” është pazgjidhshmërisht e lidhur me librin me të njëjtin emër të *Russell Weigley*.¹⁷ Në të, *Weigley* flet për një vlerësim më kritik të “Mënyrës amerikane të luftës”. Në formulimin e tij, karakteristikat kryesore të “Mënyrave amerikane të luftës” përfshijnë agresivitetin në çdo nivel të betejës, një çështje për luftërat vendimtare dhe një dëshirë për të bërë rezistencë maksimale. Ushtria e Shteteve të Bashkuara ka parë “përmbysjen e plotë të armiqve, shkatërrimin e forcave ushtarake, (si) objekt të luftës”.¹⁸ Një qëndrim tjetër është se ushtria amerikane nuk ka qenë për shpalljen e luftërave me mjete të shtrënguara

¹¹ Colin S. Gray, “National Style in Strategy: The American Example,” *International Security* 6, no. 2 (Fall 1981).

¹² Samuel P. Huntington, *The Soldier and the State: The Theory and Practice of Civil-Military Relations* (Cambridge, MA: Belknap Press, 1957).

¹³ David R. Woodward, *Trial by Friendship: Anglo-American Relations, 1917-1918* (Lexington: University Press of Kentucky, 1993), 213-214.

¹⁴ General Douglas MacArthur in Allen Guttman, ed., *Korea: Cold War and Limited War*, 2nd ed. (New York: D.C. Heath, 1972).

¹⁵ Eliot A. Cohen, *Supreme Command: Soldiers, Statesmen, and Leadership in Wartime* (New York: Free Press, 2002), 175-184; Andrew Krepinevich, *The Army and Vietnam* (Baltimore: Johns Hopkins University Press, 1986).

¹⁶ Samuel P. Huntington, *The Soldier and the State: The Theory and Practice of Civil-Military Relations* (Cambridge, MA: Belknap Press, 1957), 152.

¹⁷ Russell F. Weigley, *The American Way of War: A History of United States Military Strategy and Policy* (Bloomington: Indiana University Press, 1973).

¹⁸ Weigley, *American Way of War*, xxi.

ose qëllime të limituara dhe të paqarta. *Weigley* argumentoi se: “amerikanët, veçanërisht ushtarët amerikanë kanë pasur si përcaktim të qartë të strategjisë prirjen që t’i jepnin më pak konsiderata kundërshtive të joushtarakëve, në lidhje me atë që ata po bënin”.¹⁹

Formulimi i *Weigley*, edhe pse me ndikim, paraqet një interpretim të ngushtë të historisë së ushtrisë amerikane. Siç ka vënë në dukje *Brian M. Linn*, forcat e armatosura të SHBA kanë, në fakt, strategji favorizuese mbi asgjësimin. Përveç kësaj, Shtetet e Bashkuara kanë, në historinë e tyre, një shumëllojshmëri më të madhe strategjish sesa tregon formulimi i *Weigley*-t, duke përfshirë zmbropsjen dhe luftërat për qëllime të kufizuara.²⁰ *Linn* dhe të tjerët kanë vënë në dukje se ushtria e Amerikës ka një traditë të pasur për të kryer luftërat e vogla dhe rebelimet. Në të vërtetë, *Max Boot* shkoi aq larg sa të propozonte këtë traditë si një mënyrë alternative të rrugëve të luftës së Amerikës.²¹ *Linn* dhe *Boot*, të dy ofrojnë kritika të vlefshme të interpretimit të *Weigley*-t për historinë e ushtrisë amerikane. Formulatat e *Weigley*-t s’bëjnë gjë tjetër, veçse ngrenë, në mënyrë të mrekullueshme, si një portretizim, kulturën strategjike të ushtrisë amerikane dhe perspektivat e ushtrisë.

Një tjetër tendencë historike ka qenë një preferencë për qasje të drejtpërdrejtë në strategjinë mbi jo të drejtpërdrejtën. Ushtria e Shteteve të Bashkuara është përpjekur, gjatë historisë së saj, të mbarojë punë dhe të shkatërrojë armikun me mundësinë e parë. Siç është shprehur *Colin S. Gray*, “amerikanët e kanë favorizuar çështjen për fitore të shpejtë, nëpërmjet rreziqeve të betejës përfundimtare, në vend të trajtimit të ngadaltë të rrethimit detar”. Preferenca për strategji të drejtpërdrejtë ka qenë një trajtim industrial për luftë. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, për shembull, Shtetet e Bashkuara u lidhën me një preferencë për strategji të drejtpërdrejtë. Gjatë kësaj lufte, ata përdorën pothuajse dy të tretat e të gjitha pajisjeve ushtarake të aleatëve, duke ndërtuar 297.000 aeroplanë, 86.000 tanke, 2 milion kamionë, 8.800 luftanije dhe 87.000 mjete zbarkimi.²² Gjatë Luftës së Gjirit, SHBA, nëpërmjet asetëve strategjike të transportit ajror, lëvizën 500.000 njerëz dhe 540.000 ton ngarkesë-dhe vetëm 5% e materialeve që Shtetet e Bashkuara morën në luftë, lëvizi në ajër. Edhe operacionet paqeruajtëse, si në Bosnjë dhe Kosovë, kanë përfshirë mbështetje logjistike të konsiderueshme.

Një karakteristikë e cila vjen nga qasja industriale është përdorimi i pakufizuar i fuqisë së zjarrit. Llogaritë bashkëkohore të Luftës së Mogadishut u fokusuan në faktin se 18 ushtarë amerikanë humbën jetën dhe 83 u plagosën. Më pak i vërejtur ishte fakti se të paktën 500 somalezë u vranë dhe me mijëra u plagosën në të njëjtën luftë.²³ Një trajtim intensiv për përdorimin e fuqisë së zjarrit në luftë ka kuptim, nga një pikëpamje e caktuar. Shtetet e Bashkuara, me siguri, mund të përballojnë shpenzimet e burimeve për një trajtim të tillë. Për më tepër, fuqia e zjarrit shpesh shpëton jetët e amerikanëve. Megjithatë, Lufta e Vietnamit tregoi se si një mbështetje e fuqisë së zjarrit mund të rezultojë jo funksionale në një fushatë kundër kryengritësve.

Një karakteristikë tjetër e mënyrës së luftës amerikane është theksi mbi teknologjinë.

¹⁹ Weigley, *American Way of War*, xviii-xix.

²⁰ Brian M. Linn, “The American Way of War Revisited,” *Journal of Military History* 66 no. 2 (April 2002), 501-533.

²¹ Max Boot, *The Savage Wars of Peace: Small Wars and the Rise of American Power* (New York: Basic Books, 2002).

²² Richard Overy, *Why the Allies Won* (New York: W.W. Norton, 1995), p.192.

²³ O’Hanlon, “A Flawed Masterpiece,” *Foreign Affairs*, May/June 2002, p.52.

Asnjë komb, në historinë e kohëve të fundit, nuk ka vënë një theks të madh në rolin e teknologjisë në planifikim dhe shpalljen e luftës sesa Shtetet e Bashkuara. Lufta e Dytë Botërore shënoi mobilizimin botëror amerikan në shkencë dhe teknologji, duke kulmuar në shpërthimin e bombës atomike. Teknologjia luajti një rol të rëndësishëm në sjelljen e Amerikës në Luftën e Ftohtë gjithashtu, meqenëse Shtetet e Bashkuara kërkuan për të përdorur avantazhin e tyre cilësor për kundërpeshë të superioritetit numerik të Bashkimit Sovjetik dhe aleatëve e tij. Konfliktet e Amerikës pas Luftës së Ftohtë në Irak, Jugosllavi dhe Afganistan theksuan kufirin teknologjik mes miqve dhe armiqve. Kërkimet empirike për sjelljet e oficerëve të Shteteve të Bashkuara i tregojnë ata si tepër optimistë në lidhje me teknologjinë. Një vëzhgim i kryer në vitin 2000 nga *James R. Fitz* me 1900 oficerë të cilët bënë pjesë në institutin ushtarak profesional të Shteteve të Bashkuara, doli në konkluzionin se pjesa më e madhe e oficerëve besonin në teknologjinë re, doktrinën dhe organizimet, të cilat do ta bënin më të lehtë që Shtetet e Bashkuara të përdornin forcën dhe të arrinin fitore vendimtare në fushëbetë. Ata gjithashtu mendonin se teknologjia e avancuar do të mund t'i lejonte Shtetet e Bashkuara të angazhohen në operacione me intensitet të lartë dhe të ulnin gjithashtu dhe numrin e viktimave dhe të reduktonin kohëzgjatjen e konflikteve të ardhshme. Besimi tradicional i Amerikës mbi teknologjinë në luftë është qartësisht jo një recetë për suksesin. Shtetet e Bashkuara humbën në Vietnam, pavarësisht se shijuan një realizim të konsiderueshëm teknologjik, të paktën në pjesën më të madhe të zonave, mbi kundërshtarët e tyre, sepse nuk arritën të zhvillonin një strategji të përshtatshme për të arritur objektivat politike.

Prirja e Uashingtonit për teknologji të avancuar gjithashtu nxiti iluzionin mbi disa që Shtetet e Bashkuara mund të përdornin forcën pa vrarë ushtarët amerikanë dhe civilët e pafajshëm. Sadam Hussein pa se teknologjia e lartë ishte një shenjë më tepër dobësie sesa fuqie.²⁴ Një tendencë më e vonë dhe e paqartë ka qenë hezitimi i amerikanëve për të mos pasur viktimë. Njohja që populli amerikan ka për luftën konvencionale, e bën shumë të ndjeshëm ndaj humbjeve në luftë. Për më tepër, avantazhi i Shteteve të Bashkuara në fuqinë ajrore i ka lejuar ato të përdorin forcën ajrore në mënyrë efektive, me qëllim mosvënien e një numri të madh jetësh në rrezik. Më konkretisht, fushata ajrore e NATO-s mbi Kosovë, ishte, para së gjithash, e aftë të arrinte objektivat politike të aleancës gjithashtu edhe mospërfshirjen e forcave tokësore në këtë fushatë. Pra në këto rrethana ishte e panevojshme të futeshin jetët e amerikanëve në rrezik, pa qenë nevoja.

E ashtuquajtura *Doktrina Powell* thekson përdorimin e forcës dërrmuese kundër kundërshtarëve të Shteteve të Bashkuara, jo për shkak të domosdoshmërisë politike apo strategjike, por për shkak të besimit se ajo do të sjellë fitoren më shpejt, ndërkohë që do të ketë më pak viktimë. Sipas citimi të *Carl Builder* ushtria është: Një vëllazëri reciproke mbështetëse e shoqërisë. Esnafët (shoqëritë) janë bashkuar në një vëllazëri sepse, si vëllazër, ata kanë një lidhje familjare të përbashkët (ushtrinë) dhe njohje të pavarësisë së tyre në lidhje me njëri tjetrin në luftim.

Kultura Strategjike në veprim

Kultura strategjike kombëtare, ajo ushtarake dhe e shërbimit ka ndikuar në mënyrën se si Shtetet e Bashkuara iu afruan armës bërthamore. Kultura Strategjike Kombëtare e

²⁴ Kevin M. Woods, Michael R. Pease, Mark E. Stout, Williamson Murray, and James G. Lacey, *Iraqi Perspectives Project: A View of Operation Iraqi Freedom from Saddam's Senior Leadership* (Norfolk, VA: U.S. Joint Forces Command, 2006).

armëve bërthamore ka forcuar idenë e vjetër se në Shtetet e Bashkuara ekziston një ndarje mes paqes dhe luftës. Qysh në fillimin e Luftës së Ftohtë, këndvështrimi kryesor, i shprehur nga strategët civilë dhe oficerët ushtarakë, ka qenë se armët bërthamore janë armët e para dhe më kryesore të parandalimit.

Drejtuesit amerikanë konsideruan armët bërthamore si të ndryshme, ushtarakisht, politikisht dhe psikologjikisht, nga armët e tjera, pothuajse që nga fillimi, edhe para se sovjetikët siguruan armët bërthamore, lanë vetëm paritetin e arritur. Gjithashtu ata besuan se përdorimi i armëve bërthamore, nga Shtetet e Bashkuara, do të kishte pasojë politike afatgjata për Shtetet e Bashkuara.²⁵ Tabuja bërthamore u identifikua si koncept, së pari, gjatë fillimeve të administrimit *Eisenhower*. Në atë kohë, shihej si diçka që qeveria e Shteteve të Bashkuara duhej të kundërshtonte.²⁶ Me kalimin e kohës, megjithatë, vargu i besueshmërisë për përdorimin e armëve bërthamore është ngushtuar në mënyrë të konsiderueshme.²⁷

Si rezultat, përdorimi i armëve bërthamore që fillimisht ishte bindës, siç është përdorimi me takt i armëve bërthamore në fushëbetejë ose kërcënimet e drejtpërdrejta për të përdorur armët bërthamore në mënyrë që të frenojë konfliktin konvencional, jo për shumë kohë u duk i ligjshëm. Gjatë viteve 1990, kundërshtimi për armët bërthamore çoi në një lëvizje për t'i shfuqizuar ato së bashku. Në krye të lëvizjes ishin zyrtarë të lartë amerikanë dhe shërbyes civilë. Në një fjalim, në dhjetor të vitit 1996, gjenerali *Lee Butler*, ish Komandanti Suprem i Komandës Strategjike të SHBA, argumentoi se armët bërthamore janë të rrezikshme, shumë të shtrenjta dhe ushtarakisht inefficente, ajo armiqësi e paepur dhe tjetërsimi, pothuajse me siguri do të çonin në një krizë bërthamore, që dështimi i tmerrit bërthamor jo vetëm do të rrezikonte të mbijetuarit e antagonistëve, por çdo shoqëri dhe se lufta bërthamore është një bishë e pangopur dhe e ndezur nga instinktet dhe urinë e së cilës mundohemi ta kuptojmë, por që, ndoshta, nuk mund ta kontrollojmë.²⁸ Për të, tmerrimi bërthamor paraqiti jo një forcë për stabilitet, por më tepër një katalizator për konfliktin. Në këndvështrimin e tij, tmerrimi ishte “një formulë për katastrofë të pazbatuar... dhe bazohet në një përsëritje të mërzitshme të supozimeve të pajustificuara, pohimeve të paprovuara dhe kontradiktat logjike.” Në sytë e tij “kërcënimi për të përdorur armët bërthamore është i pambrojtshëm”.²⁹ Ai ishte dyshues për aftësinë e armëve bërthamore për të frenuar përdorimin e armëve kimike ose biologjike nga shtetet mashtrues. Ai deklaroi, shkurtimisht, se një botë e lirë nga kërcënimi i luftës bërthamore, duhet të jetë e lirë nga armët bërthamore.³⁰

Ndonëse viti 1990 dëshmoi thirrje të përsëritura nga elita për zhdukjen e armëve bërthamore, sondazhet publike tregojnë një panoramë më komplekse. Rezultati i studimeve të ndryshme tregojnë se populli amerikan ka një skepticism të

²⁵ Timothy J. Botti, *Ace in the Hole: Why the United States Did Not Use Nuclear Weapons in the Cold War, 1945 to 1965* (Westport, CT: Greenwood Press, 1996), Ch. 22.

²⁶ McGeorge Bundy, *Danger and Survival: Choices About the Bomb in the First Fifty Years* (New York: Random House, 1988), 241, 249.

²⁷ Nina Tannenwald, “Nuclear Weapons and the Vietnam War,” *Journal of Strategic Studies* 29, no. 4 (August 2006).

²⁸ General Lee Butler, *Abolition of Nuclear Weapons Speech*, National Press Club, Washington, D.C., December 4, 1996, at <http://www.wagingpeace.org/butlerspeech.html>.

²⁹ General Lee Butler, “The Risks of Nuclear Deterrence: From Superpoëers to Rogue Leaders,” National Press Club, February 2, 1998.

³⁰ Butler, *Abolition of Nuclear Weapons Speech*.

konsiderueshëm, lidhur kjo me kryerjen e eliminimit të plotë të armëve bërthamore. Sjelljet amerikane kundrejt armëve bërthamore gjithashtu mbartin markën e traditës së idealizmit liberal të SHBA. Siç bëri të ditur presidenti *Ronald Reagan* në 23 mars 1983, Nisma e Mbrojtjes Strategjike shënoi një ndryshim thelbësor në mendimin nga zmbropsja në mbrojtje: Më lejoni të ndaj me ju një vizion të së ardhmes e cila ofron shpresë. Është se ne nisim një program për t'iu kundërvënë kërcënimit të raketave sovjetike me masa mbrojtëse. Na lejoni t'i kthehemi forcës së vërtetë në teknologji që solli bazën tonë industriale dhe që na ka dhënë cilësinë e jetës ku ne jetojmë sot. Po sikur njerëzit e lirë të mund të jetonin të sigurt me dijen se siguria e tyre nuk varet nga kërcënimet, nga hakmarrja e menjëhershme e SHBA për të frenuar sulmet sovjetike, të cilat mund të shkatërrojnë raketat balistike strategjike para se ato të arrijnë tokën tonë apo atë të aleatëve tanë? Unë i bëj thirrje komunitetit shkencor në vendin tonë, atyre (shkencëtarëve) që na dhanë armët bërthamore, për t'i kthyer talentet e tyre të mëdha tani për kauzën e njerëzimit dhe paqes botërore, për të na dhënë mjetet për t'i bërë këto armë bërthamore impotente dhe të vjetruara.³¹

Për *Reagan*, të paktën, mbrojtja strategjike ofroi perspektivën e sigurisë absolute në traditën e idealistëve liberalë. Kultura Strategjike e Ushtrisë, mënyra se si ushtria e SHBA ka trajtuar armët bërthamore, pasqyron gjithashtu kulturën strategjike. Armët bërthamore, për shembull, përputhen me theksin që ushtria amerikane, tradicionalisht, i ka vënë teknologjisë së avancuar. Gjatë Luftës së Ftohtë, ushtria e SHBA e ka parë zhvillimin teknologjik, duke përfshirë edhe drejtimin në teknologjinë bërthamore, si një avantazh konkurrues mbi Bashkimin Sovjetik. Armët bërthamore janë parë si kundërpeshë e superioritetit konvencional sovjetik. Gjatë administrimit të *Carter* dhe *Reagan*, teknologjia u pa si një pikë kritike për dy superfuqitë rivale (SHBA-BRSS). Nisma e Mbrojtjes Strategjike, për shembull, përfaqësoi një përpjekje për të përdorur teknologjinë e avancuar të SHBA për të bërë të vjetruar forcën e armëve konvencionale sovjetike dhe të raketave të rënda. Planifikimi amerikan për luftën bërthamore gjithashtu pasqyroi tendencën e ushtrisë së SHBA për të menduar, në termat e luftës, për synimet e pakufizuara me mjetet konvencionale totale. Siç argumentuan së bashku *James Schlesinger* dhe *Albert Wohlstetter*, në kohëra të ndryshme, planifikimi i ushtrisë së SHBA ishte i njëanshëm drejt përdorimit masiv të armëve bërthamore, në vend të zbulohet mundësia e diskriminimit të përdorimit të këtyre armëve.³²

Si përfundim

Situatat e fundit si në Lindjen e Mesme, Ukrainë etj. po e ringjallin tashmë memorien e studiuesve dhe të politikbërjes për rishikimin e kulturës strategjike dhe faktorëve përbërës të saj. Ngjarjet sfidat dhe zhvillimet e reja të Pasluftës së Ftohtë (si pranvera arabe, lufta kundër terrorizmit, impaktet e teknologjisë së re dhe deri tek konflikti në Krime me Rusinë), sjellin nevojën e krijimit të një mendësie të re në marrëdhëniet mes kulturës politikbërëse dhe strategjisë.

Karakteristikat e qëndrueshme të kulturës strategjike, kulturës ushtarake amerikane dhe

³¹ Ronald Reagan, "Announcement of Strategic Defense Initiative," March 23, 1983, at <http://www.missilethreat.com/resources/speeches/reagansdi.html> (accessed August 16, 2005).

³² Desmond Ball, "The Development of the SIOP, 1960-1983" in Desmond Ball and Jeffrey Richelson, eds., *Strategic Nuclear Targeting* (Ithaca: Cornell University Press, 1986), 63; "Policy for Planning the Employment of Nuclear Weapons", National Security Council, NSDM-242, January 17, 1974, Washington, D.C.

kulturës organizative të shërbimeve të armatosura të SHBA kanë ndikuar kështu në mënyrën se si Shtetet e Bashkuara iu afruan armëve bërthamore. Si rezultat, kultura strategjike e Amerikës ka qenë dominuese më shumë për nga vazhdimësia sesa nga ndryshimi.

Bibliografia:

- Basil H. Liddell Hart, *The British Way in Warfare* (New York: MacMillan, 1933).
- Michael I. Handel, "The Evolution of Israeli Strategy: The Psychology of Insecurity and the Quest for Absolute Security" in Williamson Murray, MacGregor Knox, and Alvin Bernstein, eds., *The Making of Strategy: Rulers, States, and War* (Cambridge: Cambridge University Press, 1994).
- Michael Evans, *The Tyranny of Dissonance: Australia's Strategic Culture and Way of War, 1901-2005* (Canberra: Land Warfare Studies Center, 2005).
- Colin S. Gray, "National Style in Strategy: The American Example," *International Security* 6, no. 2 (Fall 1981).
- Alan Macmillan, Ken Booth, and Russell Trood, "Strategic Culture" in Ken Booth and Russell Trood, eds., *Strategic Cultures in the Asia-Pacific Region* (New York: St. Martin's, 1999).
- Edgar H. Schein, "Coming to a New Awareness of Organizational Culture," *Sloan Management Review* 25, no. 2 (Winter 1984).
- Clausewitz, *On War*.
- C. Vann Woodward, "The Age of Reinterpretation," *American Historical Review* 66 (October 1960).
- Walter Lippmann, *Public Opinion and Foreign Policy in the United States* (London: Allen and Unwin, 1952).
- Samuel P. Huntington, *The Soldier and the State: The Theory and Practice of Civil-Military Relations* (Cambridge, MA: Belknap Press, 1957).
- David R. Woodward, *Trial by Friendship: Anglo-American Relations, 1917-1918* (Lexington: University Press of Kentucky, 1993).
- *Cold War and Limited War*, 2nd ed. (New York: D.C. Heath, 1972).
- Eliot A. Cohen, *Supreme Command: Soldiers, Statesmen, and Leadership in Wartime* (New York: Free Press, 2002), 175-184; Andrew Krepinevich, *The Army and Vietnam* (Baltimore: Johns Hopkins University Press, 1986).
- Russell F. Weigley, *The American Way of War: A History of United States Military Strategy and Policy* (Bloomington: Indiana University Press, 1973).
- Brian M. Linn, "The American Way of War Revisited," *Journal of Military History* 66 no. 2 (April 2002).
- Max Boot, *The Savage Wars of Peace: Small Wars and the Rise of American Power* (New York: Basic Books, 2002).
- Richard Overy, *Why the Allies Won* (New York: W.W. Norton, 1995).
- O'Hanlon, "A Flawed Masterpiece," *Foreign Affairs*, May/June 2002.
- Kevin M. Woods, Michael R. Pease, Mark E. Stout, Williamson Murray, and James G. Lacey, *Iraqi Perspectives Project: A View of Operation Iraqi Freedom from Saddam's Senior Leadership* (Norfolk, VA: U.S. Joint Forces Command, 2006).
- Quoted in Chris Hables Gray, *Postmodern War: The New Politics of Conflict* (London: Routledge, 1997).
- Timothy J. Botti, *Ace in the Hole: Why the United States Did Not Use Nuclear Weapons in the Cold War, 1945 to 1965* (Westport, CT: Greenwood Press, 1996).
- McGeorge Bundy, *Danger and Survival: Choices About the Bomb in the First Fifty Years* (New York: Random House, 1988).
- Nina Tannenwald, "Stigmatizing the Bomb: Origins of the Nuclear Taboo," *International Security* 29, no. 4 (Spring 2005).

Roli veprues i doktrineve ushtarake në pasqyrimin e gjendjes moralo-psikologjike të ushtrisë

Nënkolonel (R) Ajet Nuellari

Trajtesë e shkurtuar. *Njohja dhe edukimi i vetive moralo-psikologjike në luftë, por edhe në stërvitje, është një nga problemet më të vështira për komandat dhe shtabet, për kuadrot dhe specialistët ushtarakë. Ato janë sintezë e pasqyrimin e një vargu faktorësh politikë, ushtarakë, ekonomiko-shoqërorë etj. Si rrjedhojë është vështirë të përcaktohet edhe shkalla e ndikimit dhe roli i çdonjërit prej këtyre faktorëve në formimin e ndërgjegjes morale të njerëzve. Të marrë së bashku, ata përbëjnë bazën objektive të edukimit, të normave e parimeve morale. Analiza e çdonjërit nga këto elemente, për të nxjerrë në pah rolin dhe ndikimin e tyre në treguesit e gjendjes moralo-psikologjike, është objekt i studimeve të veçanta.*

Doktrinat ushtarake kanë synuar të zgjidhin kundërshtitë e lindura në fushën e luftës si të planit teknik, ashtu dhe ato të planit moral. Ato jo vetëm nuk mund të kuptohen jashtë vlerave morale e psikologjike, por edhe vetë luajnë një rol mjaft aktiv e shumë të rëndësishëm në këtë drejtim.

Që kur kanë lindur doktrinat ushtarake, ato kanë synuar të zgjidhin kundërshtitë e lindura në fushën e luftës si të planit teknik, ashtu edhe ato të planit moral. Nga përmbajtja e tyre, nga mënyrat e zgjedhjes që u bëjnë ato mjaft problemeve të luftës, varet edhe ecuria e gjendjes moralo-psikologjike të ushtrisë. Kështu, doktrinat ushtarake jo vetëm nuk mund të kuptohen jashtë vlerave morale e psikologjike të njerëzve që i zbatojnë ato, por edhe ato vetë luajnë një rol aktiv në këtë drejtim.

Në ç' drejtim ndihet ndikimi i tyre te morali? Më parë, shtrimi i kësaj pyetjeje vlerësohej i gabuar, si dukuri që i hapte rrugën teknokratizimit e burokratizimit ushtarak, ku faktori moral shfaqej si sinonim i ideologjisë, i politikës, i pastërtisë klasore, gjë që në të vërtetë e kishin ngushtuar e zbehur shumë rolin e faktorit moral të luftës.

Synimi i doktrineve ushtarake është që dëshirat, vullnetin, shpirtin luftarak, entuziazmin e masave të ushtrisë, trimërinë dhe guximin e tyre t'i përdorin sa më drejt. Le të shikojmë p.sh., se si i merr në konsideratë dhe si i trajton vetitë moralo-psikologjike doktrina e luftës partizane, e cila shpreh në vetvete një "nyje të litarit" në qafë të armikut. Nga mënyra se si realizohet lufta partizane me goditje në shpinë, në krah, natën, ditën, në pyll apo në rrugë, në rajone malore e fushore, tregon për vlerën e saj në fushën moralo-psikologjike. Ajo armikut i ngjall frikën, pasigurinë, panikun, krizën morale e

shpirtërore. Pasojat e luftës partizane i kanë ndjerë edhe strategë të mëdhenj ushtarakë. Kështu, Napoleon Bonaparti humbjen e parë e pësoi nga lufta partizane në Spanjë. Ushtria e tij ishte përgatitur moralisht e ushtarakisht të shkatërronte kundërshtarin me luftë balllore. Në shërbim të kësaj lufte ai kishte vënë gjithë potencialin material e njerëzor. Ndërsa spanjollët kundër tyre përdorën luftën partizane. Nga goditjet e rrufeshme e të papritura, përballë por edhe në prapavijë, natën por edhe ditën, ushtria e Napoleonit u vu në pozitë të vështirë. Kriza morale erdhi vazhdimisht duke u thelluar derisa e çoi ushtrinë në humbje si në fazën e parë, ashtu dhe të dytë të kësaj lufte. Në këtë rast, francezët i mundi gjenialiteti i mbrojtjes së një populli që do të rrojë i pavarur. Zjarri i luftës partizane, të egër e të pamëshirshëm kundër pushtuesve francezë, u rrit akoma më shumë edhe pse Napoleoni solli në Spanjë dhe 300.000 ushtarë të tjerë. Në këtë vend ushtria franceze u ndesh për herë të parë me një armik të veçantë me të cilin s'kishte të bënte më parë. Në mënyrën më të tmerrshme ngriheshin fshatarët e zemëruar me thikë në dorë, çobani i leckosur me dyfekun e tij të ndryshkur, artizani me hurin e tij me majë hekuri. Fjala spanjolle "guerile" (lufta e vogël) e jepte në mënyrë të përsosur kuptimin e asaj që po ndodhte.

Vlerat moralo-psikologjike të luftës partizane u ndjenë edhe në Luftën e Dytë Botërore në shumë vende si: në Shqipëri, BS, Jugosllavi, Greqi etj. Siç thotë Boné "lufta partizane është një "baticë" dhe "zbaticë" rreth bazave të armikut, të cilat sulmohen nga të gjitha anët". Në rrafshin psikologjik deri më sot lufta partizane ka treguar epërsitë e saj në shfrytëzimin e cilësive të formimit e zhvillimit psikik të ushtarëve që janë pjesëmarrës në këtë lloj lufte, si dhe mangësitë dhe dobësitë e zhvillimit psikik të ushtrisë së sulmuar, të cilat në mënyrë shkallëzore e sistematike kanë çuar në konsumimin fizik, material e në krizën e besimit të këtyre të fundit.

Edhe sot format dhe metodat e organizimit të luftës partizane po u përgjigjen kushteve të luftës moderne. Ndezja e saj sidomos në prapavijën e kundërshtarit ka sa vlera ushtarake aq edhe morale-psikologjike për të acaruar krizën morale të pushtuesit në rritjen e tensionit, të pasigurisë etj. Njëkohësisht edhe lufta kundërpantizane, nëpërmjet terrorit, sabotimeve, dezinformimit e formave të tjera, ka për qëllim të ngjallë panik e pasiguri në popull dhe në radhët e ushtrisë, të destabilizojë gjendjen e brendshme e të paralizojë vullnetin e ushtrisë e të popullit për qëndrësë. Historia e luftërave antike dhe e atyre moderne flet se ka doktrina të ndërtuara me objektiva e synime të veçanta morale e psikologjike. E tillë ka qenë dhe është doktrina e luftës rrufe.

Frymëzuesit e kësaj teorie u nisën nga mendimi se "qëllimi përfundimtar" i çdo beteje është më shumë psikologjik se sa fizik. Në planin ushtarak, frymëzuesit e saj u udhëhoqën nga teza, sipas së cilës në objektivin e fundit të luftës, lufta psikologjike të ndikonte ndjeshëm në paralizimin e vullnetit të kundërshtarit për vijimin e saj, se në luftë, sipas tyre, "është shumë më pak e kushtueshme të shkatërrohet forca e vullnetit se sa të asgjësohen vetë njerëzit". Pra, lufta rrufe merr përsipër të zgjidhë probleme të rëndësishme morale, të vërë në krizë psikikën e njerëzve. Në planin strategjik, gjatë Luftës së Dytë Botërore, u synua dhe në mjaft vende u arrit që me goditje të shpejta të paralizohet vullneti dhe qëndresa e ushtrive dhe e popujve të vendeve që iu nënshtruan agresionit. E lidhur ngushtë me përmbajtjen e kësaj doktrine ishte krijimi i miteve, për shembull, për pathyeshmërinë e ushtrisë gjermane, bazuar në fitore të shpejta e të bujshme të ushtrisë gjermane në vitet 1939-1940. Natyrisht propaganda bëri zhurmë të bujshme për këto fitore, duke ushtruar trysni të madhe moralo-psikologjike mbi kundërshtarët. Dhe është e padiskutueshme që vetë epërsia morale, apo më saktë, përgatitja e lartë

moralo-psikologjike e pjesëmarrësve në luftë që një ndër faktorët më kryesorë të sukseseve të tyre.

Megjithatë, historia e luftërave njeh edhe raste kur optimizmi dhe besimi për përfundimet e luftës rrufe, për shkak të qëndresës së vendosur të popujve, nuk janë përligjur. Kështu, në periudhën e luftës civile në Angli, ndërmjet mbretit dhe parlamentit, trupat e Karlit I kishin epërsi, ishin më të përgatitura fizikisht, zotëronin mirë artin e të luftuarit, kishin armatimin më të përparuar të kohës dhe kuadrot e tyre zotëronin njohuri të mira dhe aftësi praktike në fushën e luftës. Por të gjitha këto karakteristika patën vlerë të përkohshme, pasi parimi nga të cilat ato udhëhiqeshin ishte arritja e fitoreve në një periudhë të shkurtër kohe. Në fillimet e luftës ata treguan shpirt të lartë ushtarak e sulmues, por me zgjatjen e saj, ata u ligështuan, filluan të tërhiqeshin; në radhët e tyre u ngjall paniku e mosbesimi në fitore dhe qëndresa e gjatë e kundërshtarit krijoi në radhët e tyre zhgënjim. Ushtria e Karlit I më shumë se gjithçka e mundi morali i kundërshtarit, i cili, edhe pse përbëhej nga njerëz “të paushtruar në punët ushtarake”, zotëronte frymë të lartë luftarake.

Lufta rrufe, theksojnë studiuesit gjermanë, përmban në vetvete një element thelbësor, përgjithësisht të lënë në harresë nga historianët ushtarakë, pikërisht elementin e tmerrit që synon të paralizojë vullnetin dhe besimin e kundërshtarit për qëndresë, pa bërë asnjë dallim midis ushtrisë së tij të rregullt dhe popullsisë civile. Ajo kërkon që të mos i lihet asnjë shteg shpëtimi, të mbahet nën ankthin e vijueshëm të “vdekjes që vjen nga qielli”. Terrori në këtë formë lufte nuk kursen asgjë dhe asnjë dhe furia e verbër dhe e pakontrolluar është karakteristikë kryesore e saj. Lufta rrufe në kushtet e sotme ka marrë forma e trajta të reja. Në to vihen re prirje për ta larguar ushtarin sa më shumë nga vija e zjarrit dhe e ndeshjes. Zgjidhje të tilla burojnë nga vetë natyra e luftërave të sotme, nga zhvillimi i teknikës e i armatimit, por që ndikojnë shumë për të shmangur edhe problemet me pasoja të rënda morale.

Në kushtet e reja të zhvillimit të teknikës e të armatimit, krahas doktrinës së përgjithshme ushtarake, kanë dalë edhe doktrina të veçanta për lloje armësh e forcash. E tillë është edhe doktrina e luftës me intensitet të ulët. Si doktrinë e re ajo ka veçoritë e saj. Këto i shikojnë edhe në planin moral, politik e psikologjik. Lindi si doktrinë me objektiva të theksuara politike e morale, se si të evitojë luftën bërthamore, pasojat e të cilës do të ishin katastrofale. Në të dy format e zhvillimit të saj, si me mjete dhe pa mjete, faktori politik dhe spektri i luftës moralo-psikologjike dalin në plan të parë.

Veprimet jo të armatosura përfshijnë veprimet politike propagandistike, psikologjike dhe ekonomike. Konflikti me intensitet të ulët është një formë e luftës në të cilën synimi kryesor nuk është dukuria e fitores në kuptimin klasik ushtarak, apo asgjësimi fizik i kundërshtarit, por deri diku shpërbërja e një vendi. Kjo është luftë morale që ka në bazë konflikte shoqërore, degjenerim, destabilizim ekonomik dhe luftë të vijueshme psikologjike. Kjo, shkruan një studiues amerikan, është në të vërtetë luftë e përgjithshme, diçka krejt e ndryshme nga “shkatërrimi total”.

Përdorimi i dhunës me anën e instrumentit të fuqisë ushtarake mund të mbledhë vetëm një masë njerëzish, por nuk mund të sigurojë një përkrahje të gjerë morale. Në kushtet e sotme, këtë mund ta sigurojë vetëm një luftë me intensitet të ulët. Kur ana morale bie në kundërshtim me strategjinë, atëherë krijohet hapësirë e gjerë për këtë lloj lufte. Në qendër të saj vendoset shteti si “çelës” dhe rregullator i jetës shoqërore. Për ta zhveshur

atë moralisht përpara popullit, ndërmjet kësaj lufte ndërmerren veprime politike, ekonomike e psikologjike. Lufta me intensitet të ulët fut një aspekt moral krejtësisht të ri. Sipas amerikanëve, konceptet e konfliktit me intensitet të ulët paraqesin një dilemë të pafundme morale dhe fiziologjike që janë shumë larg përmasave taktike dhe teknike. Armët vazhdojnë, ata janë një faktor i rëndësishëm në luftë, por jo faktori vendimtar, rolin vendimtar e ka populli dhe jo mjetet.

Karakterit i theksuar moralo-politik i kësaj lufte duket që në mjetet dhe format që përdor. Ajo realizohet nëpërmjet operacioneve të ndihmës, nga të huajt, forcave të brendshme që luftojnë kundër qeverisë. Realizohet nga veprimet e trupit diplomatik, deri në ndihmat ushtarake. Parimi nga i cili udhëhiqet kjo luftë është se para veprimeve të armatosura duhet realizuar më parë sulmi ndaj mendjes së njerëzve për t'i pushtuar e drejtuar ata sipas nevojave, pasi sot në botë, sipas tyre, më shumë vrasin "stilografët" sesa plumbat.

Fillimisht synohet të punohet me forcat e besuara, me përkrahësit e tyre brenda vendit, ku do të realizohet lufta me intensitet të ulët. Kontingjente të tilla vihen në zbatim të programeve të planeve konkrete të hartuara me këto synime. Në rastet kur nuk ka forca të tilla fillon në stil të gjerë përgatitja psikologjike. Ajo fillon shumë kohë para veprimeve luftarake dhe drejtohet në ato aspekte që shkaktojnë zemërimin e popullit. Propaganda vë theksin në paaftësinë dhe mungesën e vullnetit të qeverisë (pushtetit në fuqi) për të zgjidhur problemet në fjalë. Me veprimet e organizuara dhe tepër provokuese, synohet që qeveria të përdorë forcat e armatosura ndaj masave. Në këto raste qeveria vihet përfundimisht në qendër të luftës, duke humbur çdo lloj besimi në masat e popullit. Organizimin e sulmit psikologjik ata parashikojnë ta bëjnë duke shfrytëzuar edhe elementët e brendshëm. Për këtë parashikojnë të shfrytëzojnë gazetarë, klerikë, sindikalistë, njerëz të elitës etj. Synohet në ata persona që janë të njohur, të respektueshëm, me reputacion në popull. Me qëllim për t'i ruajtur, ata nuk i angazhojnë në veprime konkrete e të hapura kundër qeverisë. Detyra e tyre është të fryjnë gabimet e vështirësitë e qeverisë dhe të përhapin te masat idenë e kundërshtimit.

Për rritjen e frytshmërisë së sulmit psikologjik në luftën me intensitet të ulët, synohet të ngrihet një burim alternativ në territorin e vendit nga forcat e brendshme ose edhe nga shteti agresor në territorin e vet, zyrtar ose privat. Qëllimi është të përhapë pikëpamje të ndryshme nga ato të qeverisë.

Rëndësi i kushtohet në këtë lloj lufte mbajtjes nën kontroll të plotë të qeverisë, reagimeve të saj si dhe taktikës që ajo ndjek në këtë luftë. Kur sulmi psikologjik nuk i arrin objektivat, parashikohet përshkallëzimi i mëtejshëm i masave. Për këtë, ata e vënë theksin në dhënien e ndihmës materiale e në armatime të forcave kundërqeveritare. Në këtë fazë synohet në dy drejtime: së pari, lëvizje e brendshme për të siguruar legjitimitetin e njohjes, duhet të vendosë lidhje me udhëheqësit e vendeve të tjera, së dyti, për të shmangur skandalet që mund të lindin nga dhënia e ndihmës materialo-ushtarake, ato mundohen t'i realizojnë në mënyrë të tërthortë. Gjatë viteve 80-të, lufta me intensitet të ulët, sipas skemës së mësipërme, është realizuar në shumë vende, në politikën e të cilave, ka pasur konflikte të brendshme, si: në Afganistan, Angola, Kamboxhia, Nikaragua, etj.

Në planin moral e psikologjik edhe kur kalohet në fazën e goditjes ushtarake, nuk zbatohet aspak thelbi i saj si luftë psikologjike. Operacionet goditëse janë veprime të shpejta e të shkurtra me qëllime të caktuara politike, për terror moral e psikologjik, për destabilizimin e vendit, për të ngritur te kundërshtari shkallën e alarmit e të tensionit psikologjik. Kjo

lloj lufte krijon terren të përshtatshëm për të dhënë goditje të shpejta. Pas realizimit të objektivave politikë, forcat në përgjithësi tërhiqen nga këto vende.

Në kushtet e vendit tonë, lufta me intensitet të ulët është e mundshme. Si bazë mund të shërbejnë konfliktet e brendshme sociale, rrymat e ndryshme politike, forcat destabilizuese. Përballimi me sukses i luftës me intensitet të ulët kërkon që ajo të përfytyrohet drejt, si luftë me synime të thella politike e ushtarake. Efektet e luftës me intensitet të ulët do të varen nga kundërveprimi. Në këtë periudhë mund të ndeshemi edhe me veprime terroriste e diversioniste, nga elementë të brendshëm e të jashtëm, të cilët fillimisht tatojnë “pulsin” dhe thellojnë luftën psikologjike brenda vendit. Kundërveprimi i shpejtë e i organizuar ndaj tyre ka rëndësi sa morale aq edhe ushtarake. Rëndësi në këto situata merr vendosja e kontrollit të rreptë për të mos lejuar hyrjen e armëve, të municioneve e mjeteve të tjera luftarake, të cilat i shërbejnë armatosjes së të interesuarve në zhvillimin e luftës me intensitet të ulët. Po kështu, vigjilenca dhe gatishmëria luajnë një rol të veçantë në përballimin e luftës me intensitet të ulët. Disa ngjarje të kohëve që po jetojmë, si vjedhja e depove të armëve në ushtri, intensifikimi i banditizmit, shtimi i kriminalitetit dhe i terrorizmit në kufijtë tanë, rënia ndjeshëm e treguesve të disiplinës ushtarake etj., diktojnë gjithnjë e më shumë nevojën e forcimit të rregullit e të gatishmërisë luftarake.

Sot në botë po marrin gjithnjë e më shumë hapësirë doktrinat mbrojtëse. Po ta shohim edhe në rrafshin moralo-psikologjik, do të vinim re tipare e karakteristika të veçanta në krahasim me doktrinat e analizuara më lart. Këto rrjedhin nga sfondi historik, ekonomiko-shoqëror, nga sistemet politike e grupimet përkatëse ushtarake që vepronin, veçanërisht kur është fjala për luftën rrufe dhe atë me intensitet të ulët. Doktrina e sotme mbrojtëse është rezultat i strukturave të reja demokratike, kur kufijtë e konflikteve politike dhe ideologjike ndërmjet lindjes dhe perëndimit nuk ekzistojnë më. Kjo situatë e re politike ka ulur përballë njëra-tjetrës forca dhe grupime, të cilat më parë ishin kundërshtarë. Doktrina e re ushtarake pasqyron një filozofi të bazuar mbi të drejtat ndërkombëtare, në parimet mbrojtëse, në konsideratat gjeopolitike, në respektimin e të drejtave të popujve e të shteteve të ndryshme, në zbatimin e legjislacionit etj. Synimi i saj është garantimi i paqes, parandalimi i konflikteve, ruajtja e sovranitetit të çdo vendi, sigurimi global, rajonal dhe kombëtar. Ndërsa psikologjia sunduese që përshkon doktrinën mbrojtëse është ajo e bashkëpunimit, e sigurimit dhe e parandalimit të konflikteve.

Po të dallojmë në doktrinën e sotme mbrojtëse ndikimet e saj në rrafshin moralo-psikologjik, në të do të vërejm këto karakteristika:

Së pari, për vetë karakterin demokratik të kësaj doktrine lind një moral i ri, me një bazë sociale më të gjerë, i frymëzuar e i bazuar në parime e norma që kanë të bëjnë me ruajtjen e lirisë, të pavarësisë e sovranitetit të çdo vendi. Zhdukja e pengesave ideologjike krijon mundësinë që tërë kombi të qëndrojë e të luftojë me vendosmëri për t’i bërë ballë armikut. Mbrojtja e çdo vendi përfshin interesat e gjithë popullit ku çdo njeri duhet të japë ndihmesën e tij. Sigurimi i përgjithshëm përfshin sot lidhjet e ngushta midis ushtrisë dhe popullit të të gjitha niveleve.¹

Në këtë mënyrë, bindja dhe ndërgjegja morale në sigurimin e lirisë e të pavarësisë së çdo vendi bazohet tashmë jo në kritere ideologjike e në politikat partiake, por në ato

¹ Owe Viktorin, Vjenë, 1991, përkthimi në shqip, f. 7.

aspirata demokratike, ku në të vërtetë edhe problemet e mbrojtjes e të sigurimit të lirisë e të pavarësisë së çdo vendi shikohen më gjerë e më thellë. Kjo është një bazë e fortë mbi të cilin ndërtohet uniteti moralo-politik, zhvillohet shpirti luftarak dhe, në tërësi, elementet përbërëse të ndërgjegjes morale.

Së dyti, në kushtet e doktrinës së re mbrojtëse, roli i bindjeve dhe i ndërgjegjes morale është mjaft i rëndësishëm. Kjo për edhe faktin se, nëpërmjet saj mund të kuptohen e zgjidhen drejt kundërshtitë që shfaqen ndërmjet nevojës për demokraci, nga njëra anë dhe organizimi i disiplinës ushtarake, nga ana tjetër. Ky proces kontradiktor zgjidhet drejt ku në bazë të edukimit moralo-psikologjik vihet teza se sa më shumë bëhet i dobishëm demokratizimi i jetës së vendit, aq më i domosdoshëm bëhet centralizimi dhe disiplina në ushtri. Nëpërmjet mjaft rrugëve shoqëria kontrollon veprimtarinë ushtarake. Marrëdhëniet midis drejtimit ushtarak dhe shoqërisë ndërtohen në atë mënyrë që veprimtaria e ushtrisë të mos dalë jashtë interesave dhe synimeve të shoqërisë. Ushtarakëzimi i jetës shoqërore dhe drejtimi me metoda të tilla cenojnë demokratizimin e jetës dhe mbi masat ushtrohet një terror moralo-psikologjik. Kështu ngushtohet në mënyrë të panevojshme demokracia. Rrezikun e këtyre pasojave e ka ndier që në shekullin e 2-të të erës së re Junius Juvenal, kur thoshte se “gjithçka dihet, por një gjë e kam të paqartë se kush do të na mbrojë ne nga mbrojtësit tanë”. Pra, ky problem sa me vlera politike aq edhe moralo-psikologjike, në doktrinën e re mbrojtëse vendos raporte të qarta ndërmjet shoqërisë dhe ushtrisë, sqaron dhe përcakton brenda këtyre interesave detyrat e saj, mekanizmat që përdor në zbatimin e misionit të saj. Vendosja e këtyre problemeve mbi baza të moralshme, brenda normave dhe sanksioneve ligjore, ndikon në forcimin e marrëdhënieve ndërmjet ushtrisë e shoqërisë në tërësi. Në këtë mënyrë vetë shoqëria çlirohet nga psikoza e frikës dhe e kërcënimit, që mund të shkaktojë ushtria e vet, pasi në doktrinat e sotme mbrojtëse shoqëria, duke parë se “regjimi ushtarak dhe ligji ushtarak i jep skeletin ligjor të punës së saj, ndien siguri të plotë dhe besim se ajo i shërben popullit.”²

Së treti, doktrina e re, ku në bazë të saj ka mbrojtje kombëtare, në një formë ose në një tjetër, shpreh hapur karakterin e drejtë të luftës gjë që nxit dhe edukon një moral të fortë e të qëndrueshëm. “Është kjo arsyeja, -nënvizon shefi i Shtabit të Ushtrisë Amerikane, - që ideja e mbrojtjes kombëtare është futur thellë në popullin tonë dhe se rinia jonë sa herë të thirret për mbrojtje, do të jetë e gatshme të bëjë më shumë se sa detyra.”³ Pavarësisht se organizimet ushtarake sot në botë janë të ndryshme, asnjë nga shtetet nuk ka hequr dorë nga përgatitja e popullit dhe vendit për luftë. “Ne kemi nevojë, - theksuan përfaqësuesit amerikanë në seminarin e Vjenës, -për energjitë morale dhe fizike, për forcën dhe aftësitë e gjithë popullit për mbrojtjen e doktrinën tonë, prandaj edhe ne bëjmë “edukimin e qytetarëve me uniforma”. Kjo doktrinë shpall hapur nevojën që çdo vend dhe popull të përgatitet në të gjitha planet dhe të sigurojë një qëndrueshmëri të lartë në rast “rreziku”. “Vendosmëria për të mbrojtur dhe ruajtur veten nga çdo kërcënim i huaj, -thekson admirali amerikan Velson, -është detyrë parësore e të gjithëve. Të mos bësh këtë, do të thotë se nuk punon për Sigurimin Evropian dhe detyrimet e vendosura.”

Së katërti, zgjidhjet politike e ushtarake që rekomandon kjo doktrinë janë bindëse, të argumentuara, ngjallin më shumë besim në karakterin dhe përmbajtjen e saj. Masa të

² I. Velson, Seminarin i Vjenës, Përkthim shqip, 1991, f. 8.

³ Doktrina Mbrojtëse Austriake, Vjenë, 1991, f. 92.

tilla, si ato të sigurimit e të parandalimit të konflikteve, të besimit, kontrollit të inspektimit e të mjaftueshmërisë së forcave e të mjeteve, politika e aleancave dhe parimi i sigurimit kolektiv, pra solidaritetit ushtarak, kanë ndikim të ndjeshëm edhe mbi gjendjen moralo-psikologjike të ushtrisë dhe kombeve pjesëmarrëse në to. Prirja e sotme për ta realizuar sigurimin jo nëpërmjet përballjes garuese (pengimit të luftës nëpërmjet frenimit), por nëpërmjet bashkëpunimit, dialogut ose kontrollit të armëve pra, nëpërmjet kontrollit të mbrojtjes së paqes, shpreh realisht karakterin demokratik të këtyre masave dhe, në tërësi, të doktrinës së re ushtarake. “Doktrina e re në përgjithësi dhe aleancat, -theksoi përfaqësuesi amerikan në seminarin e 2-të të KSBE-së, -janë thelbësore për sigurinë dhe qëndrueshmërinë, se mbrojtja kolektive ka ndikimin e saj moral e politik në arkitekturën e re të sigurimit evropian.”

Bindja së aleanca të tilla do të ndërhyjnë në situata krizash, ndalon agresorët e mundshëm, garanton vendet pjesëmarrëse në të, bën presion mbi kundërshtarin, ndikon në lëkundjet e besimit të tyre.

Së pesti, doktrina e re mbrojtëse pavarësisht nga ndikimi i faktorëve të mësipërm, parakupton dhe ka si parim të saj moral, politik dhe ushtarak përgatitjen për mbrojtje të çdo vendi. Kështu, analiza gjeopolitike e çdo vendi dhe përgatitja e mbrojtjes së tyre mbi këtë bazë, organizimi i mbrojtjes mbi bazën e mobilizimit të përgjithshëm, përgatitja moralo-psikologjike dhe ushtarake e të gjitha strukturave, pra përgatitja e gjithë vendit për luftë shikohet si rrugë më e përshtatshme për mbrojtjen e lirisë e të pavarësisë së tyre; por edhe të doktrinës së re mbrojtëse në tërësi. Kjo tregon se nuk ka vend për çmobilizim, për ulje të frymës mbrojtëse, për nënvleftësimin e përgatitjes luftarake moralo-psikologjike të ushtrisë e të popullit për luftën. Këtë e diktojnë shumë faktorë, aktualisht problemet e kalimit nga vendi bipolar në shumë polare, e transformimeve në Evropë janë mbarsur me rreziqe. Po kështu ringjallja e interesave nacionale, problemet etnike, krizat ekonomike, tensionet sociale, përbëjnë rreziqe potenciale për lirinë dhe pavarësinë e çdo vendi.

Të gjitha këto kanë një efekt të fortë emocional e psikologjik në opinionin publik, në popullsinë e çdo shteti e rajoni. Rreziqet po shtohen edhe pse mjaft probleme të mprehta ende nuk janë zgjidhur; flitet shumë për pakësimin e armatimit, por po kaq flitet edhe për rritjen e gatishmërisë, lëvizshmërisë, përsosjes cilësore të forcave dhe mjeteve. Nuk është thënë asgjë si mund të kontrollohen sulmet e befasishme e të shpejta sidomos nga shtetet e mëdha, si mund t’u hiqet mundësia, të cilat, pa bërë, mobilizimin mund të kalojnë në agresion ndaj vendeve të vogla etj. Zgjidhja e këtyre problemeve brenda doktrinës së re mbrojtëse ka rëndësi, pasi çështje të tilla kanë ndikim të madh, si dhe ushtrojnë presion psikologjik mbi vendet e vogla.

Aq më tepër shtohet rreziku i luftës në kushtet e rajonit tonë, i cili është i turbullt dhe ndërthuren mjaft mosmarrëveshje të vjetra e të reja, si ato nacionale, etnike, pretendime territoriale etj. Në këtë pikëpamje Ballkani vazhdon të mbetet një vend rreziqesh, tronditjesh, tiranie dhe konfliktesh, një “fuçi baruti” shembullor. Në situata të tilla nuk ka vend për eufori e optimizëm të pabazuar. Forcimi i mbrojtjes së vendit tonë, përgatitja e lartë moralo-psikologjike, forcimi i vigjilencës dhe gatishmërisë aktualisht mbetet detyra më e rëndësishme patriotike, rruga për thellimin e demokracisë në Shqipëri dhe integrimi i saj në Evropë.

Për të shprehur lidhjet dhe ndikimet e doktrinave me moralin, analizuam vetëm katër

prej tyre, por kjo nuk do të thotë se në doktrinat e tjera nuk ekzistojnë apo janë të zbehta në lidhje të tilla. Përkundrazi ato shfaqen pa asnjë përjashtim. Mjeshtëria e komandave duhet të synojë në zbulimin e të veçantave të këtyre lidhjeve për të rritur treguesit e gjendjes moralo-psikologjike të efektivave që drejtojnë.

Ndikimi i disa problemeve strategjike mbi moralin. Është fakt i pakundërshtueshëm se strategjia ushtarake varet nga strategjia politike. Por jo kurdoherë e për çdo gjë ato përkohë me njëra-tjetrën. Kundërshtitë që lindin ndërmjet tyre kanë ndikime në rrjedhojat e luftës, si e tillë edhe në gjendjen moralo-psikologjike. Siç theksojnë studiuesit amerikanë, sado cilësi të lartë luftarake të zotërojnë masat e ushtrisë, pa një udhëheqje e strategji të përcaktuar, nuk mund të arrihen fitoret. Dhe më e keqja, nënvizojnë ata, është kur defektet e kapriçot e strategjisë mundohen t'i mbulojnë në nivelin e ulët të moralit me gjoja punën e pamjaftueshme në këtë drejtim, se kuadrot e lënë pas dore çështjen e edukimit etj., pra të krijojnë përshtypjen se strategjia nuk ka lidhje me moralin, kjo gjë është e gabuar.

Në të vërtetë ndikimi i strategjisë mbi moralin është i ndjeshëm. Përcaktimi i drejtë i objektivave politikë dhe i atyre ushtarakë ndikon në zgjidhjen drejt të formave e metodave të luftës të aleancave politike e ushtarakë, të bazave mbështetëse etj. Mosmarrëveshjet, ndërhyrjet në strategjinë politike dhe ato ushtarake, thuhet në studimin amerikan "Pentagoni dhe Arti i Luftës", detyrimisht kanë rrjedhoja edhe në gjendjen moralo-psikologjike të ushtrisë e të popullit. Veprimet luftarake, thonë ata, futen në rrugë pa krye, ushtria nuk ka të qartë perspektivën, ndërsa anarkia dhe arbitrariteti i politikanëve e i gjeneralëve nxisin një gjendje të rëndë moralo-psikologjike. Besimi i ushtarëve dhe i popullit tronditet, ata nuk dinë për kë dhe pse luftojnë. Për të shmangur këto pasoja, shtabi i lartë politik dhe ushtarak amerikan, në luftën në Vietnam, disa herë bëri korrigjimet e këtyre planeve.

Kështu, në vitin 1961, plani "*Staley Teulon*" u konsiderua i dështuar nga vetë amerikanët, pavarësisht nga objektivat e tij ambicioze ushtarake, që synonte të mbronte luftën për 18 muaj apo për të krijuar 1.600 fshatra strategjikë.⁴ Megjithëse ky plan evokonte format dhe metodat e luftës kundërpartizane të fituara në Malvine, Filipine, Greqi etj., nuk mund t'i qëndronte kohës. Vetëm në këtë periudhë në Vietnam u çlirua mbi 50% e territorit të Vietnamit të Jugut. Lufta u zgjerua në terrene fushore e malore, ndërsa në qytete lufta politike filloi të marrë përpjesëtime të gjera. Pozita e amerikanëve u vështirësua, "lufta partizane po u sillte shumë kokëçarje", pasi "ajo ndryshonte nga lufta në zonë". Si përfundim, ata e braktisën teorinë e *Taylorit*, e cila kërkonte të fitonte vetëm me veprime ushtarake, duke e kritikuar atë si të pazonjën në politikë.

Befasia dhe ndikimet e saj mbi gjendjen moralo-psikologjike. Mbi gjendjen moralo-psikologjike nuk ndikon vetëm befasia politike, por edhe ajo ushtarake, strategjike, operative dhe taktike, e cila, në përmbajtje, shfaqet si pjesë përbërëse e strategjisë së përgjithshme. Pavarësisht se në çfarë shkalle është befasia në rrafshin moralo-psikologjik, ajo thëllon krizën e besimit, ngjall panikun dhe frikën, destabilizon gjendjen e forcave që marrin pjesë në luftë, rrit shkallën e pasigurisë, dobëson vullnetin e luftëtarit. Përmasat e këtyre dukurive shtohen edhe më shumë, veçanërisht kur arrihet befasia në shkallën strategjike. Specialistët ushtarakë amerikanë e vlerësojnë këtë si mjetin më të mirë për destabilizimin e vendit, për të paralizuar vullnetin shtetëror, për të prishur unitetin moral e luftarak të vendit që i nënshtrohen agresionit. Kur thuhet se befasia është mjet më i

⁴ Studim "Mbi luftën në Vietnam", f. 22.

mirë në ndryshimin e raportit të forcave problemi nuk duhet shikuar thjeshtë në mënyrë aritmetike, por mbi të gjitha në ndikimin moral e psikologjik, pasi nëpërmjet befasisë mund të arrihen më shumë suksese, duke harxhuar energji disa herë më pak, se “befasia ishte dhe do të jetë edhe në të ardhmen kyçi i fitores”.

Qëndrueshmëria morale dhe shpirti luftarak janë të lidhura edhe me faktorin material, sigurimin e kushteve të nevojshme për luftë dhe jetesë. Një prapavijë e fortë nënkupton si anën materiale, ashtu edhe atë njerëzore e morale. Faktorë të tillë si: sigurimi shëndetësor, mënyra e ushqimit dhe e veshjes, furnizimi me armatime e municione ndikojnë në gjendjen moralo-psikologjike të pjesëmarrësve në luftë. Kjo për faktin se nëpërmjet këtyre faktorëve sigurohet ripërtëritja e forcave, rigjallërohet organizimi, fitohen energjitë e duhura për veprimet e mëtejshme luftarake, të cilat ndikojnë drejtpërsëdrejti edhe në gjendjen moralo-psikologjike. Shumë luftëra kanë përfunduar në disfata jo më shumë nga armët e armikut se sa nga kushtet e vështira materiale, mungesa në furnizim, trajtimi i keq shëndetësor, mendimet e tepërta dhe kushtet e vështira klimaterike. “Shpata dhe shigjetat, - thotë një specialist amerikan i mjekësisë, - ushta madje dhe predhat thërrmuese kanë pushtet më të vogël mbi fatet e kombeve, se sa morrat e tifos, pleshtat, murtaja dhe insektet që përhapin ethet e verdha”.⁵

Duke parë vlerat e veçanta të faktorit material në qëndrueshmërinë morale e ushtarake të çdo ushtrie, përpjekjet për dobësimin e tyre nga kundërshtari kanë qenë dhe mbeten një nga rrugët për dobësimin dhe shkatërrimin përfundimtar, si mjet i efektshëm i luftës moralo-psikologjike. Frederiku i madh zbatonte parimin “uria e dobëson armikun më shumë se lufta”, prandaj dhe synimi i tij ishte ta veçonte kundërshtarin nga bazat e tij mbështetëse, t’i godiste rezervat dhe rrugët e furnizimit. Ndërsa në kushtet e sotme të luftës moderne efektet moralo-psikologjike, duke përdorur faktorin material janë më të mëdha. Politika e trysnisë ekonomike që zhvillohet para fillimit të luftës, nëpërmjet embargoeve apo edhe gjatë veprimeve luftarake si nëpërmjet goditjeve në prapavija, zënies dhe mbajtjes së objekteve të rëndësishme të komunikacionit, zgjerimit të urave ajrore bllokimit të portave etj., janë bërë sot mjete luftime ndaj kundërshtarit.

Presioni nëpërmjet kërcënimit ekonomik, veçimit dhe dëmtimit të prapavijave ka si qëllim të lodhë e të rraskapitë kundërshtarin, të ngjallë në radhët e tij panik, frikë e pasiguri, ta detyrojë atë të dorëzohet. Në kushte të tilla, ashtu siç vdes njeriu kur një plumb i përshkon zemrën dhe i ndalon qarkullimin e gjakut, ashtu do të mbaronte çdo shtet, çdo ushtri, çdo repart e nënrepart kur shkëputet nga prapavijat e veta.

Ushtria franceze, më 1917, u detyrua të tërhiqej nga Moska pas një rënie të theksuar të frymës luftarake dhe pesimizmit të theksuar për shkak të vështirësive ekonomike dhe mungesës së furnizimit me ushqime e armatime. Krizën morale e përforconte edhe më shumë dimri i rëndë rus, gjë për të cilën francezët nuk kishin marrë masat e duhura. Po kështu, në mesin e vitit 1944, ushtria fashiste gjermane pësoi të njëjtin fat përpara ushtrisë sovjetike. Atyre iu paralizua 60% e industrisë, e transportit dhe burimeve minerale, të cilat detyrimisht çuan në një konsumim material e moral, në rënien e perspektivës së mëtejshme të luftës nga ana e tyre.

Edhe në Luftën e Gjirit, në planin e operacionit nga forcat shumëkombëshe “Stuhia e shkretëtirës”, vërehen qartë lidhjet midis faktorit ushtarak e material me atë moral. Qëllimi

⁵ D. O. Smith, “Doktrina Ushtarake e SHBA-së, Tiranë. 1968, f. 140.

i këtij operacioni ishte bllokimi i trupave të Sadamit nga Bagdadi, veçimi i forcave në vijat e fortifikuara, prerja e furnizimeve me synim çrregullimin e frontit iraken, nëpërmjet pengimit të ushqimeve⁶ dhe bombardimeve njëzetekatërorëshe pa ndërprerje për të shkatërruar moralin.⁷ Ndërsa në disa drejtime veprimet luftarake nga komandat shumëkombëshe u shtynë për më vonë, ndërmjet të tjerave si për kohën e keqe, ashtu edhe për të rritur shkallën e lodhjeve e të vuajtjeve të disa reparteve të këmbësisë, të tankeve dhe të artilerisë irakiane, pasi ishte mësuar nga të ftohta dimri për shkak të veshjes së keqe, të cilat hyjnë në llogari të faktorit komanda shumëkombëshe se këto reparte “po hiqnin të zinj të ulla në ato ditë ushtarak e moral të komandave të mësipërme.”⁸

Suksesi i ushtrisë shumëkombëshe dhe fryma e saj e lartë luftarake në Luftën e Gjirit është e lidhur edhe me kujdesin material e shëndetësor që u tregua nga komandat e operacionit; masa të tilla, si: përshtatja e veshjes për kushtet e shkretëtirës, gjetja e modeleve të këpucëve, e asortimenteve të ushqimit, e furnizimit me lëngje për të përballuar etjen, kalorinë e nevojshme dhe shumëllojshmëria e paketave ushqyese të përdorura për herë të parë, ndikuan shumë në gjendjen e mirë shëndetësore, fizike, ushtarakë dhe morale. Në udhëzimet e Shvarskopit, gjenden porosi të tilla ku personelit të logjistikës i rekomandohej të gatonte ato lloj ushqimesh që përdorshin edhe në Amerikë, sidomos për ditë pushimi dhe festash; me qëllim që “ushtarët të ndiejnë veten si në vendin e tyre, të harrojnë lodhjet dhe tensionin e luftës të ripërtërijnë forcat dhe shpirtin luftarak, pasi këto do të ndikojnë mbi gjendjen morale të tyre.”⁹

Kërcënimi nëpërmjet urisë, lodhjes, pagjumësisë, përbën një rrezik serioz në ecurinë e luftës. Spekulumet propagandistike nëpërmjet tezave të politizuara, që i zhveshin faktorët moralë nga ato materiale, janë të dëmshme e me pasoja të rënda si në kohë paqeje, ashtu dhe në kohë lufte. Kur ushtarit në luftë i mungojnë ushqimet, municioni, një pushim minimal për të marrë veten, sado trim të jetë ai, nuk mund të bëjë qëndresë e të përmbushë detyrën. Ndërsa po ta shohim më tej problemin në planin moralo-psikologjik, mungesa e furnizimit të një ushtrie jo vetëm shkakton krizë të thellë shpirtërore dhe trondit besimin e frymën luftarake të saj, por rrjedhimet negative mund të shkojnë edhe më tej, deri në organizimin nga kjo ushtri e luftës civile. Në analizë të këtij problemi, studiuesi amerikan Smith, në librin “Doktrina ushtarakë e SHBA”, arrin në përfundimin se, ushtria ruse në shekullin XVI, për mungesë furnizimi me material, hodhi armët, nuk njihte asnjë lloj pushteti civil, kundërshtoi urdhrat, deri sa përfundoi në luftë të ashpër civile, pasi shpresat për atdheun e vet humbën.

Ndikimi i faktorit material në gjendjen luftarake e moralo-psikologjike nuk duhet parë në përgjithësi, por konkretisht i specifikuar sipas natyrës së detyrave, kushteve klimatike, përbërjes së efektivave etj.

Me qëllim studimi, në stërvitjet me temë “Brigada e Këmbësisë në marshim”, “Stërvitja Drini” e vitit 1983 apo Taraboshi i vitit 1985 etj., u ndërtua kjo situatë për prapavijën: ditën e parë, efektivit iu dha dreka me 1 orë vonesë, ditën e dytë dy orë dhe ditën e tretë iu dha tri orë me vonesë. Nga të dhënat përfundimtare rezultoi se ritmi i marshimit ditën

⁶ N. E. Morris, “Rruga drejt triumfit”, përkthim nga anglishtja, Tiranë, f. 208.

⁷ Po aty.

⁸ Po aty, f. 223.

⁹ Po aty, f. 230.

e parë ishte 3 % më i ulët, ditën e dytë 5% dhe ditën e tretë 7%. Në dy ditët e fundit u shfaqën shenjat e lodhjes, të nervozizmit, mungesa e dëshirës për të marshuar, plogështia dhe shenja pesimizmi. Po këtë vëzhgim e bëmë dhe gjatë marshimit natën, ku treguesit e mësipërm ishin edhe më të ndjeshëm. Natën e parë ritmi i marshimit ra 5%, të dytën 8%, të tretën pothuajse 10%, krahasuar këto me normat e marshimit natën. Në këto kushte, tabloja psikologjike e efektivitetit ishte e ngarkuar me probleme më të mprehta. Rruga për t'i minimizuar sa më shumë këto ndikime mbi gjendjen moralo-psikologjike është edhe dhënia në kohë e ushqimit, i cili mundësisht të jetë i ngrohtë dhe me kaloritë e duhura. Po kështu kujdes duhet treguar edhe për shumëllojshmërinë e ushqimit pasi edhe ajo ka ndikimet e veta edhe mbi gjendjen e organizmit dhe aftësinë fizike e psikologjike.

Nevoja e parë e çdo grupi, qofshin dy njerëz apo edhe një komb i tërë është drejtimi. Pa drejtim nuk mund të ketë veprime të bashkërenduara. Përvoja tregon se për të bërë përpara, duhen bashkuar përpjekjet. Ky përqendrim përpjekjesh është rezultante e drejtimit të mirë. Për këtë arsye është tepër e rëndësishme që oficeri të njohë ato të vërteta e të fitojë ato shprehi që i japin mundësi t'i përdorë në mënyrë të frytshme forcat njerëzore.

Drejtimi në kohë lufte është më i vështirë, pasi dështimi apo fitimi varen edhe nga udhëheqja. Nga kjo varet liria apo skllavëria e popujve. Historia është plot shembuj që tregojnë se ushtri më të vogla në numër e me mungesë në pajisje, me gjithë ndikimin e dukshëm të faktorëve të tjerë, kanë fituar kryesisht në saj të epërsisë në cilësitë e drejtimit e të udhëheqjes. Ato janë karakterizuar nga vullneti për të fituar. Nuk është e rastit që në shumë akademi ushtarake në botë, drejtimi përcaktohet si arti i imponimit të vullnetit të dikujt mbi të tjerët, në një mënyrë të tillë që të sigurojë bindjet, besimin, respektin dhe bashkëpunimin e tyre besnik. Vetë tilla materializohen në figurën e kuadrit kur drejtuesi njih mirë profesionin. Në këtë mënyrë ushtarët janë gati ta ndjekin atë, pasi njohuritë e tij, kompetenca dhe vendosmëria më të cilën ai i shtron problemet, ngjallin besim e siguri te masa e ushtarëve, prandaj ata e ndjekin pas si në stërvitje ashtu edhe në luftë. Ndërsa pasiguria e kuadrit drejtues për çështjen që u mëson ushtarëve, paqartësitë apo mungesa e argumenteve dhe e paaftësia për t'i kryer vetë veprimet, rrjedhimisht tek ushtarët ngjallet ndjenja e mosbesimit. Kjo bën që ata ta ndjekin pa dëshirë në kohë paqeje në stërvitje dhe me frikë e pasiguri në kohë lufte. Aftësitë profesionale kanë të bëjnë me autoritetin e kuadrit drejtues, në mbajtjen lart të besimit të masës, te aftësitë e tij.

Vendosmëria e drejtuesve në marrjen dhe zbatimin e vendimeve është një tregues tjetër që ndikon në gjendjen moralo-psikologjike të vartësve. Nëpërmjet kësaj shprehet kompetenca profesionale, vetëbesimi i tyre në zgjidhjen e situatave sado të vështira qofshin ato. Pra, vendosmëria është një nga cilësitë kryesore të udhëheqjeve, të çdo rangu qofshin ato. Por kjo kurrsesi nuk duhet kuptuar si veprim që nuk mban parasysh ndryshimet e rrjedhimet e situatave të reja. Drejtuesi duhet të jetë i palëkundur, i matur dhe i vëmendshëm në kryerjen e detyrës, aq sa dhe për të mos rrezikuar jetën e tij dhe të shokëve. Këmbëngulja për plotësimin e misionit shpreh aftësitë dhe gatishmërinë për të përballuar rreziqet dhe sfidat për arritjen e suksesit të operacionit në kushte paqësore, kërcënuese e luftarake. Synimi i kuadrit është të jetë sa më parashikues, i aftë të përgjithësojë faktet dhe ngjarjet, me qëllim që të marrë një vendim sa më të bazuar e të qëndrueshëm. Pavendosmëria, në të shumtën e rasteve, është një rrjedhim i një paqartësie ndaj situatave, i mungesës së aftësive profesionale, i mungesës së përvojës në drejtimin e trupave etj. Për të edukuar vendosmërinë, drejtuesi duhet të kultivojë me durim ndjenjën e mospërfilljes së frikës dhe të ndjenjave të shqetësimit, që lidhen me aftësitë dhe vendosmërinë e tyre.

Dinamizmi dhe këmbëngulja janë kërkesa që duhet t'i zotërojë çdo drejtues. Madje këto janë testi më i mirë me të cilin kuadrot paraqiten para masës. Sado i përsosur të jetë vendimi, ai nuk mund të zbatohet pa këmbënguljen e dinamizmin e drejtuesve, pa vendosmërinë dhe predispozicionin e tyre. Masa shikon nëpërmjet qëndrimit të kuadrove, besimin, aftësinë dhe gatishmërinë me të cilin ata punojnë, për zbatimin e detyrave dhe vendimeve të marra. “Unë kuadrot i vlerësoj, -thekson një psikolog ushtarak në luftën e Gjirit, -jo vetëm për aftësitë në marrjen e vendimit, por dhe për dinamizmin e tyre për të shkuar nga vendkomanda në vijën e parë të luftës pranë ushtarëve, ku të jetojnë bashkë me vështirësitë e atmosferën e luftës, për të ndarë bashkë me efektivin fitoren dhe disfatën”.

Po kështu, kuraja për të përballuar e mposhtur frikën dhe rreziqet si fizikisht ashtu dhe moralisht është detyrë e veçantë për drejtuesin me karakter të fortë, pasi vartësit e tij duhet të shohin tek ai njeriun e zgjuar, me vullnet të hekurt, i cili do t'i udhëheqë drejt realizimit me sukses të misionit. Pa marrë parasysh vështirësitë e luftës, komandat e të gjitha hallkave duhet që kohën më të madhe ta kalojnë me masën e ushtarëve, sa më afër veprimeve luftarake. Në këtë mënyrë kuadrot udhëheqin me shembullin e tyre, tregohen të gatshëm, trima e të vendosur në zbatimin e vendimeve të marra.

Takti është një kërkesë e artit të drejtimit. Nëpërmjet tij shumë probleme, mosmarrëveshje, fërkime mund të mënjanohen duke zgjedhur fjalë dhe veprime të zgjuara, të cilat nuk shkaktojnë fyerje. Si në stërvitje ashtu edhe në luftë, ushtari i nënshtrohet urdhrimit të tij, vështirësive, por kuadri, nëpërmjet taktit të tij, duhet të tregojë se këto qëndrime i kërkon detyra. Takti në punën me njerëzit në ushtri nuk do të thotë qëndrim sentimental e tolerues, por punë këmbëngulëse, seriozitet e rreptësi në zbatimin e urdhrave e të detyrave ushtarake. Uellingtoni, i cili nuk humbi asnjë betejë, nuk ishte popullor, megjithatë ushtarët e tij kishin besim të madh tek ai, si udhëheqës e takticien. Po kështu, Stounuoll Xhekson nuk ishte popullor, përderisa i sfiliste ushtarët e tij deri në kufijtë e durimit njerëzor duke i lodhur jashtë mase, megjithatë ushtarët e tij ishin krenarë të shërbenin nën komandën e tij, për shkak të fitoreve të arritura në saj të aftësive të tij tepër të mëdha si udhëheqës ushtarak. Me gjithë rëndësinë që ka etika e komunikimit me njerëzit, kjo nuk është e tëra. Rëndësi ka vlerësimi i njerëzve nëpërmjet sigurimit të kushteve, ndërtimi i marrëdhënieve ndërmjet tyre mbi baza ligjore.

Nga këto synime nisej Shalin Wellembai, një nga udhëheqësit më të suksesshëm britanikë në Luftën e Parë Botërore. Analistët tregojnë se ai nuk ishte popullor dhe se kjo vinte për shkak të mungesës së masës së vetëkontrollit, njerëzillëkut të pakët, fuqisë së pamjaftueshme për të ngjallur entuziazmin dhe për të frymëzuar vartësit. Ai i qortonte ashpër ushtarët kur shihte se ata nuk e mbanin rripin e kapelen në vendin që caktonte rregullorja, apo kur ata mbanin pantallona të shkurtra në vapën e Palestinës. Por prapa këtyre veprimeve, në dukje tepër të rrepta, fshihej një kujdes i madh për mirëqenien e tyre, për sigurimin në çdo kohë të kushteve materiale e shëndetësore. Për ushtarët e tij ai ndjente detyrimet më të mëdha, për të ata ishin krenaria dhe sukcesi. Herë pas here ai punonte për t'u rritur atyre fuqinë fizike dhe guximin. Hallet e ushtarëve ishin edhe shqetësimet e tij më të mëdha. Nga ana e tyre, edhe ushtarët për të kishin një nderim, një besnikëri që pak udhëheqës ushtarakë e kanë gëzuar. Qëndrimi i tij njerëzor krijonte një gjendje morale të atillë, që i bënte të mundshme të gjitha arritjet. Ai i çmonte shumë ndjenjat dhe emocionet e ushtarëve. Në këtë mënyrë ai kishte fuqi të madhe për të komunikuar e ngritur entuziazmin dhe për të frymëzuar e për të forcuar disiplinën.

Energjia e drejtuesve ushtarakë është një nga kërkesat e drejtimit dhe burim shumë i rëndësishëm i suksesit. Drejtuesi bëhet i pathyeshëm kur bindet se ka energji të mjaftueshme për të mos u tërhequr kurrë para vështirësive. Energjia dhe entuziazmi janë cilësi që mund të forcohen vetëm me stërvitje dhe përgatitje të vazhdueshme. Këtë cilësi pothuajse e kanë zotëruar të gjithë udhëheqësit e mëdhenj. Pas kësaj shprehet një gjendje e mirë fizike e psikologjike. Veprimet energjike pasqyrohen në pamjen e gëzueshme dhe në optimizmin e madh edhe në rast ngjarjesh të rënda. Ky qëndrim ka një ndikim të fuqishëm mbi ushtarët, sepse këta e nuhasin menjëherë gjendjen shpirtërore të komandantit të tyre dhe detyrimisht reagojnë i tyre do t'i përshtatet kësaj gjendjeje.

Çdo ndjenjë plogështie e pasigurie që mund të shfaqin drejtuesit, ndikon për keq te vartësit e tyre. Komandanti fuqinë morale duhet ta gjejë në aftësitë dhe zotërimet e veta, si dhe në përgatitjen e repartit që drejton.

Besnikëria e drejtuesve është një nga cilësitë më të vjera të personalitetit të tyre. Besnikëria është një ndjenjë e qëndrueshmërisë dhe virtytit, shumë e domosdoshme për një drejtues ushtarak. Besnikëria ndaj vetvetes dhe aftësia për të frymëzuar të tjerët me këtë ndjenjë, janë virtyte të shenjta për një komandant, ajo është një ndjenjë e të menduarit dhe të vepruarit me çiltërsi dhe pastërti ndaj një ideali të lartë madhor, por edhe ndaj eprorit, i cili udhëheq realizimin e misionit, pasi sukcesi qëndron edhe në besnikërinë ndaj mendimeve dhe veprimeve të kryera ndaj vartësve të tij, e kjo “marrëveshje” nuk përfundon vetëm pas një sukcesi apo pas një beteje.

Besnikëria ndaj vartësve duhet të pasqyrohet në sigurimin e të gjitha kriterëve dhe nevojave të tyre materiale e shpirtërore. “Besnikëria e komandantit të kompanisë, - thekson Montgomeri, - fillon te kujdesi që tregon për ushqimin e kompanisë. Ai që nuk e bën këtë, qëndron larg artit të udhëheqjes”.

Që kuadri të japë prova besnikërie, kërkohet që kurdoherë t'i dojë ushtarët, t'i respektojë ata, t'i mbrojë e t'u dalë zot atyre kur dikush kërkon ta fyejë dinjitetin e tyre. Çdo vlerësim të keq për ta ai duhet ta vlerësojë si mangësi të punës së vet. Në këtë drejtim nuk duhet të lejojë asnjë dallim ndërmjet ushtarëve, por këtë nuk duhet ta lejojë edhe nga të tjerët.

Nisma dhe entuziazmi kërkohen nga çdo drejtues për udhëheqjen dhe drejtimin e masës. Nisma është vetë forca që duhet të ketë komandanti a drejtuesi ushtarak për të projektuar, menduar dhe vepruar, pa pritur t'i thonë të tjerët se ç' duhet të bëjë, gjithmonë në interes të zbatimit sa më mirë të detyrës pa shkelur kompetencat e instancave eprore. Për këtë është e domosdoshme të bashkëqëndrohen energjitë për të përmirësuar aftësinë mendore, të stërvitë syrin dhe mendjen, që të dijë se ç' duhet bërë pa pritur receta të gatshme nga të tjerët.

Kjo lidhet jo vetëm me cilësinë vetjake të kuadrit, por edhe me dashurinë e pasionin për detyrën ushtarake. Kuadro të tillë drejtues përshkohen kurdoherë nga entuziazmi i përhershëm për profesionin e tyre nga këmbëngulja, fryma krijuese, ndjenja e rregullit dhe e disiplinës së përhershme. Në veçanti, kur entuziazmi është bindës dhe edukon më shumë edhe ushtarët, shërben për të kultivuar edhe tek ata pasionin për shërbimin ushtarak. Kjo kërkon që drejtuesi të ketë besim te vartësit, t'u lërë fushë të gjerë veprimi, nismë e vetëveprimi, të mos kultivojë tutelën dhe imponimin, pasi këto e ndrydhin personalitetin e tyre. Me anën e saj drejtuesi si në kohë paqeje ashtu edhe në luftë i tregon vartësit se ai është zot për detyrën e ngarkuar dhe në këtë mënyrë i kultivon atij

ndjenjën e vetëbesimit dhe vendosmërinë. Por njëherazi kjo metodë e lehtëson oficerin nga hollësitë e parëndësishme dhe i lë atij kohë për të vlerësuar hapësira më të gjëra të drejtimit. Kjo edukon nismën, vetëveprimin, ndjenjën e përgjegjësisë, si dhe lufton plogështinë, mungesën e kurajës, frikën se mos gabon. Ai duhet të mësohet të mbajë përgjegjësi, madje edhe për gabimet e vartësve të vet.

Entuziazmi i drejtuesve nuk duhet parë thjeshtë si një gjendje shpirtërore e drejtuesve, por si një dukuri që ndikon mbi moralin e trupës. Morali rritet së tepërmi në qoftë se ushtarët e dinë se drejtuesi i tyre, me aftësitë e tij, i udhëheq ata me siguri e kompetencë si në stërvitje, ashtu edhe në luftë.

Humanizmi është tipar për çdo drejtues. Këmbëngulja dhe ashpërsia e drejtuesve nuk duhet të dalin jashtë përmasave njerëzore, ndjenjave të pastra dhe respektit për vartësit. Ushtarëve në çdo rast duhet t'u krijohet lehtësimi shpirtëror, duke i mbajtur afër dhe zhvilluar me ta diskutime të lira, ku të shkëmbehen mendime si për stërvitjen, organizimin ushtarak, disiplinën, marrëdhëniet ndërmjet kuadrove e ushtarëve etj. Ka shumë rëndësi që ushtari t'i tregojë kuadrit shqetësimet e tij, pasi kështu ai lidhet më mirë shpirtërisht me të.

Bibliografia:

- Owe Viktorin, Vjenë, 1991, përkthimi në shqip.
- Velson, Seminari i Vjenës, përkthim shqip, 1991.
- Doktrina Mbrojtëse Austriake, Vjenë, 1991.
- “Mbi luftën në Vietnam”, studim.
- D. O. Smith, “Doktrina Ushtarake e SHBA-së, Tiranë. 1968.
- N. E. Morris, “Rruga drejt triumfit”, përkthim nga anglishtja, Tiranë.

Rubrika e Dytë

Hapësira shqiptare dhe gjeopolitika

Rubrika në vijim është një përpjekje ambicioze për qasje pranë një koncepti të vështirë siç është gjeopolitika. Në këtë rubrikë synohet nevoja e thithjes së studimeve rreth hapësirës shqiptare dhe dinamikës së saj rajonale e më gjerë. Ndonëse gjeopolitika është shumë më e vjetër sesa pretendon terminologjia e ditëve të sotme, politika e orientuar nga interesa territoriale përkufizohet prej më se 100 vjetësh si “gjeopolitikë”.

Profesor Pajtim Ribaj, në shkrimin hyrës të kësaj rubrike, thekson se studiuesit janë të thirrur të trajtojnë skenarë gjeopolitikë të cilët e vendosin vendin, rajonin apo sistemin ndërkombëtar në pozicione të cilat kërkojnë patjetër përgjigje. Përballja me të ardhmen na ndesh me sfida investiguese parashikimesh dhe interpretimesh të mundimshme. Skenarët dhe hipotezat janë “armë” e suksesshme e gjeopolitikës moderne, në ndihmë të politikëbërësve për mbrojtjen dhe zhvillimin e interesave kombëtare.

Mendimi gjeopolitik në vendet gjermanishtfolëse vjen nga studenti i programit Master Shkencor nga Prishtina, “Studime në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes”. Në këtë shkrim shtjellohet gjeopolitika gjermane me përfaqësuesit më të spikatur dhe keqpërdorimi i termit nga nacionalsocialistët që e përdornin atë në një formë të vjetëruar ku zgjerimet hapësinore ose territoriale i shërbenin hegjemonisë ekonomike, ndërsa unifikimet e brendshme arriheshin duke eliminuar “armiqtë e popullit” si edhe duke ushtruar legjitimitetin ideologjik mbi konceptet biopolitike të “hapësirës jetike” dhe “racës zotëruese”.

“Bashkimi për Mesdheun” (BpM), i parë nën optikën e gjeopolitikës evropiane të Parisit, është sjellë në revistë nga një tjetër student që ka ndjekur studimet në programin Master Shkencor “Studime në fushën e Sigurisë dhe Mbrojtjes”, të zhvilluar në AFA, në vitet 2011-2013. Me ndjesinë e një qytetari mesdhetar, autorja ka dashur të sjellë në vëmendje të lexuesit, anët pozitive që ky bashkim mund të sjellë për vendet mesdhetare ku bën pjesë edhe vendi ynë, duke parashtruar drejtimet kryesore të partneritetit në BpM, si dhe perspektivat e marrëdhënieve ndërkombëtare në zonën EURO-MED.

Gjeopolitika - imperativ i elitave dhe politikave të larta

Prof. Dr. Pajtim Ribaj
Pedagog në AFA

Trajtesë e shkurtuar. *Rubrika përvijuese është një rubrikë e re për revistën që do të mundësojë trajtesa komplekse me synim qasjen pranë një koncepti të vështirë-gjeopolitikës. Në këtë rubrikë synohet nevoja e thithjes së studimeve rreth hapësirës shqiptare dhe dinamikës së saj rajonale e më gjerë. Ndonëse gjeopolitika është shumë më e vjetër sesa pretendon terminologjia e ditëve të sotme, politika e orientuar nga interesa territoriale përkufizohet prej më se 100 vjetësh si “gjeopolitikë”.*

Forcat shtytëse jo të barabarta të ekspansionit ekonomik dhe të hierarkisë sociale të shoqërive, të cilat kërkojnë që të dyja një administrim shtetëror dhe janë të varura nga territori, përbëjnë bazat e shtetit modern. Në të njëjtën kohë, gjeopolitika i shërben interesave të një shteti për veprimet e tij në arenën ndërkombëtare. Njëherazi, ajo është dhe mbetet një arenë konkrete ku, përveçse duhet të veprojnë, shtetet duhet të krahasohen me njëri-tjetrin. Edhe gjeopolitika si çdo politikë tjetër, ka nevojë për një legjitimitet botëkuptimor. Imazhe hapësinore dhe botërore projektohen për të siguruar kufijtë kombëtarë, për të imponuar interesat territoriale dhe për të fituar zona ndikimi, e ku, padyshim, hapësira shqiptare përfton politika dinamike për të përvijuar strategji efektive.

Hyrje

Rubrika që po përvijojmë është një përpjekje ambicioze për qasje pranë një koncepti të vështirë, gjeopolitikës. Nismëtarët janë të ndërgjegjshëm sepse ndjekin trendin e nivelit të studimeve më të mira të institucioneve dhe elitave ndërkombëtare dhe vlerësojnë arritjet në promovimin e njohurive të gjeopolitikës në institucionet shqiptare. Përfshirja e saj në disa kurrikula, sidomos në degët e shkencave politike në disa institucione të arsimit të lartë, përvoja pozitive e programeve serioze për gjeopolitikën në kurset e programit *master* në marrëdhënie ndërkombëtare, politikë e jashtme dhe diplomaci, studime mbi sigurinë dhe realizimi i një programi cilësor, të shoqëruar me veprimtari premtuese, panele e deri konferenca shkencore me objekt problemet e gjeopolitikës në Akademinë e Mbrojtjes¹, përgatitja e dhjetëra mikrotezave nga fusha e

¹ Sipas vlerësimit të shumë studentëve, moduli “Gjeopolitika”-nga më kryesorët e ciklit të studimeve të programit *master* në AFA ishte, pa dyshim, shtylla e të gjitha moduleve të tjera. Gjeopolitika, do të thoja, është bërë tashmë mbretëresha e tavolinave akademike në çdo fushë të jetës e të aktivitetit të çfarëdo lloji fushe. Mjafton të përmend se sot kemi deri edhe “Gjeopolitikë të Emocioneve”, për të shtuar më pas se gjeopolitika është çiftëzuar tashmë me hronopolitikën, duke plotësuar kësajsoj mendimin në hapësirë, me mendimin në kohë.

gjeopolitikës nga graduat *master* si dhe puna në disa doktoratura nga studiues të rinj e premtues, përbëjnë kontribute jo vetëm me vlera njohëse.

Gjithsesi, studimet dhe interesi për gjeopolitikën vjen i shtuar. Me rinovimin e saj aktual, gjeopolitika njeh një favor jo të zhveshur nga ambiguiteti. Kurrë më parë, që prej kohës së zhdukjes së saj të gjatë (gjatë Luftës së Ftohtë), ajo nuk është thirrur aq shumë nga të gjithë ata që kanë si profesion të tyre komentimin e aktualitetit ndërkombëtar. Ajo është bërë një fenomen mediatik me shumëfishimin e atlaseve strategjike, artikujve të revistave që merren me të, ose me përsëritje emisionesh televizive që i referohen, pak a shumë, në mënyrë të qartë, punimeve të saj. Këtij pasioni me origjinë shoqërore dhe teknike, të lidhur me komunikimin në masë, i shtohen dhe disa arsye që lidhen me fundin e Luftës së Ftohtë, e cila rriti nivelin e përmasave të mjeteve konceptuale e analitike të studimeve të sigurisë e të gjeopolitikës në rajon, në Evropë e në botë.

Por mediatizimi i gjeopolitikës ka sjellë edhe anën tjetër të medaljes, banalizimin e saj dhe përdorimin e termit në një kuptim gjithnjë e më të gjerë ose të pasaktë, gjë që lexohet shpesh në komunikimet e politikanëve tanë, por edhe në diskutet e intelektualëve. Gjithsesi, çdo shoqëri është e detyruar të strukturojë hapësirën e saj. Të gjitha teoritë politike e kanë shprehur këtë qartë, por raporti i hapësirës në politikë është sistematizuar, madje është reduktuar tek territori ose aspekti i tij fizik. Në veprat e gjeopolitikanëve, gjeopolitika është një studim i tipit “vazhdues” dhe dija gjeopolitike është: “fryti i një kuptimi ndërdisiplinor, i ekzistencës së identitetit gjeografik dhe historik me objektivin për të dalluar faktorët vazhdues të jetës së shteteve”².

Kështu, ndërsa historia privilegjon dhe thekson rëniet, përplasjet, shkatërrimin dhe në përgjithësi ndryshimet, d.m.th. mosvazhdueshmërinë, gjeopolitika nënvizon dinamikën e vazhdimësisë. Studimi i gjeopolitikës nuk shikon nga evenimentet, por nga ciklet e mesme dhe të gjata e në vend që të përdorë mikroskopin, përkundrazi, gjeopolitika përdor teleskopin. Gjeopolitikani shikon drejt yjeve dhe nuk shikon elementët mikroskopikë të natyrës. Tashmë, kur kemi hyrë në 102-vjetorin e shtetit shqiptar, bordi gjykon se çdo qasje ndaj këtij koncepti do të jetë një ndihmesë e mirëpritur na motivon, për këtë, roli i gjeopolitikës në formimin akademik në dobi të politikave të larta, nevoja për një elitë, ekspertiza gjeopolitike e së cilës ka impakt mbi politikën e strategjinë kombëtare, zhvillimin e mbrojtjen të interesit kombëtar. Dhe mbi të gjitha, fakti, se në rastet e përhumbjes së Shqipërisë në arenën shumë të komplikuar të marrëdhënieve ndërkombëtare, një ndër arsyt kryesore të saj është mosnjohja e gjeopolitikës dhe mungesa e një gjeopolitike kombëtare shqiptare, për më tepër, përcaktimi i qëllimeve gjeopolitike që mund të vënë në lëvizje strategjinë e madhe.

Njihet modeli gjeopolitik dhe gjeostrategjik i imponuar mbi Shqipërinë nga ndarja e bërë në fund të Luftës II Botërore, anëtarësimi i vendit në traktatin e Varshavës dhe më pas dalja prej tij, lidhja dhe prishja me Kinën për të përfunduar në një izolim total që përfundoi dhe u zëvendësua nga një realitet ndryshe. Projektioni gjeopolitik i ndarjes ideologjike dhe social-ekonomike ishte, as më pak e as më shumë, një paradigmë e aplikuar. Në të njëjtën kohë, drejtpeshimi i fuqisë dhe këndvështrimi gjeostrategjik i evoluimit të kuptueshëm të mjedisit ndërkombëtar, provoi të ishte i papërshtatshëm në fund të viteve 1980 të shekullit XX. Shqipëria ndërmori një orientim të qartë drejt

² F. Mazzei: “Relazioni Internazionali”, 2005, pp. 147-150. Cfr: G. Hegel: *The Philosophy of History*, Dover Publication, NY, 1975.

ekonomisë së tregut, demokracisë dhe sundimit të ligjit, një kurs filozofik, i cili logjikisht kishte orientim parësor tërheqjen e gravitetit të Bashkimit Evropian, si një bërthamë integrimi e dobishme e Evropës dhe atë të NATO-s, simboli i stabilitetit dhe prosperitetit të garantuar në hapësirën e gjerë euroatlantike. Orientimi i politikës së jashtme dhe sigurisë së Shqipërisë (e më pas shtetit të dytë shqiptar, Kosovës) për t'u anëtarësuar në NATO dhe BE është bërë pjesë e pandryshueshme e politikës së vendit dhe e ekzistencës sociale për të ardhmen e parashikueshme.

Dy fjalë për gjeopolitikën

Problemi me konceptin u kuptua vetëm atëherë kur fjalët “Gjeo” dhe “Politikë” (gjeopolitikë) u gërshetuan për të formuar termin “gjeopolitikë”. Gjithsesi, ky gërshetim ende nuk është kryer në mënyrë përmbyllëse, sepse të pretendosh një kuptim përfundimtar të termit “gjeopolitikë”, sigurisht që mund të zhgënjehesh e sidomos pas ndryshimeve të ndodhura në dhjetëvjeçarët e fundit. Që nga *Rudolph Kjellen*³, me përkufizimin për gjeopolitikën: “teoria e shtetit si organizëm gjeografik, ose si fenomen në hapësirë” e deri te *George Friedman*⁴: “metodë të menduari në ndjekje të interesave kombëtare që çon në një sjellje të parashikuar dhe në një aftësi për të formuar sistemin e ardhshëm ndërkombëtar”, përcaktimet e gjeopolitikës nuk kanë shteruar. Nuk mungojnë përkufizimet e saj edhe nga fjalorët shkencorë të përditësuar ku p.sh tek “*Merriam webster*” gjeopolitika përcaktohet “një studim i influencës së faktorëve si gjeografia, ekonomia dhe demografia mbi politikën dhe sidomos politikën e jashtme të shtetit” apo te “*Oxford Advanced Learner’s Dictionary of Current English*”, ku shkurtimisht përcaktohet se “gjeopolitika është politika e jashtme e një shteti, e përcaktuar në bazë të pozicionit të tij gjeografik”.

Pra, përkufizimi i gjeopolitikës varet nga koha dhe vendi. *Defarges Moreau*⁵ e shprehu këtë në një mënyrë të bukur: “Në çdo moshë, çdo kulturë ka gjeografinë e saj, vizionin dhe përfaqësimin e hapësirës”. Pavarësisht qëndrimeve të ndryshme dhe nuancave të karakterit shkencor të gjeopolitikës së ditëve tona, janë të shumtë faktorët të cilët nuk mund të anashkalohen, por ata më me ndikim janë faktorët që lidhen me politikën e jashtme të shteteve, si elementi thelbësor në funksion të së cilit është vetë gjeopolitika, faktorët që lidhen me gjeografinë si dhe ata që lidhen me individin, si pjesë përbërëse e shtetit. Ndoshta nuk ka ndonjë ndryshim thelbësor me ata që përmendte *Spykman* në vitin 1938: “Faktorët që ndikojnë politikën e shteteve janë të shumtë, të përhershëm e të përkohshëm, të dukshëm dhe të padukshëm.

Në ta përfshihen, përveç faktorit gjeografik dhe identiteti i popullsisë, struktura ekonomike e vendit, përbërja etnike e popullsisë, forma e qeverisjes si dhe paragjykimet dhe komplekset e ministrave të jashtëm”⁶. Në të vërtetë, ka ndryshuar thellësisht konteksti si në planin politik dhe në atë gjeografik apo njerëzor, por edhe mënyra e qasjes ndaj gjeopolitikës. Tani ajo paraqitet më shumë si një model diskutimi dhe paraqitjeje e mundësive sipas studimeve sesa si një teori që tregon si ndërthuret hapësira dhe politika. Kjo, qoftë edhe për faktin e mësymjes së faktorëve të rinj, në cilësi edhe në sasi, të tillë si: kultura, gjinia, sjellja njerëzore, ndryshimet klimatike, pabarazia sociale, rreziqet

³ Ribaj.P., Perceptime gjeopolitike, Akademia e Mbrojtjes, Tiranë, 2011.

⁴ Friedman, George, “100 Vitet e Ardhshme-Parashikim për shekullin XXI”, Sh.B.”Plejad, f. 36.

⁵ Moreau Defarges, Filip, “Introduction à la Géopolitique”, Seuil, 2005.

⁶ P. Ribaj, punim i cituar.

nga përhapja e armëve të shkatërrimit në masë, gjenocidi, paqëndrueshmëria, brutaliteti, stabiliteti, globalizmi etj. Çështja është se pikërisht kjo mësymje faktorësh ka pjesën e vet të ndikimit në procesin e shndërrimit të gjeopolitikës

Analiza e marrëdhënies midis hapësirës dhe politikës

Sistematizimi i raportit territor/politikë nuk shteron analizën e marrëdhënies midis hapësirës dhe politikës⁷. Duhet pranuar që gjeopolitikanët nuk e kanë konceptuar mjaftueshëm hapësirën. Lindja e gjeopolitikës u shoqërua nga gara e egër e fuqive të mëdha evropiane në fund të shekullit XIX. Kjo nxiti shumë gjeografë dhe ushtarakë të ndriçonin mendjen e udhëheqësve të tyre përsa i takonte vendit dhe detyrimeve të vendeve të tyre në tryezën ndërkombëtare të shahut. Përfundimi i të gjithëve, në mënyrë nacionaliste, ishte nevoja e marrjes ose kontrollit të pozicioneve apo territoreve të konsideruara si pozicione strategjike kyç. Prania e një stresi ambiental ose e një kërcënimi të jashtëm, përcakton vizionin e katër autorëve të parë dhe më të rëndësishëm të skemave gjeopolitike dhe gjeostrategjike botërore të epokës: *Alfred Mahan*, *Halford Mackinder*, *Karl Haushofer* dhe *Nicholas Spykman*. Në tërësi, ka ekzistuar një harmoni midis gjeopolitikës dhe teorisë së marrëdhënies ndërkombëtare.

Kështu, nëse pas vitit 1945, analiza gjeopolitike ka marrë degëzime të ndryshme, pasojat nuk kanë qenë spektakolare. Gjatë tre ose katër dhjetëvjeçarësh, mbijetesa e saj është varur drejtpërdrejt nga zhvillimi i analizës strategjike në marrëdhëniet ndërkombëtare. Kjo e lidhur më shumë me faktorët e fuqisë, me arsenalet ushtarake sesa me sjelljen e aktorëve. Infrastruktura gjeopolitike mund të përcaktohet si një kombinim i përgjithshëm i faktorëve morfologjikë të sistemit ndërkombëtar në një epokë të dhënë. Ajo paraqet kompleksin e ndërfaqeve të të gjithë hapësirave materiale, të strukturuar nga aktorët.

Duket e arsyeshme të reduktohet numri i këtyre hapësirave të ndjeshme në katër: hapësira natyrale ose fizike, hapësira diplomatike-strategjike, hapësira demografike ose më saktë hapësira demopolitike dhe hapësira ekonomike në kuptimin e gjerë. Përveç të parës, të gjitha të tjerat janë drejtpërdrejt krijime të njeriut, por meqë hapësira natyrale është gjerësisht e ndikuar dhe e transformuar nga të tjerat, dalin dy konsiderata thelbësore. Çdo hapësirë ka një strukturë të vetën, ndërkohë që infrastruktura gjeopolitike përzien marrëdhëniet e ndërlidhjes dhe i paraqitet energjike. Në fakt, çdo aktor gjendet përballë të dhënash natyrore ose historike të vendosura në hapësirën fizike. Ekziston pra një kushtëzim fillestar: “asnjë veprim material i njeriut mbi natyrën, nuk mund të kryhet pa zbatuar që nga fillimi qëllimin e realiteteve “ideore” paraqitje, gjykime, parime të mendimit...” Me fjalë të tjera, infrastruktura gjeopolitike e marrëdhënies ndërkombëtare, është dhe vetë në ndërveprim me konceptimet e botës dhe formon me to një konfigurim të sistemit ndërkombëtar për të cilin mund të thuhet se përbën njëkohësisht përmbajtjen dhe rezultanten.

Konceptimet e botës nga ana e aktorëve, strategjitë e ambicieve të tyre nuk do të ishin krejtësisht indiferente ndaj kushteve strukturore dhe realiteteve faktike. Realja është, në të njëjtën kohë, e përbërë nga sjelljet pak a shumë racionale të aktorëve, por formohet pa ndërprerje edhe nga paraqitjet e tyre. Duke u nisur nga këto premisa teorike, është e qartë të përcaktohet, në mënyrë komplekse, sistemi botëror i hapësirave në lëvizje të vazhdueshme. Sistemi, në shkencat shoqërore është një koncept teorik, në më të shumtën

⁷ Géopolitique au XXI siècle?, Paris, 2001, p 291-325.

e rasteve abstrakt dhe që përcaktohet me vështirësi. Hapësira mbetet një koncept grafik, i prekshëm të paktën në mënyrë figurative, kur bëhet fjalë për marrëdhënie jo materiale. Mund të imagjinohet pra përpunimi i modeleve gjeopolitike si mjeti për vizualizimin planetar të marrëdhënieve ndërkombëtare dhe më saktë për të objektivizuar dhe interpretuar sistemin e marrë në konsideratë.

Pavarësisht të gjithë asaj që është shkruar mbi tërheqjen ose fundin e shtetit, mund të pranohet ky konstatim thelbësor: shteti formon një kompleks kapacitetesh strategjike dhe mbetet kështu selia e vetme e negociimit, e shtrëngimit ose e ndikimit. Më në fund, duke u ofruar si një disiplinë paksa hegjemone, gjeopolitika ngre pyetësorë të rëndësishëm epistemologjikë, të cilët nuk ngrenë asgjë në dobishmërinë e justifikuar nga vëmendja që dinamikat sistematike bashkëkohore kërkojnë t'iu jepet raportit hapësirë-politikë. Kjo është e vlefshme si në nivel mikro (p.sh. çështjet territoriale apo imigrimi) dhe në atë makro (shfaqje gjeopolitike supershtetërore apo qasje rajonale të sistemit ndërkombëtar). Globalizimi i marrëdhënieve ndërkombëtare, në të gjitha format, vënia në sinkron e një pluriuniversi (e një multiuniversi ose të paktën e një universi jo të unifikuar) vënia në lëvizje e njerëzve në planet, bën që, për herë të parë, gjeopolitika të quhet ligjërishit studimi i botës politike bashkëkohore si e tillë.

Kapërcimi i klasikes

Gjeopolitika klasike lindi si një nocion i shtuar politik në analizën gjeografike të hartës për çështje drejtpeshimi forcash, epërsie dhe strategjike e përqendruar më tepër në territorin evropian. Kjo qasje i përngjiste më tepër një lloj konkurrence sesa një analize të ftohtë të pozicionimit të aktorëve në tabelën e shahut. Termi gjeopolitikë rinisi të merrte rëndësinë që meritonte rreth viteve '70 të shekullit të kaluar dhe një nga promotorët e këtij rikuperimi ka qenë *Henry Kissinger*, duke nisur që nga përfundimi i Luftës së Vietnamit, manovrat strategjike të vazhdueshme gjatë Luftës së Ftohtë dhe sigurisht, vendosja e marrëdhënieve diplomatike me Kinën. Për *Kissinger*, një aktor, në lojën e tij gjeopolitike nuk bënte asgjë më tepër sesa të ushtronte rolin e tij. Sa më "*savoir faire*" (të dish si të veprosh) që do të kishte një shtet, aq më të larta do të ishin mundësitë që ai të sundonte në hapësirën gjeopolitike. Ideja tradicionale e gjeopolitikës, ajo e cila kishte si kryefjalë territoret dhe karakteristikat fikse të një shteti tashmë mund të konsiderohet e sfiduar nga ideja e gjeopolitikës postmoderne, e cila është më abstrakte, në pamje të parë, por shumë më reale në analizën përfundimtare. Sot shtetet kanë rolin e tyre dhe ky rol nuk përkon me sensin ontologjik të fjalës ndaj dhe interpretimet e hartës duhet të kenë një legjendë shumë të zgjeruar, e cila trajton të gjitha gërshetimet, duke nisur nga ato të fuqisë ekonomike, teknologjike, pjesëmarrja në organizata ndërkombëtare, graviteti i secilit shtet, etj.

Gjeopolitika nuk duhet parë si një koncept abstrakt, pjesë e të cilit është vetëm politika e lartë. Ajo tashmë prek jetën e cilitdo qytetar. Shtetet arrijnë të "shpërndajnë" perceptime të caktuara preferenciale për shtete të tjera (për shembull, dihet që shqiptarët janë shumë të prirë për të parë më pranë vetes si aleat SHBA-në, sesa ç'mund ta shohin atë shtete të tjera në Ballkan). Kjo gjë çon në idenë se gjeopolitika postmoderne, më tepër sesa territore në një hartë, kërkon kuptim. Ajo që është më e rëndësishme është se, dashje pa dashje, gjeopolitika, nëpërmjet nevojës për të interpretuar lëvizjet e shteteve-dhe në gjeopolitikë kjo bëhet gjithmonë në kohën e tashme-prognozave apo tentativat për lëvizjet

e ardhshme të tyre, ka dhënë një kontribut të çmuar në njohjen e sjelljes së shteteve në arenën ndërkombëtare dhe i ka dhënë një logjikë mënyrave të sjelljeve⁸.

E parë në këndvështrimin e Qendrës *Stratfor*, gjeopolitika siguron depërtime të mprehta të historisë dhe politikës së një vendi, rajoni apo dhe më gjerë. Topografia, klima dhe burimet, të gjitha ndikojnë në marrëdhëniet ndërmjet shteteve dhe “bërja e hartës” ndihmon në sqarimin e motiveve të qeveritarëve dhe qeverive të tyre. E thënë më saktë, faktorët gjeopolitikë modelojnë dhe tregojnë më shumë mbi zhvillimet sociale dhe kulturore, të cilat mbartin në vetvete pasojat të rëndësishme politike. Gjeopolitika, sipas konceptit të kësaj qendre, e kuptuar siç duhet, shërben si një korrektues i dobishëm për pikëpamjet e promovuara nga “avokatët” e globalizimit, të cilët thonë se teknologjia ka kapërcyer shtrëngimet dhe kufizimet e vendosura nga gjeografia, e kuptuar, kjo, si në terma fizikë ashtu edhe politikë. Sfidat për “përdorimin” apo “bërjes gjeopolitike” është të gjendet perspektiva e duhur.

Si do të jetë kjo rubrikë?

Në numrat e parë, pas një trajtесе për vështrimin e përgjithshëm dhe vizionin e gjeopolitikës, vëmendje do t’i kushtohet punimeve historike të shkollave dhe gjeopolitikanëve klasikë: gjermanë, anglezë, amerikanë, rusë, francezë, italianë, etj., duke synuar qasje dhe impakte në rajon dhe në hapësirën shqiptare. Theksohet “ndalimi” i gjeopolitikës në favor të ideologjisë, gjatë viteve të Luftës së Ftohtë, më pas kushtet e rishfaqjes së rezervuar deri te “lulëzimi” i saj. Më shumë se 100 vjet pas lindjes së saj të vërtetë, gjeopolitika ende nuk ka gjetur të gjejë një vend unanimisht të njohur në shkencat shoqërore dhe përbën akoma një objekt kritikash ideologjike e njëkohësisht epistemologjike, të dala nga lëndët ku ajo kërkon të ndërtojë arsyetimet e saj: histori, gjeografi, shkencë politike dhe brenda kësaj të fundit, marrëdhënie ndërkombëtare.

Shkaqet e kundërshtimit të gjeopolitikës janë të ndryshme; një nga kritikantët më të pranueshëm vë theksin mbi ekzistencën e shumë traditave gjeopolitike tepër të ndryshme nga pikëpamja kombëtare, në dëm kjo të një analize gjeopolitike të aftë të vendoset në një plan universal, thelbësor për çdo shkencë. Pjesa më e madhe e kritikave të tjera tradhtojnë shpesh frikën e të parit të gjeopolitikës, referuar karakterit të saj realist dhe tendencës së saj për të ndikuar mbi forcat e thella të historisë, në kundërshtim me disa projekte politike të tilla si ngritja e pushteteve mbikombëtare. Prandaj mendojmë t’i kushtojmë hapësirë lidhjes së thellë që ekziston midis gjeopolitikës dhe shkollave kombëtare, duke nënvizuar njëkohësisht kontributet kritike dhe konceptuale në marrëdhëniet ndërkombëtare. Një vend të rëndësishëm do t’i kushtohet faktorëve të qëndrueshëm të gjeopolitikës. Përvoja ka treguar se politikat e jashtme të shumë shteteve paraqiten shpesh si konstante, pavarësisht kthesave dhe ndryshimeve ideologjike, sepse qeveritë arsyetojnë në një mjedis gjeografik të pandjeshëm ndaj ndryshimit kohor. Situatat e mbylljes dhe izolimit përshkrijnë shekujt, kjo edhe kur progresi njerëzor lejon transformimin e raportit që njeriu ka me gjeografinë. Gjeopolitikanët të vëmendshëm pohojnë se çdo politikë shtetërore është produkt i tre faktorëve themelorë konservativë: realiteti gjeografik, realiteti identitar dhe kërkimi i burimeve.

Gjeografia fizike përbën të dhënën e qëndrueshme që është në themel të politikës së

⁸ Ó Tuathail, G. (1998): Introduction. Thinking critically about geopolitics. In: Ó Tuathail, G.; Dalby, S.; Routledge, P. (Hg.): The Geopolitics Reader. London. S. 1-12.

jashtme të shteteve. Të dhënat historike ndryshojnë, por gjendja gjeografike e shteteve mbetet e njëjta. Gjeografia fizike, në të gjithë përbërësit e saj, është përcaktuesi i parë gjeopolitik; është ai që i ka vendosur popujt atje ku ata janë, që ka bërë të mundur ndërtimin e shteteve sedentare, ose në të kundërt të lëvizjeve nomade, është ai përcaktues që ka ruajtur veçoritë fetare dhe etnike. Por ky përcaktues nuk vepron i vetëm tek grupet njerëzore dhe as nuk është përsosshmërisht i pazistueshëm.⁹

Në rubrikë do të mundësohet trajtimi i qëndrueshmërisë së hartës, do të nënvizohet rëndësia e dualitetit qendër-periferi në arsyetimin gjeopolitik, para se të futet nocioni i situatës. Në vijim, do të trajtohen dy situata themelore të shteteve: mbyllja dhe izolimi. Më pas, do të përqendrohemi në qëndrueshmërinë e opozitës midis Tokës dhe Detit, si paradigmë gjeopolitike e historisë, duke pasur rast studimi realitetin shqiptar.

Antropologjia kulturore e përfaqësive të shenjta na ndihmon për të përcaktuar elementet e saj përbërëse. Elementet mbizotëruese janë toka dhe deti. Ata përfaqësojnë çdo gjë të rëndësishme për jetën e njeriut: trupi dhe gjaku, toka dhe uji, të ngurtat dhe të lëngshmet. Në kozmologjinë e shenjtë, toka përfaqëson territore të palëvizshme, të ngurta, të qëndrueshme dhe natyrisht edhe hapësirë. Uji paraqet lëvizjen, jo territorialen, butësi dhe sigurisht kohën. Gjeopolitikani rus *Aleksandër Dugin* mendon se toka dhe deti përfaqësojnë universalitetin, lidhjen me kozmosin (burimi i ujit është në qiell, toka është e vdekur pa ujë). Këto dy elemente të moçme kanë gjeneruar dy mënyra të menduarit dhe dy koncepte të gjeopolitikës: në greqisht, *thalassocratia* dhe *tellurocratia*, (det të menduarit dhe tokë të menduarit). Shtetet dhe perandoritë janë fuqitë *thalassocratic* ose *tellurocratic*. Me këtë kategorizim, mund të supozojmë se Kartagjena ishte e para fuqi e madhe detare në histori, ndërsa Roma ishte para fuqi e madhe tokësore. Deti Mesdhe duhet të konsiderohet si djepi i detit të menduarit. Diasporat greke në Mesdhe kaluan duke menduar për *thalassocratic* qytet-shtete mesjetare të Venedikut dhe Gjenovës, të cilat më vonë ua dorëzuan njerëzve të veriut, veçanërisht anglo-saksonëve. Një hipotezë e tillë presupozon se det-menduarit anglo-saksonë u transferuan përmes qytetërimit të lashtë mesdhetar dhe jo përmes vikingëve të veriut. Është euroatlanticizmi një zgjatje e mediterraneizmit dhe jo e traditës vikinge? Me siguri që është.

Dhe nëse besojmë se, në peshën që ka gjeografia në historinë e një vendi, mund të thuhet se e ardhmja e Shqipërisë do të jetë mjaft e ndikuar prej këtij faktori. Nga një vështrim i shpejtë i historisë vërehet se Shqipëria ka qenë më tepër e sunduar dhe e orientuar si një vend me kahje kontinentale, sesa me profil detar apo mesdhetar. Vija e gjatë bregdetare e Shqipërisë ka përfaqësuar më shumë një vijë kufiri sesa një portë të gjerë komunikimi me botën. Më saktë, pas rënies nën pushtimin otoman deri në përfundim të Luftës së Ftohtë, bregdeti dhe ujërat territoriale të Shqipërisë mbetën më shumë një vijë kufiri që ndante perandori ose shtete kundërshtarë. Dhe më tej, duke u ndodhur në kryqëzimin e gadishullit të Ballkanit, Evropës Qendrore dhe Mesdheut, baseni Adriatiko-Jonian ka një vendndodhje gjeostrategjike. Historikisht, hapësirat e ndara të sovranitetit kombëtar, nga njëra anë, dhe integrimi i mëtejshëm rajonal, nga ana tjetër, kanë ushtruar forca centrifugale dhe centripetale, të cilat ende janë aktive. Megjithë përmirësimet e rrënjësishme në aspektin e stabilitetit demokratik, rajoni ynë sot përballet me dy dinamika të ndryshme gjeopolitike: integrimi i mëtejshëm evropian dhe fuqizimi i dimensionit

⁹ Aymeric Chauprade, «Géopolitique, Constantes et changements dans l'histoire» f. 207.

mesdhetar të BE-së¹⁰. Kuptohet, fuqizimi dhe përmirësimi i rrjetit të infrastrukturës rajonale, sipas akteve të linjave kryesore të lëvizjes dhe shkëmbimit, si dhe lidhja e tyre me rrjetet e infrastrukturës dhe energjetike evropiane dhe euroaziatike, do të kenë ndikime pozitive në rajon, duke e bërë atë më të sigurt, duke rritur dimensionin gjeopolitik, duke zgjeruar tregun dhe duke i dhënë shtysë interesit për investime të huaja në rajon.¹¹ Dhe për këtë rol dhe kahje të Shqipërisë sot, ndihmesa e revistës nuk duhet të rreshtë.

Vend të dukshëm në rubrikë do të zërë identiteti apo më saktë qëndrueshmëria e identiteteve, ndikimi i faktorëve identitarë: klani, etnia, kombi dhe territori, gjuha, feja, panizmi, minoriteti, kategoria social-ekonomike, identiteti i trajtuar në dimensionin sasior. Faktorët e gjeografisë fizike dhe njerëzore veprojnë në kohë, përgjatë historisë së shoqërive njerëzore. Ata formojnë kuadrin e përhershëm në të cilin nënshkruhet lidhja mes të shkuarës dhe të tashmes, historisë së marrëdhënieve të njerëzve brenda shteteve-gjeopolitike e brendshme, asaj të marrëdhënieve midis vetë shteteve-gjeopolitike e jashtme. Konfliktet që trazojnë botën gjejnë frymëzim thelbësor në qëndrueshmërinë e linjave klanike, etnike, kombëtare, fetare, gjuhësore ose të qytetarisë dhe në zhvillimin e dinamikave demografike.¹²

Nisur nga e vërteta se “që të jesh duhet të kesh” do të trajtojmë aksesin në burime, se si konstantja e historisë nënvizon rëndësinë e burimeve si themel të fuqisë. Theksi do të vihet në rëndësinë e ujit dhe naftës, por dhe të pasurive të tjera, në botën bashkëkohore, duke i dhënë përparësi hapësirës shqiptare. Raporti i gjeopolitikës me ekonominë kufizohet në fushën e burimeve themelore, jetësore dhe energjetike, por strategjitë tregtare, industriale, financiare të shteteve nuk konsiderohen si të fushës gjeopolitike, edhe pse, në shumë pika, ato mund të kenë një raport me mjedisin gjeografik dhe nuk janë pa pasoja mbi fuqinë. Shqipëria i ka të gjitha: vendndodhjen e rëndësishme gjeostrategjike; hapësira të privilegjuara për të gëzuar Mesdheun-detin e bekuar të botës; tokën e nëntokën e begatë; gjeografinë veçanërisht të larmishme. Studimet serioze thonë se trojet shqiptare i kanë të gjitha mundësitë të mbajnë në standarde të përparuara jetese dhe dyfishin e popullsisë së sotme shqiptare. Por “ajo që të bën të madh, të rëndësishëm, të fortë në botën moderne nuk është sipërfaqja e tokës, por ritmi i zhvillimit”, -thotë *Ernest Gerner*.¹³ Kjo do të thotë se nuk mjafton vetëm gjeopolitika. Shqiptarëve nuk u lejohet të mbeten produkte anësore të gjeopolitikës. Gjeopolitika lidh fuqinë me interesat në hapësirën gjeografike. Këto i kemi, por që këto të bëhen vepruese, shqiptarët duhet të kenë një strategji të mirëpërcaktuar. Nëse nuk do të gjendet rruga e lejueshme qytetëruese, që do t'i bashkonte të gjitha kapacitetet e shqiptarëve, në kuadër të një objekti të përbashkët kombëtar, atëherë këto kapacitete do të shfrytëzoheshin nga të tjerët.¹⁴ Në këtë kah, takimi i 11 janarit midis qeverisë së Shqipërisë dhe asaj të Kosovës duhet konsideruar pjesë e procesit të vazhdimësisë së investimit dhe si bazë për formatimin e mendësisë strategjike moderne kombëtare, të orientuar nga planifikimi strategjik afatgjatë, karakteristik i kombeve të kulturuara, drejt mbushjes me shpejtësi të vakumeve gjeopolitike rajonale dhe larg ambicieve politike partiake, Tashmë, ne duhet të mendojmë

¹⁰ D. Bushati, 8 shkurt 2014.

¹¹ Po aty.

¹² Aymeric Chauprade, Po aty, f. 927.

¹³ Ernest Gerner, “Nacionalizmi”, Botimet IDK, 1997, f. 66.

¹⁴ A. Xhaferi, Skicë e Mbrothësisë shqiptare, cituar nga Gjeopolitika, Universiteti “M. Barleti”, Tiranë, 2008, Nr. 1, f. 83.

madhërishtëm. Jemi një komb i madh në Ballkan; të lexojmë mirë edhe dinamikën demografike, moshën. Së bashku me diasporën numri i shqiptarëve dyfishohet.

Do t'i kushtojmë hapësirë veçanërisht studimit të faktorit fetar. Kjo shpjegohet me faktin se faktori fetar mund të konsiderohet si tipar i gjeografisë njerëzore, sepse është pjesë përbërëse e identitetit të grupeve njerëzore dhe njëkohësisht prek fushën e mentaliteteve, ideve, ideologjive. Studimi i faktorit fetar është pra i rëndësishëm pasi ai vendos urën lidhëse midis gjeopolitikës dhe studimit të sistemeve të trajtuara nga pikëpamja politike dhe të çon drejt debatit realizëm-idealizëm. Në fakt, ne do tregojmë se sa feja, e cila në thelb të saj prek idealizmin, mund të instrumentalizohet nga grupet politike aq sa të studiohet “nën një kënd realist”. Raporti i njeriut me hapësirën nuk përbëhet vetëm nga konstante, pikërisht sepse njeriu nuk është vetëm një “kafshe politike” sipas fjalës së Aristotelit, por gjithashtu edhe një “kafshë shkencore”, një teknikien. Revolucionet teknike tronditën të dhënat e gjeopolitikës dhe ndryshojnë raportet e fuqisë. Ne do të përcjellim analizë mbi rolin e faktorit teknik në origjinën e supremacisë perëndimore në botë, mbi pasojat gjeopolitike të revolucioneve të lundrimit detar, mbi ato të revolucionit industrial, të hekurudhës, mbi revolucionin e aviacionit, mbi atë bërthamor, të hapësirës dhe mbi revolucionin në çështjet ushtarake. Ajo që ndryshon të dhënat gjeopolitike nuk lidhet vetëm me teknikën.

Ekziston konkurrenca e shtetit, i parë si burimi kryesor i fuqisë, nga faktori transnacional në të gjitha format, ligjore dhe antiligjore. Ekziston një metodë e analizës gjeopolitike që mund të kontribuojë, edhe pjesërisht, për të shpjeguar historinë, më saktë duke depërtuar në thellësinë historike dhe gjeografike të hapësirës shqiptare, tani që kemi kapërcyer 100 vjetorin e ekzistencës së shtetit shqiptar. Në rubrikë mendojmë të paraqesim disa trajtesa të spikatura, bashkëkohore, të autorëve më në zë, me fokus shumëdimensional gjeopolitik, si ndihmesë modeste për elitat dhe politikantët e larta. Ushtritë, marinat, hekurudhat, ekonomitë, ideologjitë, historitë, të gjitha janë të rëndësishme. Por të rëndësishëm gjithashtu janë dhe individët sepse, në fund të fundit, njerëzit i hartojnë raportet, vendimet dhe i japin urdhër ushtrive të lëvizin.¹⁵ Ata paraqesin interesat e tyre kombëtare, por sjellin gjithashtu pëlqimet apo mospëlqimet e tyre. Në qoftë se gjeopolitika nuk mund të kuptohet pa gjeografinë, historinë, kjo e fundit nuk mund të kuptohet pa individët apo figura të shquara që kanë lënë gjurmë në të.

Kuptohet hapësirë të gjerë në rubrikë do të zënë punimet nga gjeopolitika e hapësirës shqiptare. Krahas të tjerave, me kohë, do të vijmë personalitete nga më të shquarit e botës akademike brenda e jashtë vendit, doktorantë dhe graduatë në *master*, të cilët po hulumtojnë në fushën e gjeopolitikës e madje aktualisht po përgatisin edhe konferencën me temë: “Qasje në gjeopolitikën shqiptare”. Theksoj se veprimtaria do të argumentojë se rajoni i Ballkanit, sidomos hapësira shqiptare, shqiptarët si komb, si organizëm shtetëror apo shoqëri të ndryshme përfaqësojnë një faktor kyç në zhvillimet e ardhshme. Përveç të tjerash, gjeografia e saj si “parathënia e gjurmimit të ngjarjeve njerëzore”¹⁶ dhe historia, e lidhur me të, kanë përcjellë bindshëm faktin që Shqipëria “është çmimi për çdo fuqi që dëshironte të luante një rol sundues në Ballkan”¹⁷... Dhe nëse do t'i

¹⁵ Margaret MacMillan. “Paris 1919, Gjashtë muaj që ndryshuan botën”, Plejad, 2006, f. 27.

¹⁶ Kaplan, Robert.D, “The revenge of Geography”, 2012, p. 30.

¹⁷ Blitz, Brad.K, “ar and change in the Balkans, Nationalism, Conflict and Cooperation”, Cambridge University Press 2006, p 226.

referohemi *Brzezinski*,¹⁸ për analizën e vendit si strumbullar gjeopolitik, trojet shqiptare i gëzojnë thujse atributet për t'u klasifikuar si i tillë.

Së fundi, por jo nga rëndësia, në këtë rubrikë do të sillen edhe skenarë gjeopolitikë të cilët e vendosin vendin, rajonin apo sistemin ndërkombëtar në pozicione të cilat kërkojnë patjetër përgjigje. Përballja me të ardhmen na ndesh me sfida investiguese të tmerrshme parashikimesh dhe interpretimesh e konture të mundimshme. Idetë e përkohshme pacifiste që shoqëruan kalimin nga *Lufta e Ftohtë* në *Paqe të Ftohtë* provoi që fundi i *Luftës së Ftohtë* dhe mundësia realisht e pakët për luftëra ndërshtetërore, nuk pasqyroi pakësim të rreziqeve e kërcënimeve e, për rrjedhim, pakësim të nevojës për të mbajtur ushtri të fuqishme. Mjedisi i sigurisë është vazhdimisht në ndryshim si pasojë e ndikimit dhe veprimit të aktorëve dhe faktorëve të ndryshëm dhe kjo kërkon të jemi të qartë rreth mjedisit të sigurisë, në të cilin do të jetojmë, si dhe shtron nevojën e parashikimeve, zhvillimeve, vlerësimeve, administrimit dhe menaxhimit të kërcënimeve dhe rreziqeve të së ardhmes.

Skenarët dhe hipotezat janë “armë” e suksesshme e gjeopolitikës moderne, në ndihmë të politikëbërësve për mbrojtjen dhe zhvillimin e interesave kombëtare, etj. Përvijimi i skenarëve evropianë, etj., përbën një përpjekje serioze dhe detyrë të ekspertëve të gjeopolitikës rajonale e më gjerë. Përvoja e gjithanshme po na bind se prirjet globale dhe ato evropiane oponente janë të pashmangshme. Shumëkush këmbëngul drejt integritit, të tjerë drejt fragmentarizimit; bota dhe vetë BE-ja duket sikur po fashitet dhe në të njëjtën kohë sikur po ndahet. Kuptueshmëria, pasiguria dhe paparashikueshmëria janë shqetësimet sunduese të sotme. Diçka është e sigurt, shkruan *Charles Kegley*.¹⁹ “lëkundjet sizmike që po ndodhin, po sfidojnë urtësinë e besimtarëve të vjetër dhe vizionin ortodoks”. Dhe sigurisht, të flasësh për të ardhmen sot është e vështirë. Për më tepër, të parashikosh në mënyrë preçize mjedisin e ardhshëm të sigurisë, referuar sidomos mjedisit të BE, është akoma më e vështirë. Në këtë pikë na vjen në ndihmë një shkrimtar ushtarak francez-*Antoine de Saint-Exupery*-që kur flet për këtë çështje thekson: “Përsa i përket të ardhmes, detyra juaj nuk është ta parashikosh, por ta përshtatësh (për qëllimet e tua) atë”.

Shpeshherë, prej shumëkujt skenarët konsiderohen si të pamundur për të ndodhur, por *George Friedman* thotë se në historinë e botës ka ndodhur pikërisht ajo çka njerëzit mendonin se është e pamundur që të ndodhë. Natyrisht që e tashmja ka shumë vlerë dhe ka persona që iu duket humbje kohe dhe diçka e panevojshme ndërtimi i skenarëve parashikues për të ardhmen që nuk dihet se si do të jetë. Përgjigja duket se gjendet në

¹⁸ Brzezinski, Zbigniew, “The Grand Chessboard American Primacy and its Geostrategic Imperatives”, New York Basic Books, 1997, p 40 . Sipas Brzezinskit “Strumbullarë gjeopolitikë” vlerësohen ato shtete “rëndësia e të cilave nuk rrjedh aq shumë nga fuqia dhe motivimi i tyre, sesa nga vendvendosja sensitive e vendit të tyre dhe nga konsekuencat e kushteve e rrethanave potencialisht të prekshme (vulnerabël) të tyre për sjelljen e lojtarëve strategjikë. Më së shumti, strumbullarët gjeopolitikë përcaktohen nga gjeografia e tyre, e cila në disa raste iu jep atyre një rol të veçantë si strehë aksesi në zona të rëndësishme ose në moslejimin e hapësirës për burime ndaj një lojtari të rëndësishëm. Në disa raste, një strumbullar gjeopolitik mund të thuhet se ka rrjedhime shumë të rëndësishme politike dhe kulturore për më shumë lojtarë aktivë fqinjë gjeostrategjikë”.

¹⁹ *Charles Kegley*, vepër e cituar, f. 523-524.

fjalët e *Friedrich Nietzsche*, kur jep këtë vlerësim për të ardhmen: “E ardhmja ndikon te e tashmja po aq sa ndikon edhe e shkuara”.²⁰

Bibliografia:

- F. Mazzei: “Relazioni Internazionali”, 2005.
- Cfr: G. Hegel: *The Philosophy of History*, Dover Publication, NY, 1975.
- Ribaj.P., *Perceptime gjeopolitike*, Akademia e Mbrojtjes, Tiranë, 2011.
- Friedman, George, “100 Vitet e Ardhshme-Parashikim për shekullin XXI”, Sh.B.”Plejad.
- Moreau Defarges, Filip, “Introduction à la Géopolitique”, Seuil, 2005.
- Géopolitique au XXI siècle?, Paris, 2001.
- Ó Tuathail, G. (1998): Introduction. Thinking critically about geopolitics. In: Ó Tuathail, G.; Dalby, S.; Routledge, P. (Hg.): *The Geopolitics Reader*. London.
- Aymeric Chauprade, «Géopolitique, Constantes et changements dans l’histoire».
- Nest Grner, “Nacionalizmi”, Botimet IDK, 1997.
- A. Xhaferi, Skicë e Mbrothësisë shqiptare, cituar nga Gjeopolitika, Universiteti “M. Barleti”, Tiranë, 2008, Nr. 1.
- Margaret MacMillan. “Paris 1919, Gjashtë muaj që ndryshuan botën”, Plejad, 2006.
- Kaplan, Robert.D, “The revenge of Geografy”, 2012.
- Brzezinski, Zbigniev, “The Grand Chesboard American Primacy and its Geostrategic Imperatives”, New York” Basic Books, 1997.

²⁰ Friedrich Nietzsche, Chapter VIII,paragrafi 240, viti 1886, “ Gjermanët: ata i takojnë një ditë përpara të djeshmes dhe një ditë pas së nesërmes. Ata nuk kanë akoma të sotme”, cituar nga Jahaj. Z.,Shqiptarët në gjeopolitikën e Europës, AFA, 2013, f. 131.

Bashkimi për Mesdheun dhe gjeopolitika evropiane e Parisit

MSc.Silvana Markgjonaj
Redaktore në QD

Trajtesë e shkurtuar. *Mesdheu, bashkon apo ndan? Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje, do të doja të bëja një analogji mes zonës mesdhetare dhe marrëdhënieve euromesdhetare. Në varësi të veprimtarisë, d.m.th. të marrëdhënieve, i njëjti objekt, në këtë rast deti, mund të bëhet një pikë bashkimi dhe jo një hapësirë që ndan. Në qoftë se bëhet fjalë për një veprimtari, duhet të kemi edhe aktorë dhe aktorët, në këtë rast, janë popujt. Si konsiderohet Mesdheu? Sipas analistëve dhe teoricienëve, deti mund të lidhë. Bashkimi mund të bëhet një forcë nga e cila mund të përfitojnë të gjithë.*

Mesdheu etiketohet si “mare nostrum”. Të jetë vallë ky etiketim një deklaratë pronësie apo një ndërgjegjësim i madh i një trashëgimie të përbashkët vetëm e popujve që jetojnë rreth Mesdheut? Gjatë përvojës jetësore personale, gjatë udhëtimeve, kam ndjerë që Mesdheu është i yni, sepse në çdo breg të tij nuk ndjehem e huaj. Përkundrazi rrënjët historike, fetare, kulturore, artistike, ekonomike i bashkojnë ata që jetojnë në brigjet e tij me një trashëgimi të përbashkët.

Fjalët kryesore: Mesdheu, gjeopolitika, Franca, Barcelona, bashkimi, popujt.

Hyrje

Mesdheu, det i Oqeanit Atlantik, det ndërkontinental, me një sipërfaqe prej rreth 2.5 milion km² (965,000 milje katrore), gati tërësisht i rrethuar nga toka: në veri nga Evropa, në jug nga Afrika dhe në lindje nga Azia përfshin këto shtete bregdetare: Shqipërinë, Spanjën, Monakon, Francën, Italinë, Maltën, Slloveninë, Kroacinë, Bosnjën dhe Hercegovinën, Malin e Zi, Greqinë, Turqinë, Sirinë, Qipron, Libanin, Izraelin, Egjiptin, Libinë, Tunizinë, Algjerinë, Marokun.

Në kohën e sotme, nuk ka ditë që të mos dëgjosh të flitet për integrimin, bashkimin, partneritetin, të mirat e të këqijat që vijnë prej tyre, mënyrat e organizimit, pengesat e vështirësitë e realizimit, për më tepër në kushtet e krizës ekonomike aktuale. Rënia e “Perdes së Hekurt” e vuri BE-në përballë sfidave të reja dhe i ndodhur përballë tyre si dhe i kënaqur nga përfundimi i ndarjes së kontinentit evropian, BE ishte i detyruar të reagonte dhe këtë e bëri në tre mënyra, duke propozuar:

- një perspektivë pranimit në të për vendet “e reja” fqinje të Lindjes;
- një pakt stabiliteti për fqinjët ballkanikë;

¹Bichara Khader, L'Europe pour la Méditerranée, De Barcelone à Barcelone (1995-2008), p. 175.

dhe një partneritet për fqinjët mesdhetarë.

Në tërësi, tre qasjet klasike të BE-së janë: integrim, stabilizim dhe partneritet. Për të kuptuar “orientimin e ri” të politikës evropiane, duhet ta vendosim atë në kontekstin gjeopolitik botëror, rajonal dhe lokal. Një seri ngjarjesh të natyrave të ndryshme e detyrojnë Evropën të riformulojë politikën e saj në lindje dhe në jug. Në vitet 1990, vëmendja e BE-së ishte e përqendruar tek Evropa Lindore (bashkimi gjerman, zgjerimi) më shumë se tek Mesdheu.

Idea për *Bashkimin Mesdhetar* është shprehur gjatë fushatës presidenciale, në një fjalim të mbajtur nga kandidati i atëhershëm Sarkozy, në Tulon, më 7 prill 2007 dhe që, pa dyshim, ngjalli debatin rreth vënies në qendër të Mesdheut në gjeopolitikën e Francës dhe të Bashkimit Evropian.

Po le të kalojmë përtej fluturimeve lirike të Brodel (Braudel) mbi këtë Mesdhe që është për ne të gjithë, edhe kur nuk kemi jetuar kurrë në të, kthimi ynë në burime, në fëmijët e Kordu-së dhe të Grenadës, fëmijët e dijetarëve arabë që na kanë përcjellë trashëgiminë greke të cilën e kemi pasuruar ne trashëgimtarët e së njëjtës pasuri vlerash shpirtërore. Është mjaft prekëse dhe ndonjëherë dhe nostalgjike, sidomos kur atij i vjen keq që Mesdheu ka pushuar së përfaqësuari një premtim për të mos përbërë më kërcënim dhe që Evropa dhe Franca i kanë kthyer shpinën.¹

Sarkozi vazhdon më tej: “kur fëmija grek të mos e urrejë më fëmijën turk, kur fëmija palestinez nuk do ta urrejë më fëmijën hebre, etj., Mesdheu do të bëhet vendi më i lartë i kulturës dhe i frymës njerëzore”. Ja një mënyrë e çuditshme e reduktimit të konflikteve komplekse në ndjenja dashurie dhe urrejtjeje.²

Nisma EUROMED

Në këtë shkrim, duke e ndjerë veten faktor dhe aktor të së ardhmes që Mesdheu po ndërton, do të përpiqem të jap ndihmesën time në formimin e ndërgjegjes së plotë e të fortë të “*detit tonë*” (*mare nostrum*).

Nisma vjen nga bregu verior i detit, pra nga Evropa, që nga EURO-përgjigja për bashkëpunim pritet nga jugu, pra nga Mesdheu, që ku -MESDHETARE, ose fare thjesht të bashkuara EUROMED. Nisma EUROMED i ka fillimet në vitin 1995 dhe është përpunuar përmes një procesi 20 vjeçar, duke kaluar nga Barcelona, Parisi, Algjeri, Ljubljana, Marseja, etj.

Ç’është Barcelona? Pse Barcelona 1995? Në përshfaqjen e projektit të partneritetit euromesdhetar, Spanja nuk bën asnjë përpjekje. Sigurisht, sipas shembullit të vendeve të tjera euromesdhetare të jugut (Greqisë, Italisë, Francës dhe Portugalisë), Spanja nuk e shikon me sy të keq projektin e BE-së, por ajo ndjehet më e ekspozuar ndaj rreziqeve të një destabilizimi shoqëror dhe politik në zonën e saj të afërisë imediate, lidhur kjo me flukset migratore klandestine dhe me paqëndrueshmëritë e brendshme, sidomos në vendet e Magrebit. Nuk ka pse të habitemi kur Spanja luan një rol qendror në organizimin e konferencës së Barcelonës, me shqetësimin e riekulibrimin të politikës së BE-së në një zonë përparësore që prek sigurinë e saj dhe për të mos iu dhënë përshtypjen vendeve jugmesdhetare se BE po iu kthen shpinën. Ky ishte dekori gjeopolitik i vitit 1995 që

² Idem, p. 175.

shërbeu si sfond i *Procesit të Barcelonës*.

Natyrisht që perspektiva e pranimit është oferta më e mirë që BE iu bën fqinjëve të tij; është instrumenti më efikas i politikës së tij të jashtme. Pranimi në BE sjell ndryshime të mëdha, prandaj pranimi në të kushtëzohet nga kritere të forta. Ndërkohë që *Pakti i Stabilitetit* (1993), i propozuar për vendet ballkanike nuk e kërkon një gjë të tillë, për më tepër *Partneriteti euro-mesdhetar*, i quajtur *Procesi i Barcelonës* (1995). Meqë perspektiva, e ofruar në këtë rast, nuk shkon përtej stabilizimit të thjeshtë ose shkëmbimit të lirë, instrumenti i kushtëzimit është më pak strikt. Është tashmë e qartë se vendet evropiane të Ballkanit do të integrohen në BE. Historia e kërkon, gjeografia e imponon dhe interesat e komandojnë³.

Kjo pasuri e përbashkët ka ngjallur interes për ndërtimin e një arkitekture institucionale euromesdhetare, duke patur bindjen që pellgu i Mesdheut kërkon një vëmendje politike, ekonomike dhe kulturore më të madhe nga ana e aktorëve ndërkombëtarë, kombëtarë, rajonalë dhe nga ana e shoqërisë civile. Për këtë qëllim do të doja të ndalesha në fillimet e këtij interesimi, në ngjarjet që kanë shënuar historinë mesdhetare, duke mos lënë pa përmendur *Pranverën Arabe*. Në vijim do të nënvizojë perspektivën e zhvillimit të *mare nostrum*, pengesat dhe vështirësitë por edhe shpresat për një frymë integrimi periferik tashmë, në raport me atë evropian, duke krahasuar BE-në me UpM (*Unioni për Mesdheun*).

Aktorët kryesorë të pellgut të Mesdheut janë të prirur për bashkëpunim të bazuar në ndërvlerësi. Kjo ndërvlerësi, gjithsesi, nuk duhet të bazohet vetëm në bashkëpunimin ekonomik, gjë e cila do të bënte të mendohej për një eurokolonializëm të ri në zonën mesdhetare. Në të kundërt, sot kërkohet më shumë se kurrë një gjeostrategji e përbashkët mesdhetare, e dizenuar në bazë të analizave e të potencialeve që ky rajon ofron në garën globale. Sot, më shumë se kurrë, përballë krijimit të aktorëve të rinj politikë dhe ekonomikë (BRICS⁴, Alena⁵, APEC⁶, etj.), *mare nostrum* i ka të gjitha mundësitë për t'u afirmuar si djepi i skenarëve të rinj globalë. Nuk mund të injorohet, në këtë kontekst, roli i Turqisë në kuadrin e ri gjeoekonomik. Po cilët janë elementët që do të mund të garantojnë suksesin e vërtetë të ndërvlerësisë/bashkëpunimit të ardhshëm euromesdhetar?

Sigurisht që çelësi i së ardhmes së marrëdhënieve euromesdhetare do të jenë teknologjia dhe kapitalet njerëzore. Konfigurimi (skakiera) mesdhetar, nga veriu në jug, nga lindja në perëndim, hap perspektiva të reja lidhur me energjinë e rinovueshme dhe pikërisht ky sektor përgatitet të bëhet kryesor për skenarët e ardhshëm energjetikë botërorë. Përsa i përket burimeve energjitike, ose edhe investimeve në fushën e kërkimit dhe zhvillimit, *mare nostrum* është i destinuar të bëhet interlokutori/partneri thelbësor i fuqive të mëdha si SHBA dhe Kina. Nga ana tjetër, një tranzicion i tillë nuk mund të realizohet pa faktorin tjetër kyç që karakterizon tashmë zonën në të cilën jetojmë, kapitalin njerëzor. Rritja demografike në vendet e Magrebit, kultura akademike e të rinjve të Lindjes së Mesme dhe oferta e pasur formuese e vendeve evropiane që lagen nga Mesdheu, do të lejojnë lulëzimin e një kapitali njerëzor mjaft garues dhe të destinuar për të çuar përpara me sukses ëndrrën mesdhetare.

³ Bichara Khader, *L'Europe pour la Méditerranée, De Barcelone à Barcelone (1995-2008)*, p. 142.

⁴ **BRICS** (Brazil, Russia, India, China and South Africa) është një organizatë politike ndërkombëtare që në vitin 2010 ishte vetëm BRIC dhe në 2012 u bë BRICS me futje në të të Afrikës së Jugut.

⁵ Alena: *Accord de libre-échange nord-américain* Marrëveshje e Shkëmbimit të Lirë Amerikano Verior (Kanada, Meksikë, SHBA).

Si ka rrjedhur *Procesi i Barcelonës*? Ashtu sikurse deti paraqet përmasa të ndryshme: ai është i bukur, i qartë, i gjerë, por edhe i thellë, i errët, i rrezikshëm; procesi ka pasur shumë dimensione: ai është pak a shumë i gjatë, ai është herë i qartë, herë i errët, ai është i thellë. Të urojmë që të jetë fitimprurës dhe aspak i rrezikshëm. Si mund ta bëjmë atë dobiprurës për të gjithë? Deri tani është konstatuar se procesi ka qenë më shumë teorik dhe, nga kjo pikëpamje, duket i përsosur. Por si t'i shmangësh rreziqet që vijnë nga thellësitë, nga errësira dhe nga honet? Tashmë është rënë dakord mbi *Unionin*. Si t'i mbrosh teoritë, si t'i vësh ato në jetë në mënyrë që blloku i ri EUROMED të jetë i fortë përballë blloqeve që po lindin e po krijohen në botë: Alena, APEC BRICS, etj. Deri tani bëhet fjalë për një tërësi asimetrike: ndërkohë që Evropa është tashmë një union në ndërtim ekonomik dhe politik prej dhjetëvjeçarësh, Mesdheu është një hapësirë fizike, një zonë gjeografike e vendeve bregdetare që, ndryshe nga Evropa, nuk paraqet homogjenitet; prandaj procesi i ndërhyrjes rajonale nuk është aq i lehtë. Në të ka njëfarë asimetrie institucionale. Nga pikëpamja ekonomike, ekziston një çekuilibër i madh midis Evropës dhe rajonit të jugut të Mesdheut, dy herë më të populluar dhe dhjetë herë më pak të pasur. Analistët flasin për një frakturë ekonomike, më e rënda në botë. Nga pikëpamja kulturore, ka dy qytetërime: latino-kristian dhe arabo-mysliman. Flitet për një “teatër përplasjesh midis dy kulturave”.

Gjeopolitika evropiane e Parisit

Evropa mesdhetare dhe jo Gjermania, është, veç të tjerash, për Francën çengeli ideal për t'u kapur tek pjesa më e rëndësishme e botës së saj: Afrika. Në dallim nga kontinentet e tjera, ky kontinent vazhdon të jetë si i vetmi ende i paaftë për të paraqitur një fuqi botërore. E shfrytëzuar për një kohë të gjatë nga kolonialistët evropianë me francezët në krye, Afrika sot ka ngjitur një shkallë: po përballet me orekset e aktorëve globalë si Kina, SHBA, India, Brazili, Japonia dhe Rusia, por edhe të shoqërive shumëkombëshe, organizatave joqeveritare, etj., të gjithë në kërkim të lëndëve të para, ndarjeve të zonave të ndikimit, blerjeve/shitjeve, etj.

Franca nuk është emancipuar kurrë nga impulset neokolonialiste. Edhe pse me “Pranverën arabe”, sfera e ndikimit të Francës në Afrikën e Veriut po destabilizohet nga aktorët evropianë në Afrikë, Franca mbetet aktori kryesor, pavarësisht konkurrencës gjermane në rritje. Është afrikane, bërthama e fortë e frankofonisë që Parisi e përdor si çelësin gjeogjuhësor të grupit informal të mbështetjes në organizatat ndërkombëtare. Nga ana tjetër, Afrika është shpresa e demografëve trengjyresh, të cilët shohin në horizontin e 2050, një vit të mbarë, në të cilin do të ketë më shumë francezë (më shumë se 70 milionë)⁷ se gjermanë dhe popullsia e kontinentit afrikan do t'i kalojë të dy miliardët, një kuotë e mirë nga ku do të ketë frankofonë apo të pagëzuar si të tillë nga Parisi. Po në këtë vit, sipas studiuesve, banorët e vendeve të krishtera do të jenë me shumicë myslimane.

Mendimi strategjik francez

Nuk mund të vlerësohet mendimi strategjik i një vendi pa marrë njëkohësisht në konsideratë politikën e tij të jashtme, në dimensionin e dyfishtë të projektit dhe veprimit konkret. Ky mendim është i lidhur ngushtë, veç kësaj, edhe me mënyrën se si kombi projektohet në botë dhe se si strukturohet debati politik në nivel ndërkombëtar.

⁶APEC: Asia-Pacific Economic Cooperation (Bashkëpunimi Ekonomik Aziatiko Paqësor).

⁷Limes, Rivista italiana di geopolitica, *La Francia senza Europa*, f. 18.

Margjinaliteti ose fuqia e mendimit strategjik janë pra ose tregues të marrëdhënies së vendit me pjesën tjetër të botës, ose pasoja e kësaj të fundit. Kësaj i shtohet edhe një faktor tjetër përcaktues: dimensionin ndërkombëtar që është mjaftueshmërisht i njohur në vend për t' i lënë vend një "komuniteti" intelektual nga ku rrjedhin shfaqjet disiplinore, profesionet dhe pozicionet politike, ose këto janë aq të fuqishme sa pengojnë lindjen e një kolektiviteti të tillë. Një mendim strategjik nuk merr kurrë jetë nga një kontekst i izoluar dhe pa një ndërveprim të qëndrueshëm me atë që vërtetohet në ambientin në të cilin janë vendosur ata që i japin jetë.

E keqja ekzistuese në mendimin strategjik francez dhe rreziku në rritje i largimit të tij nga skena ndërkombëtare nuk mund të mos jenë e të shpjegohen veçse në raport me këto tre dimensione:

- ndërgjegjja e rolit ndërkombëtar të vendit;
- organizimi i projekcionit të tij;
- dhe funksionimi i elitave që mund të përcaktohet si një alergji ndaj dimensionit ndërkombëtar.

Vetëm në raport me këto tre aspekte, mund të vërtetojmë ose të hedhim poshtë perëndimin eventual të mendimit strategjik në Francë. Është e vështirë të kuptosh kufizimin e mendimit strategjik francez, nëse kufizohesh vetëm në vëzhgimin e ambientit akademik parizian. Nëse e krahason me atë amerikan ose britanik, prodhimi intelektual francez në fushën e strategjisë duket mjaft i dobët dhe për më tepër, shumë pak i përhapur në nivel ndërkombëtar. Ka shumë barrierë që vendosen midis sistemit editorial amerikan dhe atij francez, sidoqë kjo mund të korrigjohet pjesërisht nëpërmjet një integrimi më të madh në ambientet intelektuale ndërkombëtare, ku francezët mungojnë gjithnjë e më shumë: jo vetëm sepse nuk flasin rrjedhshëm anglisht, por edhe sepse Franca nuk ka asnjë strategji në këtë fushë. Francezët nuk janë aq të aftë as në diskutimet në korridore, edhe në nivel zyrtar (jo pak herë, Franca ka pasur ministra të Jashtëm dhe të Mbrojtjes që nuk kanë qenë në gjendje të diskutojnë në anglisht me kolegët e tyre). Kështu që pjesëmarrja është shpesh në nivel më të ulët në raport me atë të vendeve të tjera.

Të gjitha këto konsiderata çojnë në një imperativ kategorik për Francën: të ndërmerret një ndryshim kulturor i klasës udhëheqëse. Kjo është dhe mbetet pengesa kryesore për krijimin dhe përhapjen e një mendimi strategjik francez. Është e nevojshme të rrëzohen barrierat mes sferës diplomatike, sektorit ushtarak dhe botës ekonomike. Fakti që *Libri i bardhë i mbrojtjes*, (i redaktuar në të njëjtën kohë me një dokument analog të Ministrisë së Jashtëm), ka dalë pa asnjë këshillim, ka bërë që asnjë autor të mos ketë kujdesin më të madh, duke shmangur çdo refleksion të thelluar dhe publik mbi argumentet e trajtuara. Për një vend që ka qëllim akoma të mbështetet te bota, ndërkombëtarizimi i shtetit, universiteteve, ndërmarrjeve dhe mendimit, ky është çelësi i suksesit.

Franca dhe vendet arabe

Edhe pse shenjat ishin të dukshme, Franca nuk ka ditur, ose nuk ka dashur të shohë "Pranverën arabe". Kjo verbëri, pak a shumë e vullnetshme, ka shkaqe të thella. Rrjedh nga një model bashkësie, të adoptuar nga Franca dhe nga shumë vende të tjera perëndimore, 50 vjet më parë, që kishin krijuar një seri zakonesh dhe sigurish, nga të cilat, ishte e vështirë të hiqje dorë.

Përpara se të nxjerrim një bilanc nga "Pranvera arabe", është mirë të rishqyrtojmë modelin

e bashkëpunimit, të ndjekur nga Franca, për më shumë se gjysmë shekulli. Lufta e fundit botërore është shënjuar nga disa konflikte, ato mes gjeneralit të Gol dhe Uinston Çërçillit (Winston Churchill) për kontrollin e zotërimeve franceze në Lindjen e Mesme. Pas humbjes ushtarake të Perandorisë Turke, Franca që kishte luajtur rolin e mbrojtësit të pakicave të krishtera të Lindjes, përfitoi për të ndarë me Britaninë e Madhe, zotërimet turke në Lindjen e Afërme. Në vitin 1928, kjo u formalizua me Paktin e famshëm *Briand-Kellogg*. Kjo ndarje, në dëm të nacionalizmit arab dhe të monarkisë sherifale, përfaqësoi kurorëzimin e një politike të nisur shumë kohë më parë, duke filluar që nga procesi i ngadaltë i rrëzimit të Perandorisë Otomane, nisur nga Napoleon Bonaparti, më 1798, me marrjen e Egjiptit.

Në vitin 1942, anglezët, edhe pse e pritën krahëhapur rezistencën pa kompromis të gjeneralit të Gol, përfituan nga mospajtimi i tij me Çërçillin, për t'i dhënë fund ndikimit të Francës në rajon, të konsideruar nga ata si i një interesi jetësor strategjik. Megjithatë edhe sot, historianët diskutojnë mbi qëllimet reale të anglezëve, është fakt që të Gol, duke parë sjelljen e dykuptimë në Siri, vendos të mbrojë në mënyrë të pathyeshme perandorinë franceze dhe ta rindërtojë atë tërësisht me mbarimin e luftës. Që nga ai moment, politika franceze në Lindjen e Mesme synon të arrijë këtë objektiv. Edhe pse pranoi shumë shpejt pavarësinë e protektoratit të Libanit dhe Sirisë, Parisi kuptoi se kjo zonë përbënte një çelës të rëndësishëm për mbrojtjen e Magrebit. Egjipti i Naserit konsiderohet si model dhe udhërrëfyes i të gjitha lëvizjeve arabe të “rezistencës”, ndërsa Izraeli i ri u shfaq, që në fillim si një aleat ideal.

Ky kombinim solli efekte të rëndësishme: nga aleat taktik, shteti hebraik u bë një partner strategjik (deri në atë pikë sa të vendoste një bashkëpunim të ngushtë për zhvillimin e armëve bërthamore), ndërsa Egjipti i Naserit u bë armiku që do të shkatërrohej. Transporti tregtar i kanalit të Suezit, në vitin 1956, shënon kulmin e kësaj politike. Franca besonte se duke eliminuar Naserin, do të zgjidhte problemin algjerian; Izraeli mendoi se po i jepte fund konfliktit ushtarak me Egjiptin; Britania e Madhe synonte të mbronte interesat e saj ekonomike. Dështimi i ndërhyrjes, për shkak të armiqësive midis SHBA dhe Rusisë, i jep fund pranisë evropiane në Lindjen e Afërme. Që prej atëherë, siç do ta tregojë dhe dështimi i ndërhyrjes në Liban, më 1983, asgjë nuk ka ndryshuar.

Ardhja në pushtet e gjeneralit të Gol, më 1958, nuk i modifikoi fillimisht marrëdhëniet mes Francës dhe Lindjes së Afërme: rëndësia e çështjes algjeriane pengonte çdo lloj rishikimi strategjik thelbësor. Lidhja me Izraelin mbetet shumë e fortë dhe u konkretizua me furnizime shumë të mëdha armatimesh. Pas përfundimit të Luftës së Algjerisë, bëhet edhe më e qartë se gjenerali të Gol synonte të modifikonte marrëdhëniet tashmë të çorientuara me vendet arabe. E bindur se pavarësia e Algjerisë dhe politika e bashkëpunimit që e kishte shoqëruar, paraqisnin një model shembullor, diplomacia franceze kërkoi t'i riparojë marrëdhëniet me botën arabe, por ishte e qartë se vendosja e lidhjeve të reja përbënte një rirënditje për ato të vendosura prej 15 vjetësh me shtetin hebraik.

Lufta rrufë e vitit 1967 i dha të Golit një rast të madh për të ngrirë bashkëpunimin ushtarak me Izraelin. Marrëdhëniet me botën arabe pësuan atëherë një kthesë vendimtare, duke përruruar një tendencë të ndjekur nga Zhorzh Pompidu (Georges Pompidou), nën nxitjen e ministrit të jashtëm filoarab Mishel Zhober (Michel Jobert). Kështu, nën drejtimin e dy presidentëve të parë të Republikës së Pestë, Franca mbështet të drejtat e ligjshme të vendeve arabe, në veçanti të drejtat e palestinezëve, duke filluar një bashkëpunim ekonomik, të bazuar në shkëmbimin e pajisjeve (furnizimeve) energjitike

dhe kontratave të mëdha industriale (në sektorin e armatimeve, të siderurgjisë dhe të infrastrukturave).

Nën udhëheqjen e presidentit Zhiskar d'Esten (Giscard d'Estaing), kjo tendencë përforcohet edhe më tej: lidhjet ekonomike (me Irakun, p.sh.) bëhen më të ngushta, ndërkohë që marrëdhëniet me Izraelin prishen. Franca dënon nismën e njëanshme të Egjiptit pas marrëveshjeve të *Camp David*, më 1978, duke shtuar, kështu, zërin e saj në korin e protestave të botës arabe. Të vetmet ndërhyrje pozitive ishin fillimi i një dialogu politik me Organizatën për Çlirimin e Palestinës (duke e parë atë si një bashkëbisedues të besueshëm në negociatat e ardhshme) dhe marrja e një roli të planit të parë në dialogun konfuz euro-arab, pas krizës së naftës të vitit 1974. Nga ana tjetër, konflikti libanez, i shpërthyer më 1975, e kishte fiksuar aq shumë Francën sa e shtyu atë të merreshe me të, pa llogaritur pasojat politike. Qeveria franceze u tregua e paaftë të ndërmerre të e mbronte më pas një linjë të qartë politike.

Ardhja në pushtet e Fransua Miteranit (François Mitterrand), në vitin 1981, u pa si një ndryshim rrënjësor i politikës së jashtme franceze. Vizita në Izrael dhe negociimi mbi çmimin e gazit me Algjerinë që edhe pse nuk kishte të bënte drejtpërdrejt me Lindjen e Afërme, hyri në një logjikë të re të marrëdhënieve mes veriut dhe jugut dhe të bashkëpunimit me Botën e Tretë. Impakti i tij në botën arabe, në përgjithësi dhe në vendet e Lindjes së Afërme dhe të Mesme, në veçanti, ishte i konsiderueshëm. Por ky veprim, i privuar nga një racionalitet ekonomik, u eklipsua nga kriza e naftës që e shoqëroi. Vizita në Izrael, më 1982, i përgjigjej dëshirës së presidentit të ri për të kapërcyer vështirësitë e mëdha politike dhe psikologjike midis dy vendeve, pas prishjes së vitit 1967. Presidenti i ri mendoi se çështja libaneze do të ofronte mundësinë për të patur një rol të ri në Lindjen e Afërme. Vrasja e ambasadorit francez në Bejrut, Lui Dëlamar (Louis Delamare), më 4 shtator 1981, iu tregoi armiqve të Francës, dobësinë e qëllimeve të saj. Keqësimi i përgjithshëm i situatës, pas operacionit izraelit *Paqja në Galile* (1982) i shtyn aleatët perëndimorë më të vendosur (SHBA, Italinë, Francën) të dërgojnë forca për kundërvënie. Megjithatë, atentatet e shumta të vetëvrasjeve të organizuara nga lëvizjet shiite kundër forcave franceze dhe amerikane (23 tetor 1983) provokuan një tërheqje të bujshme nga Libani që shënoi fundin e përpjekjeve të Francës për të ushtruar ndikimin e saj në Lindjen e Afërme. Parisit do t'i duhej të kuptonte që kapacitetet e tij të veprimit ishin të lidhura ngushtë me vendimet amerikane.

Mbërritja e Zhak Shirakut (Jacques Chirac) në Elize, në maj 1995, ndryshoi vetëm pjesërisht këtë situatë. Presidenti i ri donte të rifitonte hapësirën simbolike, të mbetur bosh pas vitit 1983 dhe lufta kundër Irakut, e vitit 2003, ishte rasti për të treguar që Parisi mundte akoma të bënte që të dëgjohej zëri i tij. Por kundërvënira ballore me SHBA çoi në mënjanimin e Francës deri në mbërritjen e Nikola Sarkozisë (Nicolas Sarkozy). Ky i fundit kërkoi ta joshë Sirinë për ta futur në koncertin e kombeve, duke shpresuar që të nxjerrë prej saj sa më shumë përfitime: fundin e mbështetjes nga guerilasi sunitë irakenë, braktisjen progresive të Hezbollahut, mbijetesën (nëpërmjet modernizimit) të të vetmit shtet arab laik, në kuptimin e ngushtë, përmirësimin e marrëdhënieve dypalëshe me Izraelin dhe prishjen e aleancës strategjike me Iranin. Pjesëmarrja e *Bassar al-Assad* në festën kombëtare të 14 korrikut 2008, përfaqësoi përpjekjen për të rikrijuar një imazh të ri për këtë vend, pas ftohjes së marrëdhënieve pas vrasjes së Rafiq Hariri.

Pas vitit 1983, politika franceze është shtrirë mbi Magrebin dhe Mesdheun Perëndimor. Që në atë kohë shfaqet projekti 5+5, që synonte të lidhte Evropën latine me 5 vendet e

Magrebit, në një nismë të përbashkët që u ndërpre nga Lufta e Gjirit. Që prej vitit 1995, politika jugore (meridionale) e Francës është kanalizuar në politikën mesdhetare të BE-së. Kjo përbënte një revolucion kulturor për një vend që e konsideronte rajonin si një sferë ekskluzive të ndikimit. Në të vërtetë, dështimet e viteve tetëdhjetë i bënë qeveritarët francezë të kuptojnë se ishin të nevojshme nisma politike të ndryshme. Njohja e këtij rajoni që Franca zotëronte dhe lidhjet e saj të forta historike janë forca e saj e madhe, por edhe dobësia kryesore kur bëhet fjalë për të vepruar politikisht. Shtrirja e detyruar mbi Magreb e shtyu Parisin të zhvillojë një strategji për këtë rajon, por instrumenti i saj original-Bashkimi i Magrebit arab-u fundos shumë shpejt; të njëjtin fat pati edhe projekti 5+5, i sabotuar nga dënimi ndërkombëtar i Libisë dhe lufta në Kuvajt (1991); pas kësaj shpërthimi i luftës në Irak (2003).

Nisma franceze në Magreb ka njohur dy kufizime të mëdha:

- pamundësinë për të patur një strategji të përgjithshme, për shkak të marrëdhënieve shumë sipërfaqësore midis vendeve të rajonit;
- dhe heqjen dorë nga mbrojtja e të drejtave të njeriut.

Me kalimin e kohës, Parisi ka hyrë në konflikt me secilin prej vendeve të Magrebit, për shkak të mungesës së respektimit të të drejtave të tilla (Tunizia, Algjeria). Në vitet e fundit të presidencës së Shirakut dhe Sarkozisë, marrëdhëniet dypalëshe midis Francës dhe Magrebit janë pozicionuar në çështjen e njohjes nga ana franceze e krimeve të kryera gjatë kolonializmit, e kërkuar kjo me forcë nga Algjeria.

Gjatë presidencës së Sarkozisë, marrëdhëniet ekonomike dhe bashkëpunimi në fushën e antiterrorizmit, u përmirësuan, por menaxhimi i keq i *Unionit për Mesdheun* ka penguar hapa të tjerë përpara. Pas 11 shtatorit 2001, marrëdhëniet me Magrebin kanë marrë një vlerë të re. Marrëdhëniet midis Francës dhe vendeve arabe janë shënjuar më tepër nga marrëdhëniet midis liderëve, që kanë luajtur një rol shumë të rëndësishëm në marrëdhëniet e Zhiskar d'Esten (Giscard d'Estaing) me Hasanin II, të Miteranit (Mitterrand) me Çadli Benxhedid (Chadli Bendjedid), të Shirakut me Hasanin II, Sadam Hyseinin (Sadam Hussein) dhe Mubarakun (Mubarak). Nikola Sarkozy do të luante deri në fund kartën e marrëdhënieve personale, sidomos në Magreb.

Gjatë revolucionit tunizian, Franca u mbyll në një heshtje të shurdhët, për të cilën do të paguajë për një kohë të gjatë pasojat. Kjo vinte, para së gjithash nga epërsia e lidhjeve të çdo lloji që elitat tuniziane kishin vendosur me autoritetet franceze. Marrëdhëniet me secilin vend duhet të rindërtohen duke vendosur, para së gjithash, një dialog, deri më sot të pafilluar asnjëherë me udhëheqësit e rinj politikë. Parisi duhet të adresojë një politikë të dyfishtë, në drejtpeshim midis kërimit të një dinamike të re shumëpalëshe dhe nevojës së ndërtimit të marrëdhënieve dypalëshe me shtetet e veçanta. Ka të ngjarë që modelit tradicional i ka kaluar koha dhe një version modern i dialogut euro-arab do të jetë tashmë kuadri i nevojshëm ku duhet të hyjnë këto marrëdhënie të reja. Në paragrafin 58 të programit të Fransua Holand thuhet: “Do të zhvilloj marrëdhënie midis Francës dhe vendeve të bregut të jugut të Mesdheut mbi bazën e një projekti ekonomik, demokratik dhe kulturor.”⁸ Nga këto fjalë nuk mund të rrjedhë kurrë një politikë.

Sigurisht, transformimi i tanishëm i botës arabe i ka përzierë kartat. Franca duhet të rifillojë një dialog me udhëheqësit e rinj islamikë. Pasiguria do të jetë një faktor tjetër i

⁸ Limes, Rivista Italiana di Geopolitica, *La Francia senza Europa*, 3/2012, faqe 261.

rëndësishëm: e ardhmja e Libisë dhe e Sirisë është e paparashikueshme⁹ dhe ajo e vendeve me struktura të fuqishme administrative dhe shoqërore si Tunizia, Egjipti ose Maroku është ndoshta edhe më e pasigurt. Vetëm dy janë elementët që do të mbeten me siguri dhe që do ta dallojnë botën arabe për një kohë të pacaktuar në këtë kuadër: islamizmi politik dhe nacionalizmi¹⁰. Mbi këto dy konstante duhet ta ndërtojë politikën e saj Franca. Elita franceze ka zgjedhur të privilegjojë interesat personale, në dëm të interesit të përgjithshëm. Kjo zgjedhje është përkthyer me mungesën e një strategjie në rajonin e Gjirit dhe në botën arabe si dhe me mosinteresimin për rolin e saj në Lindjen e Mesme, rajon shumë i rëndësishëm për fuqitë e mëdha botërore, si në planin gjeostrategjik edhe në atë ekonomik.

Perspektiva e zhvillimit

Në analizën e politikës së jashtme franceze, Frederik Bozo¹¹ citon gjeneralin të Gol: “Për arsye se nuk jemi një fuqi e madhe, kemi nevojë për një politikë të madhe, sepse nëse nuk kemi një politikë të madhe, nga momenti që nuk jemi më një fuqi e madhe, nuk do të jemi më asgjë.”¹² Ky formulim përmbledh problematikën qendrore të politikës së jashtme të Egzagonit që prej gjysmë shekulli: “të pajtosh aspiratën për një rol të madh ndërkombëtar me masën reale të mjeteve.”¹³

Në vitin 2025, Parisi ndoshta do të pyesë: cili do të jetë vendi dhe ndikimi i Francës në botë? Situata ndërkombëtare mund të ndryshojë ndjeshëm në 11 vitet që na ndajnë nga kjo datë; mjafton të kthehesh pas në vitin 2000 për të konstatuar deri në ç’ pikë ka ndryshuar bota. Aktorët dhe raportet e forcës kanë pësuar një zhvillim të dukshëm: një seri atentatesh kanë goditur perëndimin dhe kanë shpërthyer një seri ndërhyrjesh të armatosura, një krizë financiare ka bërë që të tronditet sistemi kapitalist dhe kriza ekonomike që e ka ndjekur, ka vënë në diskutim dhjetëvjeçarë të integritimit evropian. “*Pranvera arabe*” është ndoshta shembulli më i dukshëm i paparashikueshmërisë së botës.

Pavarësisht këtyre ndryshimeve, Franca vazhdon të ketë një rol thelbësor në institucionet shumëpalëshe. Duke qenë një fuqi e mesme, është në interesin e saj të promovojë një formë të rregullimit të problemeve ndërkombëtare, gjë që do t’i lejojë të shfrytëzojë pozicionin e saj si ndërmjetëse: shumë e dobët për të peshuar e vetme, shumë e fortë për t’u lënë mënjane. Gjithsesi, në vitin 2025, Franca do të përfaqësojë më pak se 1% të popullsisë së botës, nga momenti kur 35% e 8 miliard banorëve të Tokës do të jetojnë në Azi dhe rritja ekonomike e këtij rajoni, e furnizuar nga India dhe Kina, do të përbëjë boshtin e krijimit të pasurisë së planetit. Përballja me ekonominë braziliane, kthimi i Ruisë, rëndësia në rritje e Turqisë dhe e Afrikës së Jugut do ta bëjnë gjithnjë e më të paqëndrueshëm kuadrin shumëkombësh, të trashëguar nga Lufta e Dytë Botërore. Ky zhvillim do të përbëjë një dilemë të fortë për Parisin. Është e qartë që Franca ka gjithë interesin të ruajë statusin e anëtarit të përhershëm; por edhe bllokimi i çdo reforme do të

⁹ Ibid, faqe 262.

¹⁰ Ibid.

¹¹ Frédéric Bozo është profesor në Universitetin e Parisit III, Sorbona e Re. ku jep mësim historinë bashkëkohore dhe marrëdhënie ndërkombëtare. Ai është gjithashtu Kërkues i Lartë i Asociuar në Institutin francez të marrëdhënieve ndërkombëtare (IFRI-Institut Français des Relations Internationales) në të cilin merret me çështjet e sigurisë atlantike dhe evropiane.

¹² Frédéric Bozo, *La politique étrangère de la France depuis 1945*, Paris 2012, Flammarion.

¹³ Frédéric Bozo, Ibid.

jetë dyfish jo prodhimtar. Nga ana tjetër, roli në rritje i G20 konfiguror një orientim të mundshëm për të ardhmen e drejtimit të botës. Bashkimi Evropian i ofron një mundësi Parisit të ruajë statusin e fuqisë rajonale, por përbën edhe një instrument për t'u ngritur në rang fuqie botërore.

Në mbrojtje të interesave të saj, Franca luan në shumë tavolina: më herët ka rihyrë në komandën e integruar të NATO-s, më pas ka negociuar një aleancë ushtarake me Mbretërinë e Bashkuar dhe do të vazhdojë të kërkojë krijimin e një shtabi të përgjithshëm civil dhe ushtarak në Bruksel (së bashku me Spanjën, Italinë, Gjermaninë dhe Poloninë). Emëruesi i përbashkët i këtyre orientimeve është se Franca nuk mund të veprojë më vetëm. Përtej arsenalit të saj ushtarak, Franca do të ketë nevojë të modernizojë diplomacinë e saj për të përballuar sfidat e garës kulturore të shekullit XXI. Falë rritjes demografike të Afrikës, në vitin 2025 do të jenë rreth 400 milion individët e gjuhës franceze, baras me 1/20 e popullsisë botërore. Por vetëm gjuha nuk mjafton: është e nevojshme që Franca të vërë në lëvizje një mesazh, ide dhe vlera. Nga ana tjetër, sot një tekst kinez mund të përkthehet në frëngjisht (dhe anasjelltas), përafërsisht në disa sekonda nga një program informatik. Reforma më e fundit e diplomacisë kulturore në Francë dhe krijimi i *Institutit Francez* pohon vullnetin për të vendosur një rrjetë transversale të promovimit të kulturës franceze në botë.

Parisi duhet të vendosë marrëdhënie të reja dypalëshe me shoqëritë civile, përveçse me autoritetet politike të vendeve arabe. Do të jetë në interesin e tij të riformulojë strategjinë e bashkëpunimit kulturor, akademik, gjuhësor dhe shkencor me shtetet e Magrebit, të Lindjes së Afërme dhe të Afrikës subsahariane, për të shmangur përsëritjen e gabimeve të mëparshme. Ndikimi i Francës në botën e vitit 2025 do të njohë një garë të qëndrueshme nga ana e fuqive të reja që po lindin. Dinamikat gjeopolitike ndërkombëtare nuk do të jenë të favorshme për Francën. Mjetet e saj të ndikimit do të jenë gjithnjë e më pak në gjendje të realizojnë aspiratat e saj për të luajtur një rol të madh ndërkombëtar. Por Franca ka akoma burimet e nevojshme për të ruajtur një ndikim të pakapërcyeshëm në botën e së nesërme. Kërcënimi më i madh për Parisin qëndron në tundimin për t'u mbledhur në vetvete dhe për të mohuar realitetin e ndryshimit.

Drejtimit kryesore të partneritetit në BpM

Jam e mendimit se partneriteti i vendeve anëtare të *Bashkimit për Mesdheun (BpM)*, duhet të synojë në këto drejtime kryesore, sipas tre fushave dhe konkretisht në:

Politikë dhe siguri:

- Demokratizim të vendeve mesdhetare të treta¹⁴.
- Zhvillim të të drejtave të njeriut¹⁵.
- Forcim të bashkëpunimit në fushën e sigurisë.
- Forcim të luftës kundër terrorizmit.
- Forcim të kontrollit të emigracionit¹⁶.

Ekonomi:

- Kapërcim të dobësive në integrimin ekonomik në Mesdhe.

¹⁴ I pakonkretizuar ende.

¹⁵ I pamjaftueshëm, gati simbolik,

¹⁶ E vetmja përmasë pozitive.

- Ndërvarësi por jo solidaritet.
- Rezultate të kënaqshme për BE-në.
- Kryerje të investimeve në vendet e treta mesdhetare¹⁷.
- Konsumim të ndihmës financiare nga ana e vendeve të treta mesdhetare.

Veprimtari shoqërore dhe kulturore¹⁸:

- Promovim i bashkëpunimit kulturor midis popujve të Mesdheut¹⁹.
- Largim nga thëniet “*a priori*” dhe paragjykimet reciproke midis veriut dhe jugut.
- Promovim i bashkëpunimit arsimor midis popujve të Mesdheut²⁰.
- Integrim rajonal, përsa i përket qarkullimit të lirë të njerëzve.

Përfundime

Perspektiva të marrëdhënieve ndërkombëtare në zonën EURO-MED

Në planin teorik, partneriteti gjeopolitik mbetet një ndërtesë e bukur ideologjike. Çfarë i mungon kësaj ndërtese që ajo të bëhet realitet? Në mënyrë që ky bashkim të funksionojë duhen mobilizuar disa faktorë që janë të natyrave të ndryshme: politikë në fillim, ekonomikë më pas dhe gjithashtu (e veçanërisht) psikologjikë.

Faktorët politikë:

- Veprime diplomatike drejt paqes në rajon dhe rregullimit të drejtë të konflikteve.
- Nxitje dhe shpërblim për masat e marra nga shtetet për uljen e shpenzimeve që lidhen me armatimin.
- Rishikim i nocionit të sovranitetit kombëtar dhe përshtatje e tij me kontekstin, duke shprehur dhe refuzimin për nënshtrim ndaj ndonjë dominimi.
- Hartim i një programi të përbashkët paraprak për demokratizimin e shoqërive mesdhetare dhe forcimin e shoqërive civile.
- Organizimi i debateve të gjera mbi efektet pozitive të pritura nga demokratizimi i vendeve të rajonit.
- Shmangia e imponimit të një modeli *tip* demokracie.
- Mbajtja parasysh e veçantive të çdo vendi, duke favorizuar procesin demokratik natyral e duke përcaktuar një “minimum demokratik” për t’u respektuar.
- Nxitja e modelit të demokratizimit *Bottom-up*, duke angazhuar më shumë shoqërinë civile, shoqatat, të rinjtë në jetën politike, shoqërore dhe ekonomike edhe në vendimet që kanë të bëjnë me integrimin rajonal.
- Sigurimi i demokratizimit brenda procesit të Euro-Med, duke ofruar një vizibilitet më të mirë të përmbajtjes së proceseve në këtë kuadër, nëpërmjet një plani informacioni dhe komunikimi efikas, kundrejt shoqërive civile dhe të rinjve të vendeve të treta mesdhetare.

¹⁷ Mungesë rezultati në vëllimin e eksporteve të Jugut drejt Veriut (me përjashtim të hidrokarbureve).

¹⁸ Këto mund të konsiderohen si arritjet e vetme.

¹⁹ Krijimi i Fondacionit *Anne Lindt* në Aleksandri si dhe organizimi i një kongresi mbi “Dialogun Jug-Veri të Mesdheut”, në mars 2006, në Algjer.

²⁰ Krijimi i universitetit Euro-mesdhetar EMUNI (European Mediterranean UNiversity).

- Ndërtimi i një politike realisht nismëtare për realizimin e projekteve dhe vendosjen e besimit, duke i dhënë një sens konkret “begatisë së përbashkët” dhe “integritetit solidar”.
- Të moskënaqurit duke u mbështetur në organet e Euro-Med, por ngritje të institucioneve të ngarkuara posaçërisht me integrimin politik, ekonomik dhe kulturor euromesdhetar, selitë e të cilave të jenë si në jug edhe në veri.
- Sigurimi i një harmonizimi legjislativ dhe bërja kujdes në zbatimin e traktateve dhe konventave të ratifikuara.

Faktorët ekonomikë:

- Transformimi i strukturave të ekonomive të vendeve të treta mesdhetare dhe homogenizim me ndërtimin e së tërës.
- Vënia në dispozicion të kohës së duhur për të bërë ndryshimet.
- Moshuazim i metodologjisë së qëndrueshme dhe efikase të zbatuar për futjen e vendeve të treta mesdhetare në BE (periudhë përgatitore, periudhë tranzitore).
- Mosnxitim për zbatimin e sistemit doganor, para adoptimit të mekanizmave mbrojtës të ekonomive vulnerable të jugut.
- Ofrimi i garancive të veçanta ekonomive në zhvillim, me qëllim realizimin konkret të qëllimit të procesit që është integrimi i tyre në një ansambël solidar dhe jo në një varësi.
- Nxitja e integritit nënrajonal (jug-jug) për përforcimin e pozitës ekonomike të jugut, në raport me BE-në dhe pjesën tjetër të botës.
- Perceptimi i një partneriteti “fitues-fitues” për çdo projekt.
- Dhënia e ndihmës konkrete në hapjen e tregjeve të jugut, duke siguruar ekuilibrin e shkëmbimeve tregtare dhe mënjanimin e pengesave për produktet e jugut në tregun evropian (konkretisht bujqësor).
- Ndërtimi i politikave ekonomike të vetë Euro-Med dhe moshuazimi nga BE i politikave të tij të përbashkëta që zbatohen gjithmonë në përfitim të BE-së si:
 - a) politika Euro-Med për qarkullimin e lirë të mallrave dhe të njerëzve,
 - b) politika Euro-Med e arsimimit, formimit profesional dhe zhvillimit të burimeve njerëzore,
 - c) politika financiare dhe krijimi i një banke investimi Euro-Med...

Faktorët psikologjikë:

- Minimizimi i grindjeve që rezultojnë nga konfliktet e shkuara (kolonializmi, luftërat), duke menaxhuar të gjitha “komplekset” që pengojnë të projektohet së bashku e ardhmja.
- Vendosja e një fjalori të lirshëm, një besimi rreth një ideali të përbashkët dhe shprehja hapur e vullnetit për t’u bashkuar e për të formuar një ansambël të ekuilibruar.
- Hartimi i një politikë Euro-Med kulturore dhe sportive (festivale muzike dhe kinema, liga sportive, etj.), duke synuar shkëmbimet midis të rinjve dhe një njohje më të mirë midis partnerësh, gjë që bën të nevojshëm përmirësimin konkret të kushteve të qarkullimit të qytetarëve euromesdhetarë në të gjithë zonën.

- Shmangia e sundimit të një kulture të vetme, duke iu imponuar gjithë rajonit dhe respektimi i diversitetit kulturor të rajonit që duhet të jetë një pasuri, një aset dhe një katalizator për integrimin solidar.
- Ngritja e organeve të informacionit dhe komunikimit për *Euro-Med*-in, ose të paktën dhënia e një mbështetjeje financiare për mediat që marrin pjesë në promovimin e kulturës Euro-Med.

Bibliografia

- Aymeric Chauprade, *Géopolitique Constantes et changements dans l'histoire*, chapitre 3, Equilibrer les Empires: Leçon de Géopolitique française.
- Bichara Khader, *L'Europe pour la Méditerranée, De Barcelone à Barcelone (1995-2008)*.
- George Friedman, "*Qendra Stratfor*", SHBA.
- Paul Claval, *Hérodote and the French Left*.
- Karlo Jean, *Gjeopolitika, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë më 1998*.
- Margaret Macmillian, *Paris 1919, Gjashtë muaj që ndryshuan botën*.
- Giuseppe Mammarella, *Storia d'Europa dal 1945 a oggi*.
- Giulio Caprin, *Manuali di Politica Internazionale, La Grande Guerra, 1914-1918, Sommario storico*.
- Montesquieu, *L'Esprit des Lois*, 1750.
- Joseph de Maistre, *Les soirées de Saint-Petersbourg*. 1807 in Du Pape, *Les Soirées de Saint Petersbourg et autres textes*, Paris, J.J. Pauvert éditeur, 1957.
- Charles Maurras, *Kiel et Tanger*, Préface de la deuxième édition.
- Jacques Bainville, *La troisième République, 1870-1935*.
- Peyrefitte, *C'était de Gaulle*, Paris 1994, Fayard.
- Limes, *Rivista italiana di geopolitica, La Francia senza Europa*.
- Ph. Moreau Defarges, *Introduction à la géopolitique*, Paris 2009, Seuil (botimi i parë 1994).
- Fernand Braudel, *Grammaire des civilisations*.
- Fernand Braudel, "Histoire et Sciences sociales; la longue durée", *Annales ESG*, n.4, tetor dhjetor 1958.
- Frédéric Bozo, *La politique étrangère de la France depuis 1945*, Paris 2012, Flammarion.
- Philippe Roger, *L'ennemi américain: généalogie de l'antiaméricanisme français*, Paris 2002.
- Roger Cohen, *United States as the Anti-France*, *International Herald Tribune*, 31/1/2007.
- Pew Global Attitudes: Project-International public opinion polls (Projekt sondazhesh të opinionit publik ndërkombëtar). "U.S. Favorability Ratings Remain Positive", Pew Research center, 13/7/2011.
- Michael Ignatieff, *The Transatlantic Culture of Freedom*, in *Talking Trans-Atlantic*.

Mendimi gjeopolitik në vendet gjermanishtfolëse

MSc. Lah Nitaj
Prishtinë

Trajtesë e shkurtuar. Në këtë artikull do të shtjellohet gjeopolitika gjermane me përfaqësuesit më të spikatur si Karl Haushofer¹, etj. Do të vijohet me keqpërdorimin nga nacionalsocialistët që e ushtronin këtë term në një formë të vjetëruar të saj ku zgjerimet hapësinore ose territoriale i shërbenin hegjemonisë ekonomike, ndërsa unifikimet e brendshme arriheshin duke eliminuar “armiqtë e popullit” si edhe duke ushtruar legjitimitetin ideologjik mbi konceptet biopolitike të “hapësirës jetike” dhe “racës zotëruese”.

Ndonëse mendimet gjeopolitike vazhdonin të dominonin praktikën e politikës së jashtme, termi “gjeopolitikë”, pas Luftës së Dytë Botërore shikohej në Evropë si një koncept i bazuar në ideologji fashiste. Transformimet e thella politike, ekonomike dhe të sistemit në veprim në skenarin ndërkombëtar i kanë “detyruar” studiuesit dhe opinionin publik t’i drejtohen tashmë gjeopolitikës “së rilindur” nga këto transformime, për të “menduar” për botën dhe për të qartësuar opsionet e mundshme në dispozicion të çdo aktori gjeopolitik. Gjeopolitika në vendet gjermanishtfolëse ecën në këtë trend.

Hyrje

Friedrich Ratzel² (1844–1904) ishte një gjeografi i madh gjerman dhe ai konsiderohet si themeluesi i gjeografisë moderne njerëzore dhe politike. Sipas tij, zhvillimi njerëzor është i kushtëzuar pikësepari nga mjedisi natyror: “Një popull duhet të jetojë në tokën që i ka rënë për pjesë, aty duhet të vdesë e të ndjekë ligjet... Shteti është një organizëm, jo vetëm sepse organizon jetën e popullsisë mbi terrene të pandryshueshme, por edhe sepse kjo lidhje përforcohet në mënyrë reciproke, deri në atë pikë sa ata formojnë një të tërë e nuk mund të mendohet më për njërin pa tjetrin... Shteti pëson të njëjtat ndikime si çdo jetë njerëzore... Është në natyrën e shteteve që ata të zhvillohen në konkurrencë me shtete fqinjë e, në pjesën më të madhe të rasteve, ajo që është në lojë përfaqësohet nga territoret.” Sipas Ratzel-it, pozicioni qendror i

¹ Karl Ernst Haushofer (27 gusht 1869-10 mars 1946) ishte gjeneral gjerman, gjeograf dhe gjeopolitikan. Nëpërmjet studentit të tij Rudolf Hess, idetë e Haushoferit mund të kenë ndikuar zhvillimin e strategjive të ekspansionit të Adolf Hitlerit, megjithëse Haushofer ka mohuar çdo lloj ndikimi të drejtpërdrejtë mbi regjimin nazist.

² Gearóid Ó Tuathail: Geopolitik-zur Entstehungsgeschichte einer Disziplin; in: Geopolitik-Zur Ideologiekritik politischer Raumkonzepte; Kritische Geographie; Band 14; Promedia; Wien 2001; S. 11.

Gjermanisë mbarte me vete një sërë rreziqesh.³ Shtete me hapësira të mëdha territoriale dhe me koloni, sipas *Ratzel*-it, ishin shtete të cilat kishin të ardhme. Pra, shtete me një popullsi në rritje kishin nevojë për hapësira të tjera jetike. *Ratzel* përkrahte kolonializimin gjerman të Afrikës, ndërtimin e një flote të madhe sipas standardeve ndërkombëtare dhe një Evropë Qendrore gjermane.⁴ Teoria e *Ratzel*-it u bë baza e zhvillimeve të mëvonshme të gjeopolitikës gjermane. Kështu, në momentin më kulmor, në atë të përcaktimit të armikut parësor të Gjermanisë, midis Anglisë dhe Rusisë, *Ratzel*-i, siç bëri më vonë edhe Hitleri, përcaktoi Rusinë.

Ky përcaktim i tij ishte krejt ndryshe nga përcaktimet e bëra nga shkolla gjeopolitike e Mynihut që si armik të Gjermanisë përcaktonin fuqinë “plutoratike” anglosaksone.⁵ Për herë të parë, fjalën gjeopolitike e përdori gjeografi suedez *Rudolf Kjellen*⁶ i ndikuar nga vepra e *Ratzel*-it, por mund të themi se ky autor, së bashku me *Haushofer* i dhanë jetë studimeve të vërteta gjeopolitike. Edhe pse një suedez përdori këtë fjalë, për herë të parë, Gjermania mbetet ‘djepi’ në të cilin u rrit gjeopolitika, por jo ajo naziste sepse kjo shkencë u formua të paktën një 10-vjeçar para se Hitleri të vinte në pushtet. Për të qenë më i saktë, konteksti në të cilin lindi gjeopolitika ishte ai pas Luftës së Parë Botërore, pra me humbjen e Gjermanisë në këtë luftë.

Pikërisht në atë kohë, opinioni publik gjerman filloi t’i bënte disa pyetje vetes të tilla si: A duhet të pranojmë klauzolat e koalicionit fitues të luftës?; Cilat janë territoret që duhet të lëshojmë dhe cilat janë ato që duhet t’i ruajmë me çdo kusht?; Me këtë argument do të arrijmë të mbajmë sovranitetin tonë në Prusinë lindore? Deri në atë moment, kurrë më parë nuk kishte ndodhur që për shtetin të kërkohej mendimin e popullsisë për çështje me një rëndësi të tillë siç ishte territori. Argumentet për të cilat popullsia pyetej kishin të bënin me moralin publik, me kishën ose me të drejtën e votës së gruas. Në këtë debat luajtën një rol shumë të rëndësishëm profesorët e gjeografisë dhe të historisë. Ja pra, se si dhe pse lindi si disiplinë e re gjeopolitika. Nga bazat e ideve të *Kjellen* lindën dy shkolla idesh të reja: e para, ajo që ndoqi besnikërisht rrugën e studiuesit suedez, e zhvilluar në veprën e *Hennig* dhe e dyta ajo që mbledhi një numër të madh studiuesish përreth revistës “*Zeitschrift für Geopolitik*” (krijuar më 1924 dhe publikuar, me disa ndërprerje, deri më 1968) drejtuar nga *Karl Haushofer*. “Gjeopolitika trajton shtetin si një qenie njerëzore, si një organizëm që evoluon dhe që ndikohet vendosmërisht nga faktorët gjeografikë, nga historia politike dhe tendencat e saj” (*Hennig*, 1931). Gjeopolitika rikonfirmon karakterin e saj si shkencë dinamike, ndërsa gjeografia politike, duke studiuar shtetin në të tashmen e në të shkuarën, propozohet si shkencë statike.

³ Michael Fahlbusch: Grundlegung; Kontext und Erfolg der Geo-und Ethnopolitik vor 1933; in: Irene Diekmann, Peter Krüger und Julius H.Schoeps (Hrsg.): Geopolitik – Grenzgänge im Zeitgeist; 2000; S. 106-108.

⁴ Gearóid Ó Tuathail: Geopolitik-zur Entstehungsgeschichte einer Disziplin; in: Geopolitik-Zur Ideologiekritik politischer Raumkonzepte; Kritische Geographie; Band 14; Promedia; Wien 2001; S. 18.

⁵ Henry Kissinger, “Diplomacia” .

⁶ Nuk ishte një fjale e re, por siç kanë pohuar më vonë Ernesto Massi e GiorgioRoletto⁷, themelues të gjeopolitikës italiane, bëhej fjalë për një doktrinë të re, e cila nuk kishte si qëllim të zëvendësonte gjeografinë politike, por synonte të “shtrinte hetimin e saj në fusha që lidhin ngjarjet politike në vend dhe të tregojë vijat e jetës politike të shteteve, të nxjerra nga studime gjeografike dhe historike të ngjarjeve politike, programet sociale dhe ekonomike dhe lidhjen mes tyre”. (Roletto Giorgio, Massi Ernesto, “Per una geopolitica italiana”, in *Geopolitica*, I, 1939 , f. 5-11.)

Haushofer-personaliteti më i fuqishëm gjeopolitikan gjerman

Ndryshe nga *Hennig*, shkolla e *Haushofer*-it e zgjeron fushën e kërkimit të kësaj disipline, duke u nisur nga supozimi që në studimin e shtetit, si një qenie jetësore apo organizëm, janë përfshirë të gjitha shkencat që merren me njeriun dhe me veprimtarinë e tij. Dhe përse i përket gjeopolitikës në Gjermani, autori më i afirmuar është Haushofer (1869-1946), idetë e të cilit frymëzuan regjimin nazist. Ai shtoi proceset politike në përcaktimin e gjeopolitikës⁷ duke theksuar se gjeopolitika është shkenca e re kombëtare e shtetit, një doktrinë për determinizëm hapësinor i të gjitha proceseve politike. Gjenerali Haushofer ishte mbështetës i idesë që Gjermania duhej të bënte aleancë me Rusinë dhe Japoninë që të mposhtnin Britaninë e Madhe, që kërkonte mposhtjen e monopolit detar e kolonial të fuqive anglo-sanksonë. Teoria e sundimit kontinental, pra e epërsisë së tokës mbi detin, ishte e përfaqësuar nga vetë *Haushofer*-i. Sipas tij, ky ndryshim do të vinte vetëm pas një aleance ruso-gjermane e cila do të gjunjëzonte sundimin anglez mbi detërat. Ishte politika tradicionale e Bismarkut që udhëhoqi Haushoferin në idenë e politikës për aleancën ruso-gjermane.

Evropa Qendrore dhe Lindore kishte një rëndësi të veçantë në vitet 1919 në punimet e *Makinder*-it, ide të cilat i mbështeti Haushofer, por, në një këndvështrim tjetër. *Makinder*-i donte një Evropë Qendrore dhe Lindore të pavarur, me qëllim që të përbënte një ndarje midis Gjermanisë dhe Rusisë. Ndërsa *Haushofer*-i mendonte krejt të kundërtën pasi ishte për një aleancë ruso-gjermane, duke i caktuar Gjermanisë kontrollin e Evropës Qendrore si dhe kontrollin e të gjithë atyre zonave të banuara nga popullsia gjermane.

Në zhvillimin e studimeve të tij, *Haushofer*⁸ nuk i kushton vëmendje vetëm faktorëve gjeografikë (të konsideruar si faktorë fizikë), por edhe faktorëve të tjerë, siç janë: struktura etnike, lëvizjet e emigracionit, klasat sociale, densiteti i popullsisë, ekonomia private, tregtia dhe komunikimi ndërkombëtar që bashkëveprojnë në këtë zhvillim. Me fjalë të tjera, gjeopolitika studion jetën e shtetit në dy aspekte: e lidhur me ambientet gjeografike dhe me atë se sa ndikohet ajo nga kjo gjë, pra një lloj “*arti qeverisje që trajton studimin e tokës*”. Gjeopolitika i duket *Haushofer*-it si një disiplinë e zbatueshme, si art që burrat e shtetit nuk duhet ta injorojnë nëse nuk duan t’i japin politikës së tyre zhvillimin dhe orientimin e gabuar. Sipas tij, shtetet do të jenë gjithnjë në ndryshim dhe këtu flitet për kufijtë të cilët janë të lëvizshëm, në bazë të kërkesave të popujve. Kufijtë, sipas tij, duhen parë të përkohshëm, provizorë. Gjermania, për të qenë një fuqi e madhe në qendër të Evropës, ka si kusht paraprak fitimin e hapësirave të reja. Këtu kuptojmë arsyen se përse kufijtë nuk mund të qëndrojnë të pandryshueshëm. Ky është një fakt i pashmangshëm për qëndrueshmërinë, zhvillimin ekonomik dhe mbijetesën e gjermanëve.

Shteti, për *Haushofer*, jeton me dëshirën për të parë territoret e tij të zgjeruara. Vetëm shtetet e dobëta janë në favor të mosndryshimit të territoreve, duke kërkuar moslëvizjen e kufijve me qëllim mbajtjen e kufijve të tyre të qëndrueshëm. Sipas autorit, mungesa e një vizioni gjeopolitik mund të jetë shpjegimi i humbjes së Gjermanisë në Luftën e Parë Botërore. Ai pohon si shumë të rëndësishme nënshkrimin e aleancave nga Gjermania, në mënyrë që të mos luftojë në të dy krahët dhe të sigurojë kështu fitoren. Në kërkimin

⁷ Cohen, Sauli, Bernard. “*Gjeopolitika e Sistemit Botëror*”, Rowman dhe Littlefield, 2003.

⁸ Hilger H. Heröig Haushofer, Hitler dhe Lebensraum, cituar nga: Geoffrey Sloan, Sir Halford Mackinder: The Heartland Theory The History of Ideas, Geopolitics-Geography and Strategy. Editors: Colin S.Gray and Geoffrey Sloan, Franc Cass Publisher, London, 1999, f. 218-238.

e “*spazio vitale*” apo *Lebensraum*, pra, hapësirës jetësore të saj, Gjermania duhet të mbështetet te shtetet miq, njëri prej të cilëve është Japonia, fuqia më e madhe aziatike, e cila është në gjendje të ndalojë dhe britanikët, si dhe Rusia sovjetike që realiteti gjeopolitik e tregon si *heartland*-in e tezës së *Mackinder*-it.

Haushofer nuk ka si synim luftën, por dëshiron të shohë në skenën botërore një numër të caktuar shtetesh me rëndësi ndërkombëtare, ku secili mund të kontrollojë nga një zonë influente. Renditja ndërkombëtare duhet ndërtuar nëpërmjet zonave të ekspansionit, të ashtuquajtura *pan-rajone*, ndarja e së cilave do t’i përshtatej pikërisht meridianeve. Në konceptin e tij të hapësirave botërore, *Haushofer* përcakton katër zona të mëdha: *Pan-rajoni* amerikan, i dominuar nga Shtetet e Bashkuara; *pan-rajoni* evropian, i dominuar nga Gjermania; *pan-rajoni* i Azisë Qendrore dhe e subkontinentit indian, i dominuar nga Bashkimi Sovjetik; *pan-rajoni* i Azisë-Paqësorit, i dominuar nga Japonia.⁹

Ndër të tjera, autori shton se Bashkimi Sovjetik duhej akoma të konsolidonte rolin e tij si një fuqi e madhe. Në rast falimentimi në këtë proces, *pan-rajoni* i Azisë Qendrore dhe e subkontinentit indian do të ndahej midis Gjermanisë dhe Japonisë. Kështu, më 1931, shkolla gjeopolitike-falë dhe personalitetit të *Haushofer*-hyri përfundimisht në sferën nacional-socialiste dhe pas ardhjes së Hitlerit në pushtet, më 1933, u shndërrua në një propagandë të regjimit që kërkonte justifikime për veprimtarinë e tij në lidhje me “*spazio vitale*” dhe racat, njëkohësisht. Nga përdorimi që iu bë teorive të *Haushofer*-it, u vërtetua një manipulim i rëndë. Edhe vetë autori, më 1931, njoftonte për rrezikshmërinë që zhvillimi i disa tendencave nacionale ekspansive do t’i hiqte gjeopolitikës neutralitetin si disiplinë shkencore. “Ndërsa për gjeopolitikën ka rëndësi optimimi i bashkëpunimit midis pjesëve të hapësirës brenda një “hapësire jetike” të përbashkët, në dobi të të gjithë njerëzve të kësaj hapësire të madhe, tek Hitleri ishte në plan të parë ideja e shfrytëzimit dhe sundimit të Evropës Lindore, në favor të një race gjoja zotërinjsh. Në këtë mënyrë, ai e ktheu në të kundërtën e vet domethënien e bllokut kontinental”.¹⁰ Megjithatë, përse i përket shfrytëzimit dhe sundimit tek udhëheqja naziste, duket se s’ka pohime të qëndrueshme. *Himmler*-i shkruan: “*Ne nuk duam që të jemi shtresë e zotërinjve, e cila majmet nga puna e popujve të tjerë sikurse plutokratët anglezë, përkundrazi pretendimi ynë për të udhëhequr në Evropë dhe në botë mbështetet tek zhvillimi ynë si popull udhëheqës, e dëshiruar kjo prej predestinimit, mbështetet tek arritjet tona, tek aftësia dhe angazhimi ynë, mbështetet tek shembulli ynë dhe tek drejtësia*”.¹¹

Kurse *Hermann Göring*, në një fjalim para punëtorëve në tetor 1941, shprehet qartë se jo vetëm sundimi, por pikërisht edhe shfrytëzimi ishte në fakt objektivi i nazistëve: “*Ne e dimë se po e fituam këtë luftë, atëherë populli ynë do mund të shfrytëzojë mjaltin e botës. Prandaj po e bëjmë edhe luftën, që më vonë të kemi gjithçka. Vetëkuptohet! Ne nuk po e bëjmë luftën për hir të një teorie të shpëlarë ... Jo! Ne duam t’i turremi mjaltit të botës. Ne duam tani të ulemi vendçe në kullotat e botës dhe të majmëmi*”¹². Gjeopolitika shfaqet e përshtatur ndaj këtyre rrethanave: “Politologjia në një sistem autoritar shfaqet

⁹ Po aty.

¹⁰ Ebeling, F. (1994): Geopolitik. Karl Haushofer und seine Raumwissenschaft 1919-1945. Berlin.

¹¹ G. Karakashi, Rikthimi i gjeopolitikës, UFO, Tiranë 2011, punim i udhëhequr nga Prof..Dr. Pajtim Ribaj.

¹² Po aty.

autoritare dhe në një sistem liberal shfaqet natyrisht liridashëshe-konformiteti me sistemin është në radhë të parë një çështje e mbijetesës së shkencës”. Megjithatë nuk duhet të nxitohemi thotë studiuesi Ebeling, “*e t’iu veshim përputhje mendore për shkak të pranisë së njëkohshme të nacionalsocializmit dhe gjeopolitikës dhe të terminologjisë së dyfishtë në gjuhë.*”¹³

Në këtë epokë gjejmë në diskutime edhe mendime jokonformiste në revistën e gjeopolitikës. Hitleri në librin e tij “Mein Kampf” merr shkas nga mendimet gjeopolitike e në këtë mënyrë nga tezat e Karl Haushoferit, sigurisht e kapërcen komponenten ekzistuese “paqësore” për një zgjerim pa dhunë dhe me masë të Rajhut gjerman në Evropën Lindore dhe përtej oqeanit. Vendin e kësaj e zuri figura e armikut, e mbështetur mbi argumente raciste” (Lemo). Këtë e tregon, në mënyrë shembullore, fragmenti i mëposhtëm: “*E drejta për të patur truall dhe tokë mund të kthehet në detyrë, kur pa zgjerimin e truallit duket se një popull i madh është shuguruar të perëndojë. Veçanërisht sidomos atëherë, kur nuk bëhet fjalë për një popull zezakësh të çfarëdoshëm, por për nënën gjermane të jetës, jetë që i ka dhënë botës së sotme tabllonë e vetë kulturore*”¹⁴. Gjermania ose do të bëhet fuqi botërore, ose nuk do të ekzistojë fare. Por për t’u bërë fuqi botërore, asaj i lipset ajo madhësi që i jep, në kohën e sotme, rëndësinë e domosdoshme dhe qytetarëve të saj u jep jetën”.¹⁵ Që nga shtatori i vitit 1945, Haushofer u mor edhe në pyetje jozyrtare, me qëllim që të vendosej nëse do të gjykohej në Nuremberg për krime lufte. U deklarua se ai nuk kishte kryer krime lufte. Në natën ndërmjet datave 10 e 11 mars 1946, ai dhe e shoqja kryen vetëvrasje. Ky ishte fundi i një prej mendimtarëve më ndikues në gjeopolitikë dhe në praktikën e saj. Por ky nuk ishte fundi i mendimeve të tija gjeopolitike. Ato i rezistuan kohës dhe qëndruan më lart se sa ideologjia.¹⁶

Fundi i gjeopolitikës?

Për njerëz të tillë, të mendonin që Zoti ishte në anën e tyre ishte diçka e keqe, por të mendonin që shkenca ishte në anën e tyre ishte diçka akoma më e keqe. Mund të lutesh dhe “diskutosh” me Zotin, por shkenca është e shurdhët dhe e papajtueshme. Kjo është ajo çka Strausz-Hupe¹⁷ u përpoq t’i shpjegonte amerikanëve në vitin 1942: që kuptueshmëria e nazizmit për gjeopolitikën, siç u shtjellua dhe përpunua dhe nga Karl Haushofer, (të cilin Strausz-Hupe e quante Nazi-Machiavelli), nuk ishte një kuptim i drejtë dhe i saktë për drejtpeshimin e pushteteve, por të përmbysjes së tyre. Pa u zgjeruar, vërehet se popullariteti i teorisë së gjeopolitikës nga 1945 deri tani, ka patur ulje e ngritje, me ndryshimet e kohës. Popullariteti i saj, kohët e fundit, fillon nga 1979, kur Henry Kissinger botoi vëllimin e parë të kujtimeve të tij titulluar “*Vitet e Shtëpisë së*

¹³ Ebeling, F. (1994): Geopolitik. Karl Haushofer und seine Raumwissenschaft 1919-1945. Berlin.

¹⁴ G. Karakashi, punim i cituar.

¹⁵ Adolf Hitler: Mein Kampf, München 1927 f. 741-742.

¹⁶ Ribaj, Pajtim, Mein Kampf’ dhe deformimi i gjeopolitikës së Haushofer-it, *Standart*, 2013.

¹⁷ Robert Strausz-Hupe (25 mars 1903-24 shkurt 2002) ishte diplomat dhe gjeopolitikan amerikan (austriak me origjinë). Në vitin 1923 ai emigroi në Amerikë. Duke shërbyer si këshilltar për investimet e huaja në institucionet financiare të Amerikës, ai pa dhe kuptoi nga afër shpërndarjen e gjerë në kohën e depresionit të mjerimit politik në Amerikë dhe Evropë. Këto mendime janë shprehur prej tij, pasi lexoi librin “Mein Kampf” të shkruar nga Adolf Hitler, në disa shkrime dhe botime të kohës në Gjermani dhe Austri. Mendimet e tij u ribotuan më pas dhe prej andej dhe janë shkëputur për referencë në këtë detyrë në revistën gjeopolitike “Limes” në Itali në vitin 2005.

Bardhë". Ishte e rëndësishme që ky libër vazhdonte të përdorte termin "Gjeopolitikë". Kjo ishte e rëndësishme për dy arsye: *E para*, Kissinger e përdori atë si një metodë analize për të luftuar politikën liberale të idealizmit amerikan; *e dyta*, ajo u shfrytëzua si mjet për të paraqitur një alternativë të politikës konservatore kundër ideologjisë komuniste. Kissinger e quante gjeopolitikën një sinonim të ekuilibrit global, me interesa të qëndrueshëm kombëtarë në drejtpeshimin botëror të pushtetit¹⁸.

Në Gjermani, gjeointerestat, ose politikën e pushtetit nuk ishin aktuale deri në vitet 1970. Sot, vetë kritikët e gjeopolitikës gjermane i japin kuptimit të hapësirës përsëri një farë rëndësie.¹⁹ Në Gjermani, që prej viteve 1970, po përdoren gjithmonë e më tepër shembuj shabllonë vlerësimi gjeopolitik në lidhje me nevojat për informacion për institucione të caktuara shtetërore. Kështu u veprua në vitet 1979-1980 për vlerësimin e "konfliktit kryesisht territorial" midis Kamboxhias dhe Vietnamit. Në vitet 1980, lufta ndërmjet Iranit dhe Irakut nuk u argumentua dhe interpretua si një problem i brendshëm fetar, pra, kontradiktat ndërmjet shiitëve dhe sunitëve, por, edhe si një kontradikë interesash në lidhje me Gjirin Persik dhe naftën e tij.²⁰

Rilindja e gjeopolitikës në vendet gjermanishtfolëse

Një shembull për rilindjen e gjeopolitikës në Gjermani është përzgjedhja e temës "gjeopolitikë" për takimet e shoqatës gjermane të historisë (30.10 - 01.11.1997 dhe 29.10 - 31.10.1998 në Potsdam) ku, ndër të tjera, u theksua përsëri nevoja për studimin e gjeopolitikës dhe rëndësia e saj.²¹ Po ashtu, fakti që një revistë studimore për politikën ndërkombëtare, e cila botohet në Potsdam me titullin "Geopolitik-Ein altes Konzept wird neu befragt" ("Gjeopolitika-Një koncept i vjetër po kërkohet përsëri") dhe që trajton probleme gjeopolitike, tregon për rëndësinë që po merr kjo shkencë në këtë vend.²² Pas 1990, pas ribashkimit të Gjermanisë, u publikuan një numër i madh analizash gjeopolitike, prognozash dhe sugjerimesh, të cilat kishin si qëllim të krijonin një hapësirë në kaosin gjeopolitik që ndërkohë ekzistonte. Studiuesit mundoheshin të dallonin ose krijonin struktura të reja për të përcaktuar nga fillimi koordinatat e rrjetit të ri politik. Kjo dinamikë ishte e vetëkuptueshme. Kur ka ekzistuar, në historinë botërore, një *status quo* gjeopolitike për një kohë kaq të gjatë sa nga viti 1945 deri në vitin 1989?

Edhe në Austri, prej vitit 1991, mund të thuhet që filluan të kryhen studime gjeopolitike. Si pasojë, edhe hapësira gjeopolitike e *Heinz Magenheimer*-it u bazua sërisht mbi rregullin hapësinor dhe kufijtë e gjeopolitikës klasike. Vlera e hapësirës përmbledh shpërndarjen e popullsisë, qendrat ekonomike, pasuritë nëntokësore dhe rrugët e transportit. Nën termin "pozicion" kuptohet vendi që ka një shtet kundrejt një shteti tjetër. Në këtë

¹⁸ Ai e përkufizoi gjeopolitikën si më poshtë: "Me termin gjeopolitikë unë nënkuptoj një mjet i cili i kushton rëndësi kërkesave të ekuilibrit."

¹⁹ Van der Öusten, Hermann. Geopolitik und staatliche Ordnung; in: Irene Diekmann, Peter Krüger und Julius H. Schoeps (Hrsg.): Geopolitik-Grenzgänge im Zeitgeist; Potsdam 2000; f. 421-435.

²⁰ Görtemaker, Manfred. Politischer Zeitgeist und Geopolitik - Über die zeitbedingten Voraussetzungen an wendungsorientierter Wissenschaft; in: Irene Diekmann, Peter Krüger und Julius H. Schoeps (Hrsg.): Geopolitik - Grenzgänge im Zeitgeist; Potsdam 2000; f. 15.

²¹ Diekmann, Irene; Krüger, Peter; H. Schoeps, Julius (Hrsg.). Geopolitik - Grenzgänge im Zeitgeist; Potsdam 2000; f. 9-10.

²² Görtemaker, Manfred. Politischer Zeitgeist und Geopolitik - Über die zeitbedingten Voraussetzungen an wendungsorientierter Wissenschaft; in: Irene Diekmann, Peter Krüger und Julius H. Schoeps (Hrsg.): Geopolitik - Grenzgänge im Zeitgeist; Potsdam 2000; f. 15-16.

kontekst, bëhet dallimi ndërmjet pozicionit qendror, kufitar, anësor, urëlidhës dhe pengues. Si një faktor tjetër, mund të dallojmë vijën kufitare, ku të rëndësishëm janë lloji dhe cilësia e kufijve.²³ Për drejtorin shkencor të Qendrës së Studimeve të Bundesvehr, *Heinz Brill*, gjeopolitika përbën sot një sistem të bazuar në fusha të përzgjedhura si gjeostrategjia, gjeoekonomia, gjeohistoria, gjeoetniciteti dhe gjeokultura. “Gjeostrategjia” p.sh. është për *Brill*-in një term që rrjedh nga gjeopolitika. Në gjeostrategji bëhet fjalë për gjeofaktorë si hapësirë, pozicion dhe fuqi ushtarake, në bazë të të cilëve arrihen synimet e caktuara. Për përdorimin gjeostrategjik të hapësirës janë të rëndësishme linjat lidhëse të zonave të ndikimit, urat lidhëse dhe bazat mbështetëse.²⁴ Pra, mund të thuhet se në këto vende, gjeopolitika klasike shikohet si e kaluar historike dhe po merr dimensione të reja. Po zhvillohet një gjeopolitikë e re dhe moderne, me përfaqësuesit e saj. Ndër ta spikatin *Heinz Magenheimer*²⁵, *Erich Reiter*²⁶ dhe *Heinz Brill*²⁷. Këta studiues punojnë me metoda të reja të gjeopolitikës dhe janë të lidhur fort pas parimeve demokratike. Si pasojë, u zhvillua edhe disiplina e gjeopolitikës kritike.

Skenarët gjeopolitikë sipas këndvështrimit gjerman

Debati mbi të ardhmen e Bashkimit Evropian është gjithmonë e më i pranishëm. Ky debat ndizet akoma më tepër, nëse ndonjë nga vendet anëtare të BE-së ndodhet në krizë dhe përballë problemeve të mëdha ekonomike dhe politike, siç po ndodh aktualisht në Greqi. Për këtë arsye, është e nevojshme që të parashikohen edhe skenarë të ndryshëm të zhvillimit të BE-së. Qendra për Studime Politike të Aplikuara (CAP) në Gjermani parashikon 5 skenarë për të ardhmen e BE-së, të cilët klasifikohen si më poshtë.²⁸

Skenari 1: Titaniku

Skenari 2: Evropa e mbyllur

Skenari 3: Metoda *Monnet*

Skenari 4: Hapësira e gravitetit të hapur

Skenari 5: Superfuqia Evropë

Skenari 1: Titaniku Ky skenar parashikon një rrezik thelbësor i cili çon deri në shpërbërjen e integritetit evropian. Bashkimi Evropian nuk është i aftë të përballojë kërkesat e brendshme dhe të jashtme. Brenda BE-së rriten divergjencat e interesave si edhe raportet e kapaciteteve ndërmjet shteteve të reja dhe të vjetra anëtare të tij. Heterogjeniteti dhe lufta përçarëse ndërmjet shteteve anëtare duket e pakapërcyeshme. Zgjerimi ambizioz i tejskajshëm nuk mund të përballohet nga strukturat e pandryshueshme

²³ Heinz Magenheimer: Renaissance der Geopolitik. Deutschland und Mitteleuropa 1890-1990; in: ÖMZ 2/1991; f. 131-139.

²⁴ Heinz Brill: Die Bedeutung des Begriffs „Geostrategie“; in: ÖMZ 3/1996; f. 304-306.

²⁵ Heinz Magenheimer: Renaissance der Geopolitik. Deutschland und Mitteleuropa 1890-1990; in: ÖMZ 2/1991 und ders.: Zur Geopolitischen Lage Österreichs; in: Studien und Berichte als Schriftenreihe der Landesverteidigungsakademie; 2002.

²⁶ Erich Reiter: Ein Essay zur neuen globalen Geopolitik; in: Wirtschaft und Sicherheitspolitik; 1999; S. 229ff. und ders.: Perspektiven der globalen strategischen Entwicklung-Das Ende der Ordnung von Jalta; Mittler&Sohn; Hamburg-Berlin-Bonn 2003; f. 11-20.

²⁷ Brill, Heinz. Geopolitik heute: Deutschlands Chance?; Ullstein; Frankfurt/M-Berlin 1994.

²⁸ Franco Algeri; Janis A. Emmanouilidis; Roman Maruhn: 5 EU Szenarien, Centrum für angeänderte Politikforschung (CAP), 2003.

dhe çon automatikisht në paaftësi veprimi. Dobësimi i BE-së do të acarohet akoma më tej si pasojë e një krize funksionale dhe legjitime brenda shteteve anëtare të BE-së, të cilat nuk janë të afta të zhblokojnë procesin reformues ekonomik dhe socialpolitik. Kriza e sistemeve kombëtare dhe sociale ngarkon negativisht jo vetëm shtetet anëtare, por edhe marrëdhëniet e qytetarëve me Bashkimin Evropian.²⁹ Si pasojë, forcat popullore dhe jo parlamentare, me qëndrim kritik ndaj Evropës, fitojnë terren dhe rëndësi. Polarizimi i politikave të ndryshme dhe koncepteve të normave dhe vlerave shkakton divergjenca të pakapërcyeshme ndërmjet shteteve anëtare të BE-së. Po ashtu, edhe motori i integritimit gjermano-francez është i paaftë të mbyllë të çarat e thella në procesin integruar. Të gjitha këto zhvillime e vënë në diskutim ekzistencën e BE-së. Si pasojë, shtetet anëtare jo vetëm që do të ndalojnë transferimin e kompetencave të tyre në BE, por do të fillojnë të tërhiqen edhe nga forumet e përbashkëta dhe do t'i diskutojnë çështjet politike dhe ekonomike në nivel kombëtar. Kjo humbje thelbësore e BE-së shkakton rënien dhe dobësimin e konkurrencës së Evropës përkundrejt SHBA-së dhe shteteve aziatike. Pra, atraktiviteti i modelit që ofron BE-ja shkon drejt rënies si brenda ashtu edhe jashtë saj.

BE-ja e dobësuar nuk mund të jetë më e aftë të përballojë rreziqet dhe konfliktet e ndryshme në arenën botërore. Pra, shtetet anëtare nuk janë më të afta të bien dakort për çështje themelore të Politikës së Sigurisë, si p.sh. pjesëmarrja në operacionet e përbashkëta ushtarake, ose të vazhdojnë bashkëpunimin si pjesë përbërëse e arkitekturës së sigurisë transatlantike. Divergjencat e brendshme dhe të jashtme të politikës së jashtme, në fund të procesit të shpërbërjes, çojnë në përplasje të pashmangshme interesash. Po kështu, shtetet perëndimore nuk do të jenë më në gjendje të vazhdojnë politikën e tyre integruar ndaj vendeve të Evropës Juglindore dhe Ballkanit. Si pasojë, proceset transformuese, si p.sh. në Ukrainë dhe Bjellorusi dhe në Mesdheun Jugor do të rrezikohen. Si pasojë, rëndësia e këtyre shteteve si faktorë sigurie në rajon humbet dhe stabiliteti i Evropës vihet në rrezik. Fundi i Bashkimit Evropian do të thotë edhe fundi i monedhës së përbashkët *Euro*. Monedhat kombëtare do të rifuten përsëri, çka do të çojë në një çrregullim të sistemeve financiare dhe sistemeve të bankave evropiane. Po ashtu, do të dëmtohet rëndë edhe vazhdimësia e politikave financiare dhe do të shkaktohen turbulenca monetare në sistemin monetar botëror.

Skenari 2: *Evropa e mbyllur* Në *Evropën e mbyllur*, shtetet anëtare nuk arrijnë në konsensus në lidhje me zhvillimin e mëtejshëm të Bashkimit Evropian. Një grup i përbërë nga disa shtete anëtare vendosin të bashkëpunojnë me njëri-tjetrin, jashtë kornizës së BE-së. Rruga e integritimit evropian perceptohet nga shtetet në mënyrë të ndryshme. Pavarësisht nga pritshmëria e lartë, procesi reformues i BE-së nuk jep rezultatin e duhur. Si pasojë, mendimi strategjik për një bashkim politik të madh dhe federativ humbet.³⁰ Si pasojë, qytetarët e vendeve anëtare e humbasin interesin dhe besimin ndaj një organizimi të tillë politiko-ekonomik dhe nuk identifikohen më si qytetarë të Evropës së Bashkuar. Po ashtu kombi dhe rajoni spikasin përsëri në krijimin dhe ruajtjen e identitetit. Partitë politike fitojnë zgjedhjet duke përdorur parrulla kritike ndaj Bashkimit Evropian.

Skenari 3: *Metoda Monnet* Sipas këtij skenari, BE-ja vazhdon aktivitetin e tij, sipas përvojës së krijuar deri më sot. Bashkimi Evropian arrin të kalojë me sukses, vetëm në

²⁹ Po aty.

³⁰ Franco Algeri; Janis A. Emmanouilidis; Roman Maruhn: 5 EU Szenarien, Centrum für angeeandte Politikforschung (CAP), 2003, f. 6.

mënyrë të pjesshme, sfidat e jashtme dhe të brendshme që kanë lidhje me procesin e zgjerimit dhe ndryshimet në politikën dhe ekonominë ndërkombëtare. Reformat e nevojshme të BE-së, po ashtu si edhe më parë, dështojnë. Efektet pozitive të Konventës Evropiane të vitit 2003 si edhe të konferencës përmbyllëse të qeverive në fund të saj, kufizohen vetëm në një spektër të ngushtë veprimi. Pra, shtetet anëtare janë të afta të kurojnë simptomat e aftësive vepruese të politikës evropiane, por nuk janë të aftë të shkojnë deri në thelb të problemit. Pra, rinacionalizimi i politikës evropiane dhe një kthim prapa në politikën tradicionale evropiane, në mungesë të një sistemi supranacional, nuk përbën një model alternativ për të ardhmen.³¹

Skenari 4: Hapësira e gravitetit të hapur. Në hapësirën e gravitetit të hapur ndiqet metoda e integritit të vazhdueshëm. Qendrën e gravitetit e formojnë ato vende, të cilat janë më shumë të përfshira në projektet e integritit. Në këtë skenar, qeveritë dhe politika e çdo shteti anëtar mbështesin thellimin e mëtejshëm të integritit. Hapësira e gravitetit të hapur, në të cilën bëjnë pjesë shtetet anëtare të reja e të vjetra, të mëdha e të vogla, çon në krijimin e një bashkimi politik ndërshtetëror. Hapësirën e gravitetit e dallojnë dy tipare thelbësore: *së pari*, kooperimi i shteteve anëtare bazohet mbi parimin e metodës bashkëpunuese. *Së dyti*, çdo shteti anëtar i mundësohet pjesëmarrja në fushat e bashkëpunimit. Kjo hapësirë graviteti tërheq në brendësi të saj edhe shtetet e tjera. Duke u bazuar në kritere të qarta bashkëpunimi, shtetet anëtare arrijnë të intensifikojnë bashkëpunimin ndërmjet tyre. Bashkëpunimi me vendet jo anëtare kryhet nën një frymë institucionale.

Skenari 5: Superfuqia Evropë. Në këtë skenar, Evropa shikohet si një superfuqi, e cila është e vetëdijshme për potencialin e saj. Bashkimi Evropian përdor plotësisht burimet e tij materiale dhe institucionale. Aftësitë dhe potenciali ekonomik, potenciali ushtarak dhe sistemi evropian i vlerave krijojnë një bazë të konsiderueshme veprimi. Zhvillimi linear i integritit dhe sukseset e reformave qëndrojnë në thelb të së ardhmes së Bashkimit Evropian. Transparenca në rritje në strukturat e BE-së si edhe aftësia e përballimit me sukses të rreziqeve të brendshme të jashtme, rrisin pranueshmërinë e kësaj strukturë në sytë e qytetarëve. Ndërtimi i strukturave ndërmjetëse si mediat, organizata joqeveritare, etj. çon në krijimin e një publiku të përgjithshëm, i cili përbën bazën e shoqërisë civile evropiane, çka përbën po ashtu gurin e themelit të BE-së. Në kuadër të zhvillimit integruar, shtetet anëtare i kalojnë shumë kompetenca BE-së. Gjithë spektri i politikës, si politika e brendshme dhe e jashtme, politikat sociale dhe ekonomike zhvillohen nën respektimin, në mënyrë strikte, të një kushtetute evropiane, në të cilën janë përkufizuar qartë kompetencat. Mendimi i solidaritetit dhe synimi për të barazuar cilësitë e jetës, kanë si rezultat faktin që kompetencat kalojnë gjithmonë e më shumë nga shtetet anëtare në Bashkimin Evropian.

Një doktrinë e vlefshme dhe afatgjatë

Në fjalorin gjerman të Politikës së Sigurimit, gjeopolitika trajtohet si “një fushë shkencore në pikëprerjen ndërmjet gjeografisë, shkencave politike, historisë dhe sociologjisë, e cila studion marrëdhëniet ndërmjet hapësirës dhe rrethanave politike. Ajo është gjithashtu doktrina e lidhjeve hapësinore të rrethanave politike si edhe organizmi gjeografik i një shteti dhe më tej është analiza e ndikimeve të kushteve gjeografike të një shteti mbi politikën e tij kombëtare dhe ndërkombëtare.”³² Pra, gjeopolitika mund të

³¹ Po aty, f. 8.

³² Ernst-Christoph Meier, Richard Roßmanith und Heinz-Uwe Schäfer: Wörterbuch zur Sicherheitspolitik; 2003; S. 144.

konsiderohet në përgjithësi si doktrina afatgjatë e vlefshme e ndikimit të hapësirës gjeografike mbi politikën e një shteti.³³ Çdo shtet është i varur nga përmasat e pasurive gjeologjike dhe gjeografike që ka brenda kufijve të tij. Ato përcaktojnë se çfarë formash organizimi ekonomik, shoqëror dhe politik janë të realizueshme brenda këtij shteti. Prandaj gjeopolitika, përkrah orientimit historik dhe atij të politikës së sigurimit, është edhe një orientim ndërdisiplinar gjeografik dhe politik.³⁴

“Siç dihet, faktorë si p.sh., klima dhe territori kanë një ndikim të konsiderueshëm mbi njerëzit, popujt dhe shtetet. Jeta dhe puna në një vend subtropikal është ndryshe nga jeta në një vend në Evropën Qendrore. Planëzimet e përgjithshme strategjike të një shteti ishull duhet të ndjekin kritere të ndryshme nga të një shteti të pastër kontinental. Për të argumentuar çështjet ligjore që fshihen prapa tyre dhe për t’i bërë ato të vlefshme për politikën praktike, u konsolidua, pas viteve 1880 të shekullit XIX, në shumë vende, një disiplinë shkencore, e cila u quajt gjeopolitikë.” Kjo ishte hyrja e një recense për librin *“Geopolitik heute, Deutschlands Chance?”*, shkruar prej Heinz Brill-it, drejtor shkencor i Qendrës Kërkimore Studimore të Bundesvehr-it, publikuar më datën 21 nëntor 1994 në gazetën *“Frankfurter Allgemeinen Zeitung”*.³⁵ Termi “gjeopolitikë” duhet të ndahet qartë nga termit “gjeostrategji” dhe “strategji e përgjithshme”, pavarësisht përdorimit të njëjtë konceptual të tyre. “Strategjia e përgjithshme” (*Grand Strategy*) është koncepti përgjithësues për realizimin e objektivave të jashtme dhe të politikës së sigurimit e cila, duke marrë parasysh faktorët gjeopolitikë, gjeostrategjikë dhe politikë, në kuadër të përparësive legjitime, duhet të nxjerrë në plan të parë përmbushjen e interesave kombëtare ose të interesave të aleancave të sigurisë kolektive. “Gjeostrategjia” nga ana tjetër është realizimi, sipas planeve, i synimeve strategjike dhe të politikës së sigurimit, duke marrë në konsideratë kritere të caktuara gjeopolitike rajonale dhe globale.³⁶

Bibliografia:

- Gearóid Ó Tuathail: Geopolitik-zur Entstehungsgeschichte einer Disziplin; in: Geopolitik-Zur Ideologiekritik politischer Raumkonzepte; Kritische Geographie; Band 14; Promedia; Wien 2001.
- Michael Fahlbusch: Grundlegung; Kontext und Erfolg der Geo- und Ethnopolitik vor 1933; in: Irene Diekmann, Peter Krüger und Julius H.Schoeps (Hrsg.): Geopolitik-Grenzgänge im Zeitgeist; 2000.
- Henry Kissinger, Diplomacia.
- Roletto Giorgio, Massi Ernesto, “Per una geopolitica italiana”, in Geopolitica, I, 1939.
- Cohen, Sauli, Bernard. *“Gjeopolitika e Sistemit Botëror”*, Rowman dhe Littlefield, 2003.
- Geoffreu Sloan, Sir Halford Mackinder: The Heartland Theory The History of Ideas, Geopolitics-Geography and Strategy. Editors: Colin S.Gray and Geoffrey Sloan, Franc Cass Publisher, London, 1999.

³³ Rainer Mennel: Der Balkan - Eine Studie zur Geostrategie und Politischen Geographie eines alten Konflikttraumes; 1999; S. 11.

³⁴ Wolfgang Baumann und Gunther Hauser: Mitteleuropa-Im geo-politischen Interesse Österreichs; 2001; S. 19-20.

³⁵ Lutz Unterseher: Deutschland als umworbene Macht-Zur Renaissance geopolitischer Imagination in Russland und den USA; in: Europa zëischen Krieg und Frieden. Geopolitische Hegemonie oder Gemeinsame Friedensordnung; Österreichisches Studienzentrum für Frieden und Konfliktlösung (Hrsg.); Agenda; Münster 1999; S. 169.

³⁶ Ernst-Christoph Meierm, Richard Roßmanith und Heinz-Uwe Schäfer: Wörterbuch zur Sicherheitspolitik; 2003; S. 144.

- Ebeling, F. (1994): Geopolitik. Karl Haushofer und seine Raumwissenschaft 1919-1945. Berlin.
- G. Karakashi, Rikthimi i gjeopolitikës, UFO, Tiranë 2011, punim i udhëhequr nga Prof.Dr. Pajtim Ribaj
- Adolf Hitler: Mein Kampf, München 1927.
- Ribaj, Pajtim, “Mein Kampf” dhe deformimi i gjeopolitikës së Haushofer-it, *Standart*, 2013.
- Irene Diekmann, Peter Krüger und Julius H. Schoeps (Hrsg.): Geopolitik-Grenzgänge im Zeitgeist; Potsdam 2000.
- Heinz Magenheimer: Renaissance der Geopolitik. Deutschland und Mitteleuropa 1890-1990; in: ÖMZ 2/1991.
- Heinz Brill: Die Bedeutung des Begriffs „Geostrategie”; in: ÖMZ 3/1996.
- Heinz Magenheimer: Renaissance der Geopolitik. Deutschland und Mitteleuropa 1890-1990; in: ÖMZ 2/1991 und ders.: Zur Geopolitischen Lage Österreichs; in: Studien und Berichte als Schriftenreihe der Landesverteidigungsakademie; 2002.
- Erich Reiter: Ein Essay zur neuen globalen Geopolitik; in: Wirtschaft und Sicherheitspolitik; 1999; und ders.: Perspektiven der globalen strategischen Entwicklung- Das Ende der Ordnung von Jalta; Mittler&Sohn; Hamburg-Berlin-Bonn 2003.
- Brill, Heinz. Geopolitik heute: Deutschlands Chance?; Ullstein; Frankfurt/M-Berlin 1994.
- Franco Algeri; Janis A. Emmanouilidis; Roman Maruhn: 5 EU Szenarien, Centrum für angeänderte Politikforschung (CAP), 2003.
- Ernst-Christoph Meier, Richard Roßmanith und Heinz-Uwe Schäfer: Wörterbuch zur Sicherheitspolitik; 2003.
- Rainer Mennel: Der Balkan-Eine Studie zur Geostrategie und Politischen Geographie eines alten Konfliktraumes; 1999.
- Wolfgang Baumann und Gunther Hauser: Mitteleuropa-Im geo- politischen Interesse Österreichs; 2001.
- Ernst Christoph Meierm, Richard Roßmanith und Heinz-Uwe Schäfer: Wörterbuch zur Sicherheitspolitik; 2003.

Rubrika e Tretë

Integrimi i ushtarakëve në rezervë dhe pension në shoqëri

Në këtë rubrikë jepen mendime dhe vlerësime për përmirësime të mëtejshme të përkujdesjes sociale të ushtarakëve në rezervë, në lirim dhe në pension, si dhe për integrimin e tyre në shoqëri. Me daljen në pension nuk nënkuptohet një heqje dorë nga veprimtaria fizike, intelektuale dhe sociale e këtyre personave. Ata janë në gjendje që energjitë e tyre, sidomos ato intelektuale, t'i vënë në dispozicion të shoqërisë që të mos ndjehen të larguar e të mënjanuar nga aktiviteti dhe jeta shoqërore.

Në shkrimin e tij “Një vështrim për pensionet e ushtarakëve shqiptarë në vite”, nënkolonel Xhemal Çangu trajton çështjen mbi mbrojtjen ligjore të ushtarakut, në periudha të ndryshme historike, mbi trajtimin dhe përkujdesjen për këtë kategori të madhe dhe me plot sakrifica, me synimin për vlerësimin real, për trajtim me dinjitet të ushtarakëve, si dhe nevojën për përmirësime në të ardhmen. Ai vë theksin në domosdoshmërinë e përmirësimit të akteve ligjore e nënligjore, në mbështetje të ushtarakut, ashtu siç është përcaktuar në “Programin e Qeverisë 2013-2017”, veçanërisht në pjesën e legjislacionit që ka të bëjë me përkujdesjen ndaj tij, pas lirimimit nga shërbimi aktiv, akte që rregullojnë përkujdesjen dhe trajtimin e ushtarakut në varësi të kontributit në Forcat e Armatosura.

Shkrimi i dytë i kësaj rubrike “Angazhimi në shoqëri i ushtarakëve në pension” i major Festim Alimadhi, hedh dritë mbi trajtimin që shteti shqiptar duhet të bëjë për qytetarët e vet në prag të daljes së tyre në pension. Si pikë referimi për autorin është përvoja e ushtrive perëndimore, e cila është për t'u marrë shembull dhe për t'u zbatuar në kushtet e vendit tonë, për ushtarakët të cilët shkëputen nga shërbimi aktiv ose kalojnë në pension pleqërie. Përvoja kanadeze është ndër më praktiket, në këtë drejtim, për t'u marrë në konsideratë.

Një vështrim për pensionet e ushtarakëve shqiptarë në vite

Nënkolonel (R) MSc. Xhemal Çangu
Specialist në QPR

Trajtesë e shkurtuar. *Figura dhe profesioni i ushtarakut është vlerësuar dhe vlerësohet në çdo kohë dhe çdo vend, si një nga profesionet e vështira për shkak të privacioneve që mbart. Privacionet e këtij profesioni lidhen ngushtë me karakterin e vështirë që ndeshet, gjatë punës, në ushtrimin e detyrës dhe rrezikshmërinë që paraqitet. Puna e ushtarakut, si një profesion i veçantë, i cili është më pranë sakrificave në kohë paqeje kur atij i kërkohet përballja me vështirësi e privacione të shumëllojshme, por, padyshim edhe në kohë lufte, kur ato rriten dhe i kërkohet deri sakrifica më sublime, duke mos kursyer as jetën e tij, për të cilën ai bën betimin dhe e nënshkruan atë me dorën e tij. Gjatë punës dhe karrierës ushtarake, ushtarakut i kërkohet të pranojë një numër privimesh nga liritë dhe të drejtat themelore të njeriut, ku problemet dhe nevojat e veta apo familjare, shpeshherë, për shkak të detyrës, kalojnë në plan të dytë. Duke qenë kështu, për punën e veçantë që kryen, ushtaraku gëzon edhe një mbrojtje e përkujdesje nga shteti.*

Kjo mbrojtje dhe përkujdesje sigurohet me akte ligjore, si gjatë ushtrimit të detyrës, kur ai është aktiv, por edhe pas saj, kur ushtaraku ndërpret karrierën ushtarake dhe del në rezervë, lirim apo në pension. Për të ndriçuar sadopak mbrojtjen ligjore dhe trajtimin e ushtarakut në vite në vendin tonë, po i hedhim një vështrim mbrojtjes ligjore të ushtarakut në periudha të ndryshme historike. Me këtë shkrim do të hedhim dritë mbi mbrojtjen ligjore të ushtarakëve në vite, nga 15 shkurt 1923, kur është miratuar ligji i parë për “Dorëheqje dhe pensionet në ushtri e gjindarmëri”, në vitin 1934 në miratimin e një ligji të veçantë “Ligj i pensioneve civile dhe ushtarake”, për të ardhur deri në ditët e sotme të trajtimit të ushtarakut. Nisur nga boshllëku i studimeve të mirëfillta, do të trajtojmë mbrojtjen e ushtarakut në vite, për të hedhur dritë mbi trajtimin dhe përkujdesjen për këtë kategori të madhe dhe me plot sakrifica. Politikat e ndjekura për mbrojtjen ligjore të ushtarakëve aktivë, sidomos për kontingjentin e ushtarakëve në rezervë, lirim e në pension, pra, për pensionet suplementare dhe përkujdesjen ndaj ushtarakut, pas ndërprerjes së karrierës ushtarake, shtrirë në vite e periudha kohore, do të ndihmojnë të nxirren disa përfundime në lidhje me vlerësimin real për trajtim e dinjtet të ushtarakëve, si dhe nevojën për përmirësime në të ardhmen.

Një vështrim mbi aktet ligjore në fushën e pensioneve të ushtarakëve në vite

Në objektivat sociale të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, deklarohet se shteti, brenda kompetencave kushtetuese dhe mjeteve që zotëron, si dhe në plotësim të nismës dhe të përgjegjësisë private, synon standardin më të lartë

shëndetësor, fizik e mendor të mundshëm, përkujdesjen dhe ndihmën për të moshuarit, jetimët dhe invalidët, riaftësimin shëndetësor, edukimin e specializuar dhe integrimin në shoqëri të të paaftëve, etj. Neni 52 i Kushtetutës parashikon se “*kushdo ka të drejtën e sigurimeve shoqërore në pleqëri, ose kur është i paaftë për punë, sipas një sistemi të caktuar me ligj. Çdo njeri, kur mbetet pa punë për shkaqe të pavarura nga vullneti i tij dhe kur nuk ka mjete të tjera jetese, ka të drejtën e ndihmës në kushtet e parashikuara me ligj*”¹. Sigurimet shoqërore në Shqipëri kanë një historik të vetin. Si pjesë e sigurimeve shoqërore në vendin tonë, historik të veçantë kanë edhe pensionet e ushtarakëve. Objekt i këtij shkrimi është vështrimi kronologjik i pensioneve të ushtarakëve në vite, për të shërbyer si një fillesë për trajtime më të thella në të ardhmen.

Puna e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, për shkak të pozitës juridike, ekonomiko-financiare dhe shoqërore, kërkesave të përgjithshme të pranimit të të drejtave, të detyrimeve dhe të kufizimeve, vlerësohet si një punë e “*karakterit të veçantë të detyrës dhe të shërbimit ushtarak*”². Sot, ligjërisht, ushtarakut i sigurohet një mbrojtje ligjore me ligjin organik, me statusin e ushtarakut dhe ligje të tjera nëpërmjet sigurimit “*të garancive ligjore për zbatimin e tyre*”³, por realisht ka nevojë që ato që janë të shprehura të zbatohen në praktikën e përditshme, si edhe të përmirësohen. Një vlerësim i ri tregohet në “Programin e Qeverisë 2013-2017” edhe për kategorinë e ushtarakëve aktivë dhe atyre në rezervë e në lirim. Ky vlerësim fillon me rishikimin e kuadrit ligjor, me qëllim përmirësimin e trajtimit financiar të ushtarakëve aktivë, por edhe për trajtim dinjitoz për pjesën e ushtarakëve në rezervë, lirim e në pension. Tashmë është realitet që pjesa e ushtarakëve në rezervë e lirim është një shifër jo e vogël, për rrjedhojë, kjo kategori personeli është përfituese i pensioneve suplementare, sipas akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Synimi i “Programit të Qeverisë 2013-2017” është hartimi i një plani afatmesëm dhe afatgjatë të zhvillimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë për periudhën 2013-2020. Në vëmendje të hartimit e zbatimit të planit afatgjatë të zhvillimit është: “*Krijimi i një strukture të re organizative të Forcave të Armatosura, duke ulur në mënyrë graduale numrin aktual të personelit*”⁴. Në këto kushte, kontingjenti i ushtarakëve në rezervë, lirim, si përfitues të pensioneve suplementare, sa vjen e shtohet, ndaj është e domosdoshme rritja e përkujdesjes për të gjitha problemet që ata kanë për përfitimin e të drejtave ligjore suplementare për kontributin e dhënë në Forcat e Armatosura. Rritja e përkujdesjes së kësaj kategorie kërkon përmirësime si në aspektin ligjor, nënligjor, akte të ndryshme administrative, por edhe në përmirësime strukturore. Në “Programin e Qeverisë 2013-2017” shprehet se: “*Rishikimi i kuadrit ligjor për përmirësimin e trajtimit financiar të ushtarakëve aktivë është një domosdoshmëri për mbajtjen dhe tërheqjen e burimeve njerëzore cilësore në Forcat e Armatosura për të ardhmen, por edhe për trajtimin dinjitoz të ushtarakëve në rezervë dhe lirim*”⁵.

¹ Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, neni 52.

² Ligji Nr. 9210, date 23.3.2004 “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, Neni 1.

³ Po aty.

⁴ Programi i Qeverisë 2013-2017, “Siguria kombëtare dhe kontributi në sigurinë globale”, faqe 12,

⁵ Po aty.

Historiku i mbështetjes me sigurim shoqëror suplementar të ushtarakëve në vendin tonë

Në vendin tonë, ushtarakët në rezervë, lirim e në pension janë trajtuar sipas periudhave kohore, me ligje të veçanta. Për të krijuar një ide rreth akteve ligjore që e kanë trajtuar ushtarakun, po trajtojmë një historik të shkurtër, me disa nga aktet ligjore të kohës, sipas periudhave kohore.

➤ Në periudhën e viteve 1912-1945

Me krijimin e shtetit shqiptar më 1912, paralelisht me aktet kushtetuese që kanë dalë në Shqipëri, nga akti themelor i një shteti dhe që parashikon të drejtat themelore, përfshihet edhe e drejta për sigurime shoqërore. Në këtë kohë filluan daljet e akteve të ndryshme ligjore në fushën e sigurimeve shoqërore, sipas zhvillimeve historike të sigurimeve shoqërore në Shqipëri. Pjesë e këtyre akteve të sigurimeve shoqërore janë edhe pensionet e ushtarakëve.

Në monarkinë e Mbretit Zog u vendosën skemat e pensioneve e kontributeve shtetërore për nëpunësit civilë dhe për ushtarakët. Nëpunësit, sipas ligjit nr. 129, datë 28.10.1927, për pensionet civile, *pensionoheshin detyrimisht kur kishin shërbyer 35 vjet ose kishin arritur moshën 60 vjeç*⁶, por mund ta kërkonin pensionin, edhe nëse kishin plotësuar 25 vjet në administratë. *“E drejta për pension për të gjithë nëpunësit civilë të Republikës Shqiptare fillonte mbas datës 28 Nandor 1912”*⁷. Më tej, në këtë ligj, parashikohej themelimi i Arkës së Përgjithshme të Pensioneve për Nëpunësit Civilë. *“Kjo arkë formon një institut të veçantë dhe funksionon pranë Ministrisë së Financave, nënë autoritetin e Ministrisë së Financave dhe lehet nën drejtimin e administrimit të një këshille administruese, e përbërë prej një Senatori, një Deputeti, një antari të Diktimit, një antari të Këshillit Kontrollues, dhe prej nga një funksionarit të naltë të çdo Ministrije”*⁸.

Ligji i “Pensioneve civile dhe ushtarake”, i datës 20.06.1934, bëri përcaktime më të detajuara për pensionet e ushtarakëve. Në *kaptinën III*, ka ndarje me nene të veçanta për konditat për të drejtën e pensionit për oficerët, për nënoficerët, graduatët, ushtarakët dhe gjindarmët. Kështu, për daljen në pension të plotë për oficerët përcaktohet se: *“Oficjerat kanë të drejtë me kërkuar daljen në pension dhe me marrë pensionin e rregullt kur të kenë ndonji nga konditat e posht-shënueme:*

- a) *të kenë mbushun 50 vjet moshë por që së pakut të kenë 20 vjet shërbim efektiv të vlefshëm për pension;*
- b) *të kenë mbushun 15 vjet shërbim efektiv të vlefshëm për pension e të jenë ba, për shkak sëmundje, të paaftë përherësisht për me vazhduar ma gjatë në shërbim”*⁹.

Në këtë ligj, përveç daljes në pension të plotë pleqërie për oficerët, ka edhe kushte për pensione për shkaqe të tjera, pensione të privileguera, shpërblime familjes së ushtarakut, etj. *“Oficjerat që qiten në lirim për shkaqe të parapame prej ligjeve, shkaqe të cilat nuk sjellin humbjen e së drejtës së pensionit, kanë të drejtë shpërblimi të njëhershëm në kjoftë se kanë plotësuar 8 vjet shërbim dhe jo 15 vjet shërbim efektiv të vlefshëm për pension.*

⁶ Ligji nr. 129, datë 28.10.1927, artikulli 4.

⁷ Po aty, artikulli 7.

⁸ Po aty, artikulli 31.

⁹ Ligjë e Pensioneve civile dhe ushtarake, datë 20.06.1934, neni 16.

*Kur oficeri ka plotësue 15 vjet shërbim efektiv të vlefshëm për pension, fiton të drejtën e pensionit të rregullt*¹⁰.

Në një nen të veçantë të këtij ligji, për llogaritjen e kohës së përgjithshme theksohet se: *..pjesa e kohës që kalon të gjashtë muejt, llogaritet një vjetë i tanë*¹¹.

➤ Në periudhën e viteve 1945-1990

Pensionet e kësaj periudhe kohore në vendin tonë zënë fillesat me Ligjin nr. 327, datë 04.09.1946; me dekretin nr. 341, datë 28.10.1946. Në vitin 1947, me ligjin nr. 528, datë 25.08.1947 “Mbi sigurimet shoqërore të nëpunësve dhe funksionarëve” u krijua një sistem unik i sigurimeve shoqërore, që përfshinte sigurimin për sëmundje, për pensionin e pleqërisë, invaliditetit, etj., përmes ligjit nr. 528, datë 26.08.1947. Moshja e pensionit të pleqërisë ishte 65 vjeç për burrat dhe 60 vjeç për gratë. Bashkëshortja pasjetuese quhej e paaftë për punë në moshën 40 vjeç. Në dhënien e pensionit të pleqërisë nuk bëhej dallim për punët shumë të rënda.

Me dekretligjin nr. 734 dhe 735, datë 21.09.1949, u përcaktuan kritere për dhënien e pensioneve, duke marrë për bazë vjetërsinë dhe vështirësinë e punës, gjininë dhe moshën. Kështu, moshja për gratë u ul nga 60 vjeç në 55 vjeç dhe nga 65 vjeç në 60 vjeç për burrat etj. U njoh e vlefshme për pension, koha e punës e kryer që nga shpallja e pavarësisë së vendit 28 nëntor 1912, sipas dekretligjit nr. 123, datë 05.03.1951. Ndryshime të tjera pasuan me dekretin nr. 2213, datë 06.02.1956. Në vitin 1958, me ligjin nr. 2803, datë 04.12.1958 “Komisionet e pensioneve pranë këshillit të Bashkimeve Profesionale të rretheve” bënë ndryshime të tjera në ligjin e sigurimeve shoqërore shtetërore. Në kuadrin e rishikimit të legjislacionit në fuqi, u bë njehsimi i dispozitave të sigurimeve shoqërore të punonjësve civilë dhe ushtarakë.

Ndërsa me Ligjin nr. 2813, datë 10.03.1959 “Pensionet e ushtarakëve të shërbimit aktiv të Ushtrisë Popullore dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme caktohen nga vetë këto organe”. U bënë shtesa dhe ndryshime të tjera dhe u fuqizua ligji nr. 4171, datë 13.4.1966 për “Sigurimet Shoqërore në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë”.

Në tërësi, gjatë periudhës së viteve të sistemit komunist në vendin tonë, në vitet 1945-1990, ekzistojnë paqartësi e boshllëqe që lidhen kryesisht me fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, por edhe në trajtime e përkujdesje. Ushtria Shqiptare ka pasur një histori tragjike. Kuadrot e saj, oficerët e nënoficerët në radhët e ushtrisë kanë qenë nga njerëzit më të ndershëm, më patriotë dhe më të përkushtuar për detyrën e tyre në interes të atdheut. Roli i faktorit të mbrojtjes së atdheut, vlerësohej si “detyrë mbi detyrat”. Gjithë populli ishte ushtar dhe ushtaraku trajtohej me një ligj të përbashkët me të gjitha pensionet e tjera shtetërore.

Në një periudhë më të gjatë kohore, trajtimi financiar i ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të Policisë së Shtetit, etj. është realizuar sipas dispozitave të ligjit nr. 4171, datë 13.4.1966, për “Sigurimet Shoqërore në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë”, në të cilin shprehej, në kapituj të veçantë, trajtimi i ushtarakëve aktivë pas daljes në rezervë, lirim a pension. Sipas këtij ligji, ushtarakët e Forcave të Armatosura që kishin nga 20-25 vjet punë, kur dilnin në lirim, mund të merrnin një pension të parakohshëm mujor të barabartë me 35 % të pagës i cili, bazuar në pagën mesatare të

¹⁰ Po aty, neni 18.

¹¹ Po aty, neni 11.

asaj kohe, rezultonte sa 80% e pensionit minimal. Në momentin që ushtarakët plotësonin moshën për pension (55 vjeç), merrnin pension të plotë, i cili ishte i njëjtë si edhe për nëpunësit dhe punonjësit e tjerë. Pra, gjatë kësaj periudhe nuk kishte një ligj të veçantë për trajtimin me pensione të ushtarakëve. Ky ligj i përgjithshëm i pensioneve, bashkë me ndryshimet e pësuar, trajtoi edhe ushtarakët deri në vitin 1993.

➤ Në periudhën e viteve 1991-2005

Sistemi aktual i sigurimeve shoqërore në Shqipëri filloi në vitin 1993, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 për “Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, tashmë i ndryshuar. Ndryshimi i marrëdhënieve ekonomike solli si pasojë edhe ndryshimin e strukturës sociale të shoqërisë sonë. Sistemi i ri i sigurimeve shoqërore reflektoi shumë ndryshime, duke parashikuar skema të panjohura më parë si: sigurimi vullnetar, suplementar apo krijimin e instituteve private të pensioneve. U vendos sigurimi suplementar, me synim përfitimin e pensioneve në një masë më të madhe ose më parë sesa ofron skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror. Baza ligjore e skemave suplementare të sigurimit është neni 4, i ligjit nr. 7703, datë 11.05.1993 për “Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Pjesë e rëndësishme e këtij sigurimi suplementar, është edhe sigurimi suplementar i ushtarakëve të Forcave të Armatosura, në të cilën shprehet: “*Sigurimi shoqëror për ushtarakët që shërbejnë në strukturat e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë bëhet sipas kriterëve të caktuara me ligj të veçantë*”¹².

Mbështetur në nenin 4, fillimisht dolën tre ligje që trajtojnë skemat suplementare për tre subjekte të veçanta, për nëpunësit civilë dhe personat që kryejnë funksione kushtetuese, për ushtarakët dhe për privatët, konkretisht: ligji nr. 7943, datë 01.06.1995 “Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensioneve”; ligji nr. 8097, datë 21.03.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit” si dhe ligji nr. 8087, datë 13.03.1996 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar, sot i shfuqizuar nga ligji nr. 10142 datë 15.05.2009.

Në fillim të viteve 1990, personeli i Forcave të Armatosura ishte i madh dhe i konsiderueshëm në numër. Në vitin 1991 trashëguam jo vetëm formacione të shumta së bashku me personelin, por edhe një bazë ligjore jo të plotë që trajtonte ushtarakët aktivë dhe ata në rezervë e në lirim. Hyrja e vendit tonë në proceset demokratike të fillimviteve '90, përveç të tjerash, përcaktoi edhe një qasje të re ndaj problemeve të sigurisë e të mbrojtjes së vendit dhe të personelit të Forcave të Armatosura, të përfshirë tashmë në një kontekst euroatlantik. Kjo qasje dhe përfshirje u shoqërua me reduktim të madh të personelit të Forcave të Armatosura, të filluar në muajin korrik të vitit 1992, e që ka vijuar edhe më pas, duke krijuar një masë të madhe të ish ushtarakëve që ndërprejnë karrierën ushtarake, duke kaluar në rezervë e në lirim. Sipas statistikave të kohës, në vitin 1991 “*Forcat e Armatosura kishin një efektiv të madh, si aktiv ashtu edhe rezervist, me rreth 16500 oficerë, 9000 nënoficerë, 60000 ushtarë e 8000 civilë rezervistë, rreth 450000 vetë dhe 230000 forca vullnetare, me 22 divizione dhe tre forca që ishin: mbrojtja kundërajrore, flota luftarake-detare dhe aviacioni*”¹³. Shtabi i Përgjithshëm kishte nën

¹² Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 4.

¹³ Marrë nga adresa elektronike: <http://www.aaf.mil.al/index.php/shtabipërgjithshëm>.

komandë 127 brigada këmbësorie, brigada artilerie dhe brigada sulmuese; rreth 1050 tanke, rreth 4000 gryka zjarri artilerie tokësore; 34 regjimente të artilerisë kundërajrore, pa llogaritur artilerinë kundërajrore të brigadave, etj¹⁴. Kjo masë e madhe e ushtarakëve që ndërprente karrierën ushtarake, nuk mund të liheshin pa përkujdesje dhe mbështetje financiare, pasi kjo lidhej edhe me ndikimin e madh social që do të kishte, por edhe me kontributin e kësaj kategorie personeli të dhënë në një periudhë të gjatë kohore.

Në këto kushte, në maj të vitit 1992, sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 225, datë 29.05.1992, u përcaktuan kriteret për trajtim financiar të ushtarakëve të dalë në rezervë për shkak të reformës në Forcat e Armatosura. Ndryshimet social-ekonomike të vendit në fillimet demokratike, si dhe riformulimi i sistemit të përgjithshëm të sigurimeve shoqërore, në vitin 1993, sollën si nevojë edhe përcaktimin e një skeme për trajtimin financiar të ushtarakëve aktivë dhe ushtarakëve në rezervë e në lirim. Pas miratimit të ligjit nr. 7496, datë 03.07.1991 për “Statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, e më pas të ligjit nr. 8087, datë 13.03.1996 për “Sigurimin shoqëror suplementar të Ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, u përfshi edhe trajtimi financiar i personelit të Policisë së Shtetit, i personelit të Shërbimit Informativ, i personelit ushtarak të Gardës së Republikës, etj. Megjithatë ligji hynte në fuqi menjëherë, ai nuk u zbatua për mosvënien në dispozicion të fondeve, por edhe për një rekomandim nga Gjykata Kushtetuese, sipas të cilit i propozohej qeverisë që të rishikonte dhe riformulonte në tërësi ligjin. Në vitin 1999, ligjit të mëparshëm të sigurimeve shoqërore suplementare të ushtarakëve iu bënë ndryshime themelore me ligjin nr. 8521, datë 30.07.1999. Thelbësore ishte dhënia e përfitimeve duke filluar nga data 01.01.1999, ku edhe këtu u përjashtua periudha 1992-1999, si dhe nuk u përfshi apo u përjashtuan ushtarakët e dalë në rezervë e lirim përpara datës 03.07.1991, datë e hyrjes në fuqi të statusit parë të ushtarakut, me ligjin nr. 7496, datë 03.07.1991 për “Statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.

Në periudhën 1992-1999, mbi bazën e akteve ligjore, ky trajtim është bërë me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 225, datë 29.5.1992 dhe më pas me Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 07, datë 10.1.1996, ku ushtarakët u trajtuan financiarisht me pagesë kalimtare, të barabartë me 50% të pagës në momentin e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës. Ky trajtim vijoi për periudhën nga viti 1992 deri në vitin 1998. Kjo periudhë trajtimi sipas Vendimit të KM nr. 254, datë 07.04.2005 është njohur si periudhë sigurimi për pension pleqërie, por kontributi është përcaktuar të llogaritet mbi pagën minimale si dhe pagesa e kontributeve bëhet nga buxheti i shtetit në kohën e daljes së ushtarakut në pension pleqërie. Për shkak të këtij vendimi, të gjithë ushtarakët që kanë dalë në pension në periudhën nga viti 1996 deri më 01.07.2009, kanë përfituar pensione minimale. Për periudhën nga viti 1999 e në vazhdim, ushtarakët kanë përfituar pagesë kalimtare, pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, pension suplementar mbi pensionin e pleqërisë, etj. Për shkak se ligji ishte pjesë e sistemit të përgjithshëm të Sigurimeve Shoqërore, trajtimet financiare janë kufizuar deri në dyfishin e pensionit minimal, sipas përcaktimit në ligjin bazë të pensioneve në vendin tonë, me ligjin nr. 7703, datë 11.05.1993 për “Sigurimin shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. ligji nr. 8087, datë 13.3.1996 për “Sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit

¹⁴ Po aty.

Informativ të Shtetit”, i ndryshuar, mbronte ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, etj. dhe jepte të drejtë për disa përfitime suplementare:

- Përfitim suplementar për paaftësi të përkohshme në punë.
- Parandalim dhe rehabilitim për sëmundje.
- Pagesa kalimtare kur nxirren në lirim.
- Pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi.
- Pension suplementar pleqërie për ushtarakët me status.
- Pension suplementar invaliditeti.
- Pension suplementar invaliditeti për ushtarakët që për shkak të detyrës bëhen të paaftë plotësisht.
- Pension suplementar familjar.
- Pension suplementar familjar për ushtarakët që për shkak të detyrës humbasin jetën.
- Pagesë suplementare në rast vdekjeje.

Përfitimet nga ky ligj janë financuar dhe garantuar nga buxheti i shtetit. Administrimi dhe pagesa e përfitimeve suplementare të përkohshëm është bërë nga ministritë e linjës, ndërsa administrimi dhe pagesa e pensioneve të të gjitha kategorive nga organi i specializuar, Instituti i Sigurimeve Shoqërore.

Për herë të parë në këtë ligj, në kohën e shërbimit aktiv në Forcat e Armatosura u përfshi edhe *“koha e plotë e vuajtjes së dënimit ose internimit për motive politike, para titullimit si ushtarak i shërbimit aktiv të përhershëm, kur është përfitues nga ligji nr. 7514, datë 30.09.1991 për “Pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë” dhe kur ushtarakët oficerë, nënoficerë, policë, ushtarë rrogëtarë kanë jo më pak se 5 vjet në strukturat e Forcave të Armatosura”*¹⁵.

➤ Në periudhën e viteve 2005-2009

Në vitin 2005 u miratua ligji nr. 9418, datë 20.5.2005 për “Sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”. Pas dekretimit nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, me dekret nr. 4623, datë 06.06.2005, ai u botua në Fletoren Zyrtare nr. 46, të vitit 2005, në faqen 1645 dhe do të hynte në fuqi në datën 01 janar 2006. Sipas nenit 33 të ligjit të sipërpërmendur, përcaktohet se ligji nr. 8087, datë 13.3.1996 për “Sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ të Shtetit”, i ndryshuar dhe aktet, e dala në zbatim të tij, pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, nuk do të zbatohen për ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që përfitojnë sipas këtij ligji.¹⁶

Ky ligj, akoma pa u zbatuar, u ndryshua. Ndryshimi u bë me ligjin nr. 9481, datë 16.2.2006 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9418, datë 20.05.2005 për “Sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” dhe u botua në Fletore Zyrtare nr. 33, viti 2006, në faqen 1077, për të hyrë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Sipas këtij ndryshimi, neni 32 ka përcaktuar se ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të neneve 3, 4, 13, 14, 16 e 31/1, brenda 1 muaji nga data e

¹⁵ Ligji nr. 8087, datë 13.3.1996, neni 7.

¹⁶ Fletore Zyrtare Nr. 46, të vitit 2005, në faqe:1645 e vijim.

hyrjes në fuqi të ligjit, si dhe se ka ndryshuar afati i zbatimit nga data 1 janar 2006 në datën 16 prill 2006.

Mbi bazën e kundërshtive të grupeve të interesit dhe dërgimin e disa neneve për gjykim për t'u shfuqizuar, Gjykata Kushtetuese, me vendim nr. 9, datë 26.02.2007, vendosi: *“Shfuqizimin si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të neneve 1, 7 (shkronjat “a”, “b”) e 9 të ligjit nr. 9481, datë 16.2.2006 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9418, datë 20.5.2005 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”¹⁷*. Ecuria e zbatimit të këtij ligji, mund të jetë një rast i veçantë. Ligji nr. 9418, datë 20.05.2005, i ndryshuar me ligjin nr. 9481, datë 16.2.2006, shprehur edhe Gjykata Kushtetuese me vendim nr. 09, datë 26.02.2007, qëndroi në fuqi për rreth 4 vjet, por nuk u zbatua asnjëherë për efekte financiare, mosdaljen e akteve nënligjore përkatëse për zbatimin e tij, të kundërshtive të grupeve të interesit, mosakordimin e buxhetit financiar që mbarte, etj. Në vitin 2009, u ndërmorën nisma për të studiuar dhe përgatitur një ligj gjithëpërfshirës në fushën e mbrojtjes sociale. Përveç personelit të Forcave të Armatosura, bashkë me Forcat e Armatosura u përfshinë edhe kategori të tjera, si: punonjësit e Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit Informativ të Shtetit, Policisë së Burgjeve, Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e punonjësit e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë dhe përfundimisht u miratua ligji nr. 10142, datë 15.05.2009, i ndryshuar me aktin normativ të Këshillit të Ministrave, aktualisht në fuqi.

➤ Periudha nga viti 2009 e në vijim

Ligji në fuqi për pensionet suplementare, ligji nr. 10142, datë 15.05.2009, i ndryshuar, bëri një zgjerim të subjekteve përfitues, duke përfshirë krahas Forcave të Armatosura dhe Policinë e Shtetit, strukturat e Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Policisë së Burgjeve, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Gardës së Republikës dhe shtriu efektet nga data 01.07.2009. Ky ligj, krahas të tjerave, vendosi kryerjen e rillogaritjen për të gjitha llojet e përfitimeve suplementare për të gjitha përfitimet suplementare dhe pensionet e parakohshme. Përveç zgjerimit të subjekteve të mbrojtur, ky ligj ndryshoi mënyrën e llogaritjes së përfitimeve, në të njëjtën kohë për efekt të unifikimit të masës së përfitimit të ushtarakëve me grupet e tjera sociale të mbrojtura, si dhe për uljen e ngarkesës së madhe financiare mbi buxhetin e shtetit.

Në një dispozitë të veçantë u përcaktuan modalitetet për rillogaritjen e të gjitha përfitimeve sipas dispozitave të këtij ligji si dhe u shfuqizuan të gjitha dispozitat e mëparshme që trajtonin këto lloje përfitimesh. Megjithëse ky ligj i shtrin efektet që nga data 01.07.2009, filloi të zbatohet pasi u plotësua me aktet nënligjore të dala më vonë si VKM nr. 793, datë 24.9.2010 *“Për zbatimin e ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009 për “Sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar. Ligji zgjidhi përfitimet e ish ushtarakëve në pension pleqërie, të dalë përpara hyrjes në fuqi të statusit të parë të ushtarakut, datë 03.07.1991, krijoi një skemë të re rillogaritjeje të pensioneve të pleqërisë për ata persona që kishin dalë në pension pleqërie dhe merrnin pensione minimale, për shkak të vendimit mëvonshëm nr. 254, datë 07.04.2005, si dhe

¹⁷ Vendim i Gjykatës Kushtetuese, nr. 09, datë 26.02.2007.

krijoi një skemë të kufizimit të pensionit të parakohshëm, deri në dyfishin e përfitimeve minimale.

Por, kjo ndryshoi të drejtat ligjore të përfitimeve të siguruara të ushtarakëve, të cilët nuk pranuan llogaritjet nga personat në pension të parakohshëm, pasi ishte kategoria më e madhe e përfituesve për këtë lloj pensioni, duke e dërguar çështjen në Gjykatën Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj nr. 33, datë 24.06.2010, vendosi shfuqizimin e pikës 2 të nenit 14 si dhe nenit 27 të ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009 dhe duke filluar nga data 27.6.2009 e në vazhdim, të gjitha pensionet e parakohshme për vjetërsi shërbimi të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë, duhet të rillogariteshin dhe nuk do të kufizoheshin me dyfishin e pensionit bazë, pra me pensionin maksimal të pleqërisë, por çdo përfitues për 15 vjet shërbim do të përfitonte një pension sa 50% e pagës referuese mesatare si dhe një shtesë 2% në vit të pagës referuese, për çdo vit shërbimi mbi 15 vjet për meshkujt dhe mbi 12 vjet për femrat, duke sjellë si pasojë efekte financiare shtesë. Për të rregulluar situatën ligjore pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr. 33 datë 24.06.2010, ligji nr. 10142, datë 15.05.2009, u ndryshua me ligjin nr. 10367, datë 23.12.2010 për “Miratimin e aktit normativ nr. 05, datë 10.11.2010 të Këshillit të Ministrave për “Disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10142, datë 15.05.2009 për “Sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Gjithashtu, një veçori tjetër që përfshiu ky ligj, së bashku me ndryshimet e pësuara, ishte edhe vjetërsia në shërbim. Pika 3 e nenit 3 bëri këtë përcaktim: “Për efekt të përlllogaritjes së përfitimeve, viti i shërbimit njihet vetëm kur është vit i plotë”¹⁸ për të gjitha llojet e përfitimeve suplementare. Sipas akteve, më e prekur ishte kategoria e përfituesve të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi. Masa e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi u përcaktua në këtë mënyrë:

- Pensioni i parakohshëm, për personat që plotësojnë kushtet e përfitimit, është 1.5 për qind e pagës mesatare referuese mujore neto, për çdo vit shërbimi.
- Në çdo rast, masa e pensionit të parakohshëm nuk mund të jetë më e ulët se pensioni bazë, i përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993 për “Sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
- Paga mesatare referuese neto llogaritet si mesatare e pagave referuese, sipas periudhave të qëndrimit në atë gradë apo funksion. Kjo llogaritje preku jo vetëm përfituesit e pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, por edhe të gjithë përfituesit për llojet e përfitimeve suplementare.

Ndryshimi i formulës së llogaritjes së masës së përfitimit të pensionit të parakohshëm për vjetërsi shërbimi me aktin normativ, bëri që pjesës dërrmuese të përfituesve të kësaj

¹⁸ Ligji nr. 10142, datë 15.05.2009, i ndryshuar, pika 3 e nenit 3, Fletore Zyrtare, nr. 87, viti 2009.

kategorie t'i ulej përfitimi mujor i fituar më parë. Kjo solli që mjaft ish-ushtarakë t'i drejtoheshin organeve gjyqësore.

Disa veçori të përkujdesjes dhe trajtimit financiar të ushtarakëve në rezervë, lirim e pension

Aktualisht, përkujdesja sociale e ushtarakëve në rezervë/lirim/pension realizohet nga strukturat e personelit në Forcat e Armatosura, ku pjesë e tyre janë edhe specialistët e përkujdesjes në forca, brigada, reparte. Puna e strukturës së Forcës së Armatosur për përkujdesjen e ushtarakëve në rezervë/lirim/pension lidhet ngushtë me zbatimin e ligjit nr. 9210 datë 23.03.2004 për "Statusin e Ushtarakut të FA të RSH", ligjit nr. 10142 datë 15.05.209 për "Sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të FA", i ndryshuar, VKM nr. 793 datë 24.09.2010, i ndryshuar, ligjit nr. 9128, datë 29.07.2003 për "Një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues në pension" i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9361 datë 24.03.2005 për "Një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë lundruar, të nëndetësve dhe polumbarëve të forcave detare, në pension", si dhe akte të tjera ligjore e nënligjore.

Strukturat e përkujdesjes së ushtarakëve në rezervë, lirim e në pension përpunojnë dokumentet për pagën mesatare referuese neto dhe vjetërsi shërbimi të ushtarakëve për këto lloje pensionesh të ish ushtarakëve për drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore:

- pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi;
- pension suplementar mbi pensionin e plotë të pleqërisë;
- pension suplementar invaliditeti;
- pension suplementar familjar;
- pension suplementar familjar, kur, për shkak të detyrës, humbasin jetën.

Struktura për përkujdesjen e ushtarakëve në rezervë, lirim e në pension ka mision zbatimin e politikave sociale për trajtimin financiar të ushtarakëve në rezervë, lirim e në pension dhe familjeve e tyre, si dhe përpunimin e dokumentacionit për Sigurimin Shoqëror Suplementar të ushtarakëve në rezervë, lirim e në pension, në përputhje me kërkesat ligjore e nënligjore.

Krahas akteve ligjore e nënligjore, disa aspekte të përkujdesjes janë përcaktuar edhe në politika të veçanta. "Strategjia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore të FASH"¹⁹ është një dokument që përcakton disa drejtime në pjesën 12, për nxjerrjen në rezervë, lirim e pension të ushtarakëve si për mirënjohjen, riintegrimin në jetën civile, veteranët dhe ushtarakët në rezervë, por që ka nevojë për rritje të përkujdesjes faktike të kësaj kategorie.

Struktura për përkujdesjen e ushtarakëve në rezervë, lirim e në pension, aktualisht është e shtrirë në forca, brigada, reparte dhe si një strukturë e përqendruar është Qendra e Personel Rekrutimit, e cila administron edhe të gjitha dosjet e personelit të ushtarakëve në rezervë, lirim e në pension. Këto struktura përpunojnë dokumentacionin e duhur dhe iu përgjigjen kërkesave të kësaj kategorie që kanë lidhje me daljet e ish-ushtarakëve në pension apo dokumentet e kërkuara nga sigurimet shoqërore në qarqe. Veçanërisht, Qendra e Personel Rekrutimit ka kryer një punë voluminoze për përgatitjen e dokumentacionit për pensionet suplementare të ish-ushtarakëve.

¹⁹ Strategjia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në FASH", miratuar me Urdhrin e Ministrit të Mbrojtjes, Nr. 1778, datë 02.11.2011.

Është e nevojshme që personeli që merret me përpunimin e dokumentacionit të ish ushtarakëve të punojë për njohjen e akteve ligjore e nënligjore të fushës së sigurimeve shoqërore suplementare të ushtarakëve; të ketë përzgjedhje të personelit më të mirë e të kualifikuar nga radhët e ushtarakëve në rezervë për të punuar në strukturat e përkujdesjes së ushtarakëve në rezervë, lirim e në pension; të bëhet hartimi i procedurave standarde të punës; freskimi i listave të përfituesve të pensioneve suplementare të ushtarakëve në rezervë, lirim e në pension dhe njehsim procedurash; krijim e përditësim i *data base* të përgjithshëm për përpunimet e pensioneve suplementare. Nga puna e bërë dhe përvoja e fituar, nevojitet: përshpejtimi i procedurave për përqendrimin e të dy dosjeve të personelit ushtarak në rezervë, lirim, pension (oficer, nënoficer dhe ushtar profesionist) në administrim të strukturave të Forcave të Armatosura (një dosje në Qendrën e Personel-Rekrutimit dhe tjetra në komandat e forcave, brigadave, etj.) në një vend e të bashkuara, duke plotësuar çdo dokument nga momenti i daljes në rezervë, lirim deri në trajtimin me pagesë kalimtare dhe çdo trajtim suplementar ushtaraku. Por, zgjidhje ligjore kërkohet edhe për ish-ushtarakët dhe nënoficerët e dalë në pension përpara datës 03.07.1991, për të cilët nuk administrohet dosje personeli si dhe për ish ushtarakët e sistemit të prokurorisë e të drejtësisë, etj.

Mendime dhe vlerësime për përmirësime të mëtejshme të përkujdesjes sociale të ushtarakëve në rezervë, lirim, pension

Përqendrimi i dy dosjeve (një dosje në Qendrën e Personel Rekrutimit dhe tjetra në komandat e forcave, brigadave, etj.) të personelit ushtarak në rezervë, lirim, pension, përfshi edhe të gjitha dosjet e personelit ushtarak e civil që ka punuar në Forcat e Armatosura, shtron domosdoshmërinë e përmirësimit të strukturës së përkujdesjes sociale të ushtarakëve në rezervë, lirim, pension, në një organizim të ri. Kjo strukturë, mbi bazën e punës së bërë deri tani, të përmirësojë shërbimin për kategorinë e ushtarakëve në rezervë, lirim, pension, duke përdorur avantazhet e teknologjisë së informacionit dhe detyrat e përcaktuara nga “Programi i Qeverisë 2013-2017”.

Struktura e përkujdesjes së ushtarakëve në rezervë, lirim, pension, krahas ndryshimeve të akteve ligjore e nënligjore, ka nevojë që të ndryshojë në mision, në emërtim, në sasi, në përmbajtje, etj. Këto lidhen me rritjen e numrit të ushtarakëve në rezervë, lirim, pension (aktualisht janë mbi 35 000 dosje personale të ushtarakëve në rezervë, lirim, pension) si dhe parashikohet rritja e tyre në vite, si rezultat i shkurtimeve të numrit të personelit aktiv në Forcat e Armatosura. Probleme lidhen me vijimësinë e zbatimit të ligjit nr. 9128 datë 29.07.2003 “Për një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension” i ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9361 datë 24.03.2005 për “Një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë lundrues, të nëndetëseve dhe polumbarëve të Forcave Detare, në pension”. Por, në mënyrë të veçantë, vijimësia e përkujdesjes për ushtarakët në rezervë, lirim, pension që lidhet edhe me:

- Aplikimin e ushtarakëve në rezervë, lirim të vitlindjes së radhës, që plotësojnë moshën ligjore për dalje në pension pleqërie dhe llogaritja e pensionit suplementar, mbi pensionin e pleqërisë.
- Aplikimin për herë të parë të ushtarakëve në rezervë, lirim që ndërpresin periudhën e trajtimit me pagesë kalimtare ose e plotësojnë atë, sipas nenit 12 të ligjit nr. 10142, datë 15.05.2009 (i ndryshuar), apo ushtarakët në rezervë, lirim të tjerë që plotësojnë moshën 42 vjeç për femrat dhe 47 vjeç për meshkujt,

përfitues për herë të parë në skemën e trajtimit me pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, si përfitues për llogaritje të pensionit suplementar, pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi.

- Aplikimin e shtetasve të vitlindjes së radhës, që plotësojnë moshën ligjore për dalje në pension pleqërie, por që gjatë karrierës së tyre kanë vite pune si ushtarak aktiv në FA, si përfitues për llogaritjen e pensionit suplementar, mbi pensionin e pleqërisë.
- Aplikime të reja në Drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore në qarqe, për lloje të ndryshme të pensioneve suplementare, për të cilat kërkohet llogaritja e pensionit suplementar sipas llojit që i takon, sidomos për pensione familjare, invaliditeti, etj.
- Aplikime të reja në drejtoritë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore në qarqe, për pensione suplementare mbi pensionin e pleqërisë për kategorinë oficer e sidomos nënoficer të dalë në pension përpara hyrjes në fuqi të ligjit nr. 7496, datë 03.07.1991 për “Statusin e Ushtarakëve të FA të RSH”.
- Aplikime të institucioneve tjera qendrore si: Ministria e Punëve të Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit), Garda e Republikës së Shqipërisë, Policia për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimi, Ministria e Drejtësisë (Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Burgjeve dhe Institucioneve të Ekzekutimit të Veprave Penale), Shërbimi Informativ i Shtetit, institucione të tjera kushtetuese, qendrore, në prefektura, qarqe, si dhe ato vendore.
- Kërkesa të ndryshme të ushtarakëve në rezervë, lirim, pension për vërtetimin e vjetërsisë së përgjithshme të punës në Forcat e Armatosura për dalje në pension pleqërie; për pagën referuese për periudhën e trajtimit financiar të ushtarakëve, sipas VKM nr. 225, datë 29.05.1992 dhe VKM nr. 07, datë 10.01.1996; e dokumente të tjera, të kërkuara nga ana e tyre.

Përfundime dhe rekomandime

Vendi ynë ka e do të ketë nevojë për Forcat e tij të Armatosura. Në këto kushte, është e nevojshme mbajtja e një force në sasi që të përmbushë misionin kushtetues, por edhe për trajtim e përkujdesje si për ushtarakët aktivë, ashtu edhe për ushtarakët në rezervë, lirim e në pension.

Karakterit i veçantë i detyrës dhe shërbimit ushtarak, numri i madh i ushtarakëve në rezervë, lirim e në pension, kontributi i tyre i dhënë në Forcat e Armatosura, anëtarësia në NATO dhe integrimi i plotë në këtë strukturë, shtrojnë domosdoshmërinë e përmirësimit të akteve ligjore e nënligjore në mbështetje të ushtarakut, ashtu siç është përcaktuar në “Programin e Qeverisë 2013-2017”, sidomos pjesa e legjislacionit që ka të bëjë me përkujdesjen ndaj tij pas liritimit nga shërbimi aktiv, akte që rregullojnë përkujdesjen dhe trajtimin e tij në varësi të kontributit në Forcat e Armatosura. Një standard i arritur asnjëherë nuk duhet ulur e përkeqësuar, por, niveli i arritur vetëm duhet të përmirësohet. Lipset rishikim e ripunim i legjislacionit për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve, në harmonizim me ligjin “Për statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë” dhe vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr. 09, datë 26.02.2007 dhe nr. 33, datë 24.06.2010.

Ky kuadër ligjor ka nevojë të bëjë përcaktime e detyrime për institucione e struktura përkatëse, si në Ministrinë e Mbrojtjes, ashtu edhe në strukturën përkatëse për përkujdesjen e ushtarakëve në rezervë, lirim e në pension. Përkujdesje e mbështetje duhet dhënë edhe që mbështetja juridike të jetë falas për ushtarakun për kategori të caktuara të çështjeve gjyqësore, sidomos për ato që lidhen me mbrojtjen e të drejtave ligjore të ushtarakut. Duhet rritje reale e përkujdesjes ndaj ushtarakëve në rezervë, lirim e në pension, thjeshtim e saktësim i procedurave përkatëse për përkujdesje e përfitime suplementare.

Përmirësimi i hapësirës ligjore e nënligjore kërkon edhe një strukturë të studiuar mirë e të përqendruar si për administrimin e dokumentacionit, përqendrimin e të gjitha dosjeve të personelit ushtarak nga momenti i daljes në rezervë, lirim e deri në trajtimin e mbështetjen me dokumentacion të nevojshëm për çdo kategori. Reduktimi i personelit aktiv të Forcave të Armatosura, sipas “Dokumentit të Rishikimit të Strategjisë së Mbrojtjes” dhe “Programit të Qeverisë 2013-2017”, do të rrisë numrin e ushtarakëve në rezervë e në lirim. Rritja e numrit të ushtarakëve në rezervë, lirim e në pension, ka nevojë të shoqërohet me një strukturë të studiuar mirë dhe me njerëz të përzgjedhur, të aftë dhe të përkushtuar, sidomos nga ushtarakë aktivë dhe nga ushtarakët në rezervë me përvojë në këtë fushë.

Kërkohet shfrytëzimi i teknologjisë së informacionit të sotëm për rritjen e përkujdesjes edhe të nevojave të ushtarakëve në rezervë, lirim, pension për dokumente të ndryshme të kërkuara.

Është e nevojshme të zbulohen rrugë e mundësi të reja për lobing për ushtarakët në legjislativin shqiptar por edhe në ekzekutiv e institucione të tjera qendrore e vendore.

Shoqatat aktuale të ushtarakëve në rezervë e në lirim duhet të gjejnë fushat e bashkëpunimit e të afrimit me njëra-tjetrën, për të arritur deri në bashkimin në një organizatë të vetme për mbrojtjen e të drejtave të ushtarakëve të kësaj kategorie.

Anëtarësimi i shoqatave shqiptare të ushtarakëve të liruar në Konfederatën Ndëraleate të Oficerëve në Rezervë (CIOR) është një hap pozitiv në forcimin e identitetit të tyre, por që ka nevojë të bëhet më shumë në drejtim të tërheqjes prej Konfederatës të ekspertizës dhe mbështetjes së nevojshme për mbrojtjen e të drejtave të ushtarakëve shqiptarë.

Është e nevojshme të ketë përmbledhje, botime e manuale ushtarake, për përkujdesjen e ushtarakëve aktivë dhe në rezervë, lirim e në pension, për t’u ardhur në ndihmë strukturave të personelit, financës, komandave të çdo niveli dhe vetë kategorisë së ushtarakëve aktivë dhe ushtarakëve në rezervë, lirim e në pension.

Bibliografia:

- AQFA, Fondi 48/112.
- Ligji nr. 129, datë 28.10.1927 për “Pensionet civile”, Fletoren Zyrtare e datës 08.11.1927, nr. 91, marrë nga adresa <http://www.issh.gov.al>
- Ligji nr. 4171, datë 13.4.1966 për “Sigurimet Shoqërore në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë”.
- Ligji nr. 7496, datë 03.07.1991 për “Statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.
- Ligji nr. 7514, datë 30.09.1991 për “Pafajësinë, amnistinë dhe rehabilitimin e ish-të dënuarve dhe të përndjekurve politikë”, i ndryshuar.
- Ligji nr. 7703, datë 11.05.1993 për “Sigurimin shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar,

- Ligji nr. 8087, datë 13.3.1996, për “Sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të ushtarakëve të Ministrisë së Rendit Publik dhe të Shërbimit Informativ të Shtetit”, i ndryshuar,
- Dekreti nr. 758, datë 1.2.1994, për “Një mbrojtje të veçantë të ushtarakut”,
- Ligji nr. 9128 datë 29.07.2003, për “Një trajtim të veçantë financiar të pilotëve fluturues, në pension”, i ndryshuar,
- Ligji nr. 9171, datë 22.01.2004, për “Gradat dhe karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.
- Ligji Nr. 9210, datë 23.3.2004, për “Statusin e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”.
- Ligji Nr. 9361 datë 24.03.2005, për “Një trajtim të veçantë financiar të efektivave, oficerë dhe nënoficerë lundruar, të nëndetësve dhe polumbarëve të forcave detare, në pension”.
- Ligji nr. 9418, datë 20.5.2005, për “Sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,
- Ligji nr. 10142, datë 15.5.2009, për “Sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 225, datë 29.05.1992 për “Trajtimin financiar të ushtarakëve që dalin në lirim nga zbatimi i reformës në strukturat e Forcave të Armatosura”, i ndryshuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 07, datë 10.01.1996,
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 254, datë 07.04.2005 për “Njohjen ushtarakëve të Forcave të Armatosura si periudhë sigurimi të periudhës së trajtimit financiar, sipas Vendimit nr. 225, datë 29.5.1992 të Këshillit të Ministrave për “Trajtimin financiar të ushtarakëve, që dalin në lirim nga zbatimi i reformës në strukturat e Forcave të Armatosura”.
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 793, datë 24.9.2010 “Për zbatimin e Ligjit Nr. 10142, datë 15.5.2009 për “Sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar,
- Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 252, datë 9.2.2011 për “Disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin nr. 793, datë 24.9.2010 të Këshillit të Ministrave për “Zbatimin e ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009 “ Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar “.
- Vendimet e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë nr. 09, datë 26.02.2007 dhe nr. 33, datë 24.06.2010.
- Programi i Qeverisë 2013-2017, nga adresa: <http://www.kryeministria.al/al/programi>
- Strategjia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në FASH”, miratuar me Urdhër të Ministrit të Mbrojtjes, nr. 1778, datë 02.11.2011.
- Gazeta “Ushtria”, datë 28.12.2012.-
- Adresa elektronike: <http://www.aaf.mil.al/index.php/shtabipergjithshem>
- Adresa elektronike: <http://www.iss.gov.al/>

Angazhimi në shoqëri i ushtarakëve në pension

Major Festim Alimadhi

Trajtesë e shkurtuar. *Zhvillimi i shoqërisë njerëzore ka sjellë në histori dhe ridimensionimin e rolit të shtetit në raport me qytetarët e vet, përsa i përket detyrimeve dhe të drejtave të ndërsjellta. Modeli i shteteve, sipas organizmit të tyre politik, regjimit apo sipas klasifikimit të sistemit ekonomik, nuk ka të bëjë në thelb me ndonjë vështirësi të kuptimit filozofik, por ka të bëjë me sasinë e shërbimeve që shteti i ofron qytetarit dhe vetëkputohet dhe me cilësinë e këtyre të fundit.*

Konsolidimin e shteteve dhe nivelin e tyre të demokracisë e shohim në raportin që ai krijon me qytetarët dhe shërbimet që ofron ndaj tyre. Sot, shumë organizma ndërkombëtarë, publikë ose joqeveritarë, si njësi matëse për renditjen e shteteve, kanë në qëndër të studimeve të tyre pikërisht shërbimet që ofrohen nga shteti, mënyrën dhe kohën kur ofrohen, kuptohet edhe cilësinë e tyre, apo nëse një shtet i ofron të gjitha shërbimet që ai duhet të realizojë për qytetarët e vet. Pikërisht në këta elementë, duke bërë krahasimin me shtetet e tjera, bëhet pozicionimi në renditje i secilit shtet në listë.

Prej viteve 60, në fjalorin e politikës dhe studiuesve hyri dhe përdoret sot gjerësisht termi “Shtet Social”¹. Ky term lindi si pasojë e pozicionimit të rolit të shtetit në raport me shërbimet që ai duhet t’u ofrojë qytetarëve të vet, në raport me nivelin e pagesave që qytetari duhet të bëjë për këto shërbime, duke marrë në konsideratë të ardhurat e tij. Shteti, pavarësisht formës së regjimit, ka detyrimin t’u shërbejë të gjithë qytetarëve pa dallim shtrese shoqërore, duke marrë në mbrojtje shtresat në nevojë.

Sikundër e konsideron Gidensi, sot jetojmë të sigurtë falë “dijes së ekspertëve²”, tek të cilët kemi besim pa i njohur. Për këtë arsye, trajtimi i tyre dhe puna me ta merr rëndësi të veçantë. Me ndryshimet e shumta që ndodhën në botë pas rënies së Perdes së Hekurt, shndërrimet e mëdha ekonomike, por sidomos ato politike, kanë vënë në diskutim rolin e shtetit³ për shërbimet që ai duhet t’u ofrojë qytetarëve, nëse këto shërbime duhet të jenë publike apo private. Kapitali njerëzor është shumë i rëndësishëm me punën dhe dijet e tij profesionale.

Objekti i këtij shkrimi është trajtimi që shteti duhet të bëjë për qytetarët e vet në prag të daljes së tyre në pension.

¹ Giddens, Anthony, “Sociologjia” Botim për Shoqërinë e Hapur. Toena. Viti 1999. f. 256.

² Giddens, Anthony, “Pasojat e Modernitetit”. Botim. UET Press. 2013, f. 91.

³ Pearson, Cristopher, “Shteti modern”, Botim AAIS. Viti 2010. f. 166.

Politikat shoqërore të shtetit

Në botën perëndimore, sistemi i ekonomisë së tregut hartoi dhe zbatoi programe shoqërore për popullsinë. Në sistemin socialist mbështetja dhe mbrojtja shoqërore ishte publike, pasi për vetë sistemin, më të rëndësishëm ishin shoqëria dhe shteti sesa individi. Ndërsa në sistemin e demokracive perëndimore, për shkak të rolit të shtetit dhe zgjerimit të lirive dhe të drejtave politike të njeriut, u zhvilluan dy lloj sistemesh të programeve shoqërore në lidhje me mënyrën se si shteti i ofron këto shërbime sociale që ka si detyrim për qytetarin. Këto ndryshime u bënë më të thella në vitet 1960-1970, me lëvizjet rinore që u quajtën “*revolucionet kulturore*”, të cilat sollën si pasojë edhe rishikimin e programeve sociale. Këto lëvizje qytetare sollën edhe rikonfigurimin e programeve politike të partive. Por, për shkak të situatës politike dhe të sigurisë së botës në atë periudhë, për shkak të ndarjes së saj në dy blloqe, NATO dhe Traktati i Varshavës, shtetet e secilit bllok ishin të detyruara të investonin në sigurinë dhe mbrojtjen e vendit të tyre, si në aspektin individual edhe në atë kolektiv të bllokut ku ishin angazhuar.

Dështimi i sistemit socialist, paralelisht me zhdukjen e kërcënimit për luftë, bëri që të gjitha shtetet të shikonin veten në interes të zhvillimit ekonomik dhe të përmirësimit të jetës së qytetarëve të tyre. Madje u reformua dhe koncepti i sigurisë, duke futur si elementë sigurinë njerëzore madje dhe atë gjinore⁴. Kjo shpjegon faktin që në periudhën 1990-1996, pothuajse në të gjithë botën perëndimore, fituan partitë e majta. Por këto ndryshime sollën dhe një ripërcaktim të rolit të shtetit në zhvillimin ekonomik dhe të operatorëve jopublikë në të. Aktualisht njihen katër modele të programeve sociale nga shtetet:

1. Modeli evropian, ku shërbimet dhe sigurimet që forcon shteti janë tërësisht publike, duke marrë subvencionim nga shteti, ndërsa shteti merr taksat dhe tatimet nga popullsia, duke siguruar financimin e programeve sociale, edhe kur të ardhurat nga pagesat e këtyre shërbimeve nuk mbulojnë shpenzimet. Shteti, në rastet kur të ardhurat e këtyre shërbimeve janë më të pakta se shpenzimet që kërkon mbajtja e tyre, subvencionon nga buxheti që këto shërbime të jenë sa më efikente. Në këtë kuadër, vlen të përmendet shembulli i vendeve skandinave (Suedi, Norvegji, Finlandë, Danimarkë) apo atyre të Beneluksit (Belgjikë, Hollandë, Luksemburg). Pikërisht, etiketimi i këtyre vendeve si “shtete sociale” është mëse i drejtë pasi janë vendet të cilat zënë vendet e para në renditjen e OKB-së, jo vetëm për mirëqënien e popullsisë, por dhe për shërbimet publike për të.

2. Modeli anglosakson, por jo vetëm, ku shteti ka privatizuar shërbimet. Duke qenë shtete me pak taksa, pasi shteti vetë ofron pak shërbime publike ose asnjë, ngaqë i privatizon, dhe operatorë privatë ofrojnë shërbimet për popullsinë. Shteti mbikëqyr punën e operatorëve për cilësinë dhe ndërhyr kur ka probleme në përmbushjen e detyrimeve sipas kushteve kontraktuale.

3. Modeli i vendeve arabe, ku futen Katari, Arabia Saudite dhe Emiratet e Bashkuara Arabe, ku për shkak të të ardhurave të jashtëzakonëshme nga nxjerrja dhe eksporti i naftës, nuk ka një sistem tatimor dhe taksash në kuadrin e programeve sociale që shteti u ofron qytetarëve. Kjo nënkupton se në shtetet e mësipërme, të gjitha shërbimet jo vetëm që janë publike, duke mos pasur asnjëherë mendime për privatizimin e tyre, por ato u ofrohen qytetarëve të tyre falas nga shteti, duke u shndërruar në modelin e shtetit ideal. Pra një qytetar saudit, apo nga Katari dhe Emiratet e Bashkuara Arabe, nuk paguan

⁴ Collins. Alan, “Studime Bashkëkohore të Sigurisë”, UETPress. 2010, f.108- 145.

asnjë lloj takse dhe tatimi për shtetin, duke e pasur pagën unitare (pa ndryshim midis asaj bruto dhe neto) dhe shërbimet publike që ofrohen nga shteti janë totalisht falas. Është për t'u verifikuar se sa do të rezistojë ky lloj modeli, duke qenë varësia nga rezervat e naftës.

4. Modeli socialist, model në të cilin kaluam edhe ne. Ende në botë ka vende socialiste si Kuba, Koreja e Veriut, apo Kina e cila është një përzjerje socializmi me kapitalin e huaj. Ka dhe shtete të tjera diktatoriale të cilat funksionojnë në formën e shteteve socialiste. Shërbimet janë tërësisht publike dhe në përgjithësi, sjellja sociale e shtetit është edhe ideologji.

Programe sociale të shtetit për personat në prag pensioni

Zhvillimi shoqëror solli modernizimin, i cili solli rishikimin e të gjitha shkencave dhe të arsimit, duke i ndarë studimet e fushave në disiplina, dhe këto disiplina në nëndisiplina të tjera, përgatitjen profesionale të punonjësve të fundshekullit të 20-të dhe të fillimshekullit të 21-të. Pikërisht këto zhvillime bënë që jo vetëm në sektorin publik, por edhe në atë jo publik, të dilte në pah rëndësia e *Burimeve Njerëzore*, përgatitja dhe kualifikimi i të cilëve merrte rëndësi të jashtëzakonshme për t'i bërë ballë sfidave të reja. Por këto burime njerëzore të arsimuara, të kualifikuara dhe të ndërlidhura dhe me përvojën e bënin dhe e bëjnë edhe sot shumë të vështirë zëvendësimin e tyre, prandaj kërkohej dhe një politikë e mirë e mbajtjes dhe trajtimit për kushtet e punës dhe të jetesës.

Një ndër momentet më të rëndësishme për këto *Burime Njerëzore*, në të cilin duhet të bëhet edhe mbyllja e karrierës është momenti i daljes në pension të tyre. Ky moment është shumë i rëndësishëm jo vetëm për vendin e punës ku ka punuar ky punonjës, në sektorin publik apo privat, por edhe për faktin se është një moment i rëndësishëm në jetën e tij që mbart në vetvete ngarkesë emocionale dhe sociale për ndryshimet e shumta që do të ketë jeta e tij pasi të shkëputë marrëdhëniet me punën. Të gjitha vendet e demokracive perëndimore kanë punuar edhe për këtë moment për shtetasit e tyre, për të qenë sa më i lehtë ky kalim nga pikëpamja psikologjike por edhe sociale në jetën e tyre. Në vendin tonë mungon përvoja e këshillimit para daljes në pension për gjithë popullsinë e brezit që përgatitet për të dalë në pension pleqërie. Një ndërmarrje e tillë po përgatitet aktualisht në Ministrinë e Mbrojtjes, sipas modelit të SHBA-ve për ushtarakët dhe civilët që punojnë në ushtri, nën konsulencën dhe ndihmën amerikane, atashuar pranë saj, duke qenë në këtë mënyrë në pararojë të ndryshimeve pozitive sociale në vend.

Përvoja perëndimore

Përvoja e shteteve perëndimore në këtë fushë është e bollshme, duke siguruar trajnim/këshillim për të gjithë personelin, si atë që punon në sektorin publik dhe atë që punon në sektorin jopublik, për përgatitjen e tij sidomos nga ana psikologjiko-sociale për organizimin e jetës pas shëkuptjes nga puna dhe kalimin në pension pleqërie. Përvoja e ushtrive perëndimore, në këtë drejtim, përbën një përvojë të vyer për t'u marrë shembull dhe për t'u zbatuar në kushtet e vendit tonë, për ushtarakët të cilët shkëputen nga shërbimi aktiv ose që kalojnë në pension pleqërie. Këshillimi i personelit ushtarak dhe civil që shërben në MM dhe FA, i cili i afrohet moshës për t'u shkëputur nga shërbimi aktiv ose për të kaluar në pension pleqërie, fillon nga 2 vjet deri në 3 muaj para shkëputjes nga puna, deri në shkëputjen e plotë nga puna aktive dhe kalimi në pension.

Përvoja kanadeze është ndër më praktiket, në këtë drejtim, për t'u marrë në konsideratë.

Në ushtrinë kanadeze organizohen kurse trajnimi/këshillimi me personelin ushtarak dhe civil që shëben në ushtrinë kanadeze. I gjithë personeli, pa dallim grade, funksioni dhe kualifikimi, në një moshë të caktuar kur përgatitet për pension pleqërie, ose për t'u shkëputur nga shërbimi aktiv, sipas vjetërsisë në shërbim dhe në gradë, shkëputet nga puna për të kaluar në kurset e këshillimit/trajnimit për këtë qëllim. Kurset organizohen nga departamentet e menaxhimit të burimeve njerëzore dhe përkujdesjes sociale, në bashkëpunim me universitetet, institute studimi publike dhe jopublike, ministritë e çështjeve sociale, kompanitë e sigurimeve, etj., me të cilët lidhet kontratë bashkëpunimi dhe në varësi të periudhave të përcaktuara gjatë vitit, organizohen kurset me kohë-zgjatje 1-2 javore, për personelin i cili mbush moshën ose vjetërsinë e shërbimit.

Drejtues të këtyre trajnimeve janë drejtorët/shefat e Sektorit të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore dhe të Përkujdesjes Sociale në këto institucione, të cilët planifikojnë personelin që do të marrë pjesë në këto trajnime dhe lajmërojnë atë, duke koordinuar periudhat kur e dëshirojnë gjatë vitit. Nuk lejohet shtyrja për vitin tjetër për asnjë person i cili ka mbushur moshën e caktuar, ose për ushtarakët në prag vitet e shërbimit. Drejtuesit ose shefat e sektorëve koordinojnë punën me veprimtarinë e javës së këshillimit, me lektorët të cilët do të flasin gjatë periudhës së kursit, me oraret dhe temat përkatëse. Kryesisht lektorët, pavarësisht se vijnë nga universitetet, institutet e studimeve, apo ministritë dhe kompanitë e sigurimeve, janë specialistë të fushave të mëposhtme:

1. juristë;
2. ekonomistë;
3. sociologë;
4. psikologë;
5. administratorë/menaxhim personeli;
6. diplomatë/konsuj;
7. vullnetarë në pension/përfaqësues të Shoqatave të Pensionistëve, etj.

Të gjithë këta lektorë, sipas fushave përkatëse, informojnë pjesëmarrësit në kurset e këshillimit/trajnimit për situatën e tyre psikologjike, jetën sociale, përfitimet dhe humbjet ekonomike-financiare, mundësitë që u ofrohen për punësime dhe punë vullnetare, mundësitë dhe pozicionin e shtetit në arenën ndërkombëtare, pas daljes së tyre në pension ose shkëputjes nga shërbimi aktiv. Nëse do të bënim një zberthim më të saktë për ta kuptuar:

1. Lektori *Jurist* informon mbi të drejtat që përfitojnë nga trajtimi që shteti iu bën personave në pension pleqërie. Ai i njuh me ligjet që janë në fuqi dhe çfarë humbasin dhe përfitojnë shtesë, pasi të kalojnë në kategorinë sociale të *Moshës së Tretë* (Pension Pleqërie)
2. Lektori *Ekonomist* informon mbi trajtimin ekonomik që përfitojnë pasi të kalojnë në pension pleqërie ose shkëputje nga shërbimi aktiv. Ai shpjegon se si të përlllogarisin pensionin, si organizohen taksat dhe tatimet, cilat shërbime përfitojnë pa pagesë, në cilat shërbime iu përgjysmohet pagesa, cilat mbeten siç kanë qenë dhe më parë.
3. Lektori *Sociolog* përshkruan jetën të cilën e pret një individ pasi del në pension. Ndryshimi i marrëdhënieve shoqërore, shfrytëzimi i kohës në dispozicion, kontributi në komunitet dhe probleme të tjera sociale.
4. Lektori *Psikolog* njihet me organizimin aktual të jetës së individit dhe bën përgatitjen psikologjike të tij për një jetë krejt ndryshe, për organizimin e saj në kushtet e një kohe

më të shumtë në dispozicion dhe të një ngarkese tjetër psikologjike, në formën e rekomandimeve.

5. Lektori *Administrator/Menaxhim Burimesh Njerëzore* rekomandon dhe këshillon për të shfrytëzuar mundësitë që iu jepen në kalimin në jetën civile ushtarakëve që shkëputen nga shërbimi aktiv, ose për personelin i cili del në pension, si mund të aktivizohet në punë ose vullnetarë pa pagesë në sektorin publik dhe privat, në përputhje me kualifikimin dhe përvojën profesionale, të fituar gjatë jetës.

6. Lektori *Diplomat/Konsull* ose personel i kualifikuar në *Marrëdhëniet me Jashtë*. Roli i tij është kryesisht informues në lidhje me organizimin e infrastrukturës diplomatike dhe konsullore që organizon shteti, të cilat i mbulon me infrastrukturë të Trupit Diplomatik, ose që mbulohet me shërbim në përbërje të ambasadave të tjera. Ky lloj këshillimi ka për qëllim që personeli, i cili përgatitet për t'u shkëputur nga shërbimi aktiv ose përgatitet për të dalë në pension, të dijë se në cilat shtete mund të udhëtojë pa vizë, për cilat shtete i duhet të marrë vizë, ku mund të drejtohet për ndihmë, nëse ndodhet jashtë vendit për arsye turizmi ose në përbërje të organizatave humanitare e jofitimprurëse, por edhe si duhet të drejtohet.

Këta lektorë informojnë gjithashtu për programet e ndihmës që shteti ofron në pjesë të ndryshme të globit, në kuadrin e organizatave ndërkombëtare ose individualisht, në formën e ndihmave dhe donacioneve. Informojnë gjithashtu për shërbimin që iu ofrohet shtetasve, në rast se kanë probleme me institucionet lokale ose shtetërore në rajonet ku shkojnë, në rast problemesh ligjore dhe diplomatike gjatë veprimtarisë së tyre atje. Sqarohet gjithashtu edhe problemi i procedurave të azilit apo të drejtës së bashkimit familjar, nëse gjatë këtyre udhëtimeve, ka njohje të ndryshme dhe kërkohet të tërhiqen në shtetin e tyre njerëz të ndryshëm.

Ky lloj shërbimi merr një rëndësi të veçantë pasi shumë persona, kryesisht kur dalin në pension anëtarësohen në shoqata dhe organizata humanitare kombëtare ose ndërkombëtare, duke shkuar në shtete të ndryshme për të kontribuar vullnetarisht në role të ndryshme, kryesisht në profesionin që ata kanë ushtruar dhe sipas kualifikimit që kanë. Është në kulturën dhe mentalitetin e shteteve perëndimore që pensionistët të angazhohen vullnetarisht në organizata ndërkombëtare humanitare, sidomos personeli që ka shërbyer në sistemin shëndetësor dhe arsimor, pasi kontributi i tyre është shumë i nevojshëm në vendet e dala nga luftërat dhe konfliktet, ose në vendet në zhvillim, ku shërbejnë dhe si këshilltarë për strukturat e shteteve ku shkojnë në mision.

7. Lektorët *Vullnetarë në Pension/Përfaqësues të Shoqatave të Pensionistëve* informojnë mbi përvojën e tyre, duke qenë se e kanë kaluar këtë fazë, duke treguar se ku mund të angazhohen në veprimtari të dobishme shoqërore, të anëtarësohen në shoqata të ndryshme për mbrojtjen e të drejtave të tyre, veprimtari dhe takimet që realizojnë, bashkëpunimin me institucionet vendore dhe qendrore, në interes të tyre si grup interesi, por edhe në interes të komunitetit ku jetojnë dhe ushtrojnë veprimtarinë.

Shumë prej personave që dalin në pension angazhohen vullnetarisht në ndihmë të komunitetit, pranë institucioneve lokale, kryesisht për të dhënë kontributin e tyre si detyrë qytetare ndaj shtetit. Mund të përmendim faktin e angazhimit të tyre, sidomos të ish mësuesve të gjuhës ose redaktorëve të shtëpive botuese apo të gazetave, të cilët angazhohen si mësues gjuhe pranë zyrave të pritjes së emigrantëve të huaj, të cilët kërkojnë azil ose kërkojnë të qëndrojnë e punojnë në këto shtete. Nuk është për t'u

habitur që mësuesit e gjuhës, në qendrat e pritjes së emigrantëve apo refugjatëve, janë të gjithë pensionistë. Po ashtu mund të theksojmë dhe faktin që shumë ciceronë/guida nëpër muze të ndryshëm, në kopshtet zoologjike dhe botanike, apo në guidat turistike në të gjitha qytetet ose edhe në vende arkeologjike/historike janë pensionistë. Këto angazhime dhe punë vullnetare bëjnë që jeta e këtyre personave, të cilët dalin në pension pleqërie, të jetë aktive dhe ata të ndjehen të dobishëm për komunitetin, shoqërinë dhe për shtetin.

8. Lektorë të tjerë sipas rastit, mund të jenë përfaqësues nga institucionet fetare, përfaqësues të organizatave ndërkombëtare, përfaqësues nga biznesi të cilët pasqyrojnë punën e institucioneve të tyre, informojnë mbi veprimtarinë e tyre dhe iu kërkojnë të angazhohen dhe antarësohen pranë tyre.

Këto janë disa nga politikat sociale që ndiqen nga shteti për kalimin gradual dhe të butë të personave të cilët kalojnë nga jeta profesionale e ngarkuar në një jetë me më pak veprimtari, për të pasur edhe ata ndikimin e tyre në jetën e shoqërisë dhe të shtetit. Me daljen në pension, nuk nënkuptohet një heqje dorë nga veprimtaria fizike, intelektuale dhe sociale e këtyre personave. Ata kanë mundësinë që energjitë e tyre sidomos ato intelektuale t'i vënë në dispozicion të shoqërisë, me qëllim që shoqëria të mund të përfitojë nga energjitë e tyre, por gjithashtu edhe ata të përfitojnë në aspektin social dhe psikologjik, pasi nuk ndjehen të larguar dhe mënjanuar nga aktiviteti dhe jeta shoqërore e organizmit, qoftë atij lokal, por edhe atij qendror, si brenda vendit, edhe jashtë tij.

Ndoshta është pak e vështirë për lexuesin të kuptojë se si funksionon kjo praktikë. Ndoshta lind pyetja se cila është rruga dhe cilat mund të jenë këshillat që iu jepen personave, para se të dalin në pension pleqërie? Shpjegimi jepet në vijim.

Kronologjia e mundshme e veprimeve para shkëputjes

Dy vjet para shkëputjes nga puna aktive

1. Planifikoni takimin tuaj për këshillim, para shkëputjes nga shërbimi, në periudhën në të cilën organizohen këto këshillime, nga drejtoria ose sektori i menaxhimit të burimeve njerëzore dhe i përkujdesjes sociale.
2. Rishikoni listën e diskutimeve të këshillimit, para shkëputjes. Identifikoni furnizues/këshilluesit individualë të shërbimit të këshillimit të cilët do t'iu japin ndihmë.
3. Planifikoni listën e problemeve për të cilat jeni i interesuar të trajtohen në kursin e këshillimit/trajnitimit që organizohet.

18 muaj para shkëputjes nga puna aktive dhe dalja në pension

1. Ndiqni takimet për programin e ndihmës për kalimin në pension.
2. Zhvilloni planin tuaj individual për kalimin në pension (në shtëpi të vetëdrejtuar). Nëse nevojitet, kërkoni ndihmë nga këshilltari për kalimin në pension.
3. Merrni vendime thelbësore për jetën tuaj (vazhdimi i punës, ndryshimi i karrierës, gatishmëria për të bashkëpunuar ose anëtarësuar në fondacione ose shoqata humanitare), duke përcaktuar objektivat për të ardhmen.
4. Përgatituni për objektivat e karrierës së ardhshme pas daljes në pension pleqërie. Identifikoni nevojat për trajnim, arsimim dhe/ose certifikim dhe përcaktoni rrugën si do të arrini objektivat. Filloni kurset e shkollimit që i gjykoni si të nevojshme.

5. Vlerësoni gjithashtu kërkesat e familjes (të ardhurat për shkollimin e fëmijëve, kujdesin për prindërit e moshuar) në realizmin e objektivave tuaj.
6. Përcaktoni nevojat për të ardhura pas daljes në lirim. Planifikoni pagën neto që do të merrni pasi të dilni në pension pleqërie. Verifikoni nëse keni nevojë për të shtuar të ardhurat neto, pas daljes në pension.

12 muaj para daljes në pension pleqërie

1. Vazhdoni trajnimin/arsimimin/kualifikimin e nevojshëm për t'u kualifikuar për objektivat tuaj të karrierës, pas daljes në pension.
2. Hetoni dhe vlerësoni alternativat e sigurimit për jetën.
3. Mendoni si do të organizoni jetën pasi të dilni në pension, ku do të jetoni, ku do të shkoni për të kontribuar.
4. Identifikoni problemet shëndetësore dhe planifikoni trajtimin tuaj shëndetësor dhe të familjes suaj. Rëndësi mer fakti i përgatitjes dhe vaksinimit të mundshëm, nëse do të shkoni jashtë vendit për të shërbyer në vendet e prapambetura dhe në kriza.
5. Përditësoni dokumentet ligjore (testamentin, prokurat, autorizimet, etj.)
6. Punoni dhe ndiqni rrjetin social ku dëshironi të punoni. Mbani kontaktet e mundshme me organizma publikë dhe jo publikë.

6 Muaj (180 ditë) para daljes në pension

1. Programoni egzaminimin tuaj mjekësor, para shkëputjes.
2. Përcaktoni mundësinë nëse arrini të merrni lejen e zakonshme vjetore. Nëse nuk arrini ta merrni, aplikoni për të marrë vlerën financiare të saj deri në momentin e shkëputjes.
3. Filloni programin vizita të afërmit tuaj dhe me njerëzit me të cilët do të dëshironit të kishit kontakte, në rast largimi jashtë vendit pas shkëputjes nga puna dhe daljes në pension pleqërie.
4. Vazhdoni të punoni me rrjetin e miqve që keni në organizata joqeveritare apo shoqata, fondacione, me të cilat do të bashkëpunoni dhe do të ndihmoni pasi të shkëputeni.

Në 30 ditët e fundit, rishikoni të gjithë dokumentacionin⁵ që ka të bëjë me ju dhe vjetërsinë në punë, për të shmangur të gjitha mangësitë dhe problemet që mund të ketë.

Përfundime

Dalja në pension pleqërie është një moment shumë i rëndësishëm në jetën e çdo njeriu, proces i cili ndodh vetëm një herë në jetë dhe bën kalimin e personave nga njëri brez në tjetrin, duke kaluar personin nga grupi që quhet brezi i 2-të, i cili është në aktivitet fizik dhe mendor duke punuar, në grupin e brezit të 3-të, që njihet si grupi shoqëror i njerëzve në pension. Ky moment përveçse një moment i rëndësishëm, jo vetëm në pikëpamjen ligjore apo edhe atë sociale, është një moment shumë i rëndësishëm edhe psikologjik për këta persona.

⁵ Në këtë periudhë vendoset theksi në shmangien e problemeve dhe mangësive, për të mos patur problem me dokumentacionin për shkëputjen dhe daljen në pension.

Por qytetarët e botës perëndimore që shkëputen nga puna aktive për të kaluar në pension pleqërie, nuk nënkuptojnë me daljen në pension një jetë pasive, duke u përjashtuar apo vetëpërjashtuar nga shoqëria dhe zhvillimet sociale, jo vetëm në lokalitetin ku ata banojnë, por edhe në shtetin e tyre, në kontinent apo në mbarë botën. Ata nuk lejojnë që të ndjehen të panevojshëm dhe të pafuqishëm për të dhënë kontributin e tyre, fizik apo intelektual. Ata angazhohen në shoqata, fondacione duke vepruar si grup interesi, duke u përfaqësuar në të gjitha zhvillimet shoqërore dhe zyrtare. Në botën perëndimore, në dhjetëvjeçarin e fundit, është krijuar një kulturë e tillë që kontributi i këtyre njerëzve është i një rëndësie të jashtëzakonshme në vendet e varfëra apo ato në zhvillim. Shkuarja në këto vende si vullnetarë dhe vënia në funksion të këtyre shteteve dhe shoqërive, i energjive të tyre intelektuale apo edhe fizike, përbëjnë për këto vende dhe njerëzit e tyre, një pasuri të jashtëzakonshme për ta, duke u shndërruar në një impet të jashtëzakonshëm zhvillimi. I tillë është edhe angazhimi i tyre brenda vendit, duke u anagzhuar si vullnetarë në fushat e tyre të profesionit, por edhe në fusha të ndryshme, duke vënë në dispozicion të shtetit dhe shoqërisë kontributin e tyre të jashtëzakonshëm, sidomos atë intelektual.

Në vendin tonë, fatkeqësisht, jo vetëm që nuk kanë ekzistuar programe të tilla sociale, por edhe këto koncepte bashkëkohore të shteteve perëndimore, janë ende jo vetëm të pazbatueshme, por edhe të panjohura, në pjesën më të madhe, jo vetëm të administratës shtetërore, por edhe të subjekteve jopublike në Shqipëri.

Bibliografia:

- Fukayama, Francis, “Fundi i historisë dhe njeriu i fundit”, Zenit 2007.
- Fukayama, Francis, “Ndërtimi i shtetit demokratik”, Botim AAIS 2010.
- Dahrendorf, Ralf, “Konflikti Shoqëror Modern”, Botim Dituria 2001.
- Giddens, Anthony, “Sociologjia”, Botim Toena 1999.
- Giddens, Anthony, “Pasojat e Modernitetit”. Botim UET Press 2013.
- Huntington, Samuel, “Ushtaraku dhe Shteti”, SHBU 1996.
- Pearson, Christopher, “Shteti Modern”, Botim AAIS 2010.
- Heywood, Andrew, “Politika”, Botimet Dudaj 2008.
- Russo, Zhan Zhak, “Kontrata Sociale”, Botime Bota Shqiptare 2008.
- Veber, Maks, “Politika si profesion”, Botime Dituria 2006.
- Collins, Alain, “Studime Bshkëkohore të Sigurisë”, UET Press 2010.
- Bajramaj, Izet, “Revolucioni i Madh Francez (1789–1794)”, Botime Veso 2009.

Rubrika e Katërt

Punime Historike

Revista Ushtarake vazhdon t'i japë rëndësi të veçantë rubrikës historike. Kjo rubrikë ka vlera të veçanta jo vetëm në rifreskimin e kujtesës së lexuesit të saj, por edhe sepse aty trajtohen tema të ndryshme të historisë botërore dhe të popullit tonë, të cilat sjellin në vëmendjen e shoqërisë të vërteta historike të patrajuara më parë ose të trajtuara në një këndvështrim të ri.

Zëvendësshefi i Shtabit të Përgjithshëm, Gjeneralmajor Viktor Bërdo, në shkrimin “Strategjia e *Shpagimit Masiv*, ndryshimi i parë madhor në strategjinë bërthamore amerikane” vë theksin te politika e “Shpagimit Masiv”, të projektuar nga presidenti amerikan *Eisenhower* gjatë Luftës së Ftohtë. Sipas presidentit amerikan, mënyra më e mirë për të penguar kërcënimin sovjetik ishte përdorimi i armëve bërthamore. Kjo teori ndikoi fuqishëm në strategjinë bërthamore dhe ekonomike të SHBA-ve, duke forcuar pozitat e tyre si superfuqi bërthamore.

Trajtimi i periudhës 6-mujore të historisë së popullit tonë, nën drejtimin e Princ *Wied-it* (7 mars-3 shtator 1914), është sjellë nga major Dr.Marenglen Kasmi, i cili thekson vështirësitë dhe problemet që kishte Shqipëria në atë kohë, rivalitetet dhe kontradiktat që e karakterizonin dhe rolin që luajtën Fuqitë e Mëdha për vendin tonë.

Një shkrim interesant në këtë rubrikë është shkrimi “Aspekte të Betejës së Lumës”, i autorit Sali Onuzi, i cili sjell në vëmendje edhe një herë analizimin e kësaj beteje , nën një këndvështrimin të ri, bazuar në dokumente e fakte të arkivës austro-hungareze. Beteja dhe gjithë lufta e Lumës, në nëntor-dhjetor 1912, zë një vend të merituar në Historinë Ushtarake të Shqipërisë të periudhës së pavarësisë. Kjo betejë dhe fama e saj shkuan larg deri në Londër, duke e siguruar Lumën njëherë e përgjithmonë brenda kufirit të shtetit të ri shqiptar.

Strategjia e “Shpagimit Masiv”, ndryshimi i parë madhor në strategjinë bërthamore amerikane

Gjeneralmajor Viktor Berdo
Zëvendësshef i Shtabit të Përgjithshëm të FA

Nënkolonel Dritan Stroni
Kursi i Lartë i AFA

Trajtesë e shkurtuar. *Lufta e Ftohtë u karakterizua nga një luftë e ashpër politike, strategjike dhe ideologjike, si dhe nga një konkurrencë e ideologjive shoqërore dhe ekonomike midis SHBA dhe Bashkimit Sovjetik, e cila u përhap në të gjithë botën. Ata rivalizuan njëri-tjetrin, nëpërmjet strategjive të Luftës së Ftohtë, ku në themel qëndronte strategjia bërthamore. Vitet e Administratës së Eisenhower cilësohen si periudha më e “furishme” në projektimin e SHBA si një superfuqi e padiskutuar bërthamore. Politika e Eisenhower, e njohur si “Vështrim i Ri” pati ndikime të mëdha në strategjinë bërthamore dhe ekonominë e SHBA.*

Eisenhower ishte i bindur se çelësi i fitores në Luftën e Ftohtë nuk ishte thjeshtë forca ushtarake, por një ekonomi e fortë. SHBA duhet t'i tregonin botës se nisma e lirë mund të krijonte një shoqëri më të mirë se komunizmi. Në të njëjtën kohë, liria ekonomike do të parandalonte përmbysjen drejt komunizmit. Sipas Eisenhower, mënyra më e mirë për të penguar kërcënimin sovjetik ishte përdorimi i armëve bërthamore. Ky ishte themeli i strategjisë doktrimore të “Shpagimit Masiv”.

Hyrje

Kjo është epoka ku siguria do të jetë fëmija i guximshëm i terrorit dhe mbijetesa vëllai binjak i asgjësimit.¹

Lufta e Ftohtë u karakterizua nga një luftë e ashpër politike, strategjike dhe ideologjike, si dhe nga një konkurrence e ideologjive shoqërore dhe ekonomike midis SHBA dhe Bashkimit Sovjetik e cila u përhap në të gjithë botën. Ajo ndikoi në politikat e brendshme dhe të jashtme të dy kampeve. Gjatë Luftës së Ftohtë, SHBA dhe Bashkimi Sovjetik besonin se ata duhet të ndalonin njëri-tjetrin për të zgjeruar pushtetin e vet në zonat përkatëse të ndikimit dhe në ato që njiheshin si “zona gri” apo neutrale. Ajo që diferencoi Luftën e Ftohtë nga konfliktet e tjera të shekullit të 20-të ishte se të dy palët nuk u angazhuan në një luftë reale fizike. Ata rivalizuan njëra-tjetrën

¹ Winston Churchill, “*Never Despair*”, Speech on 1 March 1955, House of Commons.

duke përdorur ato që quhen strategjitë e Luftës së Ftohtë, ku përfshiheshin ndihma e jashtme, propaganda, spiunazhi, politika e lojës me zjarrin, aleancat shumëkombëshe, luftërat zëvendësuese (lokale).

Nëpërmjet ndihmës së jashtme, të dy superfuqitë u përpoqën të fitonin aleatë, duke u dhënë ndihmë financiare shteteve të tjera, siç ishte Plani Marshall i SHBA për Evropën apo ndihma e Bashkimit Sovjetik për Egjiptin me qëllim ndërtimin e hidrocentralit Aswan. Të dy superfuqitë përdorën propagandën për të fituar mbështetje të jashtme, ku mund të përmendet transmetimi i programit Radio Evropa e Lirë për vendet e Evropës Lindore. Secila palë përdori spiunazhin nga frika se kundërshtari mund të fitonte epërsi. Politika e lojës me zjarrin, (brinkmanship) është praktikuar nga Sekretari i Shtetit *John Foster Dulles*² Mjetet kryesore të kësaj strategjie ishin konkurrenca teknologjike dhe shkencore, armët bërthamore, sistemet raketore, fluturimet hapësinore. Kriza e raketave në Kubë ishte një shembull i kësaj strategjie që prodhoi një tension serioz midis dy kampeve. Për të fituar mbështetjen e vendeve të tjera, SHBA dhe Bashkimi Sovjetik hynë në aleanca shumëkombëshe, siç ishte NATO dhe Traktati i Varshavës. Strategjia e luftërave zëvendësuese kishte në themel shmangien e përplasjes së drejtpërdrejtë të dy superfuqive. Kështu SHBA dhe Bashkimi Sovjetik nuk u angazhuan në një luftë të drejtpërdrejtë me njëri-tjetrin, por u angazhuan në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, duke mbështetur “satelitët” e tyre në shumë konflikte të vogla rajonale, siç ishin Konflikti Korean, Lufta e Vietnamit, Revolucioni Kinez, Revolucioni Kuban, Lufta Civile në Nikaragua, Revolucioni Iranian, Lufta Sovjeto-Afgane, etj.

Megjithatë, strategjia që ka drithëruar gjithë botën dhe ka mbajtur në tension superfuqitë gjatë Luftës së Ftohtë ishte strategjia bërthamore. Ajo u bë mekanizmi më i rëndësishëm në dorën e dy superfuqive për arritjen e objektivave të tyre dhe dominuar botën. Referuar rrezikut që shkaktoi, ndikimit në jetën globale, ngarkesës buxhetore që prodhoi, tensionin dhe frikës mbarëbotërore që krijoi, si dhe duke vizualizuar në mendjen e njerëzimit ato që ndodhën në Hiroshima dhe Nagasaki, strategjia bërthamore u bë dominuese mbi të gjitha strategjitë e tjera.

Deri në vitin 1945, amerikanët mendonin se çdo luftë ku ata u angazhuan nuk do të ishte krejtësisht shkatërruese për shoqërinë e tyre. Epoka bërthamore “sfidoi këtë supozim, jo vetëm për shkak të dëmit të armëve bërthamore, por edhe për shkak të rreziqeve që lidhen me Luftën e Ftohtë”³. Për shumë vite, planifikuesit ushtarakë amerikanë, studiuesit e politikave dhe udhëheqësit politikë analizuan se si lufta bërthamore mund ose duhet të kryhet, si mund të parandalohet, si mund të fitosh, të mbijetosh apo të mbrohesh. Strategjia bërthamore u bë një disiplinë akademike, po ashtu edhe një preokupim i civilëve, ekspertëve dhe ushtarakëve, ku shumica e tyre punuan në fshehtësi të rreptë.

Gjatë Luftës së Ftohtë dhe pas saj, koncepti drejtues i strategjisë bërthamore ishte parandalimi i konfliktit. Presidentët e SHBA, nga Truman deri tek Bush, besonin se vetëm kërcënimi me sulm bërthamor do të kthente mendjen e udhëheqjes ekspansioniste sovjetike nga përshkallëzimi i konflikteve politike në ato ushtarake. Nëse parandalimi dështonte dhe fillonte lufta, ata besonin se planet e luftës bërthamore dhe kapacitetet do të ishin thelbësore. Për t’u përgatitur për rastin më të keq dhe për të kryer parandalimin e nevojshëm të kapaciteteve bërthamore sovjetike, presidentët e SHBA miratuan

² Charles W.Kegley, Jr. *Politikat Botërore*, faqe 422-23.

³ William Burr, “Strategjia Nukleare”, Oxford University Press, 2001.

“Shpagimi Masiv”, ndryshim madhor në strategjinë bërthamore amerikane _____

investime masive në armë bërthamore nga 1940 deri në 1997, të cilat arritën në 5,4 trilion dollarë (me kursin e vitit 1996).⁴

Strategjitë amerikane në vitet e presidentëve gjatë Luftës së Ftohtë

Vitet e Truman dhe Eisenhower. Për të mbështetur planifikimin dhe operacionet bërthamore amerikane, në vitin 1946, u krijua Komanda Strategjike e Forcave Ajrore të SHBA (Strategic Air Command-SAC). Në fillim, ajo posedonte një arsenal të vogël të armëve bërthamore dhe avionëve bombardues. Në vitin 1950, kishte rreth 250 avionë bombardues bërthamorë dhe rreth 300 armë atomike.

Megjithëse presidenti *Truman* nuk e shihte armën bërthamore si mjet “terrori”, në vjeshtën e vitit 1948, me rritjen e tensionit në Berlin, ai autorizoi forcat e armatosura të përfshinin armët bërthamore në planifikimin e tyre. Gjithashtu, *Truman* miratoi dislokimin e bombarduesve bërthamorë në Mbretërinë e Bashkuar, duke mundësuar arritjen e objektivave në Bashkimin Sovjetik pa u furnizuar. Në vitet 1949-1950 u rritën me shpejtësi kapacitetet prodhuese të SHBA, si dhe filloi zhvillimi i armëve termobërthamore (bomba-H).

Që para ardhjes së residentit *Eisenhower*, strategjia bërthamore e SHBA kishte filluar të lëvizte drejt asaj që më vonë u quajt strategji e “Shpagimit Masiv”. Në fund të viteve 1940, SAC dhe drejtuesit e lartë ushtarakë formuluan planet e luftës bërthamore, duke përfshirë një sulm bombardues masiv të vetëm kundër objektivave sovjetike. Komandanti i SAC, gjenerali *Curtis LeMay*, duke parë mbrojtjen nga sulmet bombarduese strategjike si të pashpresë, këmbënguli se kushdo që kalon në ofensivë i pari, do të mbizotërojë dhe një sulm parandalues do të jetë i justifikuar nëse një sulm sovjetik konsiderohet i mundshëm.⁵ Edhe pse planet e hershme të SAC u përqendruan në objektivat industriale dhe energjetikë sovjetikë, pas testimi të bombës bërthamore nga sovjetikët në vitin 1949, planifikuesit ushtarakë vunë theksin tek goditja “kundërforcë” e instalimeve bërthamore sovjetike dhe instalimeve të lëshimit të armëve bërthamore.

Presidenti *Eisenhower* dhe këshilltarët e tij përqafuan publikisht konceptin e një sulmi masiv bërthamor që u quajt “Shpagim Masiv”. Pavarësisht dyshimeve të *Eisenhower* që armët termobërthamore rrezikonin qytetërimin, ai urdhëroi investime miliarda dollarëshe në sistemet e lëshimit me rreze të gjatë, në bombardues dhe raketa balistike ndërkontinentale, si dhe nëndetëse të pajisura me lëshues raketash balistike. Nga fundi i viteve 1950, SAC kishte zhvilluar një sistem të goditjes së objektivave nga ajri me një sulm të menjëhershëm, që përfshinte më shumë se 1.400 objektiva sovjetikë.

Vitet 1950 sollën një rrebesh shkrimesh dhe publikimesh akademike për strategjinë bërthamore. *Henry Kissinger* me “*Armët bërthamore dhe politika e jashtme*” (1957), ishte një nga studimet më të njohura të luftës së kufizuar bërthamore. Gjithashtu, *Bernard Brodie*, *Herman Kahn*, *William W. Kaufmann*, *Thomas Schelling* dhe *Albert Wohlstetter*, të mbështetur nga Korporata RAND, përhapën supozimin e *Kissinger*, që përdorimit masiv të armëve bërthamore i mungonte kredibiliteti. Shefi i Operacioneve Detare, *Arleigh Burke*, hodhi argumente për “pengimin e përcaktuar” dhe jo “Shpagimin masiv”. *Burke* pohoi se sistemet e lëshimit të raketave të nëndetëseve *Polaris*, do t’i lejonte presidentit t’i përgjigjej në një mënyrë të matur një krize.⁶

⁴ Po aty.

⁵ Po aty.

⁶ William Burr, “Strategjia Nukleare”, Oxford University Press, 2001.

Në mbyllje të administratës së tij, *Eisenhower* drejtoi hartimin e një plani të ri luftime që u quajt Plan i Vetëm i Integruar Operacional (Single Integrated Operational Plan-SIOP). Plan i parë, i prodhuar nga SAC në vitin 1962, parashikonte nisjen e 3.200 armëve bërthamore kundër 2.600 instalimeve në Bashkimin Sovjetik, Kinë dhe vendet satelite, duke shkaktuar deri në 425.000.000 viktima.⁷ Këto detaje e frikësonin *Eisenhower*, megjithatë ai miratoi SIOP-62, në fund të vitit 1960, si bazë për dislokimin e forcës, prodhimin e mbushjeve dhe rritjen e gatishmërisë.

Vitet e Kennedy, Johnson dhe Nixon. Administrata e *John F. Kennedy* ndërmori një hap të rëndësishëm drejt lehtësimit të “përdorimit të vonshëm” të armëve bërthamore, duke mbështetur strategjinë “Përgjigja Fleksibile” për të siguruar përdorimin e opsioneve të pengimit jo bërthamor. Të vendosur për të bërë luftën bërthamore më “të kontrollueshme”, Sekretari i Mbrojtjes, *Robert McNamara* (1961-1968) ishte ai që shprehu këtë strategji. Megjithëse planifikuesit e SAC e konsideronin “përgjigjen e kontrolluar” jo praktike, ata ranë dakord se SIOP duhet të përfshijë një sërë opsionesh sulmi, si dhe heqjen e Kinës apo vendeve satelite nga lista e objektivave. Megjithatë, SIOP-63 përsëri parashikonte sulme të mëdha, duke pasqyruar akoma një qasje drejt strategjisë të “Shpagimit Masiv”.

Edhe pse retorika publike e *McNamara* fillimisht theksoi strategjinë e “dëmit të kufizuar”, që mund të zvogëlonte kapacitetet sovjetike për të sulmuar objektivat amerikane, pa shkatërruar qytete dhe vranë miliona njerëz, kjo qasje provoi të ishte e diskutueshme për shkak të implikimeve të saj në sulmin e parë. *McNamara* ndryshoi shpejt fokusin e tij parandalues drejt “shkatërrimit të sigurt”, që lidhej me aftësinë për të shkatërruar industrinë sovjetike dhe kapacitetet luftuese edhe nëse sovjetikët sulmojnë të parët. Megjithatë, planifikimi operacional vazhdoi të theksojë goditjen e objektivave strategjike sovjetike, duke sugjeruar që planifikuesit bërthamorë të parashikonin goditjen e parë në çdo përballje ushtarake, përpara se të kapesh një sulm sovjetik.

Futja e sistemeve të reja të paralajmërimit satelitor i dha mundësi presidentit *Richard M. Nixon* të kishte më shumë sukses në zhvillimin e alternativave të besueshme. Që nga viti 1974, *Nixon* dhe *Kissinger* (në pozicionin e këshilltarit të sigurisë kombëtare) urdhëruan zhvillimin e studimeve që çuan në hartimin e një direktive sekrete, e cila kërkonte mundësi për sulme bërthamore të dallueshme, të kufizuara, të përzgjedhura, të mëdha dhe rajonale, për të rritur kontrollin mbi përshkallëzimin dhe për të nxitur ndërprerjen e hershme të luftës. Duke pranuar se parandalimi mund të dështojë (referuar burimeve të fshehta sovjetike se konflikti bërthamor nuk do të mund të përmbahet), *Nixon*, në vitin 1974, kërkoi plane për të përmirësuar pozicionin e pasluftës të SHBA, duke shkatërruar objektivat kritikë për rimëkëmbjen sovjetike. Kjo nënkuptonte goditjen indirekte të popullsisë civile. Gjithashtu, planifikuesit ushtarakë u udhëzuan të mbanin një rezervë strategjike të forcave mbijetuese për mbrojtjen dhe shtrëngimin gjatë dhe pas konfliktit të madh bërthamor. Administrata *Nixon* ndeshi në presione të brendshme politike për kontrollin e garës së armatimit, që patën ndikim në armët bërthamore dhe strategjinë bërthamore. Në vazhdim të tensionit me Moskën, *Nikson* dhe *Kissinger* kërkuan kufizime për forcat strategjike, duke ruajtur opsionet strategjike në rast konflikti.

Vitet e Carter dhe Reagan. Me rënien e detantës, në fund të viteve 1970, presidenti *Jimmy Carter* miratoi ndryshime të rëndësishme në strategjinë bërthamore. Në Direktivën

⁷ Po aty.

Presidenciale 59 ai autorizoi planifikimin për një luftë të zgjatur bërthamore nëse parandalimi dështonte. Gjithashtu, *Carter* orientoi goditjen drejt vendkomandave nëntokësore sovjetike, me qëllim kërcënimin e udhëheqjes politike dhe ushtarake sovjetike dhe përforcimin e mundësisë së parandalimit. Në vitin 1981, presidenti *Ronald Reagan* riafirmoi konceptin *Carter* të një lufte të zgjatur bërthamore, duke shtuar se në një konflikt të tillë SHBA “duhet të mbizotërojë” dhe “detyrojë Bashkimin Sovjetik për të kërkuar ndërprerjen e kërcënimeve të hershme”⁸. Në Nismën Strategjike të Mbrojtjes të vitit 1983, *Reagan*, gjithashtu, propozoi krijimin e një mburoje kundërraketore. Synimi “mbizotërues” mbeti strategji kombëtare derisa presidenti *Bill Clinton* e shfuqizoi atë në vitin 1997.

Periudha e Pasluftës së Ftohtë. Fundi i Luftës së Ftohtë prodhoi ndryshime të rëndësishme në forcën bërthamore dhe planet e luftës, por jo në strategji. Ekspertët ushtarakë hoqën shumë objektiva të ish-blokut sovjetik nga SIOP dhe çaktivizuan mijëra armë bërthamore. Buxhetet e mbrojtjes u ndikuan nga zhvillimet politike globale. Në vitin 1990 buxheti i armëve bërthamore ishte rreth 5.6 trilion dollarë (sipas kursit të vitit 1996), ndërsa në vitin 1998, ai ishte rreth 35 miliardë dollarë. Pavarësisht zhvillimeve gjeopolitike dhe mbështetjes financiare, presidenti *Clinton* vazhdoi t’i qëndronte opsionit të forcave të armatosura për “parandalimin”. Strategjia bërthamore dhe udhëzimet e objektivave të miratuara nga *Clinton* në vitin 1997, nxorrën në pah shqetësimet në lidhje me forcat strategjike ruse dhe kineze, si dhe pasqyruan shqetësimet e reja rreth vendeve të afta për krijimin e armëve të shkatërrimit në masë. Ndërkohë që SHBA vazhdon akoma të mbështesë supozimin “përdorimi i fundit”, kërcënimet gjatë konfrontimeve me Kinën më 1996, Irakun më 1998 dhe 2003, sugjeruan mbështetjen e vazhdueshme në armët bërthamore si instrumente të politikës.

Studiuesit, ekspertët, historianët dhe kritikët ndajnë mendime të ndryshme për rolin e strategjisë bërthamore në Luftën e Ftohtë, por në fund bashkohen tek një mendim, që pavarësisht tensioneve të shumta, Lufta e Ftohtë përfundoi pa një kataklizëm bërthamore. Shumë mbështesin argumentin se strategjia bërthamore e SHBA pengoi luftën midis superfuqive dhe do të vazhdojë të jetë e domosdoshme për parandalimin e konflikteve të ardhshme. Një pjesë tjetër që i referohen kostos shumë të lartë të armëve bërthamore dhe opsionit të “parandalimit”, ngrenë pikëpyetje nëse duhet të ishte kaq e shtrenjtë. Ekspertë dhe drejtues të tjerë ushtarakë, duke marrë në konsideratë se “parandalimi” përfshinte rreziqe të papranueshme për njerëzimin, mbështesin angazhimin për heqjen e armëve bërthamore.

Drejt formësimit të strategjisë së “Shpagimit Masiv”

Preludi i administratës *Eisenhower*

Në fund të vitit 1952, shumica e amerikanëve ishin gati për një ndryshim në udhëheqjen e vendit. Një nga faktorët kryesorë për këtë qëndrim ishte edhe Lufta e Ftohtë. Shumë besonin se politika e jashtme e presidentit Truman, nuk po funksiononte ashtu siç duhej. Bashkimi Sovjetik kishte testuar bombën atomike dhe kishte konsoliduar pushtetin e tij në Evropën Lindore. Nga ana tjetër, Kina kishte rënë në krahun komunist dhe trupat amerikane ishin duke luftuar në Kore. I lodhur nga kritikët dhe pasiguria se mund të fitonte, Truman vendosi të mos rikandidohej. Në këto kushte, demokratët zgjodhën si

⁸ William Burr, “Strategjia Nukleare”, Oxford University Press, 2001.

kandidat për president *Adlai Stevenson*, guvernator i Illinois. Republikanët zgjodhën si kandidat *Dwight D. Eisenhower*, gjeneralin që kishte organizuar dhe drejtuar pushtimin në Normandi dhe Frontin Perëndimor në Luftën e Dytë Botërore. *Stevenson* nuk kishte asnjë shans përpallë një heroi kombëtar, që kishte kontribut të padiskutueshme në fitoren e Luftës së Dytë Botërore. Amerikanët ishin në kërkim të liderit që mund t'i besonin për të udhëhequr kombin në Luftën e Ftohtë. Fushata zgjedhore u karakterizua nga fjalime shpesh të ashpra, ku *John Foster Dulles* e quajti politikën e *Truman* si politikë të "izolimit", "negative, të pamoralshme dhe të kotë", ndërsa *Eisenhower* i cilësoi përpjekjet e *Marshall* si "një purgator të improvizimit."⁹ Zgjedhjet konfirmuan fitoren e padiskutueshme të *Eisenhower*.

Lufta e Ftohtë kristalizoi idetë e *Eisenhower* nga momenti që ai mori detyrën. Ai ishte i bindur se çelësi i fitores në Luftën e Ftohtë nuk ishte forca e thjeshtë ushtarake, por një ekonomi e fortë. SHBA duhet t'i tregonin botës se nisma e lirë mund të krijonte një shoqëri më të mirë se komunizmi. Në të njëjtën kohë, liria ekonomike do të parandalonte përmbyshjen drejt komunizmit.

Si një ushtarak profesionist, *Eisenhower* e njihte koston lidhur me luftën konvencionale në shkallë të gjerë. Ai besonte se përgatitja për këtë lloj luftime ishte shumë e shtrenjtë. "Ne nuk mund të mbrojmë vendin në një mënyrë që do të shterojë ekonominë tonë" deklaroi *Eisenhower*. Në vend të mbajtjes së një ushtrie të madhe dhe të shtrenjtë, vendi "duhet të përgatitet të përdorë armët bërthamore në të gjitha format." Arma bërthamore jep "më shumë zhurmë për një të shtënë."¹⁰

Lufta e Koresë e kishte bindur *Eisenhower* se SHBA nuk mund ta përmbajë komunizmin duke luftuar në një seri luftërash të vogla të kufizuara. Luftëra të tilla ishin të papëlqyeshme dhe shumë të shtrenjta. Për këtë arsye, këto luftëra duhet të frenohen që të ndodhnin në këto vende. Mënyra më e mirë për të realizuar këtë ishte kërcënimi me përdorimin e armëve bërthamore.

Nga Truman tek Eisenhower dhe politika "Vështrimi i Ri"

Buxhetet e mbrojtjes të *Truman* kishin qenë shumë të larta si rezultat i zbatimit të NSC-68 (National Security Council-Këshilli i Sigurisë Kombëtare), i cila vinte në plan të parë ngritjen e një ushtrie të madhe për të sfiduar Bashkimin Sovjetik, si dhe për shkak të luftës në Kore. Në vitin 1952, buxheti i mbrojtjes arriti në 56.68 miliardë dollarë.¹¹ Sipas *Eisenhower*, nëse këto shifra rriteshin në mënyrë të pakontrolluar, mund të çonin në shterim të ekonomisë amerikane.

Gjatë ditëve të fundit të administratës *Truman*, politika e sigurisë kombëtare amerikane vazhdoi të ishte e bazuar në parashikimet e bëra në NSC-68. NSC-135/3, e cila u miratua nga *Truman* në shtator 1952, deklaronte se SHBA duhet të "bllokojë zgjerimin e mëtejshëm të fuqisë sovjetike dhe rrezikun e madh të luftës së përgjithshme". Me kërkesën e *Truman*, në fillim të janarit 1953, u hartua NSC-141. Ajo përsëriti paralajmërimin e NSC-135/3 për rrezikun e ardhshëm sovjetik, që lidhet me zhvillimin e kapaciteteve atomike sovjetike dhe në veçanti, me zhvillimin e mundshëm të bombës me hidrogjen, që do të rrisnin cenueshmërinë e SHBA nga sulmi ajror sovjetik, në periudhën 1954-1955. Këto kapacitete

⁹ Keith A. Barlow, "Massive retaliation", US Army War College, 6 March 1972, 10.

¹⁰ The Cold War Begins, Eisenhower's Cold War Policies, 554.

¹¹ Nevin Power, "Did Eisenhower's New Look Defence Policy Make America Safer or Not?", 3.

bërthamore sovjetike do të “përfaqësojnë një goditje me përmasa kritike”.¹²

Pavarësisht nga pretendimet, *Eisenhower* trashëgoi dhe përdori një pjesë të politikave të *Truman*, ku përmenden zgjerimi i Komandës Ajrore Strategjike (SAC), sistemi i aleancave në mbarë botën, monopoli i bombës atomike, programi i ndihmës ekonomike, teknike dhe i zhvillimit të vendeve mike. NSC-141 që u trashëguua nga *Truman*, ishte një dokument i veçantë për vlerësimin e sigurisë së përgjithshme kombëtare.

Gjatë fushatës dhe në fillim të presidencës, *Eisenhower* hodhi idetë që formësuan politikën e tij të quajtur “Vështrim i Ri”. Termat “Vështrim i Ri” dhe “Shpagimi Masiv” përdoren në mënyrë të alternuar në kontekstin e riorganizimit të pozitive të mbrojtjes së Amerikës nga *Eisenhower*. “Vështrimi i Ri” ishte politika e *Eisenhower* për të zvogëluar shpenzimet e qeverisë për mbrojtjen, nëpërmjet një riorganizimi të sektorëve të ndryshëm të institucioneve të mbrojtjes, për të shkurtuar shërbimet që dublonin njëri-tjetrin. “Nëse vendi njej saktësisht se cilat janë interesat e tij themelore të sigurisë kombëtare, që të mbrohet nga kërcënimet e jashtme dhe, nëse administrata zgjedh me kujdes mjetet e mbrojtjes kombëtare,”¹³ SHBA do të mbetet ekonomikisht e fortë, duke mbajtur në botë rolin e udhëheqësit.

“Vështrimi i Ri” u frymëzua nga përcaktimi i *Eisenhower* dhe *Dulles* për rimarrjen, me një kosto më të lirë, të nismës në Luftën e Ftohtë, që ata besonin se e kishin humbur nën presidencën e *Truman*. Për të arritur këtë, “Vështrimi i Ri” përbëhej nga një numër kërkesash taktike dhe strategjike. Kjo politikë u përpoq të qartësonte se çfarë interesash të sigurisë kombëtare të SHBA duhet të mbrohen gjatë Luftës së Ftohtë dhe jo “thjesht të reagohet kundër shumë kërcënimeve sovjetike”, të cilat nga 1952 u bënë “mjaftë të kushtueshme, të çrregullta dhe jo bindëse për t’u ndjekur nga SHBA dhe aleatët e saj.”¹⁴

Filozofia e “Vështrimit të Ri” nuk mund të shikohej e shkëputur dhe e pavarur nga politika e *Truman*. Vlen të përmendet se, buxheti i fundit i mbrojtjes së *Trumanit* (viti fiskal 1953) kishte treguar saktësisht tendenca dhe përparësi të njëjta. *Truman* favorizoi SAC, rriti prodhimin e armëve bërthamore dhe vendosi përshpejtimin e bombave-H. Kjo ishte arsyeja që vendimi i *Eisenhower* për t’u mbështetur më fort në armën bërthamore, ishte më pak i ri sesa mund të duket në pamje të parë. “Shpagimi Masiv” e solli atë në ekstremet e veta, por baza e tij teknologjike dhe materiale ishin formuar nga vendimet e marra gjatë administratës *Truman*.¹⁵

Politika e *Eisenhower*-Doktrina strategjike e “Shpagimit Masiv”

Ndryshimi i parë i madh, në strategjinë bërthamore amerikane, erdhi në 12 janar të 1954, kur *John Foster Dulles*, Sekretar i Shtetit i presidentit *Eisenhower*, njoftoi publikisht se, në çdo konflikt të ardhshëm me vendet komuniste, SHBA do të “varen kryesisht mbi një kapacitet të madh, për t’u hakmarrë...me anë të mjeteve dhe në vendet e zgjedhjes sonë”.¹⁶ Për më tepër, ky vendim themelor do të shmangte “...pasojat e rënda buxhetore, ekonomike dhe sociale.”¹⁷ Edhe pse *Dulles* nuk i referohet, në mënyrë specifike, armëve

¹² Saki Dockrill, “*Eisenhower’s New-Look National Security Policy, 1953-61*”, Macmillan Press LTD, 1996, 15.

¹³ Saki Dockrill, Po aty.

¹⁴ Saki Dockrill, Po aty.

¹⁵ *Olav Njolstad*, “*In Search of Superiority: US Nuclear Policy in the Cold War*”, 1994, 19.

¹⁶ *John Foster Dulles*, “*The Evolution of Foreign Policy*”, 12 January 1954, *Department of State Bulletin*, Vol. 30, 107-110.

¹⁷ *Samuel F. Wells*, “*The Origins of Massive Retaliation*”, *Political Science Quarterly*, Vol. 96, No. 1, Spring 1981, 34.

bërthamore, mesazhi ishte i qartë se përgjigja e mundshme e SHBA, në rast të ndonjë sulmi të ardhshëm, qoftë ai i vogël apo i madh, konvencional apo bërthamor, kundër SHBA, aleatëve të saj ose bazave të saj jashtë vendit, do të ishte nisja e një sulmi shkatërrues bërthamor mbi instalimet ushtarake sovjetike dhe kineze, impianteve industriale dhe qyteteve të tyre.¹⁸

Kjo politikë u quajt “Shpagim Masiv”. Edhe pse politikat dhe programet e sigurisë të SHBA u zhvilluan dhe patën ndryshime gjatë viteve në vazhdim, pas fjalimit të *Dulles*, dy supozimet dhe vendimet themelore, të shpallura në fjalim, vazhduan t’i jepnin formë politikës të sigurisë amerikane për pjesën tjetër të presidencës së *Eisenhower*. Supozimi i parë ishte se fuqia tokësore e “Botës Komuniste” gëzonte epërsi të tillë që asnjë mbrojtje e thjeshtë lokale nuk do mund të ishte e suksesshme. Pavarësisht nga përpjekjet e SHBA dhe vendeve evropiane për të rritur aftësitë e NATO-s, bilanci ushtarak konvencional në Evropë mbetet i pafavorshëm për Perëndimin dhe mund të korrigjohej vetëm me kosto ekonomike shumë të larta. Supozimi i dytë ishte se nëse SHBA përpiquej të mbante forca tokësore të përshtatshme për të siguruar mbrojtjen lokale të “Botës së Lirë”, ajo do të konsumonte veten deri në falimentim. *Eisenhower* besonte se ekzistonte një kufi për një shoqëri liberale kapitaliste se sa mund të shpenzonte për mbrojtjen pa dëmtuar bazën e saj ekonomike. Sipas tij, SHBA i ishte afruar rrezikshëm këtij pragu, gjatë dy viteve të fundit të administratës *Truman*. Vendimi bazohej në idenë se SHBA dhe aleatët e saj do të mund të zmbrapsin agresionin komunist kundër mbrojtjes lokale të “Botës së Lirë” me anë të mbështetjes fillestare mbi kapacitetin e saj për sulm bërthamor. Pra, *Eisenhower* arriti në përfundimin se “e vetmja mënyrë për të zvogëluar shpenzimet e mbrojtjes, si dhe për të kompensuar epërsinë sovjetike konvencionale në Evropë, do të ishte që të mbështetet më fort në armën bërthamore, elementi efektiv i arsenalit të SHBA.”¹⁹

Doktrina e “Shpagimit Masiv” ishte në përputhje të plotë me sulmin e përgjithshëm të politikës së mbrojtjes të *Eisenhower*. Kjo doktrinë ndryshonte nga pozicioni i administratës *Truman*, në dy elemente të rëndësishme. *Truman* nënvizonte se SHBA nuk e panë bombën atomike si mjet të fundit. Bomba atomike do të përdorej vetëm në rast të një lufte për jetë a vdekje, si rrjedhojë e një sulmi fillimisht bërthamor sovjetik kundër SHBA, apo një sulmi masiv konvencional kundër aleatëve evropianë dhe aziatikë. Doktrina e re përcaktonte që, nëse SHBA gjykonte se interesat e sigurisë amerikane kërcënoheshin, madje edhe nga një sulm i kufizuar, do të shkaktonte një reagim masiv.

Për të rritur besueshmërinë e kësaj strategjie, *Eisenhower* dhe *Dulles* treguan kujdes të madh ndaj bindjes së udhëheqjes sovjetike, e cila e kishte parë armën bërthamore si një mjet të zakonshëm të kompletimit të ushtrisë dhe jo si instrument i jashtëzakonshëm politik i fuqisë. *Eisenhower*, në shumë nga intervistat dhe konferencat e tij për shtyp, tregoi se, në kontrast me *Truman*, “do të përdor armën bërthamore kundër objektivave taktikë apo strategjikë, sa herë që rrethanat operacionale favorizojnë përdorimin e tyre.”²⁰ Kur *Dulles* dhe *Eisenhower* bënë deklarimet e tyre mbi politikën e re në janar 1954, ata kishin udhëzuar ndryshimet në planet e luftës të SHBA, për të siguruar përdorimin e menjëhershëm të armëve bërthamore në të gjithë gamën e konflikteve të mundshme ushtarake.²¹

¹⁸ Po aty, 34.

¹⁹ Olav Njolstad, Po aty, 18.

²⁰ Samuel F. Wells, “The Origins of Massive Retaliation”, *Political Science Quarterly*, Vol. 96, No. 1, Spring 1981, 37.

²¹ Olav Njolstad, Po aty, 17.

Truman, në politikën e tij, parashikonte angazhimin në disa operacione konvencionale, para se të merrte në konsideratë përdorimin e armës bërthamore. Doktrina e “Shpagimit Masiv” nuk jepte saktësisht kohën e saktë dhe drejtimin e përgjigjes bërthamore të SHBA. Kështu, në rast të një lufte të kufizuar dhe lokale, si në Kore, Iran apo në krahun jugor të NATO-s, ishte i pritshëm një reagim i mundshëm bërthamor amerikan në pikën e agresionit sovjetik, duke goditur brenda ose në afërsi të teatrit të luftimeve. Historiani amerikan *John Lewis Gaddis*, nxorri në pah, si një nga objektivat kryesore të “Shpagimit Masiv”, “eliminimin e çdo supozimi nga udhëheqja sovjetike në lidhje me simetrinë midis aktit të tyre të agresionit dhe përgjigjes së mëvonshme amerikane.”²² Në të vërtetë, *Eisenhower* dhe *Dulles*, me doktrinën e tyre të re, synuan ta bënin më të vështirë për sovjetikët zvogëlimin e rrezikut të luftës së përgjithshme, konvencionale apo bërthamore, madje edhe në rast të incidenteve të vogla ushtarake. Në 5 dhjetor 1955, në letrën drejtuar *Dulles*, *Eisenhower* deklaronte se: “Në një kuptim të caktuar, demokracia duhet të jetë gjithmonë në mbrojtje e në pritje të ndonjë sulmi, qoftë ushtarak ose ekonomik...Diktaturat mund të lëvizin në mënyrë të fshehtë dhe selektive.”²³

Suksesi i “Shpagimit Masiv” qëndronte tek frika që gjithë bota pa tek ajo që ndodhi në *Hiroshima* dhe *Nagasaki*. Edhe *Churchill* këtë kishte në konsideratë kur tha se “është e sigurt që Evropa do të ishte komuniste dhe Londra nën bombardime..., por pengesë ishte bomba atomike në duart e SHBA.”²⁴ Pa dyshim, ishte frikësimi nga monopoli bërthamor i SHBA, ajo që mbajti agresionin lokal dhe luftën e përgjithshme larg nga skena botërore, gjatë periudhës 1945-1949.

Efektet e Doktrinës të “Shpagimit Masiv” në Forcat e Armatosura

Në vitet e para të administratës *Eisenhower* u shënuar një rritje e konsiderueshme në prodhimin e armëve bërthamore të SHBA. Në fillim të 1955, SHBA kishte rreth 2.000 bomba në rezervat bërthamore, që ishin dyfishi i numrit nga koha e *Truman*. Për më tepër, inventari përfshinte një rezervë të konsiderueshme të bombave-H (Mk.17 dhe Mk.18).²⁵

Pavarësisht futjes së raketave taktike bërthamore tokë-tokë në Forcat Tokësore, përfituesi i vërtetë i burimeve bërthamore ishte SAC. Gjatë dy viteve të administratës *Eisenhower*, SAC kishte, në dispozicion të tij, më shumë se 2.000 avionë të dislokuar në më shumë se tridhjetë baza, brenda dhe jashtë SHBA. Gjysma e forcës ajrore të SAC-it ishin avionë bombardues strategjikë, numri i të cilëve ishte rritur në mënyrë dramatike, ndërkohë që B-52 i parë u bë operativ në pranverën e vitit 1955. Varësia nga SAC dhe misionet e tij bërthamore u rritën edhe më shumë kur *Charles P. Wilson*, Sekretari i Mbrojtjes, përdori NSC-162/2, dokument i cili “formalizoi vendimin për t’u mbështetur në armët bërthamore si mjet parandalimi nga SHBA dhe imponoi reduktimin në numër të Forcave Detare dhe Tokësore.”²⁶

Në fund të viteve 1950, SHBA ndërmori përpjekje të konsiderueshme për të kompensuar ndonjë përparësi strategjike sovjetike. Kështu, *Eisenhower* miratoi planet e blerjes të rreth 250 raketave balistike “Atlas” dhe “Titan”, 450 raketave balistike “Minuteman”

²²Po aty, 18.

²³ Saki Dockrill, Po aty, 4.

²⁴ Keith A. Barlow, “Massive retaliation”, US Army War College, 6 March 1972, 31.

²⁵ Olav Njolstad, Po aty, 19.

²⁶ Glenn H. Snyder, “The New Look of 1953”, 425-451.

dhe 19 nëndetëseve bërthamore “Polaris”. Në të njëjtën kohë, ai financoi një rritje të vazhdueshme të fuqisë strategjike bombarduese, e cila, deri në fund të 1960, llogaritet në më shumë se 600 avionë B-52 dhe gati 1.400 avionë B-47.²⁷ Gjithashtu, *Eisenhower* i kërkoi kongresit më shumë se një miliard dollarë shtesë në buxhetin e mbrojtjes për rezervën e paprekshme strategjike amerikane.

Politika e *Eisenhower* u karakterizua nga një “hendek në rritje midis ‘hardware-ve’ dhe ‘software-ve’ të strategjisë bërthamore të SHBA.”²⁸ Kështu, në njërin anë ishin programet e kushtueshme të mbështetjes së sistemit strategjik me pajisje si bombardues strategjikë B-52, raketa balistike “Minuteman” dhe nëndetëse “Polaris”, ndërsa në anën tjetër, objektivat strategjike dhe aspektet e tjera operative mbetën çuditërisht të pandryshuara nga këto përmirësime sasiore dhe cilësore në armë dhe sisteme të lëshimit. Në këto kushte, misionet kryesore të forcave strategjike mbetën, në thelb, të pandryshuara gjatë gjithë viteve 50-të.

Gjatë kohës së “Shpagimit Masiv”, politika e angazhimit të SHBA u karakterizua nga një stanjacion i zhvillimit të parimeve kryesore operacionale. Kjo ndodhi me Planin Emergjent të Luftës në vitin 1953 dhe Planin e Vetëm të Integruar Operacional (SIOP). SIOP ishte zhvilluar në mënyrë që të përshtaste planet strategjike të luftës, në përputhje me tre zhvillime të rëndësishme: rritjen e kapaciteteve të SHBA nga ana sasiore dhe cilësore, përmirësimin e zbulimit të objektivave strategjikë, me anë të fluturimeve të avionëve spiunë U-2 mbi territorin e BS dhe realizimi i programit “Polaris” i marinës. Ky program krijoi nevojën urgjente për koordinim më të mirë të mësymjes strategjike. Kjo çoi në krijimin e një Shtabi të Përbashkët Strategjik të Planifikimit të Objektivave i cili, në gusht 1960, u ngarkua me hartimin e një Liste Objektivash Strategjikë Kombëtarë dhe përgatitjen e një Plani të Vetëm të Integruar Operacional për të gjitha objektivat e luftës strategjike.²⁹ Një ekspert amerikan do të citonte në lidhje me këtë plan se: “Çdo gjë do të eci shpejt ... raketat e para dhe disa mijëra bomba graviteti do të lëshohen nga avionët. Çdo qytet i madh në Rusi, Evropën Lindore dhe Kinë do të sulmohet. Një numër i objektivave ushtarakë dhe ekonomikë...stacione hekurudhore, baza nëndetësesh, aeroporte, diga hidroelektrike, fushat e naftës, minierat...do të goditen”.³⁰

Pavarësisht rritjes së forcës strategjike dhe arsenalit shkatërrues bërthamor, politika e re e *Eisenhower* mundësoi shkurtimin e shpenzimeve ushtarake. Kjo u arrit duke zvogëluar numrin e forcave, që ishin të shtrenjta për t’u mbajtur. Në të njëjtën kohë, arsenalit bërthamor i SHBA u rrit nga rreth 1.000 bomba në vitin 1953, në rreth 18.000 bomba në vitin 1961. Të gjitha këto zhvillime në forcat strategjike amerikane e treguan veten në fillim të viteve 1960, në presidencën e *John F. Kennedy* dhe *Lyndon B. Johnson*. Pra, të gjitha zhvillimet “filluan gjatë administratës *Eisenhower* dhe në shumë aspekte, ato paraprinin, në vend që të ndiqnin nisjen e satelitit artificial *Sputnik*.”³¹

Kritikat e politikës së “Shpagimit Masiv”

Një lumë kritikash pasuan fjalimin e famshëm të Sekretarit të Shtetit *Dulles* për “Shpagimin Masiv”. Fjalimi ka pasur më shumë kundërshtime në drejtim të pikëpamjeve

²⁷ *Olav Njolstad, Po aty, 20.*

²⁸ *Olav Njolstad, Po aty, 21.*

²⁹ *Po aty, 22.*

³⁰ Thomas Powers, “*Choosing a Strategy for World War III*”, *Atlantic Monthly*, November 1982, 92.

³¹ *Olav Njolstad, po aty, 21.*

të tij. Sulmet ndaj doktrinës strategjike të “Shpagimit Masiv” u fokusuan në efektivitetin e fuqisë bërthamore të SHBA-ve, si një instrument i mundshëm mbështetjeje i mbrojtjes lokale të “Botës së Lirë”. Që nga momenti kur sovjetikët zotëruan armën bërthamore, veprimet duhet të ishin shumë intensive, para se angazhimi i armëve bërthamore mund të ishte një zgjedhje racionale. Fjalimi i *Dulles* dhe shpjegimet e tij të mëvonshme nuk arritën të bënin dallim të qartë midis parandalimit dhe mbrojtjes, dekurajimit të armikut duke ndërmarrë veprime ushtarake dhe suksesit në zvogëlimin e kostove dhe rreziqeve të pengimit të situatave. Këto pika të errëta rritën vlefshmërinë e shumë analizave kritike të doktrinës së “Shpagimit Masiv”.³² Shumë kritikë mendonin se doktrinës i mungonte besueshmëria dhe kështu ajo kishte pak vlera parandaluese kundër nivelit të ulët të rreziqeve apo situatave të paqarta ndaj sigurisë së “Botës së Lirë”, pasi iu kushtua pak vëmendje konceptit të vlerës së mbrojtjes së forcave ushtarake. Për më tepër, procesi i shndërrimit të fuqisë ushtarake në fuqi ose ndikim diplomatik ishte gjithmonë i vështirë, por veçanërisht kur fuqia ushtarake ishte e përqendruar në një formë që do të ishte e arsyeshme të përdoret vetëm në nivele shumë të larta të provokimit. Me pak fjalë, mungesa e doktrinës së vlerës së mbrojtjes kufizonte seriozisht zbatueshmërinë e saj për luftën lokale ose të kufizuar.

Pjesërisht, si rezultat i këtyre kritikave, politikat e sigurisë të administratës *Eisenhower* u zhvendosën në drejtim të rritjes së aftësive për të luftuar në konflikte të kufizuara. Megjithatë, çdo përfshirje e SHBA në konflikte të tilla ishte varur kryesisht mbi përdorimin e armëve taktike bërthamore.³³ Kur sovjetikët prezantuan armët bërthamore taktike në strukturat e tyre të forcës gjatë viteve 1950, u rrit intensiteti i kritikave për politikën amerikane të “Shpagimit Masiv”. Rreziku i përshkallëzimit në një luftë të përgjithshme bërthamore, me përdorimin në fillim të armëve taktike bërthamore, e bënë luftën e kufizuar taktike bërthamore thujse një instrument “të pastër” të “Shpagimit Masiv”. Me fjalë të tjera, për shkak të mundësisë së përshkallëzimit, një mbrojtje lokale, bazuar në përdorimin e armëve taktike bërthamore përfaqësonte shumicën e mangësive të “Shpagimit Masiv” në drejtim të vlerës së saj parandaluese, mbrojtëse dhe diplomatike.

Në katër vitet e para, politikat e blerjes dhe dislokimit të *Eisenhower*, shprehën doktrinën e “Shpagimit Masiv”. Megjithatë, këto politika ishin më pak të përshtatshme në mandatin e tij të dytë. Kritikët e asaj kohe pohonin se administrata *Eisenhower* dështoi në njohjen dhe trajtimin e rritjes së kërcënimit të sulmit sovjetik, pas lëshimit të satelitit artificial “Sputnik”, në tetor 1957. Bashkimi Sovjetik kishte zhvilluar kapacitete sulmuese me raketa, që mund të shkatërrojnë të gjithë qytetet e mëdha të SHBA-ve dhe pjesën më të madhe të forcave hakmarrëse amerikane në një sulm të parë masiv. Këto kritika e kishin shpërfillur nevojën e parandalimit.

Kritikët e kohës, si analisti *Albert Wholstetter*, ekzagjeruan në përgjithësi zhvillimet teknologjike dhe aftësitë e prodhimit ushtarak të Bashkimit Sovjetik. Ata, gjithashtu, qenë të prirur të injoronin përpjekjet e konsiderueshme që SHBA ndërmori në fund të viteve 1950 për të kompensuar përparësitë e mundshme strategjike sovjetike. Në vend që të ishte indiferent ose i nënshtruar ndaj kërcënimit sovjetik në rritje, *Eisenhower* u përgjigj, në mënyrë mjaft të drejtë, me konservatorizmin e tij buxhetor dhe doktrinën e tij ushtarake.

³² Paul Peeters, “*Massive Retaliation, the Policy and Its Critics*”, 1959.

³³ David W. Tarr, “*American Strategy in the Nuclear Age*”, 1966, 88-89.

Edhe në pjesën ushtarake kishte pakënaqësi në lidhje me planet operacionale të administratës *Eisenhower*. Kundërshtimet e filozofisë së angazhimit të *Eisenhower* ishin shfaqur që në 1957, kur udhëheqjet ushtarake të forcave tokësore dhe detare filluan të pyesin se si mund të mblihdeshin, në një strategji të njëkohshme, angazhimet e të gjithë rezervave bërthamore, që, të paktën në letër, kishin një diferencë ndërmjet kategorive të ndryshme të misioneve dhe objektivave strategjike. Ata jo vetëm që kundërshtuan vlerësimet optimiste të SAC se një sulm i plotë çarmatosjeje kundërforcë ishte i mundur, por gjithashtu pohuan se skenari më i mundshëm i angazhimit të forcave strategjike amerikane nuk ishte sulmi parandalues kundërforcë i parashikuar nga SAC, por një sulm hakmarrës në përgjigje të një sulmi fillestar sovjetik, që kishte shkatërruar deri në 75% të forcave strategjike ajrore dhe tokësore amerikane. Në bazë të këtyre supozimeve, ata bënë thirrje për një “angazhim alternativ” që do të kishte rëndësi të barabartë në shkatërrimin e qendrave të popullsisë brenda BS, në masën e nevojshme për të neutralizuar aftësitë e BS për të vazhduar luftën. Përveç kësaj, Shefi i Shtabit të Ushtrisë *Maxwell D. Taylor* kërkoi një riorientim të përgjithshëm të politikës së mbrojtjes së SHBA, larg nga ofensiva strategjike në një luftë ndaj BS dhe me opsione të luftës së kufizuar, që do të zhvillohej në konfliktet lokale.

Politika e goditjes së objektivave duhet të ishte më elastike dhe ajo nuk i përshtatej SAC. Disponimi nga BS i bombës-H dhe zhvillimet në drejtim të raketave balistike sollën që bazat e SAC të ishin jashtëzakonisht të rrezikuara nga sulmi sovjetik. SAC, në vend që të pranonte apelin e forcave detare dhe tokësore për një politikë më elastike të angazhimit, paraqiti një mbrojtje metodike të përcaktimit të objektivave kundërforcë dhe u përpoq të sillte programin e marinës “Polaris” në direktivat e planifikimit. Në kuadrin e këtij rivaliteti ndërmjet forcave, shansi për një rishikim rrënjësor të politikës ekzistuese të angazhimit të SHBA ishte i vogël.

Kundërshtimet ndaj planit të SAC do të mund të tejkaloheshin vetëm nëse kërkesat e forcave detare dhe tokësore, për një politikë më elastike të goditjes të objektivave, do të kishin mbështetjen e *Eisenhower*. Plani i parë SIOP detyronte presidentin *Eisenhower* të zgjidhte midis dorëzimit kombëtar ose një holokausti bërthamor. Rritja e aftësive sulmuese sovjetike, në fund të viteve 1950, do të thoshte që SHBA nuk mund të kishin shpresë për të neutralizuar raketat balistike dhe forcat strategjike bombarduese sovjetike me një sulm të kufizuar kundërforcë. Gjithmonë disa armë të armikut kishin mundësi t’i mbijetonin sulmit. Disa nga këto, me siguri, do të fillonin hakmarrjen kundër objektivave të SHBA.

Është e kuptueshme se besueshmëria e “Shpagimit Masiv” do të ishte e vështirë të mbahej në rrethana të tilla, pasi edhe një angazhim total i forcave sulmuese të SHBA nuk mund të pengonte sovjetikët për të shkatërruar një apo shumë qytete amerikane. “Referuar origjinës së tij profesionale si ushtarak, *Eisenhower* pa dyshim e kuptoi këtë.”³⁴ Gjithashtu, ai kuptoi se zgjidhja praktike e vetme e këtij problemi ishte nëpërmjet shumëfishimit të kapaciteteve pasive dhe aktive të mbrojtjes së SHBA dhe politikave të tij ekonomike. Në vend që të vendoste ekonominë kombëtare në rrezik, *Eisenhower* “vendosi të krijojë besimin e tij në mospëlqimin e demonstruar nga udhëheqja sovjetike për marrjen e rrezikut ushtarak.”³⁵ Në takimin e nivelit të lartë për vendosjen e parimeve

³⁴ *Olav Njolstad, Po aty, 24*

³⁵ *Po aty.*

bazë të planit operacional, *Eisenhower* këmbënguli që, e gjithë rezerva strategjike, duke përfshirë edhe nëndetëset e reja “Polaris”, të angazhohej në një goditje të vetme “simultane”, në të kundërtën “ne humbim gjithë konceptin e objektivave tona të hakmarrjes, i cili merr përparësi mbi çdo gjë tjetër.”³⁶

Në fjalët e historianit amerikan *David Rosenberg*, deri në fund të 1959, koncepti i *Eisenhower* i “Shpagimit Masiv” ishte reduktuar “në një strategji të zgjidhjes së dëshpëruar”³⁷. *Eisenhower* iu tha këshilltarëve të tij, se çështja kryesore ishte se “ne kemi aftësi për të shkatërruar të gjithë ata që na sulmojnë” dhe “gjëja më e madhe sot është që të sigurojmë frenimin e luftës”.³⁸

Debati lidhur me qëndrueshmërinë e “Shpagimit Masiv”, si një parandalim i besueshëm, dha rezultate të papritura në qarqet civile, sidomos në institute të tilla si Korporata RAND, së cilës iu kërkua nga Pentagoni të kryente studime në lidhje me pasojat e një lufte bërthamore mes SHBA dhe BS. Studimi i porositur nga Forcat Ajrore Amerikane tregoi se ka pasur një mundësi për të kontrolluar luftën bërthamore, duke shënjestruar arsenalin bërthamor sovjetik dhe duke kursyer qendrat urbane dhe industriale të tij, duke shpresuar në krijimin e një stimuli për të kursyer qytetet amerikane dhe për të dhënë mundësinë e ofrimit të mekanizmave të nevojshëm politikë, për t’i dhënë fund armiqësive, me kushte të favorshme për perëndimin. Goditja e bazave të armëve bërthamore sovjetike u quajt “kundërforcë”³⁹, ndërsa mbajtja peng e qyteteve të tij u quajt “kundërvlerë”. Këto koncepte do të formojnë shtyllën kurrizore të strategjisë së “Përgjigjes Fleksibile”, e cila do të zëvendësojë “Shpagimin Masiv” si koncept strategjik.

Ndikimi i doktrinës së “Shkatërrimit Masiv” në politikat e NATO-s

Në vitet 1949-1950, NATO kishte miratuar dokumentet kryesore strategjike si, DC 6/1 (Defence Committee-Komiteti i Mbrojtjes) në 1 dhjetor 1949, që përfaqëson konceptin e përgjithshëm strategjik, MC 14 (Military Committee-Komiteti Ushtarak) në 28 mars 1950, që përfaqëson udhëzimet specifike strategjike dhe DC 13 në 1 prill 1950, që përfshin të dy dokumentet për planifikimin e detajuar rajonal.

Takimi i Lisbonës i Këshillit të Atlantikut Verior (North Atlantic Council-NAC) në shkurt 1952, kishte vendosur objektiva force shumë ambiciozë, ku nga 1954, NATO-s i nevojiteshin në total rreth 96 divizione, me gati gjysmën e divizioneve të gatshme, në fillim të konfliktit. Por, përmbushja e këtyre synimeve u provua financiarisht dhe politikisht si e pamundur për anëtarët e Aleancës.

Gjatë viteve 1950-1952, Aleanca pësoi ndryshime të rëndësishme në përfshirjen e anëtarëve të rinj, në organizimin strukturor dhe futjen e koncepteve të reja mbi mbrojtjen e territorit të Aleancës. Këto ndryshime bënë të nevojshëm rishikimin e dokumenteve kryesore strategjike. Kështu, në 3 dhjetor 1952, NAC miratoi MC 3/5 “Koncepti Strategjik për Mbrojtjen e Zonës së Atlantikut Verior” dhe në 9 dhjetor 1952, Komiteti Ushtarak miratoi MC 14/1 “Udhëzimet strategjike”. MC 14/1 ishte shumë më i detajuar se MC 14, pasi përfshinte shumë çështje të mbuluara më parë nga DC 13, duke përfshirë

³⁶ Po aty, 25.

³⁷ Po aty.

³⁸ Po aty.

³⁹ Robert S. McNamara, “Defense Arrangements of the North Atlantic Community”, Buletini i Departamentit të Shtetit, 47, 9 korrik 1962, faqe 64-70.

supozimet, kapacitetet e vlerësuara të armikut dhe kurset e veprimit. MC 14/1 citonte se qëllimi strategjik i përgjithshëm i Aleancës ishte “të siguronte mbrojtjen e zonës së NATO-s dhe të shkatërronte vullnetin dhe aftësinë e Bashkimit Sovjetik dhe satelitëve të tij për të luftuar, fillimisht me anë të një sulmi ajror dhe në të njëjtën kohë, realizimin e operacioneve ajrore, tokësore dhe detare”. Sulmet strategjike ajrore aleate do të përdorin “të gjitha llojet e armëve”.⁴⁰ MC 14/1 merrte parasysh gjithashtu ndikimin e mundshëm të “armëve të shkatërrimit në masë” sipas objektivave të forcës të NATO-s. Nuk është e habitshme që në konceptin strategjik të Aleancës, armëve bërthamore iu ishte dhënë rol për parandalimin dhe mbrojtjen nga çdo agresion i BS dhe aleatëve të tij mbi anëtarët e NATO-s.

Politika e mbrojtjes e NATO-s përcaktonte në MC-14/1 supozimin se objektivi i aleancës gjatë kohës së paqes ishte të bindte Bashkimin Sovjetik se “lufta nuk paguan”⁴¹ dhe, nëse lufta shpërthen, do të mbrohet zona e Atlantikut të Veriut. Në analizimin e pikave të forta dhe të dobëta të Bashkimit Sovjetik dhe aleatëve të tij u konstatua se ai posedonte një forcë të madhe tokësore dhe fuqi komplekse. Blloku sovjetik kishte aftësi të projektonte fuqi ushtarake në zonat në afërsi dhe kishte epërsi numerike në aspektin e fuqisë njerëzore, si dhe nuk paraqiste rrezik në veprimet në det dhe kishte një avantazh të dukshëm në luftën në tokë.⁴²

Nëse Bashkimi Sovjetik dhe satelitët e tij do të sulmonin Evropën Perëndimore, objektivi i NATO-s ishte që të shkatërronte vullnetin dhe kapacitetin e agresorit për të zhvilluar luftë. Ky objektivi do të arrihej me anë të një ofensive ajrore, tokësore dhe detare të kryer në të njëjtën kohë. Aleatët besonin se vetëm nëpërmjet përdorimit strategjik dhe taktik të fuqisë ajrore, ku NATO dhe veçanërisht SHBA ishin superiorë mbi bllokun sovjetik, do të mund të ndalej një sulm ndaj zonës së përgjegjësive të Aleancës. Arsyeja e përdorimit të fuqisë strategjike ajrore të armatosur me armë bërthamore ishte se në vitin 1952 Aleancës i mungonin mjetet konvencionale për të kundërshtuar kërcënimet sovjetike.⁴³

MC-14/1 parashikonte, në fazën e parë të operacioneve, t'i kundërvihej ofensivës sovjetike, me të gjitha mjetet në dispozicion dhe duke siguruar se aleatët ende kishin aftësi për të kryer “sulme strategjike ajrore, me të gjitha mjetet e mundshme dhe me të gjitha llojet e armëve.”⁴⁴ Në Evropën Perëndimore, qëllimi i mbrojtjes ishte mbajtja e “armikut sa më larg të jetë e mundur në lindje”⁴⁵ të Gjermanisë, që përkthehet në konceptin e mbrojtjes së përparuar. Kjo ishte kryesisht detyrë e forcave tokësore, të cilat do të ndihmoheshin nga forcat taktike dhe strategjike ajrore, që ofrojnë një shumëllojshmëri të gjerë mjetesh.

Koncepti strategjik i Aleancës e vinte theksin mbi fuqinë ajrore, armët bërthamore apo konvencionale, si një faktor kyç për frenimin dhe mposhtjen e një agresioni të mundshëm.⁴⁶ Aleanca theksonte se përdorimi i armëve bërthamore ofronte perspektivë

⁴⁰ Gregory W. Pedlow, “NATO Strategy documents 1949-1969”, Tetor 1997, XVI.

⁴¹ M.C.-14/1, 6.

⁴² Po aty, 8.

⁴³ Schwartz, David N., “NATO’s Nuclear Dilemmas”, The Brookings Institution, Washington D.C. 1983, p.17.

⁴⁴ M.C.14/1,10.

⁴⁵ Po aty 17.

⁴⁶ Mearsheimer J. John, “The Tragedy of Great Power Politics!”, W.W. Norton & Company, London, 2001, 99-110.

të sigurisë pa kosto të lartë, në krahasim me zhvillimin e forcës konvencionale.⁴⁷ Një strategji e bazuar në armët bërthamore ishte e preferuar, në veçanti nga anëtarët evropianë të Aleancës, për arsye politike dhe ekonomike, pasi ata nuk mund të përballonin një forcë konvencionale. SHBA iu bënë thirrje aleatëve të tyre evropianë për të kontribuar në zhvillimin e një force të mjaftueshme konvencionale për NATO-n. Çdo sulm mbi një anëtar të NATO-s do të pasohej nga një sulm masiv shpagues.

Në këtë kohë, autoritetet ushtarake të NATO-s u përballën me çështjen se si të integronin armët bërthamore në strategjinë e NATO-s. Më 10 korrik 1953, SACEUR (Supreme Allied Commander Europe-Komandanti Suprem i Forcave Aleate për Evropën) *Matthew B. Ridgway* i paraqiti Grupit të Përhershëm një raport mbi kërkesat e forcës për 1956. Ky ishte shqyrtimi i parë i gjerë i strategjisë së NATO-s mbi përfshirjen e armëve bërthamore. Raporti i *Ridgway* provokoi diskutime, pasi ai arriti në përfundimin se përdorimi i armëve bërthamore do të kërkonte rritje, jo ulje, të niveleve të forcës, për shkak të normave të larta të pritshme të viktimizeve.⁴⁸ Menjëherë pas daljes së raportit, *Ridgway* u zëvendësua si SACEUR nga Gjenerali *Alfred Gruenther*, i cili bëri thirrje për një vështrim të ri në integrimin e armëve bërthamore në strategjinë e NATO-s. Për këtë, në gusht 1953, *Gruenther* krijoi një “Grup të Ri Qasjeje” në SHAPE për studimin e kësaj çështjeje. Ndërkohë që studimet e “Qasjes së re” ishin ende në zhvillim e sipër, më 10 dhjetor 1953, NAC u kërkoi autoriteteve ushtarake të NATO-s të siguronin një rivlerësim të forcës ushtarake të nevojshme nga Aleanca, në fundin e viteve 1950.

Në këtë kohë, SHBA bënë thirrje për integrimin e plotë të armëve bërthamore në strategjinë e NATO-s. Në 23 prill 1954, Sekretari Amerikan i Shtetit *John Foster Dulles*, në Ministerialin e Parisit, deklaroi për NAC pabarazinë e madhe numerike mes forcave konvencionale të NATO-s dhe forcave të Bllokut Sovjetik, si dhe bëri thirrje “për të përdorur armë bërthamore si armë konvencionale, kundër aseteve ushtarake të armikut, sa herë dhe kudo që do të ishte avantazhi për të bërë këtë”.⁴⁹

Në verën e vitit 1954, SHAPE kishte përfunduar punën për “Qasjen e Re” dhe dorëzoi dy studime të mëdha tek Grupi i Përhershëm: Studimin e Kapaciteteve të SACEUR për vitin 1957 dhe Modelin më Efektiv të Forcës Ushtarake të NATO-s për Vitet e Ardhshme. Grupi i Përhershëm përpunoi studimin e fundit dhe prodhoi një projektraport, që u bë një dokument i ri i strategjisë së NATO-s, MC 48.

Pas rënies së propozimit për Komunitetin Evropian të Mbrojtjes, Komiteti Ushtarak miratoi, më 22 nëntor 1954, MC 48 “Modeli më Efektiv i Forcës Ushtarake të NATO-s për Vitet e Ardhshme”. Në 17 dhjetor 1954, NAC miratoi këtë dokument duke dhënë miratimin politik për planifikimin e mbrojtjes së zonës së NATO-s, duke përdorur armët bërthamore. Në kontrast me dokumentet e mëparshme të strategjisë, që jepnin vetëm referenca për armët, duke përdorur frazën “të gjitha llojet e armëve, pa përjashtim”, MC 48 theksoi në mënyrë të qartë përdorimin e armëve bërthamore. Në dokument deklarohet se “ardhja e sistemeve të armëve bërthamore do të ndryshojë në mënyrë drastike kushtet

⁴⁶ Schwartz, David N., “NATO’s Nuclear Dilemmas”, The Brookings Institution, Washington D.C., 1983, 16-17.

⁴⁷ Gregory W. Pedlow, “NATO Strategy documents 1949-1969”, Tetor 1997, XVII.

⁴⁸ Po aty.

⁴⁹ Gregory W. Pedlow, “NATO Strategy documents 1949-1969”, Tetor 1997, XVIII.

e luftës moderne”. Si rezultat, superioriteti në armët bërthamore dhe kapacitetet e lëshimit të tyre do të jetë faktori më i rëndësishëm në një luftë të madhe në të ardhmen.⁵⁰

MC 48 arriti në përfundimin se “forcat e NATO-s duhet, para së gjithash, të jenë forca ekzistente”, të pajisura me “aftësi të integruar atomike”. MC 48 nuk kufizonte përdorimin e NATO-s në një sulm hakmarrës me armë bërthamore pas përdorimit nga BS në fillim. MC 48 argumentonte se NATO do të ishte në gjendje të parandalonte sulmin sovjetik në Evropë vetëm nëse NATO angazhon menjëherë armët bërthamore.

Në 14 nëntor 1955, Komitetit Ushtarak miratoi MC 48/1 “Modeli më Efektiv i Fuqisë Ushtarake të NATO-s për Vitet e Ardshme-Raporti nr 2”, i cili hyri në fuqi më 9 dhjetor 1955. Ky dokument nuk zëvendësoi MC 48, por siguroi informacion shtesë. Këto ndryshime në dokumentet strategjike të NATO-s bënë të nevojshëm pasqyrimin edhe në dokumentet e tjera. Kështu, në verën e vitit 1956, Grupi i Përhershëm dhe Komiteti Ushtarak filloi të punojë për dy dokumente të reja (MC 14/2 dhe MC 48/2) për të krijuar një seri koherente të dokumenteve strategjike.

Kjo periudhë përfaqësonte një moment tensioni brenda Aleancës. Franca kërkoi që në MC 14/2 të përfshiheshin ngjarjet jashtë zonës së NATO-s, që kanë efekt në politikën dhe veprimtarinë ekonomike sovjetike. Kjo kërkesë mori rëndësi më të madhe, në vjeshtën e vitit 1956, kur Mbretëria e Bashkuar dhe Franca u përpoqën të rimarrin kontrollin e Kanalit të Suezit nga Egjipti, por që u kundërshtua fort nga SHBA. Nga ana tjetër, Britania e Madhe filloi të shtynte Këshillin e Atlantikut të Veriut (NAC) për të nxjerrë udhëzime politike që do të shkaktonin zvogëlimin e kërkesave të forcës, duke u mbështetur pothuajse plotësisht në armët bërthamore për të mbrojtur Evropën. Vendet e tjera nuk ishin të gatshme për këtë. Në këto kushte, doli “direktiva politike” e 13 dhjetor 1956, CM (56) 138 “Direktiva për Autoritetet Ushtarake të NATO-s” nga Këshilli i Atlantikut të Veriut që bënte thirrje për një rishikim të planifikimit të mbrojtjes të NATO-s.⁵¹

Bazuar në direktivën e re politike, Grupi i Përhershëm filloi rishikimin e strategjisë së NATO-s. Si rrjedhojë, u prodhuan dy dokumente të reja strategjike: MC 14/2 “Koncepti Strategjik i Përgjithshëm për Mbrojtjen e Zonës së NATO-s” dhe MC 48/2 “Masat për Zbatimin e Konceptit Strategjik” që u miratuan nga Komiteti Ushtarak në prill 1957 dhe NAC në 9 maj 1957.

MC 14/2 përfaqësonte konceptin e “Shpagimit Masiv”, duke theksuar fort përdorimin e armëve bërthamore në mbrojtjen e zonës së NATO-s. Aty deklarohet:

Objektivi ynë kryesor është të parandalojmë luftën, duke krijuar një pengesë efektive për agresionin. Elementet kryesore të parandalimit janë elementet e përshtatshme bërthamore, forcat e tjera të gatshme dhe përcaktimi i qartë për t’u hakmarrë kundër çdo agresori me të gjitha forcat që kemi në dispozicion, duke përfshirë edhe armët bërthamore, të cilat do t’i kërkojë mbrojtja e NATO-s.⁵²

MC 14/2 karakterizohet si strategji e “Shpagimit Masiv”, në të cilën forcat konvencionale të NATO-s shërbejnë thjesht si një “kurth” për lëshimin e forcave hakmarrëse bërthamore të NATO-s. MC 14/2 theksonte që forcat konvencionale të ishin në gjendje të vepronin

⁵⁰ Po aty, XIX.

⁵¹ Gregory W. Pedlow, “NATO Strategy documents 1949-1969”, Tetor 1997, XX.

⁵² Po aty.

në situata më të vogla “pa nevojën e armëve bërthamore”. Nga ana tjetër, MC 48/2 deklaronte që kishte dy lloje forcash të NATO-s, forcat bërthamore hakmarrëse dhe forcat mburojë, të cilat do të “mbrojnë zonat detare dhe territoret e NATO-s sa më përpara (larg) të jetë e mundur, në mënyrë që të ruajnë integritetin e zonës së NATO-s, duke u mbështetur në përdorimin e armëve të tyre bërthamore në fillim”.⁵³

Edhe pse MC 48/2 fokusohej kryesisht në luftën bërthamore, MC 14/2 përmbante elemente të fleksibilitetit për NATO-n. Aty theksohet se forcat e NATO-s duhet të jenë të afta të veprojnë “menjëherë për të rivendosur dhe ruajtur sigurinë e zonës së NATO-s, pa nevojën e burimeve të armëve bërthamore”. Megjithatë, ky fleksibilitet nuk përfshin idenë e një lufte të kufizuar. Kjo është përfshirë në të dy dokumentet (MC 48/2 dhe MC 14/2), ku citohet se:

Nëse sovjetikët përfshihen në një veprim armiqësor lokal dhe kërkojnë të zgjerojnë qëllimin e një incidenti apo ta zgjasin atë, situata do të kërkonte shfrytëzimin e të gjitha armëve dhe forcave në dispozicion të NATO-s, pasi, në asnjë rast, nuk ka një koncept të luftës së kufizuar me sovjetikët.⁵⁴

Kur NATO filloi të mbështetej mbi armët bërthamore strategjike të SHBA për mbrojtjen e Evropës, territori i SHBA-ve nuk ishte i kërcënuar nga armët bërthamore për shkak se Bashkimi Sovjetik nuk kishte sisteme të lëshimit në distancë për të arritur SHBA. Pacenueshmëria e SHBA-ve u zvogëlua si rezultat i zhvillimeve në BS të bombarduesve me rreze të gjatë dhe lëshimit të satelitit të parë artificial *Sputnik*. Rritja e kërcënimit bërthamor sovjetik e rriti frikën midis aleatëve evropianë se SHBA nuk mund të jenë të gatshme të përdorin armët e tyre bërthamore për të mbrojtur Evropën, në të gjitha rrethanat. Aleatët evropianë të SHBA, veçanërisht Franca, Britania e Madhe dhe Gjermania Perëndimore, nuk kishin shumë besim në garancinë bërthamore amerikane, pasi ata besonin se SHBA nuk do të rrezikonin qytetet amerikane për ato evropiane, në rast të një sulmi bërthamor të Bashkimit Sovjetik kundër Evropës Perëndimore. Presidenti francez *Charles de Gaulle* mund të kishte të drejtë kur deklaroi se “asnjë presidenti i SHBA nuk do të shkëmbente *Chicago*-n për *Lyon*-in.”⁵⁵ Gjithashtu, ata kishin frikë se, në rast të luftës bërthamore, do të ndiheshin të braktisur dhe pa mundësi parandalimi të sulmeve bërthamore të BS mbi Evropën Perëndimore, kur SHBA do të fillonin sulmin e “Shpagimit Masiv” ndaj BS.

Qëndrimi kritik i SHBA ndaj Francës dhe Britanisë së Madhe, në Krizën e Suezit, në vitin 1956, përforcoi bindjen se ata nuk do të mund të mbështeten në përkrahjen amerikane për interesat e tyre jetike. Si pasojë, Franca dhe Britania e Madhe filluan ndërtimin e arsenaleve të tyre bërthamore. Mungesa e besimit në garancinë bërthamore amerikane, zhvillimi i arsenaleve bërthamore kombëtare nga Britania e Madhe dhe Franca, mungesa e vullnetit të SHBA për të shkëmbyer informacione në lidhje me armët bërthamore dhe strategjinë, krijuan rritjen e tensioneve brenda NATO-s në çështjen e politikës bërthamore.

Këto ishin arsyet që “Shpagimi Masiv” u pa si një zgjidhje afatshkurtër për dilemat e sigurisë me të cilat do të përballëshin SHBA dhe NATO. Shqetësimet në lidhje me efektivitetin e strategjisë me bazë bërthamore të NATO-s filluan të rriten në fund të vitit 1958, me fillimin e Krizës së Dytë të Berlinit. Megjithatë, referuar faktit se në vitet

⁵³ Po aty.

⁵⁴ Po aty, XXI.

⁵⁵ Schwartz N. David, “*NATO's Nuclear Dilemmas*”, The Brookings Institution, Washington D.C., 1983, 58.

1950-1960, SHBA kishte një epërsi të qartë në drejtim të armëve bërthamore dhe mjeteve të lëshimit, strategjia e “Shpagimit Masiv”, me gjithë të metat e saj, ishte një mjet i përshtatshëm për të ndaluar zgjerimin e Bashkimit Sovjetik.

Parë nga këndvështrimi ushtarak, strategjia e “Shpagimit Masiv” sakrifiko kapacitetet konvencionale në favor të ndërtimit të arsenaleve bërthamore, duke e lënë NATO-n të pambrojtur ndaj sulmeve të zbulimit, incidenteve kufitare, agresioneve të kufizuara konvencionale kundër një anëtar të NATO-s dhe presioneve politiko-ushtarake. Kjo duket edhe në një fjalim në *Sinsinati* në 1958 të Komandantit Suprem të Forcave Aleate për Evropë (SACEUR) gjeneralit amerikan *Lauris Norstad*, që shprehu shqetësimin se:

“Në një epokë mjaft bërthamore..., mburoja e NATO-s na siguron një opsion më shumë të dobishëm sesa një zgjedhje të thjeshtë midis gjithçkaje ose asgjëje. A duhet të dështojme në ruajtjen e një force mbrojtëse të arsyeshme në kufirin e NATO-s, pastaj shpagimi masiv mund të jetë përgjigja jonë e vetme ndaj një agresioni, pa marrë parasysh natyrën e tij”.⁵⁶

Për eliminimin e kësaj dobësie, SACEUR hartoi një plan për thirrjen e 30 divizioneve si forcë aktive dhe 30 divizioneve të tjera në rezervë, si dhe krijimin e një arsenali bërthamor të NATO-s. Për të qetësuar aleatët evropianë, në 1957 SHBA ofruan raketa balistike me rreze të mesme dhe krijuan një arsenal bërthamor të NATO-s.⁵⁷ Armët bërthamore dhe sistemet e lëshimit u ofruan në bazë të marrëveshjes “çelës i dyfishtë”, ku SHBA ofronin pajisjet, ndërsa partnerët e evropianë, bazat dhe drejtimin e sistemeve. Vendimi për përdorimin e tyre duhet të ishte i përbashkët. Kjo marrëveshje kënaqte interesin amerikan për të patur një komandë të unifikuar të besueshme për lëshimin e armëve bërthamore të shpagimit masiv dhe shmangte gabimet e sulmeve të pakoordinuara bërthamore nga arsenalet kombëtare. Megjithatë, vetëm tre vende pranuan instalimin e raketave në territoret e tyre: Britania e Madhe, Italia dhe Turqia. Në 1960, SHBA filluan një tjetër program për krijimin e një force të qëndrueshme bërthamore të NATO-s, të quajtur Forca Shumëpalëshe, e përbërë nga një numër anijesh të armatosura me raketa balistike, me rreze të mesme dhe që drejtoheshin nga ekipe ndërkombëtare të vendeve të Aleancës. Ky propozim nuk u prit mirë nga anëtarët evropianë, ku Franca e konsideronte atë një “dredhi” të SHBA për të penguar zhvillimin e arsenaleve atomike kombëtare dhe imponimin e tyre në Evropë, ndërsa Britania e Madhe e hodhi poshtë atë në aspektin teknik si të pamundur, për shkak të heterogjenitetit të ekuipazheve.⁵⁸ Ky propozim u braktis në 1965 nga SHBA.

Në studimet që u zhvilluan për vlerësimin e aftësive ushtarake, potencialeve ekonomike dhe demografike të Bashkimit Sovjetik, u zbulua se vlerësimet e mëparshme të forcave sovjetike ishin mbivlerësuar dhe ekzistenca e 175 divizioneve sovjetike dhe vendeve satelite të tij, të gatshme të godisnin Evropën Perëndimore, nuk ishte e vërtetë. Kjo ishte arsyeja e rishikimit të strategjisë së NATO-s, duke e vendosur theksin në zhvillimin e aftësive konvencionale.⁵⁹ Strategjia e re u prezantua nga SHBA në 1961, në takimin e ministrave të NATO-s në Athinë.

⁵⁶ Po aty, 65.

⁵⁷ Schwartz N. David, Po aty, 82-85.

⁵⁸ Po aty.

Përfundime

Fjalimi emocional mbi doktrinën e “Shpagimit Masiv” turbulloi strategjinë e administratës *Eisenhower*. “Shpagimi Masiv” synonte pengimin e përdorimit nga BS të armëve bërthamore, si dhe eliminimin e cenimit nga BS të fushave jetike për interesat kombëtare të SHBA. Zhvillimet politike dhe strategjike në vitet e para të administratës *Eisenhower* e vunë theksin në forcat strategjike bërthamore, duke dëmtuar perspektivën e forcave konvencionale. Ky zhvillim u mbështet në elementin e sigurisë dhe reduktimin e shpenzimeve financiare. Referuar kësaj politike, niveli i forcave hakmarrëse amerikane që do të pengonin kërcënimin sovjetik, ishte i pamjaftueshëm në fillim të viteve ‘50. Kjo solli që gjatë viteve të *Eisenhower*, armët bërthamore të kishin një rritje të jashtëzakonshme, në numër dhe cilësi. Edhe sistemet e lëshimit të armëve bërthamore patën një zhvillim cilësor dhe sasior. Humbësit e mëdhenj të këtyre zhvillimeve ishin forcat konvencionale. Me bindje të plotë, kjo periudhë mund të cilësohet si “çmenduria” e strategjisë bërthamore të SHBA.

Në themel të kësaj strategjie qëndronte frika nga monopoli bërthamor i SHBA që do të bënte të mundur mbajtjen larg të kërcënimeve sovjetike ndaj interesave amerikane. Doktrina strategjike e “Shpagimit Masiv” pati një ndikim të madh jo vetëm në politikën amerikane, por edhe tek aleatët e saj dhe NATO. Ajo qëndroi në themel të konceptit strategjik të NATO-s për një kohë të gjatë, si dhe ndikoi tek aleatët me potencial për zhvillimin e programeve bërthamore. Kjo periudhë u karakterizua nga frika dhe mungesa e besimit midis aleatëve dhe SHBA.

Doktrina strategjike e “Shpagimit Masiv”, që në fillim, u përball me një lumë kritikash në drejtim të pikëpamjeve, të besueshmërisë, efektivitetit, madje edhe në drejtim të planëzimit ushtarak operacional. Në varësi të këndvështrimit, informacionit në dispozicion dhe vërtetësisë së tij, këto kritika mund të ishin objektive dhe subjektive. Megjithatë, ato ndikuan në të ardhmen e kësaj doktrine. Ajo që mund të konsiderohet arritje e madhe e kësaj politike dhe strategjie është se ato e bënë SHBA një fuqi të padiskutueshme botërore, që do të ndikonte zhvillimet e ardhshme botërore.

Bibliografi:

- *Olav Njolstad*, “*In Search of Superiority: US Nuclear Policy in the Cold War*”, 1994.
- Keith A. Barlow, “*Massive retaliation*”, US Army War College, 6 March 1972.
- Winston Churchill, “*Never Despair*”, Speech on 1 March 1955, House of Commons.
- Nevin Power, “*Did Eisenhower’s New Look Defence Policy Make America Safer or Not?*”.
- Saki Dockrill, “*Eisenhower’s New-Look National Security Policy, 1953-61*”, Macmillan Press LTD, 1996.
- John Foster Dulles, “*The Evolution of Foreign Policy*”, 12 January 1954, *Department of State Bulletin*, Vol. 30.
- Samuel F. Wells, “*The Origins of Massive Retaliation*”, *Political Science Quarterly*, Vol. 96, No. I, Spring 1981.
- Glenn H. Snyder, “*The New Look of 1953*”.
- Thomas Powers, “*Choosing a Strategy for World War III*”, *Atlantic Monthly*, November 1982.
- Paul Peeters, “*Massive Retaliation, the Policy and Its Critics*”, 1959.
- David W. Tarr, “*American Strategy in the Nuclear Age*”, 1966.
- Mearsheimer J. John, “*The Tragedy of Great Power Politics*”, W.W. Norton & Company, London, 2001.
- Schwartz N. David, “*NATO’s Nuclear Dilemmas*”, The Brookings Institution, Washington D.C., 1983.

Wilhelm zu Wied dhe Shqipëria (mars-shtator 1914)

Major Dr. Marenglen Kasmi
Pedagog në AFA

Trajtesë e shkurtuar. *Periodha e qeverisjes së Wied -it në Shqipëri, nga 7 marsi deri më 3 shtator 1914, është një periudhë e ngjeshur me kontradikta politike dhe ushtarake si të jashtme ashtu edhe të brendshme. Konfliktet e brendshme buronin nga larmia fetare i popullsisë shqiptare, politikat personale të figurave politike, si dhe nga zgjedhja që iu diktua Shqipërisë, nëpërmjet vendosjes së një pushteti ksenokrat. Rivalitetet dhe interesat e ndryshme të Fuqive të Mëdha gjatë Konferencës së Ambasadorëve, para së gjithash të Austro-Hungarisë dhe Italisë, e kthyen Shqipërinë në një «kukull loje». Këtë gjë e dëshmon edhe përzgjedhja në krye të shtetit shqiptar e një figure të panjohur gjermane, siç ishte Wilhelm zu Wied. Në këto gjashtë muaj mbretërim, dolën në pah si rivalitetet ndërmjet Fuqive të Mëdha, ashtu edhe problemet e brendshme që kishte Shqipëria në fillimet e saj si shtet i pavarur.*

Shqipëria në Konferencën e Ambasadorëve në Londër

Luftërat Ballkanike e detyruan Turqinë, pas më se 500 vjetësh, të largohet nga Shqipëria. Grekët kishin pushtuar Shqipërinë Jugore, malazezët pjesën veriore të saj, bashkë me Shkodrën. Serbët kishin hyrë në thellësi të territorit shqiptar deri në detin Adriatik. Secili nga këto shtete shpresonte të përmbushte synimet e vjetra ndaj Shqipërisë. Por, në të njëjtën kohë, pushtimi i Shqipërisë ishte i një rëndësie të veçantë edhe për Italinë. Sundimi i Shqipërisë për Italinë do të thoshte zotërim i detit Adriatik. Për këtë arsye, fati i Shqipërisë ndiqej me jo pak interes në arenën politike evropiane. Edhe Austro-Hungaria, për të cilën një dalje e lirë në detin Adriatik konsiderohej e rëndësishme, ishte jo më pak e interesuar në këto zhvillime.¹

Këto përplasje interesash kërkonin zgjidhje e, në të njëjtën kohë, Fuqitë e Mëdha duhej të merrnin në konsideratë faktin që, një përplasje e tillë interesash në këtë vend, edhe nëse nuk sigurohej ekzistenca shtetërore e Shqipërisë, mund të bëhej burim kontradiktash të vazhdueshme mes shteteve fqinje, gjë që mund të rrezikonte seriozisht paqen në Evropë. Si zgjidhja më e mirë për të shmangur këtë rrezik, u konsiderua njohja e Pavarësisë së Shqipërisë dhe krijimi i një principate shqiptare, nën drejtimin e një princi të huaj.

¹ Wilhelm, Fürst von Albanien, Prinz zu Wied: Denkschrift über Albanien, (nicht veröffentlichte Manuskript) f. 6

Turqia, tashmë e dobësuar, hoqi dorë nga Shqipëria, duke miratuar kështu formimin e një principate të pavarur shqiptare. Ajo ia la në dorë Fuqive të Mëdha rregullimin e kufijve territorialë të Shqipërisë dhe çështjeve të tjera që duhej të trajtoheshin për zgjidhjen e këtij problemi.

Nëpërmjet vendimeve të Konferencës së Ambasadorëve, më 29 qershor 1913, Shqipëria u shpall e pavarur dhe u njoh si e tillë nga Gjermania, Austro-Hungaria, Anglia, Rusia, Franca dhe Italia. Vendimet e konferencës mbi organizimin e ardhshëm të Shqipërisë ishin:²

- E garantuar nga Fuqitë e Mëdha, Shqipëria shpallet principatë autonome, sovrane dhe me të drejtë trashëguese. Princi do të zgjidhet nga Fuqitë e Mëdha.
- Çdo lloj ndërhyrjeje e Turqisë ndaj Shqipërisë është i ndaluar.
- Shqipëria është neutrale; neutraliteti i saj garantohet nga gjashtë Fuqitë e Mëdha.
- Kontrolli i administratës civile dhe financave të Shqipërisë i besohet një komisioni ndërkombëtar. Komisioni përbëhet nga anëtarë të Fuqive të Mëdha dhe nga shqiptarë.
- Të drejtat e komisionit zgjatin dhjetë vjet; nëse është e nevojshme, afati mund të zgjatet.
- Komisioni duhet të përgatisë një strukturë organizative të detajuar për gjithë degët e administratës në Shqipëri. Brenda gjashtë muajve, komisioni do t'i paraqesë Fuqive të Mëdha një raport për ecurinë e punës, si edhe mbi vendimet në lidhje me organizimin e administratës dhe financave.
- Princi do të zgjidhet brenda gjashtë muajve. Deri në zgjedhjen e tij dhe në formimin e qeverisë kombëtare përfundimtare, kontrolli i instancave vendore dhe xhandarmërisë i kalon Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit (KNK).
- Siguria dhe rendi publik do të sigurohen nëpërmjet organizimit ndërkombëtar të xhandarmërisë. Ky organizëm do t'i besohet oficerëve të huaj të cilët kanë komandën e përgjithshme mbi xhandarmërinë.
- Këta oficerë do të merren nga ushtria suedeze (më vonë u zëvendësuan me holandezë-M.K).
- Misioni i oficerëve të huaj instruktorë nuk kufizon as unifikimin e shërbimit, as përdorimin e oficerëve vendas, nënoficerëve dhe xhandarëve.
- Pagat e këtyre oficerëve do të sigurohen nga të ardhurat e vendit, me garancinë e Fuqive të Mëdha. Kandidatura për zgjedhjen e princit të ri duhet të përzgjidhet nga Fuqitë e Mëdha më të interesuara, Austro-Hungaria dhe Italia.

Pra, Shqipëria u shpall dhe u njoh nga vendimet e Konferencës së Ambasadorëve, si një shtet i pavarur.³ Kandidati duhej të përzgjidhej me konsensus nga Austro-Hungaria dhe Italia, duke marrë edhe miratimin e shteteve të tjera pjesëmarrëse në Konferencë. Zgjedhja e princit ishte e lidhur ngushtë me formën e re shtetërore që duhej të kishte Shqipëria.

² Po aty, f. 6; Georges CASTELLAN: Histori e Ballkanit, Çabej, Tiranë 1991, f. 396-398; Ferdinand SCHEVILL: Ballkani. Historia dhe qytetërimi, Tiranë 2002, f. 392-393.

³ Wilhelm, Fürst von Albanien, Prinz zu Wied: Denkschrift über Albanien, (nicht veröffentlichte Manuskript) f. 6.

Për krijimin e shtetit të ri shqiptar ishin të interesuara kryesisht shtetet e Aleancës Trefishe. Edhe për Gjermaninë, si pjesëtare e kësaj aleance, zgjidhja e problemit shqiptar ishte e rëndësishme, sepse për të Shqipëria konsiderohej si një “*tertium comparationis*”⁴ ndërmjet Austro-Hungarisë dhe Italisë.

Dërgimi i këtij sundimtari të huaj, i cili do të përfaqësonte politikën e Fuqive të Mëdha në Shqipëri u shoqërua me diskutime të shumta.⁵ Në të ranë në sy divergjencat dhe konfliktet e interesit ndërmjet Austro-Hungarisë dhe Italisë për zgjidhjen e çështjes shqiptare. Të diktuar nga koha e shkurtër e zgjedhjes së princit (brenda gjashtë muajve që nga marrja e vendimit), Austria dhe Italia vlerësuan Princin *Wilhelm zu Wied* si kandidatin më të përshtatshëm për marrjen e fronit shqiptar. Të gjashtë Fuqitë e Mëdha ranë dakord me këtë propozim.

Kush ishte *Wilhelm zu Wied* ?

Wilhelm zu Wied lindi më 26 mars 1876 në *Neuwied*. Më 3 qershor 1897, në moshën 21 vjeçare, ai nisi karrierën ushtarake si nëntoger në Regjimentin e 3-të të Kalorësisë së Gardës Prusiane, në Potsdam.⁶ Ky regjiment ishte i njohur për numrin e madh të oficerëve me origjinë nga familjet aristokrate gjermane. Madje, edhe vetë perandori *Wilhelm II* kishte shërbyer në të.

Wied -i u përshtat shumë shpejt në jetën ushtarake. Ai gëzonte respektin e shokëve dhe vartësve të tij. Edhe në jetën civile, ai shfaqej i matur, i kujdesshëm dhe shquhej për drejtësinë e tij.⁷ Më 30 nëntor 1906 ai u martua me princeshën *Sophie von Schönburg-Waldenburg* (*Sofi fon Shënburg-Valdenburg*). Martesa dhe detyrat e tij në regjiment nuk e penguan të përgatitej dhe të kalonte me sukses provimin e pranimit në Akademinë e Luftës. Më 19 dhjetor 1907, *Wied*-i mori gradën e togerit dhe më 20 mars 1911, gradën e kapitenit.⁸ Në Potsdam lindën edhe dy trashëgimtarët e familjes, *Marie Eleonore* (*Mari Eleonore*) dhe *Carol Viktor* (*Karl Viktor*).

Pas përfundimit me sukses së Akademisë së Luftës në Berlin, e cila zgjati tre vjet, *Wied* -i u kthye përsëri në regjimentin e tij. Pak kohë më vonë, pasi u gradua kapiten, ai u emërua në Shtabin e Përgjithshëm në Berlin. Pas disa vitesh shërbimi në Shtabin e Përgjithshëm, ai u kthye përsëri në Potsdam si “*Rittmeister*” (kapiten i kavalerisë) dhe u emërua komandanti i një skuadroni në të njëjtin regjiment që kishte qenë dikur. Propozimi për të marrë kurorën e Shqipërisë e gjeti *Wied*-in në këtë detyrë. Gjatë ceremonisë së largimit nga regjimenti, *Wied*-it iu dha grada “*Major à la suite*”.⁹

⁴ Term retorik nga latinishtja, i cili përcakton elementin e përbashkët midis dy subjekteve.

⁵ Ministri i Jashtëm austriak konti Berchtold vlerësonte Princin turk Fuad si kandidatin më të mundshëm për Princ të shqiptarëve. Meqenëse Princi Fuad e kishte kryer arsimimin e tij ushtarak në Torino, konti Berchtold e ndërroi mendimin e tij, duke pasur frikë se mos ai do të ndiqte një kurs pro-italian. Po ashtu edhe kajzeri austriak nuk e pëlqeu këtë kandidaturë. Si pasojë, Berchtold-i mendonte se duka *Wilhelm II von Urach* (*Vilhelm II fon Urah*) ishte kandidati më i mundshëm për fronin shqiptar. Ai kishte një prejardhje të pastër gjermane, ishte i pasur dhe me përkatësi fetare katolike. Por, ky kompromis do të dështonte si pasojë e ndërhyrjes energjike të ministrit të jashtëm italian San Giuliano, i cili preferonte një protestant në këtë post.

⁶B Arch R8034/III 489.

⁷ B Arch R8034/III 489.

⁸ B Arch R8034/III 489.

⁹ «*Major à la suite*» do të thoshte që *Wied*-it lejohej të vishte uniformën ushtarake, por që nuk ishte më pjesë

Përzgjedhja e tij si sundimtar i Shqipërisë ishte bazuar mbi arsye të forta pragmatike. *E para*, si gjerman, ai përfaqësonte një komb, i cili nuk tregonte ndonjë interes të madh ndaj Shqipërisë dhe *së dyti*, ai ishte protestant dhe nuk i përkiste asnjërës prej përkatësive fetare në Shqipëri. Një arsye tjetër, jo më pak e rëndësishme, ishte që princ *Wied*-i ishte i varfër dhe si i tillë nuk mund të kishte shumë pretendime.¹⁰

Politika gjermane nuk ishte dakord me ardhjen e *Wied*-it në Shqipëri. Madje *Wilhelm II* ishte i mendimit se, në rastin e Shqipërisë, do të ishte më mirë zgjedhja e një princi mysliman, me një kuletë të mbushur plot dhe, siç ai do të shprehej, “ç’ka në Shqipëri ishte veçanërisht e nevojshme”.¹¹ Po kaq pesimist ishte edhe vlerësimi që ai kishte për *Wied*-in: “Unë isha jo shumë i entuziazmuar kur mora vesh për përzgjedhjen e princit *Wilhelm zu Wied*. Unë e vlerësoja shumë atë si një natyrë fisnike, kalorësiake dhe me ndjeshmëri të hollë. Por, e quaja si të papërshtatshëm për atë post. Princi nuk e njihte shumë Ballkanin për të realizuar me sukses këtë detyrë kaq të vështirë. Nuk ishte aspak e këndshme për mua që atje (në Shqipëri-M.K) të turpërohej një princ gjerman”.¹²

Shqipëria në prag të ardhjes së *Wied*-it

Në dhjetor të vitit 1913, dy oficerë, kapiteni austriak *Ulmansky* dhe ai gjerman *Clanner*, të urdhëruar nga Shtabi i Përgjithshëm austro-hungarez, kryen një vizitë disajvare në Shqipëri. Kapiten *Ulmansky* vizitoi qytetet e Shkodrës, Lezhës, Durrësit, Tiranës dhe Pogradecit, ndërkohë që kapiteni *Clanner* vizitoi jugun e Shqipërisë. Në fund të vizitës, *Ulmansky* hartoi një raport shumë të hollësishëm dhe profesional për situatën në Shqipëri.

Ulmansky e klasifikonte shoqërinë shqiptare në katër grupime kryesore dhe konkretisht në:

- shtresën e kulturuar dhe të arsimuar elitare të vendit;
- në bejlerët e fshatit;
- në elementë të kulturuar, që kishin jetuar në Evropë, por që ishin me prejardhje nga shtresat e ulëta të shoqërisë;
- dhe në pjesën tjetër të popullit, ç’ka përbënte edhe shumicën e tij dhe që ishte analfabete.

Cilat ishin tiparet e këtyre grupimeve, sipas kapiten *Ulmansky*-t?¹³

Shtresa elitare e vendit; e cila ishte në kontakt me kulturën evropiane ose që kishte shërbyer në aparatit shtetëror gjatë sundimit turk. Në këtë kategori kishte vetëm pak elementë të vlefshëm që mund t’i shërbenin *Wied*-it. Xhelozia e tyre ndaj njëri-tjetrit, ambiciet për pushtet, nder dhe para do t’i shkaktonin probleme të mëdha princit. Prandaj, ishte në interes të tij dhe të vendit, që, së pari, të kufizohej pushteti efektiv i këtyre elementëve. Shumica e kësaj shtrese kishte koncepte etnike shumë të ngatërruara. Madje, disa koncepte të tyre, mund të konsiderohen edhe si të pamoralshme. Gjithsesi, në këtë kategori kishte elementë të mirë dhe me vlera, të cilët mund të përdreshin në pozicione drejtuese të administratës.

Bejlerët që jetojnë në fshat; pjesa më e madhe e tyre nuk mund të merrej në administratë, sepse ishin analfabetë. Por, një pjesë e tyre, që ishte e arsimuar, mund të krijonte një

¹⁰ Kandidatura e tij u propozua dhe u mbështet fuqimisht nga çifti mbretëror i Rumanisë, *Wied*-i ishte një nga nipërit e mbretëreshës Elisabeta e Rumanisë.

¹¹ Kaiser WILHELM II: Ereignisse und Gestalten, Leipzig 1922, f. 136.

¹² WILHELM II: Ereignisse und Gestalten, f. 137.

bazë të fuqishme mbështetëse për qeverinë e re. Në një farë mase, ishte e nevojshme të ngarkoheshin me punë edhe të paarsimuarit e kësaj shtrese. Ndoshta, duke shfrytëzuar inteligjencën e tyre natyrore, si edhe dëshirën për të bashkëpunuar, mund të bëhej e mundur që, brenda një kohe të shkurtër, ata të ushtronin funksione administrative.

Elementët që rridhnin nga populli i thjeshtë, që kishin jetuar në Evropë dhe e njihnin kulturën evropiane. Ashtu si një pjesë e shtresës elitare të vendit, edhe kjo shtresë, gjatë jetës në Europë kishte shijuar kënaqësinë e rreme të kulturës evropiane dhe si pasojë kishte koncepte etnike të ngatërruara. Por, një pjesë e tyre zotëronte një arsimim të vërtetë dhe ata mund të përbënin një mbështetje shumë të fortë për qeverinë.

Pjesa më e madhe e popullit, gjendej në një prapambetje shekullore dhe ishte e nevojshme që me ta të ndiqej një edukim kulturor gradual. Nëse do të tentohej të përshejtohej procesi i kulturimit të tyre-argumentonte më tej *Ulmansky*-mund të kishte pasoja fatale. Por, nëse do të ngrihej një regjim i bazuar në rregulla, i fuqishëm dhe i drejtë, atëherë zhvillimi kulturor në vetvete do të përshejtohej dhe njerëzit, shumë shpejt, do të shndërroheshin në qytetarë të bindur dhe të nënshtruar. Por nëse fuqia shprehëse e pushtetit do të mungonte-ç'ka edhe ndodhi-atëherë ata nuk do të bindeshin më.

Veçantia e organizimit shtetëror në Shqipëri, në vitet 1913-1914, ishte i dukshëm. Në vend vepronin, paralelisht me njëra tjetrën, disa qeveri lokale. Në Shkodër drejtonte qeveria e detashmentit ndërkombëtar, nën komandën e kolonelit britanik *Phillips*.

Qeveria e Esat Pashës, në Durrës, mund të konsiderohej si e vetmja qeveri shqiptare, e cila ishte vërtet në gjendje të qeveriste. Nëpërmjet organeve përkatëse, Esat Pasha ishte në gjendje të mblidhte taksat, filloi të ndërtonte rrugë, krijoi një xhandarmëri të disiplinuar dhe emëroi në vendet më të rëndësishme nëpunës që ndiqnin dhe zbatonin urdhrat e tij. *“Në territorin e zotërimit të tij, të krijohej përshtypja e një sundimi ushtarak dhe kudo vihej re një farë rregulli i tillë”*, theksonte *Ulmansky*.¹⁴ Marrëdhëniet e Esat Pashës me qeveritë e tjera nuk ishin aspak të mira. Po ashtu edhe popullsia vendase nuk ishte e kënaqur me qeverisjen e Esat Pashës, si pasojë e dhunës qeverisëse që ai ushtronte ndaj tyre.

Qeveria e Ismail Qemalit në Vlorë, në ndryshim nga qeveritë e tjera lokale shqiptare, ishte më e veçantë. Ajo konsiderohej si qeveria zyrtare e Shqipërisë dhe mbante lidhje diplomatike me qeveritë evropiane. Në të vërtetë, ndikimi i saj shtrihej vetëm në qytetin e Vlorës dhe në territoret e afërta të qytetit. Qeveria kishte xhandarmërinë e saj dhe, në ndryshim nga qeveritë e tjera lokale shqiptare, kishte krijuar edhe ushtrinë e saj. Krahasuar me qeveritë e tjera lokale, qeveria e Vlorës kishte të ardhurat më të mira, si pasojë e vjeljes së taksave portuale.

Megjithë veçantinë politike dhe mungesën e një qeverisjeje të centralizuar të vendit, çka shkaktonte probleme të shumta, në brendësi të vendit mbizotëronte një farë qetësie dhe rregulli dhe të huajt mund të udhëtonin pa probleme. Shërbimi postar si dhe ai telegrafik funksiononin në të gjithë vendin.

¹³ (B Arch R901/901, *Militärbericht Nr. 9*, „Ein Bericht über Albanien”, Wien 2. Februar 1914, *Deutsche Botschaft Wien, Büro des Militärattachés*).

¹⁴ B Arch R901/901, *Militärbericht Nr. 9*, „Ein Bericht über Albanien”.

Riorganizimi i marrëdhënieve politike në prag të ardhjes së Wied-it

Në mendimin e Fuqive të Mëdha, por edhe në atë të shumë intelektualëve dhe patriotëve shqiptarë në zë të kohës, Shqipëria mund të arrinte të sigurote ekzistencën e saj vetëm nën sundimin e një përfaqësuesi të huaj.¹⁵ Riorganizimi i marrëdhënieve politike do të përbënte edhe detyrën më të vështirë që do të kishte Wied-i, sapo të kishte formuar qeverinë e tij. Ndër kryetarët e qeverive lokale që u përmenden më sipër, Ismail Qemali dhe Esat Pasha ishin më të rëndësishmit. Këta ishin të vetmit që mund të bënin rezistencë ndaj Wied-it. Ismail Qemali bënte pjesë tek patriotët e sipërpërmendur shqiptarë që, në situatën e vështirë që po kalonte vendi, e shikonte të ardhmen e Shqipërisë të siguar vetëm nën tutelën e Fuqive të Mëdha dhe të një princi të huaj. Me Esat Pashën, puna qëndronte ndryshe. Ai e pranoi ardhjen e princ Wied-it, vetëm pas ndërhyrjes së Kontrollit Ndërkombëtar të Komisionit.

Si Ismail Qemali, ashtu edhe Esat Pasha trembeshin se mos Wied-i zgjidhte njerin apo tjetrin për t'u mbështetur pas tij, ç'ka edhe e shprehnin hapur. Për të mos u bërë pré e këtyre armiqësive, *Ulmansky*, e këshillonte Wied-in të zgjidhte ndërmjet dy mundësive. *E para*, të gjithë kryetarët e qeverive aktuale t'i emëronte si drejtues të administratës lokale të zonave që ata kishin nën administrim deri në momentin e ardhjes së tij në Shqipëri dhe, me ndihmën e tyre, të krijonte qeverinë e re. *E dyta*, që ishte dhe mundësia më e pranueshme për kushtet shqiptare, t'i emëronte këta persona në detyra të larta, por që të mos kishin ndikim mbi organizimin shtetëror. Kështu për shembull, Ismail Qemalin ta dërgonte si ambasador në Londër, ndërsa Esat Pashën ta titullonte komandant të oborrit të tij.¹⁶ Zgjidhja e *Ulmansky*-t ishte interesante, por gjithsesi shumë e varfër për shijet dhe ambiciet e Esat Pashës. Ngjarjet do të tregonin se ai nuk ishte i kënaqur me postin e ministrit dhe jo më të një komandanti oborri.

Organizimi ushtarak shqiptar në prag të ardhjes së Wied-it

Në prag të ardhjes së Wied-it në Shqipëri, siç u theksua edhe më sipër, vetëm qeveria e Vlorës kishte një forcë ushtarake, me një ministri lufte, si edhe një shtab madhor që drejtonte ushtrinë, e cila, gjithsesi, ishte në fazën e saj të formatimit. Megjithatë, në kuptimin e mirëfilltë të fjalës, kjo forcë ushtarake qëndronte nga pikëpamja organizative më pranë armës së xhandarmërisë sesa të një ushtrie. Ish oficeri i ushtrisë austro-hungareze, togeri *Leon De Ghilardi*, kishte ngritur në Vlorë një grup mitraljer, të përbërë nga mitralozë dhe një njësi këmbësorie, me rreth 300 burra.¹⁷

Vlerësuar në përgjithësi, në Shqipërinë e kësaj kohe, organizimi ushtarak përbëhej nga xhandarmëritë e qeverive lokale, ish anëtarët e ushtrisë turke dhe popullsia e aftë për mobilizim. Sipas *Ulmansky*-t, numri i përgjithshëm i xhandarëve të gjithë qeverive lokale së bashku, ishte rreth 2000 burra.¹⁸ Mosha e tyre shkonte deri në 40 vjeç. Ata ishin të armatosur me mauzerë të prodhimit turk, shumica e të cilëve ishin ruajtur që nga koha e shërbimit në ushtrinë turke. Por, ndërmjet tyre kishte diferenca shumë të mëdha në pikëpamje të stërvitjes, përgatitjes dhe perceptimit të tyre ndaj shërbimit. Për këtë arsye, kjo forcë xhandarmërie nuk mund të përdorej nga Wied-i si një forcë ushtarake e njehsuar.

¹⁵ Po aty.

¹⁶ B Arch R901/901, Militärbericht Nr. 9, „Ein Bericht über Albanien”.

¹⁷ Po aty.

¹⁸ Po aty.

Në sytë e *Ulmansky*-t edhe oficerët shqiptarë që kishin shërbyer në ushtrinë turke nuk duhej të merreshin në konsideratë nga *Wied*-i për krijimin e ushtrisë shqiptare. Ndër të tjera, ai raportonte se: “*Numri i ish oficerëve turq në Shqipëri (nënkupton oficerët shqiptarë që kishin shërbyer në ushtrinë turke-M.K.) duket të jetë tepër i vogël. Secili prej tyre, me të cilin unë pata rastin të bisedoj, më krijoi përshtypjen më të keqe të mundshme dhe unë besoj se përfshirja e tyre në ushtrinë e ardhshme shqiptare duhet të evitohet me çdo kusht*”.¹⁹

Ky konstatim, sado i ashpër në dukje, mund të konsiderohet, në një farë mase, i drejtë, nëse kemi parasysh se pjesa më e madhe e oficerëve dhe ushtarëve shqiptarë që kishin shërbyer në ushtrinë turke kishin kryer detyra të dorës së fundit. Madje, kjo gjë bëhej jo pa qëllim nga turqit, të cilët nuk u besonin ushtarëve shqiptarë dhe nuk i përfshinin ata në programet përgatitore e stërvitore, duke i lënë ata në prapavijë si roje, punëtorë, etj.

Gjashtë muaj mbretërim

Pasi *Wied*-i mori nga Fuqitë e Mëdha një paradhënie prej 10 milionë frangash, më 7 mars 1914, ai zbriti në Durrës, ku u prit me nderime të mëdha. Vetëm pas mbërritjes në Durrës, ai e kuptoi seriozitetin e situatës në të cilën gjendej. Fillimisht, ai duhej të zgjidhte tri detyra të rëndësishme, të cilat ishin organizimi i administratës, problemi i financave dhe çështja epirote.²⁰

Në postin e kryeministrit, ai zgjodhi 75-vjeçarin Turhan Pasha, një ministër dhe diplomat shqiptar në pension të Perandorisë Osmane. Kjo kandidaturë iu propozua atij prej Italisë dhe Austro-Hungarisë. Pasi u sigurua për lidhjen e pensionit të tij, Turhan Pasha e pranoi detyrën e ofruar. Ai ishte një politikan me përvojë, por, siç do ta tregonte edhe koha, i papërshtatshëm për këtë detyrë. Ai nuk kishte jetuar në Shqipëri dhe nuk e njihte realitetin e politikës shqiptare. Nëse jemi të prirë ta besojmë këtë vlerësim, në këtë situatë të vështirë dhe me probleme të shumta, përkrah *Wied*-it do të kishte qenë më i vlefshëm një person energjik dhe i vendosur sesa një politikan i tillë. Madje, ai nuk fliste e shkruante shqip.

Më tej, duhet të formoheshin ministrinë dhe administrata e tyre. Por edhe krijimi i xhandarmërisë, centralizimi i financave dhe njohja e vendit, qëndronin në agjendën ditore të princit. Që në ditët e para të qëndrimit në Durrës, *Wied*-i duhet ta ketë kuptuar që ai nuk mund të sundonte dot gjatë në këtë vend.

Kushtet dhe situata në të cilën Fuqitë e Mëdha vendosën të krijojnë Shqipërinë ishin shumë më të pafavorshme sesa në vendet e tjera të Ballkanit. Zhvillimi i vonuar social-ekonomik i vendit, niveli i lartë i analfabetizmit, larmia fetare, prania e elitës shqiptare të brumosur me mentalitet turk, mungesa e infrastrukturës dhe prapambetja e shoqërisë shqiptare, si edhe konfliktet e armatosura me vendet fqinje, e bënë të pamundur krijimin e kushteve normale nga qeveria e përkohshme.²¹

Në pamje të parë, pasi mori këstin e parë të ndihmës nga Fuqitë e Mëdha, u krijua përshtypja se *Wied*-i mund të fillonte punën për organizimin e shtetit të tij. Por, nëse i

¹⁹ Po aty.

²⁰ Karl THOPIA: Das Fürstentum Albanien. Eine Zeitgeschichtliche Studie. In: Ludwig von THALLOCY (Hrsg.): Illyrisch-albanische Forschungen, Band II., München und Leipzig 1916, f. 246-247.

²¹ SCHMIDT-NEKE: „Fürst Wilhelm von Albanien Faktoren, f. 220.

referohemi shtypit italian të kohës, shikojmë se *Wied*-i, nga shuma që mori prej Fuqive të Mëdha si paradhënie, rreth 800.000 i përdori menjëherë për të shlyer borxhet e tij të vjetra, rreth 1.5 milionë franga i harxhoi për ngritjen e oborrit të tij dhe, me pjesën e parave që i teproi, duhej të organizonte administratën civile dhe ushtarake.²²

Krijimi i xhandarmërisë

Në këto kushte, vështirësi të veçantë përbënte për *Wied*-in çështja e krijimit të xhandarmërisë dhe jo vetëm në këndvështrimin financiar. Problematik ishte edhe pozicioni dhe kompetencat e oficerëve holandezë. Fillimisht, ambasadorët e Fuqive të Mëdha në Londër ranë dakord që, për krijimin e xhandarmërisë shqiptare, duhej të punësoheshin oficerë suedezë, por pasi qeveria suedeze refuzoi ta merrte përsipër këtë detyrë, qeveria holandeze u shpreh e gatshme të dërgonte një mision ushtarak në Shqipëri, nën drejtimin e kolonelit e më vonë, gjeneralit *De Veer*. Sipas marrëveshjes, oficerët holandezë varehin nga komandanti i tyre holandez, i cili kishte varësi direkte nga princi.

Sapo Esat Pasha u emërua ministër i Brendshëm, ose siç i pëlqente atij të thirrej, ministër i Luftës, ai u ngatërrua në punët e oficerëve holandezë dhe filloi t' u jepte atyre urdhra. Në rregulloren që përcaktonte marrëdhëniet ligjore dhe shpërblimin e oficerëve dhe nënoficerëve holandezë në shërbim të xhandarmërisë shqiptare thuhej se komandanti holandez i xhandarmërisë varej drejtpërdrejt nga princi dhe Kontrolli Ndërkombëtar i Komisionit (KNK). Gjithsesi, kjo nuk ishte një varësi dyfishe, sepse kryesisht ai duhej të zbatonte urdhrat e princit. KNK-ja duhej vetëm të kontrollonte mënyrën e drejtimit të tij. (*Neni 2, paragrafi 2*) Në nenin 4 të kësaj rregulloreje parashikohej një kontratë dyvjeçare me të drejtë shtyrjeje për një vit. Pas kalimit të kësaj kohe, oficeri ose nënoficeri kishte të drejtë të largohej ose të qëndronte përfundimisht në shërbim të Shqipërisë.²³

Oficerët holandezë e kundërshtuan këtë veprim dhe kjo gjë shkaktoi edhe përplasjen e parë ndërmjet *De Veer*-it dhe Esat Pashës, madje në prani të *Wied*-it. Për të shmangur përplasjet e paevitueshme, *De Veer*-i e ngriti komandën e tij në Vlorë, gjë që e vështirësonte shumë punën për ngritjen e xhandarmërisë shqiptare. Po ashtu edhe në Shkodër, oficerët holandezë nuk ishin të mirëpritur. Koloneli anglez *Phillips* mendohej të forconte pozitat e tij në qytet, sa më shumë të ishte e mundur dhe prania e holandezëve e bezdiste atë.

Këto kontradikta e çuan *Wied*-in në përfundimin që milicia duhej të ngrihej e veçuar nga xhandarmëria, madje me instruktorë të tjerë të huaj. Në këtë pikë Esat Pasha shikonte edhe shansin e tij. Ai filloi të rezervonte dhe ruante gjithçka të nevojshme për milicinë, gjë që e vinte xhandarmërinë para vështirësive të mëdha.

Pra, që në fillim të sundimit të tij, *Wied* -it, i duhej të ballafaqohej me probleme nga më të ndryshmet dhe më elementaret. Shqiptarët prisnin që *Wied*-i me anë të një shkopi magjik dhe me energji gjermane të bënte evropianizimin e vendit brenda një kohë të shkurtër. Që në javët e para ata do të kuptonin se, përveç faktit se në Durrës ishte shtuar një rezidencë Princërore, për ta nuk kishte ndryshuar ndonjë gjë e madhe.

Për të vënë në funksion të plotë makinën e tij shtetërore, *Wied*-i duhej të zgjidhte edhe dy probleme të tjera emergjente. *Së pari*, ai duhej të zgjidhte sa më shpejt problemet në

²² B Arch R8034/III 489.

²³ B Arch R901/ 32622.

jug të vendit, me Greqinë. Kjo ishte e nevojshme, sepse sa më shpejt të zgjidhej kjo çështje, aq më shpejt mund të përqendrohej vëmendja në zgjidhjen e problemeve të brendshme. *Së dyti*, duhej të përgatitej sa më shpejt statuti, në mënyrë që regjimi i tij të vendosej mbi baza të shëndosha. Ky regjim duhej të mbështetej mbi një administratë të planëzuar.

Kryengritja kundër Wied-it

Nëse u referohemi burimeve arkivore dhe shtypit të huaj të kohës, në muajin maj 1914, në Shqipëri ekzistonin tri lëvizje kundër qeverisë së Wied-it. Përkrah lëvizjes antiqeveritare në Shqipërinë e Mesme u shfaqën edhe dy të tjera. Njëra nga këto lëvizje drejtohej nga njëfarë Arif Hikmeti. Ky ishte një shqiptar i lindur në Kumanovë, i cili kishte bërë karrierë si nëpunës në administratën turke. Si shumë të tjerë, edhe ai u kthye në Shqipëri, me shpresë se do të arrinte të siguronte ndonjë post në qeverinë e Wied-it. Arif Hikmeti, në ndryshim nga shumë kolegë të tjerë që nuk arritën të punësoheshin, nuk e kaloi kohën kot kafeneve e restoranteve të Durrësit, duke sharë qeverinë, por shkoi në brendësi të vendit për të propaganduar kundër Wied-it dhe pro ardhjes së një prej djemve të sulltan Abdyl Hamitit, në vend të tij.²⁴ Po ashtu, Arif Hikmeti bashkëpunoi ngushtë me Ahmet Zogun, prijësin e myslimanëve matjanë.

Lëvizja tjetër kundër Wied-it ishte një lëvizje fshatare, e cila shtrihej në zonën e Durrësit dhe Tiranës. Fshatarët e këtyre zonave u mblodhën të armatosur në Shijak. Sipas ministrit gjerman në Durrës, kur ata pyeteshin se përse ishin mbledhur, përgjigjeshin se po bënin revolucion.²⁵ Për arsyet e fillimit të këtij revolucioni, fshatarët kishin mendime të ndryshme. Një pjesë mendonin se revolucioni drejtohej kundër bejlerëve dhe agallarëve, si edhe kundër politikës ekonomike të qeverisë e cila, nëpërmjet masave të saj, favorizonte pashallarët dhe jo popullsinë e varfër.²⁶

Me përshkallëzimin e mëtejshëm të situatës, në fund të muajit maj 1914, kryengritësit kërkuan të negocionin me përfaqësuesit evropianë të atashuar në Durrës si dhe Komisionin Ndërkombëtar të Kontrollit. Në emër të kryengritësve foli shehu i Shijakut, Hamdi Rubjeka. Në emër të tyre, ai u ankua se “*feja myslimane nuk respektohej ashtu si duhet, dhe, si pasojë, kryengritësit duan të kthehen përsëri nën Turqinë*”.²⁷ Nëse kjo gjë nuk ishte e mundur, atëherë ata kërkonin që shtetet evropiane të kujdeseshin që feja myslimane të respektohej më shumë në Shqipëri.

Këto formulime të përgjithshme tregojnë se kryengritja nuk kishte thjesht një karakter fetar mysliman, por ushqehej politikisht nga prapavija e frontit. Për më tepër, nëse kemi parasysh nivelin arsimor të popullsisë shqiptare të kësaj kohe, nuk ishte e vështirë të bëje manipulimin e një shoqërie të përçarë fetare dhe analfabete. Është tepër e vështirë të besohet që fshatarët e Shqipërisë së Mesme kërkonin kthimin e tyre nën sundimin turk, për më tepër që ishin pikërisht ata që kishin vuajtur më shumë nën këtë sundim dhe që kishin luftuar për qindra vjet kundër Turqisë.

Fillimisht, në thelbin e saj, kryengritja e Shqipërisë së Mesme nuk mund të ishte gjë tjetër veçse një kryengritje apo revoltë agrare kundër kastës feudale sunduese të vendit,

²⁴ P A/AA, Diplomatiscche Agentur Durazzo, Aufstand im Mittelalbanien, Raporti Nr. 58, datë 18 maj 1914, f. 94.

²⁵ Po aty, f. 95.

²⁶ Po aty, f. 95.

si pasojë e mosmbajtjes së premtimeve që i kishte bërë kjo kastë (sidomos Esat Pasha) popullsisë fshatare për kryerjen e reformës agrare. Në një hap të dytë, kjo pakënaqësi u shfrytëzua politikisht nga gjithë armiqtë e *Wied*-it dhe të Shqipërisë.

Të parët që shpresonin të përfitonin nga kjo lëvizje ishin përkrahësit e xhonturqve. Duke shfrytëzuar besimin e thellë të fshatarësisë myslimane dhe duke propaganduar rrezikun që i kanosej fesë myslimane nga princi katolik, ata premtorin që Perandoria Osmane jo vetëm që do t'u dërgonte atyre një sundimtar mysliman, por do të plotësonte edhe të gjitha kërkesat e tyre.

Së dyti, Serbia, e cila nëpërmjet mbështetjes që i jepte lëvizjes kryengritëse të Arif Hikmetit²⁸ në Dibër, arriti me forcën e parave të ndikonte edhe në revoltën e Shqipërisë së Mesme, duke i bashkuar këto dy rryma.

Së treti, edhe Italia ishte e interesuar në këtë kryengritje dhe shumë shpejt bëri për vete kokat drejtuese të revoltës, duke i shfrytëzuar ata për qëllimet e saj. Synimi kryesor i Italisë ishte krijimi i një protektorati italian në Shqipëri. Duke qenë se shumica e popullsisë shqiptare ishte myslimane, Italia synonte që, nëpërmjet krijimit të protektoratit, fillimisht, në viset myslimane shqiptare, jo vetëm të balanconte ndikimin austriak të katolikët e veriut por, me kalimin e kohës, të zgjeronte kufijtë e këtij protektorati në gjithë territorin shqiptar. Esat Pasha konsiderohej nga Italia njeriu kyç që do të mundësonte arritjen e këtij synimi. Diplomati austriak *Carl Buchberger*, konstaton, me të drejtë, se zhvillimet në Shqipëri ishin pritur me një farë lehtësime nga qeveria italiane.²⁹ Pra, Fuqitë e Mëdha e kishin “shitur” tashmë *Wied*-in dhe përkeqësimi i situatës e përshpejtonte procesin e ndërkombehtarizimit të aparatit qeverisës shqiptar.

Së katërti, nëse marrim në konsideratë raportet sekrete të përfaqësuesit gjerman në Durrës, *Lucius*, arrijmë në përfundimin se edhe Greqia kishte dorë në organizimin e kësaj kryengritjeje. Ndër të tjera, ai raportonte në Berlin: “*Nuk përbën më asnjë dyshim që kryengritja stimulohet dhe mbështetet, në plan të parë, nga Greqia. Pavarësisht faktit se tashmë grekët bashkëpunojnë hapur me epirotët, edhe këtu unë kam zbuluar fakte të pakundërshtueshme që ministri dhe peshkopi grek punojnë pa pushim që ky vend (Shqipëria-M.K.) të mos bjerë asnjëherë në qetësi. Për të arritur këtë qëllim, ata kanë hedhur në qarkullim shuma të mëdha parash (...).*”³⁰

Në qendër të përplasjes së gjithë këtyre interesave qëndronte *Wied*-i. Ngjarjet e ndodhura së fundmi, e kishin dëmtuar imazhin e tij, si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Atij i mungonin trupa ushtarake për të luftuar kryengritjen brenda vendit, si dhe në jug të Shqipërisë kundër andartëve grekë. Pavarësisht ndërhyrjes energjike të KNK-së, u arrit vetëm një armëpushim dyjavor, kohë në të cilën nuk mund të shpresohej në asgjë më shumë sesa që *Wied*-i të përgatitej për mbrojtjen e Durrësit. Ndërkohë, qeveria mori vendimin për të shtypur rebelimin me forcën e armëve.

²⁷ THOPIA: Das Fürstentum Albanien. f. 269.

²⁸ Eqrem Bej Vlora e përshkruan Arif Hikmetin si përfaqësues të politikës së Turqve të Rinj në Shqipëri. Ai vinte nga radhët e Institutit gjuhësor «Aksaray Mahfili», i cili kishte dashur të fuste alfabetin turk për shkrimin e gjuhës shqipe. (Eqrem bej VLORA: Kujtime 1885-1925, Tiranë, botimi i tretë, f. 355).

²⁹ THOPIA: Das Fürstentum Albanien, f. 276.

³⁰ PA/AA, Diplomatische Agentur Durazzo, Aufstand im Mittelalbanien, Raporti Nr. 86, datë 30 Qershor 1914.

Planin për shtypjen e kryengritjes e hartoi nënkoloneli holandez *Thomson*. Sipas këtij plani, kryengritësit do të sulmoheshin, në të njëjtën kohë, nga tre drejtime. Në Durrës, qeveria kishte rreth 1100 burra nën armë, Preng Bib Doda ndodhej në Lezhë me rreth 4000 burra dhe Azis Bej Vrioni kishte mobilizuar në jug të vendit rreth 1000 toskë. Edhe Ahmet Zogu kishte premtuar të ndihmonte me 2000 matjanët e tij.

Me siguri që plani i hartuar nga qeveria mori dhënë dhe në mënyrë të papritur, rreth 3000 forca kryengritëse të mirëorganizuara dhe të drejtuara nga oficerë turq,³¹ sulmuan Durrësin nga tre drejtime të ndryshme. Që në fillim të luftimeve, mbeti i vrarë nënkoloneli *Thomson* i cili luftonte në këmbë për t'u dhënë zemër trupave të tij.

Pas vdekjes së *Thomson*-it, vendin e tij e zuri majori *Kroon* i cili, deri në këtë kohë, ishte në Shkodër. *Kroon* mori menjëherë masa për organizimin e një kundërsulmi ndaj kryengritësve. Ashtu si kolegu i tij, edhe *Kroon* e drejtoi vetë kundërsulmin. Në krye të forcave qeveritare ai arriti deri në gjysmën e lartësisë së kodrave që mbaheshin nga kryengritësit. Si pasojë e zjarrit të dendur të kryengritësve, forcat qeveritare e ndërprejnë kundërsulmin dhe duke mos iu bindur urdhrat të tij u tërhoqën.

Gjithsesi ky dështim nuk mund të konsiderohet si një mungesë karakteri dhe trimërie e malësorëve shqiptarë që luftonin për *Wied*-in. Gabimi ishte i oficerëve holandezë. Thuajse të gjithë ata nuk arritën të njihnin mentalitetin shqiptar. Në vija të përgjithshme, holandezët notonin mes dy rrymash mendimi, përse i përket perceptimit të tyre ndaj shqiptarëve. Njëra palë mendonte se në rastin e shqiptarëve, ata kishin të bënin me një popullsi të egër dhe të pacivilizuar, njësoj si në kolonitë holandeze. Ndërsa, pala tjetër shikonte te shqiptarët një popull të disiplinuar, luftarak dhe të gatshëm për të luftuar. Në këtë grup bënin pjesë edhe *Thomson*-i dhe *Kroon*-i. Duke pasur këtë perceptim të gabuar, ata u ngarkuan malësorëve detyra, të cilat mund të realizoheshin nga një trupë ushtarake e mirëfilltë dhe e stërvitur, por jo nga një grup malësorësh, të cilët njihnin si mënyrë luftimi vetëm organizimin e një prite në male dhe jo në fushë të hapur luftimi.³² Pra, ideja fillestare e *Thomson*-it për organizimin e një sulmi të përqendruar ishte po aq e gabuar ushtarakisht, sa edhe ajo e pasardhësit të tij, majorit *Kroon*.

Pas shpërthimit të kryengritjes në Shqipërinë e Mesme, humbi ndjeshmëria e Evropës Perëndimore ndaj çështjes së Epirit. Në Gjirokastër vazhdonte të qeveriste Zografi. Ndërmjet krahinës autonome të vetëshpallur dhe territoreve që zotëroheshin prej xhandarmërisë ishte krijuar një zonë neutrale dhe priteshin vendimet e Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit. Në zonën e Korçës, u shtuan sulmet e bandave greke. Në Shkodër, vazhdonte përplasja e myslimanëve dhe katolikëve, e italo-filëve me filo-austriakët, e kundërshtarëve të kolonelit *Philipp*s me përkrahësit e tij e kështu me radhë.

Përpjekjet e *Wied*-it për t'u rikthyer në Shqipëri

Pas fillimit të Luftës së Parë Botërore, *Wied*-i, të cilit kjo ngjarje i erdhi për shtat dhe në një farë mënyre, e shpëtoi nga telashet, vendosi më 3 shtator 1914 të largohej nga Shqipëria. Ai nuk hoqi dorë nga froni, por deklaroi se do të largohej vetëm përkohësisht nga vendi.

Pas kthimit të tij në Gjermani, ai i kërkoi kajzerit që të rimerrej si oficer aktiv në ushtrinë perandorake gjermane. "*Një princ gjerman që është i aftë për të luftuar, duhet të jetë*

³¹ THOPIA: Das Fürstentum Albanien, f. 273.

³² THOPIA: Das Fürstentum Albanien, f. 275.

pjesë e ushtrisë gjermane” do të shprehej *Wilhelm II* kur i paraqitën kërkesën e *Wied-it*.³³

Majori *à la suite Wied*, u dërgua si oficer shtabi në front, por pa marrë ndonjë post të caktuar, sepse me largimin nga ushtria ai ia kishte hequr vetes këtë të drejtë. Kajzeri e pranoi kërkesën e *Wied-it* për t’u rikthyer në ushtri, meqë me fillimin e luftës ishte shpallur mobilizimi i përgjithshëm, por nuk e riktheu atë si pjesë organike të ushtrisë. Për këtë arsye, *Wied-i* nuk përparoi më në gradë dhe në fund të luftës mbante përsëri të njëjtën gradë të majorit *à la suite*.

Ndoshta, ky ishte një dënim nga kajzeri për dështimin në Shqipëri dhe që nuk i dëgjoi këshillat e tij për të mos e pranuar fronin shqiptar. Edhe dërgimi i tij në front dhe jo diku tjetër, ku ishte i përshtatshëm shërbimi për një aristokrat të këtij niveli, do të thoshte që Gjermania nuk e njihte atë më si mbret të Shqipërisë.

Më 7 mars 1918, *Wied-i* iu drejtua me shkrim kajzerit, ku i lutej që ta lironte nga ushtria, me qëllim që t’i përkushtohet plotësisht kthimit të tij në Shqipëri. Për ta bërë sa më bindëse kërkesën, ndër të tjera ai shkruante: “*Unë i kam propozuar si Madhërisë suaj ashtu edhe qeverisë austro-hungareze që, nëpërmjet një thirrjeje drejtuar shqiptarëve për të rrokur armët kundër italianëve, jam në gjendje të ndihmoj frontin austro-hungarez në Shqipëri me një ushtri prej afro 50.000 burrash. (...) Bazuar në lajme, të sigurtat për vërtetësinë e tyre, që vijnë nga Shqipëria, pjesa më e madhe e shqiptarëve vazhdon të jetë besnike ndaj meje dhe pret me padurim kthimin tim*”.³⁴

Duke marrë shkas nga ngjarjet e brendshme në Shqipëri, qysh pas largimit të tij nga Shqipëria, *Wied-i* kishte filluar prej vitit 1915 të mendonte për një kthim të mundshëm në Shqipëri.³⁵ Më 24 shkurt 1915, pasi ishte ndërmarrë ofensiva e parë austro-hungareze ndaj Serbisë dhe me ndihmën e Gjermanisë po planëzohej një operacion i dytë, *Wied-i* i kishte kërkuar kajzerit që t’i jepte komandën e këtij operacioni. Fillimisht, ministria e Jashtme austro-hungareze e përshëndeti një nismë të tillë. Qeveria gjermane njoftoi *Wied-in* se, në këtë rast, ajo do të miratonte çdo vendim që do të merrte qeveria austriake.³⁶ Por, në fillim të marsit të vitit 1915, marrëdhëniet ndërmjet Austro-Hungarisë dhe Italisë u përkeqësuan së tepërmi, duke kaluar në konflikt të hapur. Si pasojë, nuk mund të ndërmerrej një ofensivë e dytë nga ushtria austro-hungareze kundër ushtrisë serbe. Kështu që kajzeri nuk e pa të arsyeshme ta komandonte *Wied-in* pranë ushtrisë austro-hungareze.³⁷ Gjithsesi, pasi në një kohë më të vonë u planëzua një ofensivë e përbashkët gjermane

³³ PA/AA, R 4299, f. 11.

³⁴ Po aty, f. 23.

³⁵ Ndër të tjera, në veprën e tij përkujtimore kushtuar Shqipërisë, *Wied-i* shkruan: “[...] *Udhëheqësit e dikurshëm të rebelëve më dërguan një telegram të përbashkët, në të cilin shkruanin se ishin të zhgënjyer nga Esati dhe duke më kërkuar falje kërkuan që të kthehem. [...] Diku nga mesi i muajit shkurt 1915, qeveria provizore thirri një Kongres në Elbasan, me qëllim këshillimin dhe marrjen e masave për situatën aktuale që po kalonte vendi. Aty u mor ky vendim: “Duke pasur parasysh vështirësitë e mëdha që paraqiten për emërimin e një Princi nga familja perandorake otomane si Princ i Shqipërisë, Asambleja Kombëtare, duke marrë edhe miratimin e qeverisë otomane vendosi që të pranojë një Princ jo mysliman me kushtin që, Princi duhet të jetë pa diskutim gjerman. Ajo vendosi që, nëse Gjermania është dakord, ti lutet Princit Wilhelm (Wiedit –M.K) të pranojë edhe njëherë kurorën shqiptare”. (WIED: Denkschrift über Albanien, f. 33-34).*

³⁶ WIED: Denkschrift ber Albanien, f. 38.

³⁷ Po aty, f. 38.

dhe austro-hungareze, qeveria e Monarkisë së Danubit nuk e shikonte më të arsyeshme praninë e *Wied-it* në këtë operacion. Ajo tashmë zotëronte pjesën më të madhe të territorit shqiptar dhe nuk i duhej më *Wied-i* për të përfaqësuar dhe mbrojtur interesat e saj në Shqipëri.

Duke mos hequr dorë nga kthimi i tij, në vitin 1920, *Wied-i* hyri në bisedime dhe me Serbinë. Ai arriti të merrte miratimin e saj për t'u rikthyer në Shqipëri.³⁸ Gjithsesi, në planin e tij të rikthimit, paraqiste një problem serioz mungesa e financave. Madje, ai u shpreh i gatshëm që të jepte hua (me konçension) pasuritë e nëntokës shqiptare, mjafton që të siguronte paratë që i nevojiteshin.³⁹

Përfundime

Periudha e qeverisjes së *Wied-it* në Shqipëri, nga 7 marsi deri më 3 shtator 1914, është një periudhë e ngjeshur me kontradikta politike dhe ushtarake si të jashtme, ashtu edhe të brendshme. Konfliktet e brendshme buronin nga larmia fetare e popullsisë shqiptare, politikat personale të figurave politike dhe zgjedhja që iu diktua Shqipërisë, nëpërmjet vendosjes së një pushteti ksenokrat. Rivalitetet dhe interesat e ndryshme të Fuqive të Mëdha gjatë Konferencës së Ambasadorëve, para së gjithash të Austro-Hungarisë dhe Italisë, e kthyen Shqipërinë në një “kukull loje”. Këtë gjë e dëshmon edhe përzgjedhja e një figure të panjohur gjermane, siç ishte *Wied-i*. Në këto gjashtë muaj mbretërim, dolën në pah rivalitetet ndërmjet Austrisë dhe Italisë. Për të dyja palët, kontrolli i bregdetit shqiptar kishte një rëndësi strategjike. Edhe veprimtaria që ushtronte Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit (KNK) mund të konsiderohet si një pushtet paralel i Fuqive të Mëdha, përkrah sundimit të *Wied-it*.

Që në fillim të ardhjes së *Wied-it*, ra në sy mungesa e përvojës së tij shtetdrejtuese, por edhe kabineti i tij ishte pa përvojë. Por arsyet e dështimit të këtij eksperimenti në Shqipëri janë më komplekse. Në vija të përgjithshme, këto arsye bazoheshin në neglizhencën dhe qëndrimin pasiv të *Wied-it*, në paaftësinë e zyrtarëve shqiptarë për të drejtuar në pozicione kryesore dhe në rivalitetet e shumta. Siç u theksua më sipër, përse i përket *Wied-it*, duhet të merret në konsideratë se ai ishte i pamësuar me një ambient të tillë dhe, po ashtu, ishte i përgatitur pak për këtë detyrë. Atij i mungonte edhe aftësia vendimmarrëse dhe guximi për të urdhëruar, si edhe aftësia për të kontrolluar zbatimin e urdhrave të tij. Kjo është pak e çuditshme, sepse si oficer karriere prusian, të paktën procesi i vendimmarrjes dhe i kontrollit duhet të zotërohej prej tij, pavarësisht cilësisë së vendimeve. Si pasojë, vendimet që duheshin marrë në mënyrë të shpejtë zvarriteshin për ditë me radhë dhe shpesh ishte pikërisht vonesa kohore që bëhej shkak për dështimin e radhës. Paaftësia e administratës bazohej në mentalitetin turk të kryerjes së detyrës. Largimi i Esat Pashës nga kabineti u hapi rrugë edhe shqiptarëve të tjerë të përgatitur, si p.sh. Filip Nogës, nga i cili mund të priteshin punë cilësore dhe serioze. Pavarësisht aftësive dhe seriozitetit, shumica e kolegëve të tyre i përkisnin shkollës turke dhe me ta

³⁸ PA/AA, R 4299, f. 41.

³⁹ Ishte paksa paradoksale për zhvillimin e artit në Shqipërinë e këtyre viteve, por, *Wied-i* hyri në bisedime edhe me një shoqëri amerikane, ku përkundrejt një huaje prej 10 milionë dollarësh ai do t'i garantonte kësaj firme monopolin e ndërtimit të kinemave dhe xhirimit të filmave në Shqipëri. Po ashtu kundrejt një pagese të caktuar, *Wied-i* u shpreh i gatshëm të shpërndante edhe disa tituj aristokracie në oborin e tij.(PA/AA, R 4299, f. 41).

nuk mund të ngrihej një administratë e fortë perëndimore. Si pasojë, mbledhja i linte vendin mbledhjes, secili ministër bënte çdo gjë dhe asnjëri prej tyre nuk bënte diçka për të qenë.

Paaftësia e theksuar e ministrave dhe kontradiktat ndërmjet atyre myslimanë dhe katolikë mund të shmangeshin, duke krijuar një kabinet të vogël dhe të përbërë nga personalitete të padiskutueshme. Qendrën e rëndësës së këtyre ministrave duhej ta formonin departamentet, të cilat mundësisht duhej të drejtoheshin nga evropianë. Në fakt, kjo gjë ishte e parashikuar në statut, por ai duhej të hynte në fuqi sa më shpejt, në mënyrë që të fitohej më së fundmi një bazë e shkruar për të drejtuar shtetin. Rivaliteti ndërmjet holandezëve dhe Esat Pashës mori fund me largimin e këtij të fundit. Edhe mosmarrëveshjet ndërmjet gjeneralit *De Veer* dhe kolonelit *Thomson* u shuan. Pra, tashmë holandezët nuk kishin më asnjë justifikim për të mbuluar dështimin e tyre.

Së fundmi, rivaliteti *Löwenthal-Aliotti*, konkretisht Austri-Itali; kontradiktat ndërmjet Aleancës Trefishe dhe Antantës shfaqeshin dukshëm dhe në mënyrë të pajustificueshme në punën e KNK-së. Anëtarët e këtij komisioni nuk ndiheshin si përfaqësues të një komisioni ndërkombëtar, me një mandat nga Konferenca e Londrës, në të cilën të gjitha shtetet pjesëmarrëse kishin rënë në konsensus për të ardhmen e Shqipërisë. Sidomos përfaqësuesi rus dhe ai francez ndiqnin një politikë speciale të qeverive të tyre.

Gabimi më i madh që bëri *Wied*-i ishte largësia që ai mbajti nga populli, i cili në fillim, shpresoi aq shumë prej tij. Rregullat, veset, mënyra e sjelljes së tij dhe organizimi i jetës në pallat ishte i përsosur, si për ndonjë oborr të vjetër aristokrat në Evropë. Por, kjo mënyrë sjelljeje, tepër ceremoniale ndaj një populli analfabet dhe me një nivel të ulët kulturor, bëri që simpatia ndaj të tij të bjerë shumë shpejt. Me përjashtim të disa udhëtimeve të tij të shkurtra në Tiranë, Vlorë dhe Kavajë, ai thuajse nuk doli asnjëherë para popullit të tij. Shqiptarët si edhe osmanët, ishin popull që impresionoheshin shumë nga pamja e jashtme dhe kjo gjë iu mungoi atyre.

Pavarësisht përpjekjeve të *Wied*-it për t'u rikthyer, kohët dhe interesat e Fuqive të Mëdha kishin ndryshuar. Edhe përvoja gjashtëmujore e *Wied*-it në Shqipëri kishte treguar se problemi shqiptar nuk mund të zgjidhej në këtë mënyrë. Princ *Wied*-i ishte monarku i parë që humbi fronin, si pasojë e ndryshimeve që solli Lufta e Parë Botërore. Pas luftës, *Wied*-i jetoi fillimisht në *Bavari* dhe *Shlesien*, në Gjermani e më pas në një pronë të tij në Moldavinë rumune. Në vitin 1944, kur Ushtria e Kuqe hyri në Rumani, *Wied*-i, ndërkohë i mbetur i vë, së bashku me vajzën e tij, u strehua në pallatin veror të mbretit të Rumanisë në Karpate, ku edhe vdiq, tre javë para se të mbaronte Lufta e Dytë Botërore. Varri i tij u zbulua në vitin 1991 në kishën luteriane të Bukureshtit, pas rënies së pushtetit komunist. Gjatë diktaturës komuniste, arkivoli i tij ishte fshehur nën një mbulesë prej druri.

Bibliografia:

Fonde arkivore:

- B Arch R901/ 32622.
- B Arch R8034/III 489.
- B Arch R901/901, *Militärbericht Nr. 9*, „*Ein Bericht über Albanien*“, Wien 2. Februar 1914, *Deutsche Botschaft Wien, Büro des Militärattachés*.
- PA/AA, R 4299.
- PA/AA, Diplomatische Agentur Durazzo, Aufstand im Mittelalbanien, Raporti Nr. 58, datë 18 maj 1914.

- PA/AA, Diplomatiska Agentur Durazzo, Aufstand im Mittelalbanien, Raporti Nr. 86, datë 30 Qershor 1914.

Literaturë:

- Eqrem bej VLORA: Kujtime 1885-1925, botimi i tretë, Tiranë 2008.
- Ferdinand SCHEVILL: Ballkani. Historia dhe qytetërimi, Tiranë 2002.
- Georges CASTELLAN: Histori e Ballkanit, Çabej, Tiranë 1991.
- Kaiser WILHELM II: Ereignisse und Gestalten, Leipzig 1922.
- Karl THOPIA: Das Fürstentum Albanien. Eine Zeitgeschichtliche Studie. In: Ludwig von THALLOCHY (Hrsg.): Illyrisch-albanische Forschungen, Band II., München und Leipzig 1916.
- Schmidt-Neke, Michael (1991): „Fürst Wilhelm von Albanien Faktoren”. In: *Aspekte der Albanologie* 18, (Akten des Kongresses „Stand und Aufgaben der Albanologie heute”, 3.-5. Oktober 1988, Universität zu Köln, Herausgegeben von Walter Brey, Rolf Ködderitzsch und Hans-Jürgen Sasse), f. 203–221.
- Wilhelm, Fürst von Albanien, Prinz zu Wied: Denkschrift über Albanien, (nicht veröffentlichte Manuskript), 1917.

Aspekte të Betejës së Lumës

(Vlerësuar edhe në dritën e arkivit austro-hungarez)

Kolonel (R) Sali Onuzi

Trajtesë e shkurtuar. *Beteja e Lumës është zhvilluar nga 15-18 nëntor 1912. Forcat serbe, pas pushtimit të Prizrenit, nisën për në Adriatik dy kolona, ndërkohë që krijuan dhe hodhën në veprim "Grupimin e Lumës", për ta nënshtruar atë (me djegie shtëpish dhe mbledhje armësh) me objektiv daljen në Dibër, për të siguruar kështu krahun verilindor të pushtimit të bregdetit të Adratikut nga ana e tyre. Lumjanët dhe pjesa veriore e Dibrës (Rec e Dardhë) zunë qafën e Kolesjanit dhe prej aty i sulmuan forcat serbe, i thyen dhe i ndoqën nga Kulla e Lumës deri në portat e Prizrenit. Për numrin e forcave serbe pjesëmarrëse dhe të të vrarëve të tyre ka pasur, në shumë nga botimet e mëparshme, shifra të fryra, ashtu si dhe për pllakat e lapidarëve të ngritur për të (12 mijë, 16 mijë apo 18 mijë të vrarë).*

Më 2012, me botimin e dokumenteve austro-hungareze të vitit 1912, për Shqipërinë nga Instituti i Historisë i Akademisë sonë të Shkencave, dolën në dritë edhe dy telegrame të konsullit Prochaska nga Prizreni për Vjenën. Mbështetja në të dhënat e tij dhe në vlerësimet që i bën Betejës së Lumës, del se në Lumë kanë vepruar asokohe 6 batalione (6500 ushtarë serbë). Shkrimi sugjeron një tjetër skemë të vendosjes së forcave serbe dhe, krahasuar edhe me dokumente të tjera, një shifër më realiste të numrit të të vrarëve serbë në këtë betejë (2000-3000). Tërheqja mjeshërërore nga lumjanët dhe rënia në kurth e forcave serbe, goditja në befasi, terreni dhe moti shumë i keq, i bëjnë të besueshme njoftimet që jepen nga disa dokumente të kohës për humbje të mëdha të serbëve. Në shkrim argumentohet se kjo luftë ishte një betejë me të gjitha karakteristikat e saj, nga sasia e forcave, koha e zgjatjes, shtrirja territoriale, përfundimi dhe rezultatet e saj.

Beteja e Lumës është beteja e fundit e shqiptarëve kundër ushtrisë serbe për vitin 1912 dhe e fundit si betejë që është zhvilluar në Lumë. Populli e ka përjetuar atë emocionalisht, prandaj dhe i ka ngritur këngë e lapidarë. Folklori e ka bërë mirë punën e tij, por shkrimi kërkon që historiografia të shkruhet bazuar në fakte, duke mënjanuar folklorizmin. Shkrimi tregon se cili ishte konsulli austro-hungarez Oskar Prochaska dhe propozon që bëmat e këtij diplomati trim të nderohen nga institucionet tona dhe historia jonë.

Gjendja e palëve. Një muaj para Betejës së Lumës kishte shpërthyer Lufta I Ballkanike midis aleatëve dhe Turqisë. Ushtria serbe kishte pushtuar Kosovën deri në Shkup. Prizreni u pushtua më 30 tetor. Armata e tretë e saj, veç dy kolonave që nisi për të dalë në Mjedë e në Lezhë, kishte përgatitur forca të divizionit

“Shumadija I” për të hyrë në Lumë. Sipas *Giani Baj Macarios*¹, historian italian, që ka shfrytëzuar arkivat e shtabit të përgjithshëm serb, këmbësoria serbe kishte pushkë nga më të mirat e kohës, tip “mauzer”, model 1899 (me 2000 m largësinë e hedhjes së plumbit, çdo ushtar kishte 150 fishekë) dhe mitralozë “Maksim”. Edhe artileria ishte moderne, e tipit “Shnajder”, shumica e modelit 75 mm, e vitit 1907 (43 bateri) plus 9 bateri me qitje të shpejtë “Shnajder-cruesot” dhe 54 topa malorë “*de bange*”. Divizioni “Shumadija I”, me një efektiv 35 mijë vetë, (aq sa popullsia e gjithë Lumës) kishte 36 topa, mjaft nga të cilët do t’i përdorte në Lumë. Ky divizion përbëhej nga ushtarë të thirrjes së parë (21-31 vjeç)², deviza e të cilëve ishte “të shfarosim shqiptarët”. Aleati i Serbisë, Mali i Zi, ndërkohë kishte pushtuar Pejën e Gjakovën dhe kishte rrethuar Shkodrën.

Shqiptarët në Kosovë, që me fillimin e luftës ballkanike, mbetën vetëm, ballë për ballë me ushtrinë serbe, ngaqë ushtria osmane, befasisht u tërhoq nga kufiri drejt qendrës së gadishullit në Kumanovë e Manastir. Komanda e saj nuk u dha shqiptarëve të Kosovës as pushkët (63000) që iu kishte premtuar³. Në këtë pësjellim që u krijua, shqiptarët e Kosovës, më gjithë qëndresën që bënë, nuk arritën të ndalin agresorët, të cilët depërtuan edhe grykën e Cërnavës, prej nga hynë në Prizren. “Po atë ditë (datë 27 tetor, shënimi im), erdhi këtu (në Prizren, shënimi im) Baftjar Pasha me tre batalione dhe katër topa mali. Në vend që të nisej për në Levën e Zezë, u nis për në perëndim, qëndroi disa ditë në Hocë dhe, nëpërmjet Lumës, shkoi në Dibër.”-raportonte, më 13 nëntor, konsulli austro-hungarez *Prochaska* për Vienën. Më tej: “Gjendja e ushtrisë (osmane) e keqe, e papërgatitur për luftë në dimër, vështirësi për mbajtjen e lëndëve ushqimore, madje ushtarët që kanë mbetur në Prizren, për shumë ditë janë pa bukë dhe po lypin derë më derë...Në ushtri “se njeh qeni të zotin”⁴.

Forcat shqiptare të krahinës së Lumës, pas qëndresës në qafë të Duhles, qenë tërhequr brenda krahinës së vet. Për efektivin e tyre janë dhënë shifra të ndryshme: 4000 vetë, Sh. Braha⁵ shënon mbi 2000, Sh. Hoxha⁶ aq sa jep edhe “Historia e Popullit Shqiptar”, botim i vitit 2002⁷ dhe historiografia ushtarake jugosllave⁸.

Nisur nga popullsia e krahinës, (2820 shtëpi), na duket se shifra më afër realitetit është 3000 vetë në Qafën e Kolesjanit⁹ plus 1000 vetë të çetave të fshatrave të Rrafshës së Lumës, të Tërthores e të Zhurit, etj., plus edhe afro 1000 vetë të batalionit të Dibrës, që erdhën pas fillimit të luftës, bëjnë rreth 5000 trupa gjithsej. Nga të gjitha burimet del se

¹ Macario, Giani Baj: “Balkani 1912-1913 . Studio politico e militare col concorso degli stati maggiori Jugoslavo e Bulgaro). “La Prova”,Milano 1937.f.128.

² Rankin, Reginald, Lt.Colonel. The inner history of the Balkan war, New York, 1914.f. 553.

³ Macario, Giani Baj, vepër e cituar, f. 121.

⁴ -” Shqipëria në dokumentet austro-hungareze. (1912) vëllimi VI (nëntor-dhjetor)” Tiranë 2012. Botim i Institutit të Historisë, f 340 ISBN 978-9928-141-04-0.

⁵ Braha, Shaban, “Beteja e Drinit kundër agresionit serb”, Prizren. 2000 “Kosova”f. .62.

⁶ Hoxha, Shefqet:”Lufta e Lumës kundër pushtuesit serb, 9 nëntor-6dhjetor 1912, “Kumtesë e mbajtur në sesionin përkujtimor, me rastion e 100 vjetorit, organizuar nga Bashkia e Kukësit.)

⁷ Historia e Popullit shqiptar, v. II, Instituti i Historisë, Tiranë 2002, f. 507, .ISBN99927-623-1.

⁸ Ratkovic,Branislav “ Prvi balkanski rat 1912-1913”.v. i dytë. Beograd 1975.f. 262.

Nisur nga popullsia e krahinës, (2820 shtëpi), na duket se shifra më afër realitetit është 3000 vetë në Qafën e Kolesjanit¹) plus 1000 vetë të çetave të fshatrave të Rrafshës së Lumës, të Tërthores e të Zhurit, etj., plus edhe afro 1000 vetë të batalionit të Dibrës që erdhën pas fillimit të luftës, bëjnë rreth 5000 trupa gjithsej. Nga të gjitha burimet, del se forcat shqiptare ishin më të pakta në numër se ato serbe.

forcat shqiptare ishin më të pakta në numër se ato serbe. Por duhet vlerësuar cilësia e tyre: ato ishin forca të afta luftarake, jo vetëm pse kishin shërbyer e luftuar rregullisht si nizamë e si redifë në ushtrinë osmane, por edhe sepse trashëgonin, brez pas brezi, e zhvillonin atë, që *John Keegan* e quan “kultura e luftës”. Shfrytëzimi me mjeshtëri të jashtëzakonshme i terrenit, në një teatër luftimi nga Gryka e Kaçanikut në Grykë të Cernalevës, në Qafë të Duhles, në Qafë të Zhurit dhe, së fundi, në maratonën e tyre, në Qafën e Kolesjanit, në një mbrojtje shkallë-shkallë, në prita, me sulm të befasishëm e deri në luftim trup me trup, etj., përbënte artin e kësaj kulture të të luftuarit. Nuk kishin munguar të luftonin me Dervish Pashën, në mbrojtje të Lidhjes së Prizrenit dhe kishin thyer, për herë të parë, që nga s’mbahej mend në trojet shqiptare, forcat e ushtrisë osmane, më 1909, duke iu dhënë shpirt e krahë kryengritjeve të mëdha të viteve 1910, 1911 dhe 1912.

Në nëntor 1912, shqiptarët e Lumës do ta përsërisnin këtë edhe ndaj forcave të ushtrisë serbe, që kish një muaj që vetëm fitonte në teatrin e Ballkanit. Për herë të parë ajo do të rrethohej e për herë të parë, do të thyhej në Lumë. Së dyti, do të turpërohej në Shkodër. Në Lumë mbrohej edhe Shkodra edhe Vlora. Në veprën e tij, profesor Qamil Hoxha ka sjellë¹⁰ kujtimet e Shaqir Agës nga Petkaj, i cili në moshën 94 vjeçare më 1977 tregonte se, duke qenë xhandar në Shkodër në nëntor 1912, Hasan Riza Pasha dhe Esat Pasha e kishin nisur me dy besnikë të tij me një letër për Islam Spahinë dhe Suf Xhelilin. Ai e solli letrën në destinacion dhe tregonte se pas asaj letre filloi lufta në Qafë të Kolesjanit. Pas Luftës së Lumës, Serbia nuk i kaloi më forcat e saj për Shkodër nga drejtimi VL i Shqipërisë. Pati sjellë nga Selaniku me anije në Shëngjin 15 mijë trupa, duke e çuar në 30 mijë numrin e forcave serbe në rrethimin e Shkodrës. (Ia aty 10 mijë të vrarë e të plagosur).

Në teatrin e veprimeve luftarake të Lumës do të bashkëvepronin edhe forca të krahinës së Reçit e të Dardhës së Dibrës, nën drejtimin e Elez Isufit, që ishin mobilizuar ato ditë në regjimentin e Dibrës, pas informacionit për hyrjen e trupave serbe në Lumë dhe qenë kthyer rrugës për në Shkodër¹¹. Një batalion arriti dhe mori pjesë në mbrojtjen e Shkodrës, kurse pjesa tjetër e ndarë, arriti në qafë të Kolesjanit, pasi kishte filluar lufta. Por forcat e qëndresës në Lumë kishin edhe pikën e dobët të tyre: një armatim të pakët e të vjetëruar, në “gjashtë vetë a kishte njeni pushkë a jo, luftonin me kosa, sakica, etj.”... prisnin të vritej një serb e t’i merrnin pushkën”¹².

Sipas dokumenteve osmane, lumjanët, brenda 24 orëve të para të luftës, u zunë serbëve rreth 1000 pushkë. Forcat dibrane sollën në qafë të Kolesjanit edhe dy topa e 17 gjyle, që ua kishin zënë forcave osmane në tërheqje, fakt që e konfirmojnë edhe arkivat serbe¹³.

⁹Konsulli Prochaska në telegramin e tij të datës 13 nëntor shkruan se “ më 21 tetor ...”4000 lumjanë dhe vullnetare të këtushëm, së bashku me të paktën 1000 burra, u nisën që këtu (nga Prizreni për në Cernalevë S.O)Pra janë 3000 lumjane, një forcë krahinore e organizuar ushtarakisht dhe e lëvizshme që lufton edhe jashtë krahinës së saj.

¹⁰ Hoxha, Qamil: “Jeta dhe vepra ime, “Geer”, Tiranë 2008, f. 381.

¹¹ Nosi. Lef :Dokumenta historike për t’i shërbyer historisë tonë kombëtare, 1912-1918. Botim II. Instituti i Historisë.Tiranë,2007, f .26, ISBN:978-99956-10-04-3. (Në një telegram dërguar më 19 nëntor 1912 nga Dibra, valiut dhe komandantit osman në Elbasan: “Vullnetarët që do të plotësojshin fuqinë e regjimentit të formuem në Dibër, u ndanë, edhe pasi u kthyen prapë në vendt, ndën komandën e të parit tyne, Elez Jusufit, u turrën drejt Lumës. Atje po luftojnë sot e po u bëjnë ball sërbeve...”).

¹² Hoxha, Shefqet : Luma në luftrat për liri. “Geer”. Tiranë, 2002,f. 202-203.ISBN:9927-767-9-X.

¹³ Ratkovic, Borisllav, vepër e cituar, f. .262.

Për numrin e efektivit të ushtarëve serbë që kanë vepruar e luftuar në Lumë në nëntor 1912 janë shprehur mendime të ndryshme dhe kontradiktore. Disa studiues, duke dashur të “argumentojnë” numrin e 12 mijë serbëve të vrarë (disa thonë edhe 18 mijë), kanë llogaritur dhe vendosur *a priori* shifrën 16000 për ushtarët serbë që kishin arritur në Bicaj në mes të nëntorit 1912¹⁴. Shifra prej 16000 ushtarësh, në fakt, është sasia e dy grupimeve që krijoi armata e tretë serbe, nga forca të divizionit “Drina II” dhe ‘Shumadija I’ të cilët, rrugës për të dalë në Adriatik, kaluan në krahun e djathtë të Drinit të Bardhë. Këto grupime nuk kanë zhvilluar betejë e luftime si ato të datës 15-17 dhe 18 nëntor në Lumë, përjashtuar ndonjë ndeshje të vogël. Ata nxitonin për të dalë në Adriatik, për të kapur sa më shpejt Lezhën dhe Durrësin, sipas urdhrin të kryeministrit serb.

Konsulli austro-hungarez *Prochaska*, më 13 nëntor shkruante nga Prizreni për Vienën: “Thuhet se ushtria serbe këtu do të shkojë në Shëngjin. Ushtarët, (duhet të jetë fjala për ushtarët osmanë të Xhavit Pashës, që u tërhoqën nga Gjakova më 4 nëntor pa luftuar, shënim im) të cilët, më 5 të këtij muaji, ishin nisur për në Lumë, më 7 të këtij muaji u kthyen nga Dibra e Madhe. Më 8 filloi të shkrijë bora dhe ushtarët u nisën përsëri. Deri tani kanë shkuar 12 batalione dhe pak kavaleri. Deri dje, kur ata hynë në Bicaj, nuk hasën në kundërshtim. Malësorët katolikë u dorëzuan me këshillën e Preng Bib Dodës. Serbët fituan sepse nuk kishte kush t’i kundërshtonte”¹⁵.

Kjo nuk do të thotë se 12 batalionet kishin hyrë në Bicaj. Këto batalione kanë filluar të dalin nga Prizreni që nga data 9 nëntor. Ata janë nisur në dy drejtime, njëri për Mirditë (që kaloi në krahun e djathtë të Drinit të Bardhë dhe te Ura e Vezirit e që përbëhej nga 6 batalione (B. Ratkovic), dhe pjesa tjetër për në Lumë. Kur *Prochaska* shkruan “nuk hasën në kundërshtim” e ka fjalën për të dy drejtimet, si atë të Lumës dhe për grupimin e Adriatikut. Ushtarët e të dy drejtimeve ishin të divizionit “Shumadija I”, të bazuar në Prizren. Në Gjakovë ishte bazuar divizioni “Drina II”.

Nga këto 12, 6 batalione të tjerë duhet të kenë bërë pjesë në “Grupimin e Lumës”, ndryshe ç’ka thënë historiografia jugosllave për 3 batalione: një batalion në vijë të parë, në Bicaj, një tjetër në krahun e djathtë të përroit të Shejës dhe një i tretë pa e kaluar lumin Luma¹⁶ (Këto kanë qenë batalioni 2, 3 dhe 4 të R.10, plus tre batalione të tjerë që historiografia jugosllave, sipas *Prochaskës* dhe nesh, i ka fshehur, shënimi im). Mendojmë se të gjashtë batalionet janë vendosur në territorin e Lumës. Pra, një regjiment e gjysmë, si grupim i veçantë (“grupimi i Lumës”), në tri ditë kohë, në një gjatësi prej 35 km. Kemi të drejtë të themi se lufta dhe fitorja mbi to ishin betejë dhe jo thjesht një ose disa luftime. Dhe betejat e marrin emrin nga vendi ku zhvillohen, prandaj ajo me të drejtë përgjithësisht është quajtur “Beteja e Lumës”¹⁷ Në disa botime është quajtur “luftë”, por me kuptimin betejë, siç edhe përdoret në historiografinë shqiptare ky term. Ndërsa termi “Beteja e Drinit”, përdorur nga Shaban Braha, etj., shpreh një zgjerim, ashtu si termi “Beteja e Kolesjanit”, shpreh një zvogëlim, përdorur nga Vangjel Kasapi, Haziz Bulica dhe Sami Ferizaj¹⁸ Në Kolesjan dhe në dy krahët anash tij filloi sulmi i befasishëm

¹⁴ Mataj, Qemal.: Vepër e cituar, f. 12/Braha, Shaban, vepër e cituar.

¹⁵ Shqipëria në dokumentet austro-hungareze (1912) vëllimi VI (nëntor-dhjetor). Botimet “Toena”, Tiranë, 2012, f. 340 ISBN :978-9928-141-04-0.

¹⁶ Ratkovic, Borisllav, vepër e cituar, f. 261-262

¹⁷ Hoxha, Shefqet, Fjalori Enciklopedik Shqiptar, Akademia Shkencave, Tiranë, 2008, f. 228.

¹⁸ Ferizaj, Sami, Kumtesë e botuar në “Elez Isufi, Kreshnik i Dibrës”, M. Murra, T. 1996 etj. f. 28.

i lumjanëve, por beteja u zhvillua në të gjithë territorin, nga Kolesjani në Bicaj, Kulla e Lumës, Zhur, Curr, etj. (shih telegramin e konsullit *Prochaska*).

Kjo do të thotë se skema e historiografisë serbe duhet rivlerësuar dhe studiuar sipas të dhënave të reja që jep arkivi austro-hungarez dhe konsulli *Prochaska*, duke ndërtuar një skemë tjetër, duke mbajtur parasysh numrin e 6 batalioneve, terrenin, kohën dhe intensitetin e veprimeve luftarake. Dhe konkretisht:

Në Bicaj duhet të jenë vendosur dy batalione këmbësore (njëri që ka sulmuar drejt qafës së Kolesjanit dhe tjetri që ka mbrojtur shpinën e tij). Në krahun e djathtë të përroit të Shejës një batalion tjetër që ka mbuluar sulmet nga krahu perëndimor i Gjallicës.

Një batalion i katërt mund të ketë kaluar lumin Luma dhe të jetë futur në luftim në fazën e dytë të Betejës, në Rrafshin e Lumës, nga Zborri i Nangëve në Bugajë, deri në Kullën e Lumës. (Bëhen kështu nga qafa e Kolesjanit në Kullë të Lumës 4 batalione serbe, shënimi im)

Dy batalione të tjerë mund të jenë mbajtur për kontrollin dhe sigurimin e rrugës Prizren-Kulla e Lumës (Përbreg) dhe mbrojtjen e tërheqjes. *Prochaska* shënon se kjo luftë e ashpër është zhvilluar edhe në Zhur e Curr, afër Prizrenit. Kjo skemë mund të ketë edhe variante të tjera.

Kështu informacioni që i ka dhënë Ahmet Zogu Aqif Pashë Elbasanit e ky kryesisë së Qeverisë së Vlorës, se në Lumë “kanë vramë afro gjashtë batalione serbe”, flet për 6 batalione që janë përfshirë në këtë luftë (pavarësisht nga shkalla e pjesëmarrjes dhe e humbjes përkatëse të secilit: repartet serbe nga qafa e Kolesjanit në Bicaj e deri në Kullë të Lumës duhet të kenë pasur humbjet më të rënda) Sipas *Prochaskës* “të mëdha e të përgjakshme”. Sipas Ahmet Zogut “vramë afro 6 batalione ushtarë”¹⁹. Këtyre të dhënave u vjen në ndihmë edhe një informacion i nënkonsullit britanik nga Shkupi i cili në shkurt 1913 shkruan se në Lumë Serbia ka humbur 8 batalione (kjo përfshin edhe fazën e tretë pas nëntorit 1912)²⁰.

Për të përfunduar, forcat serbe pjesëmarrëse kanë qenë 6 batalione (6500 vetë) me gjithë artileri e ndërlidhje e logjistike. Pra, nuk kanë qenë 18000 e as 16000, siç kanë shkruar disa studiues pa pasur mbështetje dokumentare dhe pa bërë analiza historiko-ushtarake. Po del se nuk kanë qenë as tre batalione forca pjesëmarrëse dhe as 198 të vramë (apo disa qindra), siç e ka fshehur historiografia jugosllave. Datën e fillimit të betejës më 15 nëntor e jep edhe konsulli austro-hungarez *Oskar Prochaska*, në raportin e tij dërguar Vienës, ato ditë (27 nëntor). Sipas tij, forcat serbe kishin hyrë në Bicaj më datë 12 nëntor, pa hasur në kundërshtim. (nga raporti i datës 13 nëntor) Por më 15 nëntor “lumjanët kishin ngritur krye papritur e pakujtuar” (raport i datës 27 nëntor), gjë që vërteton tërheqjen mjeshtrërore në kurth të reparteve serbe nga lumjanët dhe goditjen e tyre në befasi”. Lufta, vijon konsulli, u bë te Kulla e Shën Gjonit (për Gjomç në Bicaj, shënim im), Kulla e Lumës dhe në Zhur e Curr afër Prizrenit”. Rënia në kurth, goditja në befasi, terreni dhe moti shumë i keq e bënë të mundur (dhe të besueshme) humbjen e rëndë të forcave serbe.

¹⁹ Nosi, Lef, .Dokumente historike, 1912-1918, Tiranë 2007, Instituti i Historisë. f. 138. ISBN978-99956-10-04-3.(botuar për herë të parë më 1924).

²⁰ Albania and Kosovo, Political and ethnic boundaries 1867-1946, Documents Archive editions limited, 1999, British Library. f .347 ISBN 185207910X.

Në Lumë, në nëntor 1912, u ballafaquan koncepte e praktika të ndryshme, madje të kundërta të të luftuarit. Forcat shqiptare të Lumës, ndonëse nuk kishin epërsinë e duhur të raporteve klasike 3:1, por vetëm 1.5 me 1, organizuan e zhvilluan si tip luftimi sulmin bazuar në elemente ku ishin superiore iniciativa, mashtrimi, befasia e goditjes dhe sidomos shfrytëzimi mjeshëtor i terrenit, duke e ndjellë e futur armikun në një kazan të thellë midis lartësive të Gjalllicës, Pikëllimës e Kolesjanit nga lindja dhe jugu dhe nga lumenjtë Drini i Zi dhe Drini i Bardhë nga perëndimi e veriu, në një terren “të prerë” nga lumi i Lumës dhe përroi i tmerrshëm i Shejës. Zor të gjendet terren më i përshtatshëm për sulm dhe më i vështirë për mbrojtje në atë situatë luftarake të të dyja palëve. Përveç këtyre edhe errësira e natës së 15 dhe 16 nëntorit dhe moti i keq. Prandaj, forcat shqiptare lumjane dhe dibrane, ia dolën të realizojnë një goditje të fuqishme që e dëmtoi rëndë armikun.

Të vrarët e forcave ushtarake serbe

Edhe për këtë tregues të luftimeve në Lumë ka pasur e ka një interes të veçantë. Në fakt duhet pranuar se numri i humbjeve serbe është vështirë të nxirret me saktësi. Siç është e njohur botërisht, komandat serbe i fshihnin të dhënat e humbjeve në front dhe nuk i lejonin korrespondentët e huaj të shtypit aty, aq sa për të ruajtur imazhin e gënjeshtërt që përhapte sikur ushtria e saj “çlirimtare” po pritej krahëhapur kudo, si edhe për të mënjeluar reagimin e familjeve të ushtarëve dhe të oficerëve të vrarë. Po edhe sot Serbia nuk i ka hapur arkivat e saj ushtarake për studiuesit shqiptarë, në përpjekje për të fshehur të vërtetat e masakrave të saj mbi shqiptarët e pambrojtur, po edhe humbjet e saj të rënda.

Historiografia ushtarake serbe mezi ka pranuar si humbje në Lumë vetëm disa qindra ushtarë e oficerë të vrarë, kur vetëm njëri nga ushtarët e batalionit të tretë që luftoi në Bicaj, *Novakoviç* ka shkruar se mbetën disa qindra. Sidoqoftë, sipas historianëve ushtarakë serbë, në Lumë janë vrarë vetëm 198 ushtarë dhe plagosur 31 të tjerë! Këto të dhëna, që sipas tyre, janë nxjerrë nga arkivat e reparteve që vepruan në Lumë, janë të pabesueshme. Mjafton të themi se ata vetë kanë pohuar se regjimenti i 10 që luftoi në Bicaj të Lumës (b3 dhe b4 me 15 dhe 16 nëntor) kishte pësuar “humbje të mëdha”, madje kishte humbur edhe arkivin e tij²¹.

Në një telegram të administratës ushtarake osmane të datës 20 nëntor 1912, të dërguar nga Ohri në Elbasan, thuhet se në luftë të rreptë, gjatë 24 orëve (është fillimi i betejës, shënimi im) serbët në Lumë janë vrarë e shkatërruar keq, se janë në tërheqje, se u ishin vrarë 3 oficerë dhe “ushtarë pa numër” Ky numër mund të konkretizohet, po të kemi parasysh se po në këtë telegram, një rresht më lart, thuhet se “afro një mijë mauzerë serbi janë pushtue”, që sigurisht kanë qenë të ushtarëve që janë vrarë, pra afro njëmijë. Dhe telegrami vazhdon më tej “Lufta ndashti po vazhdon në Bicaj edhe shpresohet sigurisht që gjer mbrëma t’i pushtohen anmikut topa, mitraloza dhe shumë armë”²².

Pra deri më datë 16 nëntor, një humbje prej 1000 vetësh e bën më të besueshme të kenë qenë në Bicaj deri në Kolesjan dy batalione. Mund të besohet se ky ritëm humbjesh shumë i lartë (50%) të ketë vijuar edhe më datë 16-17 nëntor dhe 17-18 nëntor. Pra i bie të kenë humbur rreth 2000 e më shumë ushtarë serbë dhe gjysma e tyre, (diçka më pak

²¹Ratkovic,Borisllav, vepër e cituar, f. 261-265. ISBN 978-99956-10-04-3.

²² Nosi, Lef, Dokumente historike 1912-1918.,Instituti i Historisë, Tiranë 2007, .f .29.

a më shumë) të kenë dalë gjallë e të plagosur. Kjo mund ta konkretizojë përfundimin e *Novakovic*-it (serb që ka marrë pjesë në këtë betejë) që thotë: “disa qindra të vrarë”, “humbje të mëdha” dhe “humbje e plotë”²³.

Këto i përforcon telegrami i dërguar Vienës më 27 nëntor 1912 nga konsulli *Prochaska*, i cili shkruante nga Prizreni për “një luftë të ashpër e të përgjakshme, që u ka kushtuar serbëve humbje të mëdha dhe i ka detyruar të thërrasin për ndihmë të gjitha forcat e tyre”. Konsulli austro-hungarez sjell edhe një fakt tjetër: shkallën ekstreme të urrejtjes ndaj lumjanëve, që flet në mënyrën e vet për shkallën e humbjeve në Lumë. Ai i raporton Vienës: “Në vizitën që kleri katolik bëri tek gjenerali serb (është fjala për komandantin e Armatës së tretë *Bozhidar Jankovic*, shënimi im) më 21 të këtij muaji (3 ditë pasi kish marrë fund beteja (shënimi im), ai deklaroi se sa u përket lumjanëve, ai ka marrë urdhër që “fisi i Lumës do të shfaroset krejt, me gra e fëmijë”. Tanimë, dihet se forcat serbe bënë krime të llahtarshme më 1912-13 për të zbatuar këtë urdhër famëkeq. Në tetor 1913, masakruan më shumë se 1800 vetë në Topojan, Përbreg, Brekijë, Kalis, Palush, Lojme, etj.

Në këtë sasi të vrarësh, nga gjashtë apo tetë batalione vepruese në Lumë, mund dhe duhen llogaritur edhe të vrarët e reparteve të tjera të forcave serbe paramilitare që u futën në Lumë para datës 13 nëntor, të ashtuquajtur “vullnetarë”, të përbërë nga banditë që kishin për detyrë të hapnin rrugën për trupat e rregullta. Kryeredaktori i gazetës së armatës së tretë serbe, *Jasha Tomić*, në librin e tij “Lufta në Shqipëri dhe rreth Shkodrës”, botuar më 1913 në Novi Sad, informon për veprimin e këtyre forcave në Lumë, me një efektiv nga 70 deri në 200 vetë, njërën prej të cilave e komandonte ish ministri i mbrojtjes së Malit të Zi, *Gatallo*.

Veç numrit të pidentifikuar të këtyre çetave, që vepronin barbarisht në Kosovë, kishte edhe 7 regjimente me efektiva të thirrjes së tretë, gjoja për të siguruar qetësi në prapavija. Janë padyshim më shumë se njëmijë ushtarë dhe oficerë serbë të vrarë dhe, po të mendojmë se për 24 orët e para ishin vrarë njëmijë, duhet të jenë vrarë edhe aq, në mos më shumë, gjatë tërheqjes së shpartalluar nga Bicaj te Kulla e Lumës (ku kishin humbur gjithë karrot dhe kuajt e mushkat). Kjo edhe për shkak të goditjes së fortë nga ana e forcave shqiptare të vendosura në Përbreg. Por edhe disa qindra të vrarë që pranon historiografia ushtarake serbe për trupat e veta në Lumë, janë jo vetëm një disfatë, por një katastrofë, që bëhet edhe më e dukshme po të krahasohet me humbjet e serbëve gjatë Luftës së Parë Ballkanike. Në betejën e Kumanovës (23-24 tetor 1912), ku morën pjesë 168 mijë trupa (111000 serbë dhe 58000 osmanë) mbetën të vrarë nga të dy palët 1887 vetë (687 serbë dhe 1200 turq). Por numri prej 12 mijë, 15 mijë apo 18 mijë ushtarësh serbe të vrarë në Lumë në nëntor 1912, që jepet në disa botime shqiptare²⁴, madje edhe në pllakën e lapidarit që i kushtohet kësaj lufte, është i zmadhuar dhe jo real. Me të drejtë prof. Shefqet Hoxha e ka quajtur “një shifër folklorike”²⁵. Kjo bëhet edhe më e kuptueshme po të kemi parasysh se gjithë humbjet e ushtrisë serbe në Luftën e Parë Ballkanike janë llogaritur në 22 mijë të vrarë.

Serbia pati në Lumë edhe një katastrofë morale. “Shqiptarët ‘e egër’, ushtarët tanë të zënë robër i çarmatosin dhe i lëshojnë, kurse ushtria jonë ‘e kulturuar’ e shekullit XX

²⁶ Tucovic, Dimitrije, Zgjedhje punimesh. II, Rilindja, Prishtinë, 1981, f. 154-155.

²³ Novakovic, Kosta, Nëpër Shqipëri, Revista Dy Drinat, Bicaj, Kukës, Nr 1.1998, f.31-35.

²⁴ Kolgjini, Tahir, Luma dhe luftërat e saj, botuar në “Shenjzat”, nr. 3-4. 1969, f.16:

²⁵ Hoxha, Shefqet: Luma në luftërat për liri. “Geer”. Tiranë, 2002, f. 202-203. ISBN:9927-767-9-X.

po i vret fëmijët e tyre”, shkruante në shtypin e kohës *Dimitrije Tucoviç*²⁶. Historiani Shaban Braha informon për “lirimin e dorëzimin e 720 robërve të kapur në Luftën Lumës²⁷

Ky është një tregues tjetër i fitores morale të shqiptarëve kundër serbëve më 1912. Ndërkohë janë bërë përpjekje për të evidentuar dëshmorët e palës shqiptare në Betejën e Lumës. Është dhënë shifra e 200 të rënëve, (nga të cilët 109 prej tyre janë identifikuar me emër dhe mbiemër me fshatin nga është dhe vendi ku ka rënë²⁸.

Më 18 nëntor merr fund Beteja e Lumës, me fitoren e forcave shqiptare të Lumës dhe të Dibrës. “Grupimi serb i Lumës” shpartallohet, një pjesë e mirë e tij asgjësohet. Pas saj, komanda e armatës së tretë serbe hedh kundër Lumës forca të freskëta e të shumta (nga 19 nëntori më 6 dhjetor 1912) dhe e merr vetë në dorë drejtimin e operacionit luftarak. Historiografia serbe ka pohuar se për këtë armatë ishte hapur në Lumë një front i ri luftime. Kundër Lumës angazhohen të gjitha forcat e divizionit “Shumadija I” që kishin mbetur në Prizren, Regjimenti 11k dhe ai 12k, i përforcuar me 2 batalione të tjera, (njeri prej të cilëve b2 i R 10 k) dhe b1, b2 dhe b3 të R19k.

Edhe vetë historiografia serbe ka pranuar botërisht se këto forca të vendosura në Prizren në nëntor, janë përdorur aktivisht në fazën e tretë kundër Lumës. Këto përbënin organikisht rreth 13 mijë vetë dhe po t’u shtohet edhe efektivi prej 1000 vetësh i forcave mbështetëse, dhe 6500 vetë të efektivit që luftoi në Lumë nga 13 deri më 18 nëntor, del se gjatë nëntorit deri me 6 dhjetor 1912 luftuan në Lumë kundër popullit të paarmatosur 20500 ushtarë dhe oficerë serbë. Po t’u mblidhen këtyre edhe efektivat e çetave të ashtuquajtura “vullnetare” e komitë që hynë në Lumë në fazën e parë, menjëherë pas 30 tetorit, do të thotë se Serbia dërgoi në Lumë gjatë gjithë muajit nëntor, për çdo shtëpi, 7-8 ushtarë dhe oficerë.

Kapaciteti dhe detyra e Lumës ishte, siç edhe ia doli me sukses, të përballonte sulmin e forcave serbe në fazën e parë dhe të dytë. Faza e tretë e luftimeve ishte forcë dhe kapacitet operativ-strategjik, jashtë çdo mundësie krahinore. E megjithatë, ndonëse përballë forcash 5-6 herë më të mëdha në numër, shqiptarët e Lumës nuk i dorëzuan armët para divizionit dhe armatës serbe. Ata bënë në Bardhok e kudo, gjatë një tërheqjeje shkallë-shkallë, një qëndresë të fortë, si në rrafshin e Lumës dhe kundër dy kolonave serbe, njëra nga Opoja në Topojan e tjetra nga Surroji në Ujmisht. Siç dihet, ushtria serbe bëri masakra, duke gjuajtur, djegur e rrafshuar fshatrat me top, ndërkohë që moti i ftohtë (borë e madhe dhe temperatura deri minus 15 gradë nën zero²⁹, kërcënonte fëmijët e vegjël, gratë dhe të moshuarit. Në fund të fundit, edhe lumjanët ishin njerëz, kanë shkruar, pa e fshehur simpatinë, kronistët e kohës.

Studimi i arkivave serbe (që edhe sot mbahen të mbyllura, në veçanti për shqiptarët) do të sillte të dhëna edhe më konkrete e të hollësishme për këtë betejë të famshme, të cilën e ka ruajtur aq fort kujtesa popullore dhe folklori i krahinës³⁰ dhe e ka përmendur në krijimtarinë e tij artistike dhe shkrimtari i madh Ismail Kadare.³¹

²⁷ Braha Shaban. Beteja e Drinit kundër agresionit serb. Prizren, 2000. f. 115.

²⁸ Duraku, Izet, .Kumtesë e mbajtur në sesionin jubilar më 2012, organizuar nga Bashkia e Kukësit.

²⁹ Lt.colonel Brevete Boucabeille, La guerre Turco-Balcanique, 1912-1913, Paris 1914, f. 126.

Macario, Giani Baj, vepër e cituar f. 180. Të dy këta autorë e japin këtë temperaturë për terrenin nga kaluan kolonat e ushtrisë serbe nëpër Mirditë dhe Pukë.

³⁰ Kënga e Luftës së Lumës që luftoi kundër serbit, botuar në “Visare të Kombit, nr. 4, 1939.

³¹ Ismail Kadare, Krushqit janë të ngrirë.

“Shpërbërja morale dhe fizike” (“the moral then physical disintegration”) e njëres palë përcakton termin “betejë”. (John Keegan, historian i madh ushtarak britanik në “*The face of Battle*.”1976). Kjo shpërbërje morale dhe fizike e forcave serbe u shfaq qartë në Betejën e Lumës. Kjo “luftë e ashpër” (Prochaska) në Lumë më 15-18 nëntor 1912, është një betejë e vërtetë, e fundit në Shqipëri kundër ushtrisë serbe në atë vit dhe beteja e fundit që Luma ka zhvilluar ndërkohë. Pikërisht se ka qenë e tillë, populli e ka përjetuar emocionalisht, e ka përjetësuar në këngë dhe në lapidarë (një në Qafë të Kolesjanit dhe një në qytetin e Kukësit).

Përfundimisht, beteja dhe gjithë lufta e Lumës në nëntor-dhjetor 1912 zë një vend të merituar në *Historinë Ushtarake të Shqipërisë* të periudhës së pavarësisë. Ajo është dëshmi e faktit se shqiptarët luftonin të frymëzuar nga ndjenja kombëtare dhe pavarësia që ato ditë po shpallej në Vlorë më 28 nëntor 1912. Luma, frika prej saj, i ndaloi një javë forcat e armatës III serbe në rajonin e Prizrenit për t’u riorganizuar, duke i dhënë kohë Ismail bej Vlorës, të mbërrinte në Durrës, para se të mbërrinin aty repartet e ushtrisë serbe (Vlorën e kishin bllokuar luftanijet greke). Kjo betejë dhe fama e saj shkuan larg deri në Londër, duke e siguruar Lumën njëherë e përgjithmonë brenda kufirit të shtetit të ri shqiptar

Shënim. Pasi nuk ishte përmendur në asnjë botim zyrtar të mëparshëm, më 2002 botimi akademik i “*Historisë së popullit shqiptar*” shënonte me parë shtypjen se qëndresën e 2000 lumjanëve kundër forcave serbe në nëntor 1912, pa thënë asnjë tjetër fjalë për një betejë të zhvilluar e të fituar prej tyre. Por e vërteta zhytet e nuk mbytet, thotë populli.

Më 2012, me rastin e 100 vjetorit të Pavarësisë, Instituti i Historisë botoi veprën dokumentare në 6 vëllime “*Shqipëria në dokumentet austro-hungareze.(1912)*” përgatitur dhe redaktuar nga akademik i asociuar Maranglen Verli dhe Dr. Ledia Dushku. Në këtë vëllim janë përfshirë dy informacione (telegrame) që konsulli i Perandorisë Austro-Hungareze, Oskar Prochaska i dërgonte Vjenës ato ditë nëntori 1912 dhe që flasin qartë për luftë, madje “luftë të ashpër”, të përgjakshme” dhe “për humbje të mëdha të serbëve,” që i ka detyruar të thërrasin për ndihmë të gjitha forcat e tyre.

Po kush ishte konsulli Oskar Prochaska. Diplomati i Perandorisë Austro-Hungareze, Prochaska ishte konsull me rezidencë në Prizren. Me origjinë ishte çek, kishte lindur më 12 korrik 1876 në Brno, qendër e Moravisë, qyteti i dytë në Çeki, pas Pragës. Lufta e Parë Ballkanike e zuri Prochaskën aty ku shërbente, në Prizren dhe ai i dënoi, siç e meritonin, masakrat e trupave pushtuese serbe mbi popullsinë shqiptare. Për këtë arsye, serbet e arrestuan diplomatin trim Oskar Prochaskën “për nxitje të popullsisë shqiptare për qëndresë (Siç i shkruante Vjenës ambasadori austro-hungarez në Beograd, Ugron, serbet i gjetën rojës së konsullit Prochaska një letër private të këtij të fundit, në të cilën ai përshkruante fill e për pé barbarizmat serbe.) Ky incident i rëndë çoi në një krizë diplomatike mes Perandorisë Austro-Hungareze dhe Mbretërisë së Serbisë. Emri dhe bëmat e konsullit Prochaska u morën në mbrojtje nga shtypi austro-hungarez dhe u bënë të njohura e popullore anekënd perandorisë shumëkombëshe. Prochaska u lirua nga burgu serb në janar 1913. Ai e vazhdoi karrierën diplomatike si konsull i Perandorisë në Rio-De Zhaneiro të Brazilit.

Po emri i konsullit Prochaska , për informacionet e tij tanimë historike dhe publike në Shqipëri, meriton të vlerësohet, të ketë, për shembull, një zë në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar dhe të përmendet në botimin akademik të “*Historisë së popullit shqiptar*”

Mendoj se Oskar Prochaska meriton ta ketë fotografinë e tij në muzetë tona, në Kukës e Prizren, por edhe në Muzeun Historik Kombëtar. Madje ai meriton të shpallet “qytetar nderi” i qarkut të Kukësit dhe i komunës së Prizrenit. Figura e tij, në përkrahje të popullit shqiptar, në një moment të vështirë të historisë së tij kombëtare, është shembulli i një diplomati për çdo kohë, është nder për vendin e tij, Çekinë. Dhe me siguri, Oskar Prochaska do të nderohet, sa herë të flitet e të përkujtohet beteja e Lumës dhe lufta e popullit shqiptar kundër pushtuesve serbë më 1912.

Bibliografia:

- Historia e Popullit shqiptar, vëllimi i II, botim i vitit 2002.
- “Dokumente Historike”, botuar në vitin 1924 nga Lef Nosi, Ribotim më 2007 nga Instituti i Historisë së Akademisë së shkencave të RSH.
- Shqipëria në dokumentet austro-hungareze. (1912) vëllimi VI (nëntor-dhjetor). Tiranë 2012. Qendra e studimeve albanologjike. Instituti i Historisë-Tiranë.
- Fjalori Enciklopedik shqiptar. Akademia e shkencave të RSH, Tirane, 2008.
- “Ismail Qemali”. Përmbledhje dokumentesh, Tiranë 1982, dokumenti nr 224.
- Shefqet Hoxha “Luma në luftërat për liri” dhe Beteja e Lumës në “Shpalimet e vitit 2007”, Tiranë, 2008.
- Shaban Braha “Beteja e Drinit kundër agresionit serb”. “Kosova” 2000.
- Isa Halilaj: “Shtigjeve të kohës”. Geer 2010.
- Esat Bilali “Shkrime historike” Koha” Tiranë, 2001.
- Idriz Basha i Novoseit. “Esat Pashë Toptani. 1912-1920” Bruksel 1982.
- Qemal Mataj: Ramadan Zaskoci. 1979.
- Nazif Dokle: Kukësi në enciklopedi “Koha” Tiranë, 1999.
- Tahir Kolgjini: Luma dhe luftërat e saj “Shenjzat”, me pseudonimin Lok Lumthi.
- Ismail Qemali: Kujtime. Botimet Toena, 2009.
- Visaret e Kombit, vëllimi IV, Tiranë, 1939, Kënga e luftës së Lumës kundër serbit
- Albanian and Kosovo: political and ethnic boundaries, 1867-1946” Londër.
- Lt.colonel Reginald Rankin .The inner history of the Balcan War.
- Giani Baj Macario Ballkani 1912-1913. “La prova” Milano 1937.
- Lt.colonel Brevete Baucabeille. “La guerre turco-balcanique 1913-1914”, Paris 1914, (Biblioteka e Shkodrës).
- Ferik Abdurrahman Nazif, Mirliv Kirametin : “Iskodra Mudafasi” Instambul, 1933.
- Dimitrije Tucoviç “Zgjedhje punimesh”, v.2-i.vitit 1981, botim i “Rilindjes”, Prishtinë
- Borisllav Ratkoviç: “Prvi balkanskih rat 1912-1913” (Operacije srpske vojske) v.II, Beograd 1975.
- www.Military history of Serbi.
- Jasha Tomic: Rat u Albaniji i oko Skadra, 1912-1913 godine, botim i vitit 1913, Novi Sad.
- Borisllav Ratkovic, Mitar Burishic, Savo Skoko: “Srbija i Crna Gora u Ballkanskim patovima 1912-1913”. Beograd. 1972.
- Enciklopedija jugoslave, botim i parë, viti 1984.
- Vojna Enciklopedija, Beograd 1973-1975.
- John Keegan “A history of Warfare. USA 1994.
- John Keegan: The face of battle” 1976.
- Richard C. Hall, “The Balkan Wars” 1912-1913, “Prelud to the first World War” London and New York. 2000.
- Egidio Ivetic. Luftërat ballkanike. “Dituria”, v. 2008.

Brief Summary in English

NATO Security Policy and its impact on the national security policy

Colonel Editson Zarka
Director of Strategic Policy
Ministry of Defence, Tirana

Short commentary. *Our country's membership in NATO in 2009 and the full integration of the Armed Forces in this Alliance in 2013 has raised the need for further harmonization of policies, processes and procedures between this organization and national institutions. This is a process that began before membership in NATO, especially after our country's involvement in the Membership Action Plan (MAP) in 1999. During a 10-years period the focus was on five key areas to achieve the required standards of membership, namely in the political, economic, defence, military, defence resource, safety of classified information and legislation.*

Currently, NATO membership and full integration has established our country as an equal member among 27 other allied countries in the Alliance where political and military decisions are made, which become mandatory at national level. This paper intends to shed light on NATO formulation and decision-making procedures in terms of security and defence policy, compared to formulation and decision-making procedures of national security policy and defence. The influence of the first on the last ones is a characteristic, which should be taken into consideration by our policy making structures.

Key words: NATO, security policy, decision making, defence, military.

Evolution process - The core of the Armed Forces' transformation

LtC. (R) MSc, Kanan Himaj
Analyst, NCSD

Short commentary. *Throughout the world, nowadays we are witnessing continuous and profound changes, the evaluation of which is determined by the emergence of new parameters in the improvement of human, political, economic and military life. Evolution Processes in the Albanian Armed Forces have taken different forms and each of the stages of change has a "name" of its own. Changes made in the past until NATO membership are already well known, but they bear the baptismal name "transformation"*

and they have brought changes in the form and content of the modernization of the Armed Forces. Currently, the most mentioned term is taken from NATO terminology. Actually, all processes continue to bring about changes affecting military organization, in all its dimensions: conceptual (strategy, doctrine), structural (personnel, equipment, etc.), technological, cultural and organizational.

The trigger for this paper is the moment and expectations for comprehensive and realistic changes in our Armed Forces. Changes in defence planning issues are associated with the compilation of the new security strategy, military strategy and further with perspective plans of the force. Nowadays, these are major issues to be solved at all strategic levels of the country because they are not only issues of AF but of the entire Albanian society. Therefore, the process of change is the main focus, in many aspects, in order to have a better understanding of defence planning system in the context of security and collective defence of the Euro-Atlantic Alliance.

Key words: Evolution, NATO, reform, transformation, modernization, restructuring, skills, security, collective defence and security.

Need for the revision of National Security Strategy Document of the Republic of Albania

LtC. MSc. Ardian Lulaj
Lecturer at AFA

Short commentary: National Security Strategy Document is a very important paper, which in my opinion, comes after the Constitution of the Republic of Albania. In this document the Armed Forces, as one of the elements of national power are among the key stakeholders for the design and implementation of national security. Moreover, Defence Directive 2014 for the Armed Forces is stated as one of the main foci of the work is drafting of strategic documents in the field of security and defence.

This paper intends to give some of the reasons why this document should be reworded and at the same time it presents the stakeholders that should be involved in the drafting this document. Finally, it gives some recommendations that can be considered during the work for the design of the document of the new National Security Strategy of the Republic of Albania.

COIN operations and David Galula

Lieutenant Colonel Arjan Roshi,
Lecturer at AFA

Lieutenant Colonel Vladimir Imeraj
Lecturer at AFA

Short commentary. Armed Forces of the Republic of Albania continue to contribute by

troops and capabilities to the Alliance operations, within and beyond the Euro-Atlantic zone. This is a significant step for our country considering it in terms of a relatively small force as well as in terms of the capabilities we possess. Naturally, being a member of NATO has its own responsibilities and obligations. In the program, as well as in the meetings with political and military leaders of the Alliance, the Government and the Ministry of Defence of the Republic of Albania have already reconfirmed Albania's determination to further contributions. From this perspective, arises the question: Is this contribution a challenge for our Armed Forces? Do we possess the necessary human resources and material capabilities to assume new responsibilities? And above all, are we adapted to nowadays operational environment of NATO operations? Do we possess the necessary doctrine, the latest one, combined with that of the Alliance, to be feasible in our conditions?

All the above mentioned relates to how we should be prepared for facing these challenges, in order to be a dignified representative and a worthy member of the Alliance.

The nature of nowadays conflicts has become much more complex than before. The participation of our special forces in the missions in Afghanistan and especially "Eagle" mission has necessitated the searching of a contemporary doctrine on studying, preparing and planning operations against the insurgency. It is our duty to provide the combat forces and the courses which are held at the Academy of the Armed Forces, with coherent knowledge about these kinds of operations.

Certainly there has been put a lot of efforts and work. The publication of the teaching book "Combating insurgency" prepared by the joint contribution of the lecturers of the Academy of the Armed Forces and Doctrine Centre at TRADOC published by the latter is a significant contribution. We do not forget the theoretical basis provided by the Alliance and the other partner armies, especially the U.S. army which owns a special doctrine. What we want to emphasize is the fact that these modern armies refer quite a lot to the history and especially to experts of counter-insurgency operations. Let's refer specifically to one of them, in order to assist the courses at the Academy of the Armed Forces and to have him as a reference even in the scientific-research studies. He is David Galula, to whom and to his experience, the U.S. military has also been referred during the preparation of its manual "On counter-insurgency operations".

Role of the Albanian Coast Guard in the marine environment and the impact of tanker vessels during the ballasting process

MSc. Riza Zaja
PhD Program 2011-2014, AFA

MSc. Bledar Sakaj
PhD Program 2011-2014, AFA

Short commentary. *Currently in Albania and specifically in Vlora Bay, it was built the Petrolifera port, where a large number of tank ships are operating. A large number of environmentalists in Albania criticize the presence of these cistern vessels, which are*

polluting the Bay of Vlorë performing the ballasting process.

This problem has caused an institutional clash between the institution of the Petrolifera port and the association of the environmentalists in Vlorë the city. Should we be specifically concerned about the impact that these tanks operation will have on Vlorë Bay? The answer to this question is found basing on various experimental arguments, the Committee for the Protection of the Marine Environment (MSC) and the on the Albanian Coast Guard Manual, 2002 .

Special Forces and the change of the combat environment from conventional to unconventional one

Colonel Dritan Demiraj
Head of Simulation Centre

Short commentary. *From the elements of the operational environment and the microclimates produced by them, there is a need for a form of war that is the most favourite and the most appropriate choice, very different from modern conventional war. There are several dimensions which clearly explain the difference between the conventional and the unconventional war but here I would like to mention only some of them. Before analyzing these dimensions, it is necessary to define the terms “conventional war” and “unconventional war”.*

Special operations are often carried out in conjunction with conventional military operations, as part of a sustained political-military campaign. Some special operations are spectacular direct actions that have attracted wide attention, but many others are long term ones. They are an indirect attempt that has never been made known. Regardless of what form is performed, any special operation is carried out to solve specific problems in operational or strategic level ,as economically as possible ,which are difficult or impossible to be performed only by conventional forces.

US Strategic Culture

MSc. Lindita Mukaj
PhD Program 2011-2014, AFA

LtC. Arben Dhuli
High Course for Officers, AFA

Short commentary. *American strategic culture affects many spheres of life activity. The development trend of this culture takes time and integrative and collaborative processes in all fields. As a nation, this culture is inculcated by free security and filled with hatred against the feeling of exclusion. It carries the liberal idealism and sees war as the continuation of politics.*

U.S. military culture, the so-called “American way of war”, emphasizes direct strategies,

an industrial display for war, fire capacity and effort to develop an intensive technology for war. The following article shows how strategic culture should, the American culture in particular, influence the security policies. Among other cultures it is worth mentioning the recent events in Ukraine which seem to display some characteristics of strategic culture.

Operational role of military doctrines on moral and psychological education of military personnel

LtC (R) Ajet Nuellari

Short Commentary. *Recognition and acquisition of moral education and psychological traits in the battle as well as in training, is one of the most difficult problems for commands and staffs, for cadres and military specialists. They are reflection and synthesis of a number of political, military, economic, social factors, etc. Consequently, it is difficult to determine the extent of the impact and role of any of these factors in shaping people's moral conscience. Taken together, they constitute the objective basis of education and morality standards. Analysis of each of these elements, to highlight their role and impact in the indicators of moral and psychological state, is the subject of specific studies.*

Military doctrines have aimed to resolve disputes arising in the battle field, in technical and moral aspect. They cannot be understood outside the psychological and moral values because they play a very active and important role in this regard.

Geopolitics – imperative for elites and high rank policies

Prof. Dr. Pajtim Ribaj
Lecturer at AFA

Short commentary *This section is the newest one of the review, which covers complex approaches aiming to conduct a difficult concept such as it is the geopolitics. The aim of this section is to collect studies on the Albanian area and its regional dynamics and beyond. Although geopolitics is much older than the nowadays technology claims, the oriented policy by territorial interests is defined, from more than 100 years, as "geopolitics".*

Unequal driving forces of economic expansion and of social hierarchy, which both require a state management and are dependent on territory, constitute the basis of the modern state. Geopolitics serves to the interests of a state, in benefit of its actions on the international theatre. At the same time, it is and remains a concrete arena where the states should operate and be compared with each other.

Even geopolitics, as any other discipline, requires a legitimate comprehension worldwide. There are designed global and spatial images to secure the national borders, to impose territorial interests and to gain influence's areas. Obviously, the Albanian space acquires dynamic policies to outline effective strategies.

Union for the Mediterranean and European geopolitics of Paris

MSc. Silvana Markgjonaj
Editor at Centre for Doctrine

Short commentary. *Mediterranean unites or separates? To answer this question, I would like to make an analogy between the Mediterranean area and the Euro-Mediterranean relations. Depending on the activity, such as, relations, the same object, in this case the sea could become a connective point and not a dividing space. If it comes to an event, you must have the actors and actors, in this case, are the people. How is the Mediterranean regarded? According to analysts and theoreticians, the sea can connect. Union can become a force from which all can benefit.*

Mediterranean is labelled as “mare nostrum”. Is this labelling a statement of ownership or a great awareness of a common heritage of the peoples who live around the Mediterranean? In my personal life experiences during visits, I felt that the Mediterranean is ours, because in each of its side, I do not feel a foreigner. On the contrary, the historical, religious, cultural, artistic and economic roots connect those who live in its beaches with a common heritage.

Key words: Mediterranean, geopolitics, France, Barcelona, union, people.

Geopolitical thought in the German-speaking countries

MSc. Lah Nitaj
Pristina

Short commentary. *This article addresses the German geopolitics with its more prominent representatives as Karl Haushofer¹ etc. It continues with the misuses of this term from National Socialists who used it in an outdated form where its spatial or territorial extensions served to economic hegemony, while internal unification was achieved by eliminating “enemies of the people” as well as exercising ideological legitimacy on bio-political concepts of “vital space” and “dominant race”.*

Although geopolitical opinions continued to dominate foreign policy practices, the term “geopolitics” after the Second World War was seen in Europe as a concept based on fascist ideology. The profound political, economic transformations and those of the operating system in the international scenario have “forced” the researchers and the public opinion to refer to geopolitics already “reborn” from these transformations. Geopolitics in German-speaking countries is moving in this trend.

Key words: Geopolitics, Germany, economic hegemony, fascist ideology.

An overview on the Albanian military pensions in years

LtC (R) MSc. Xhemal Çangu
Expert at Personnel Recruitment Centre

Short commentary. *Military people and their occupation is considered as one of the*

toughest professions, at any time and in every country, because of the privations it involves. Difficulties of the profession are closely related to the hard nature of their job, to the task they accomplish and to the vulnerabilities this profession bears. The job of a person in uniform, as a specific one, requires sacrifices in time of peace when he/she is asked to face with difficulties and multiple deprivations. Moreover, in times of war these sacrifices increase because he/she takes the oath and signs to be ready for the most sublime sacrifice, to give his/her own life. During their military activity and career, people in uniform are asked to confront a number of deprivations of fundamental freedoms and human rights, where family scrapes and needs are often considered of second hand due to their obligations towards society and state. Hence, given the nature of work of people in uniform they enjoy the protection and care of the state.

Such protection and care is provided by legal acts, not only for the time of their active duty, but also when their military career is interrupted and they are in reserve, released or retired. This paper tries to shed light on the legal protection and treatment of the military people over the years in our country by referring to different historical periods. According to the data the legal protection of people in uniform begins on February 15, 1923, when the first law on “Resignation and pensions in gendarmerie” was passed. In 1934 the “Law on the civil and military pensions” was passed which contained a lot of articles that dealt with the care towards military people. From those times on all governments have paid special attention to the care and treatment of military people. Given the gaps for proper research in this field, this paper is an attempt to address the protection of the military people over the years. Policies designed for legal protection of active military people, especially for the military contingent in reserve, released or retired, i.e. about supplementary pensions and welfare of the military personnel after cessation of military career, extended in certain years and periods, will help draw some conclusions about the real appreciation of the dignity of military people and the need for improvements in the future.

Commitment of the retired militaries on society

Major Festim Alimadhi

Short commentary. *The development of human society has brought about the re-dimensioning of state's role in relation to its citizens, in terms of mutual rights and obligations. The states model, according to their political organization, regime or classification of their economic system, do not have anything in common with difficulties concerning mainly philosophical concept, but it has to do with the amount of services that the state provides to the citizens and is certainly related to their quality.*

We look at the consolidation of states and their level of democracy, in association with the relationship it creates with citizens and the services offered to them. Nowadays, on their studies, many international, public or non-governmental organizations are focused on the services provided by the state, the manner and time these services are offered and certainly on their quality, or whether a state provides all the services that it should guarantee to its citizens. Based on these elements, the states are placed on the states ranking list.

Since 60's, the term “welfare state”, has been widely used by politicians and researchers. This term came into use as a result of the positioning of state's role in relation to services it should provide to its citizens, the category of payments that citizen should get for

these services, taking into account their own incomes. Regardless of the form of the regime, the state has the obligation to serve all its citizens independently of their social stratum, protecting the poor people.

As Giddens states, we live safely today thanks to “experts’ knowledge”, to whom we trust without knowing them. For this reason, treating and working with them is of a particular importance. Due to major changes that have taken place worldwide after the fall of the “Iron Curtain”, great economic transformations and especially political ones have questioned the role of the state regarding the services it should provide to its citizens, i.e. if they would be public or private. Human capital is vital regarding its work and professional knowledges.

The purpose of this analysis is related to the State’s treatment on its citizens, on the eve of retirement.

Strategy of “Massive Retaliation”, as the first major change in US nuclear strategy

Major General Viktor Berdo
Deputy Chief of GS of AAF

LtC. Dritan Stroni
High Course for Officers, AFA

Short commentary. *The Cold War was characterized by a tough political, strategic and ideological war, as well as a competition of social and economic ideologies between the U.S. and Soviet Union worldwide spread. They were competing each other by using the Cold War strategies, where the nuclear strategy was the purpose behind. The Eisenhower Administration years are considered as the most “furious” time in designing U.S. as an unquestioned nuclear superpower. Eisenhower’s policy, known as the “New Look” had major impacts on U.S. nuclear strategy and its economy.*

Eisenhower was convinced that the key to victory in the Cold War was not merely the military force, but a strong economy. U.S. should display the world that the free initiative could create a better society than communism. At the same time, the economic freedom would prevent the collapse towards the communism. According to Eisenhower, the best way to prevent the Soviet threat was the use of nuclear weapons. This was the foundation of the doctrinal strategy “Massive Retaliation”.

Wilhelm zu Wied and Albania *(March- September 1914)*

Major PhD. Marenglen Kasmi
Lecturer at AFA

Short commentary. *The period of Wied governance in Albania, from 7 March to*

September 3, 1914, is a period full of political and military contradictions, both external and internal. Internal conflicts stemmed from the religious heterogeneity of the Albanian population, personal policies of the political figures and choices dictated to Albania, through the establishment of a xenocrat power. Rivalries and differing interests of the Great Powers, during the Conference of Ambassadors, first of all of Austria-Hungary and Italy, turned the country into a "game puppet".

This is confirmed by the selection of an unknown German figure as Wied at the head of the Albanian state. During those six months rule, rivalries between the Great Powers, as well as internal problems that Albania had at its beginnings as an independent state emerged.

Aspects about Luma's Battle (Estimated by the austro-hungarian archive)

Colonel (R)Sali Onuzi

Short commentary. *Luma's Battle* was conducted from 15-18 November 1912. After the invasion of Prizren, Serbian forces, sent to Adriatic two military convoys, while they established and put into operation "Luma Group", to subjugate it (by burning houses and collecting weapons) with the objective to reach Dibra, in order to ensure their invasion in northern eastern part of the Adriatic coast. The Luma's people and Northern part of Dibra (Rec e Dardhë) occupied the Kolesjan's pass of the mountain and they attacked in that position the Serbian forces, defeated them and chased them to Luma's Tower up to the Prizren's gates. Regarding the number of the Serbian forces who participated and were killed in this battle, in many of the editions, figures were exaggerated, something which occurred also in the memorials builds up to commemorate this battle (12 thousand, 16 thousand or 18 thousands were killed).

In 2012, after the publication of the Austro-Hungarian documents about Albania by the Institute of History of our Science's Academy, were published as well two telegrams of the Consul Prochaska, sent from Prizren to Vienna. Based on his data and assessments of Luma's War, we learn that at that time there were fighting 6 battalions (6500 Serbian soldiers). The article suggests another scheme of Serbian forces installation and, compared to other documents, there is a more realistic figure of Serbian forces killed in this battle (2000-3000). The clever withdrawal of Luma's people and the falling in ambush of Serbian forces, the surprising attack, the bad terrain and weather, make reliable the reports about huge losses of Serbians, given by some documents provided at that time. In the paper was argued that this war was a battle with all its characteristics, if we take into consideration the amount of forces, the duration time, the territorial expansion, the end of the battle and its results.

Luma's battle is the last battle of the Albanians against the Serbian army in 1912 and the final battle conducted in Luma. People have experienced it emotionally and therefore created songs and memorials. Folklore has performed its function very well, but it requires, by this article, that historiography should be written based on facts, by avoiding folklore. The paper indicates who was the Austro-Hungarian Consul Oscar Prochaska and suggests that the feats of this brave diplomat should be honoured by our institutions and our history.

KUJTESË

PËR BASHKËPUNËTORËT E REVISTËS USHTARAKE

Të nderuar bashkëpunëtorë të Revistës Ushtarake!

“Revista Ushtarake” është një Revistë kërkimore me fokus teoriko-shkencor. Ajo është revistë e elitës ushtarake të FA dhe e analistëve të spikatur civilë që, nëpërmjet shkrimeve të tyre, synojnë jo vetëm të informojnë, por në radhë të parë të ofrojnë zgjidhje për çështjet më të rëndësishme të reformës së Sigurisë dhe të Mbrojtjes në nivel strategjik, operacional dhe taktik. Pra, përparësia numër një e RU janë vlerat zbatuese të krijimtarisë origjinale të autorit.

Ftojmë studentët ushtarakë e civilë të sistemit të kurseve të larta të AFA, instruktorët, pedagogët, punonjësit kërkimorë, analistët, komandantët, shefat dhe trajnuesit e të gjithë institucioneve e njësisive të FA të RSH, analistët e pavarur civilë apo ushtarakë në fushën e Sigurisë e të Mbrojtjes të jenë të pranishëm me shkrimet e tyre në faqet e RU-së. Në vijim, Redaksia e RU jep disa udhëzime e të dhëna teknike për strukturën e artikujve të Revistës Ushtarake, të cilat duhet të respektohen nga autorët.

Struktura e artikullit

Titulli. Emërtimi i artikullit, me tre deri në katër fjalë.

Autori, Bashkautor: Shkruhet emri i autorit ose bashkautorëve të artikullit.

Trajtesa e shkurtuar: Është pjesa që paraprin një artikull. Tek trajtesa autori shkurtimisht, duhet të paraqesë karakteristikat e artikullit (thelbin apo çështjet themelore të trajtesës, synimet e autorit, këndvështrimin, përfundimet ose rekomandimet, etj). Trajtesa nuk zëvendëson parathënien e vetë artikullit. Ajo zë rreth 1/2 e faqes dhe nuk duhet t'i kalojë të 400 fjalët.

Paraqitja, gjatësia: Pjesa kryesore e shkrimit (përfshirë parathënien dhe përfundimet) shkruhet në gjuhën shqipe dhe duhet të jetë maksimumi 6-8 faqe kompjuterike (15 000-25 000 shkronja e shenja, duke përfshirë edhe hapësirat përfshi edhe “endnotes” dhe informacionin shtesë.

Formati: Faqja duhet të jetë e formatit A4; Lloji i shkrimit: “Times New Roman”; Madhësia e shkrimit 11. Kryeradha (Paragrafi i ri) përcaktohet me një rresht bosh. Paraqitja e tekstit të jetë e thjeshtë dhe në minimum të alternativave të stileve dhe formatimit. Kapitujt nuk duhet të jenë të numëruar; teksti duhet të ketë një strukturë me maksimumin 3 nivele. Duhet të shmangen tekstet e theksuara me bold apo shkronjat me ngjyra. Shkrimi i pjerrët dhe thonjëzat duhet të përdoren vetëm për citimet e burimeve të përdorura dhe literaturës.

Grafikët, tabelat dhe imazhe të tjera duhet të bëhen të formatuara në grup, duke shmangur shpërbërjen e tyre. Ato duhet të vendosen sa më qartë në një pozicion të përshtatshëm pranë tekstit që i shpjegon ato. Të gjitha imazhet duhet të pasqyrohen në mënyrë të tillë që lexueshmëria të mos ndikohet nga reduktimi i madhësisë dhe printerat bardhë e zi. Nëse një imazh është marrë nga një burim tjetër, është e domosdoshme që të citohet burimi përkatës i tij.

Artikujt duhet të dërgohen të printuar dhe në mënyrë elektronike dhe me CD në Redaksinë e Revistës Ushtarake. Për ata artikuj që nuk i plotësojnë kërkesat e mësipërme të formatit dhe të gjuhës, Redaksia vendos nëse do t'i rikthehen autorëve për përmirësim, apo do të përjashtohen nga procesi i paraqitjes në Këshillin Botues.

Dokumentacioni: Redaksia e RU vlerëson me rëndësi të veçantë paraqitjen, nga çdo autor, të artikujve e trajtesave me referenca dhe “*footnote*” si dhe në fund të materialit të vendosë literaturën e shfrytëzuar. “*Footnote*” duhet të respektojnë në mënyrë korrekte rregullat kombëtare e ndërkombëtare ku të përfshihen; Mbiemri, emri (i autorit që i referohet), titulli i materialit të referimit, emri i entit botues, vendi i botimit, viti i botimit, numri i faqeve ku referohet, numri ISBN, *website*-in ku ndodhet artikulli. (p.sh. *Smith, James, Siguria në Shekullin e 21-të: Histori e panjohur. 2nd edition. New York, London: Oxford University Press, 2006. p..235, ISBN 0071448209, <http://www.iir.cz/display.asp?lng=uk&ida=>*).

Biografia: Së bashku me shkrimin, autori të dërgojë edhe një përshkrim të shkurtër biografik me rreth 100 fjalë ku të përfshijë: emrin, mbiemrin, gradën, pozicionin e punës, arsimimin, angazhimet kërkimore, fotografinë, numrin e telefonit dhe adresën elektronike.

Stili: Shkrimi duhet të paraqesë një strukturë të thjeshtë, duke përdorur tituj dhe nëntituj. Është e rëndësishme që në fund të shkrimit, autori ta mbyllë me disa përfundime dhe rekomandime të cilat duhet të jenë zgjidhje të propozuara për realitetin tonë.

Artikulli nuk duhet të përmbajë material të klasifikuar dhe duhet të zbatohet rregullat e klasifikimit të informacionit.

Artikulli nuk duhet të përmbajë ngjyrimë e as qëndrime politike apo partiake.

Për çdo informacion të mëtejshëm, mund të kontaktoni me:

Dega e Botimeve (Redaksia e RU), Qendra e Doktrinës, KDS

Mail: Komanda e Doktrinës dhe Stërviçjes, QD, Dega e Botimeve
Kutia Postare 24 23, Rruga e Dibrës, Tiranë, Shqipëri

Nr. Tel: 00355(4)23 63 465 ext. 516 /1195, 516/ 1159

Mobile: 0664050100/0664050220

Nr. Fax: 00355(4)23 69 179

Email: revistaushtarake@aaf.mil.al qdm@aaf.mil.al
ahmet.leka@aaf.mil.al silvana.markgjonaj@aaf.mil.al

Redaksia e Revistës Ushtarake

